



**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË DHE
FINANCIAR
NË
“UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A., DURRËS”**

MARS 2019

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	HYRJA	2
	a. Titulli	2
	b. Marrësi	2
	c. Objektivat dhe qëllimi	2
	d. Identifikimi i çështjes	2
	e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	2
	f. Përgjegjësitë e audituesve	3
	g. Kriteret e vlerësimit	3
	h. Standardet e auditimit	3
II.	PËRSHRIMI I AUDITIMIT	4
III.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	5
	Pika 1. Mbi realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimii mëparshëm.	5
	Pika 2. Mbi hartimin, shqyrtimin, zbatimin dhe raportimin e programit ekonomik - financiar.	22
	Pika 3. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese (Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori) dhe përputhshmëria ligjore e vendimeve të marra.	27
	Pika 4. Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënien e pagave dhe shpërblimeve.	38
	Pika 5. Mbi mbajtjen e evidencës kontabël, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, evidentimin, ndjekjen dhe pasqyrimin e debitorëve dhe kreditorëve, si dhe përlllogaritjen, njohjen, regjistrimin dhe pagesën e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore.	55
	Pika 6. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.	72
	Pika 7. Mbi auditimin me zgjedhje të pagesave të kryera me anë të arkës dhe bankës, shpenzimeve administrative dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve me vlerë të vogël.	118
	Pika 8. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit dhe funksionimi i auditit të brendshëm.	130
	Pika 9. Të ndryshme, që mund të dalin gjatë auditimit.	144
IV.	KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT	168



V.	ANEKSE	169
VI.	DOKUMENTE SHOQËRUESE	170

I. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH nr. 1189/1 prot., datë 25.10.2018, nga data 26.10.2018 deri më datën 28.12.2018, në subjektin “Ujësjiellës Kanalizime Sh.a., Durrës”, për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datë 31.10.2018, u krye auditimi “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” me përbërje:

1. E.Gj., Përgjegjës grupi,
2. B. D., Auditues,
3. I.H., Auditues,
4. A. R., Auditues.

a. Titulli: Raporti përfundimtar mbi auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së aktivitetit të “Ujësjiellës Kanalizime Sh.a., Durrës”.

b. Marrësi: Ujësjiellës Kanalizime Sh.A., Durrës, me Administrator z. S.K..

c. Objektivat dhe qëllimi: Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit, që Ujësjiellës Kanalizime Sh.A., Durrës, u ka bërë fondeve në dispozicion, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve, si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së shoqërisë.

Auditimi ka për qëllim *promovimin e transparencës* duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar siç kërkohet në aktet ligjore. Gjithashtu, projekti i auditimit ka për qëllim *promovimin e përgjegjshmërisë* ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese *dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre*.

Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik **duke marrë parasysht rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (sipas ISSAI 400, p 18)**.

Dhënia e opinionit nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore, si dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret. Raportimi mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit.

d. Identifikimi i çështjes: Insitucioni duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet.



e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të auditur lidhur me çështjen nën auditim: Këshilli Administrimit dhe Administratori i shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Sh.A., Durrës.

Strukturat drejtuese të UKD janë përgjegjëse për organizimin e duhur, funksionimin duke respektuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve, duke pasur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, efektivitet dhe eficensë.

f. Përgjegjësitë e audituesve: Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit për auditimin.

Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI dhe ISSAI, të cilat kërkojnë kryerjen e auditimit me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme, sipas evidencës së mbledhur gjatë auditimit.

Gjithashtu, janë respektuar kërkesat etike, si dhe është planifikuar dhe kryer auditimi, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

g. Kriteret e vlerësimit: Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin të Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI-t); Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC; Manualët e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH-së; Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për rregjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe ligje të tjera të fushës së ndërtimit; Ligji 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; Ligji 8102, datë 28.03.1996, i ndryshuar, ligji 8975, datë 21.11.2002, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”; Rregulloren e Brendshme të Institucionit; Udhëzimi nr. 906, datë 21.11.2011, dhe nr. 4, datë 14.06.2012 “Për zbatimin e VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës së dhënies me qira, enfiletozë, si dhe kontrata të tjera tëpasurisë shtetërore”; VKM nr. 1304, datë 11.12.2009; Udhëzimet e APP për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël; Statuti dhe rregullorja e brendshme e shoqërisë; si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore për çështje që do të trajtohen gjatë procesit, të cilat nuk janë parashikuar më sipër; akte të tjera ligjore dhe nënligjore, që janë të nevojshme; etj.

h. Standardet e auditimit:

-ISSAI100- (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik).

-ISSAI400- (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë).

-Kodi etik i KLSH.



II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Administrator i shoqërisë Ujësjellës Kanalizime SHA, Durrës, është Z. S.K..

Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit është rregullshmëria e operacioneve financiare të subjektit për periudhën nga data 01.01.2017 deri me datë 31.10.2018.

Objekti i përshkrimit të auditimit është dhënia e një opinionit nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret, si dhe mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko financiare në Ujësjellës Kanalizime Sha Durrës.

Metoda e auditimit është auditimim i njëpasnjëshëm, me zgjedhje, konkretisht:

- Përzgjedhja e auditimit për veprimet e kryera me bankë është kryer në mënyrë të njëpasnjëshme dhe me përzgjedhje, mbi vlerën e transaksioneve dhe dokumentacionit bashkëlidhur realizimit të kontratave,
- Procedurat e prokurimit janë audituar bazuar në rëndësinë e objektit të prokurimit, vlerës së fondit limit, riskut të zbatimit të kontratave, përqindjes së realizimit kundrejt fondit limit, numrit të operatorëve ekonomik pjesëmarrës, si dhe eksperiencës së punës audituese mbi fushat me risk në prokurimet publike, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si akteve nënligjore në zbatim të tij.



III. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Pika 1. Mbi realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të merren masa për përshtatjen e rregullores së brendshme dhe përfshirjen e detyrave dhe objektivave të të gjithë strukturës së miratuar.

Të përcaktohen rregullat në lidhje me komunikimin apo denoncimin e rasteve korruptive apo shkeljet dhe papërgjegjshmëritë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

-UKD nuk ka marrë masat përkatëse për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH për përshtatjen e rregullores së brendshme dhe përfshirjen e detyrave dhe objektivave të të gjithë strukturës së miratuar dhe rregullat në lidhje me komunikimin apo denoncimin e rasteve korruptive apo shkeljet dhe papërgjegjshmëritë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale. Si përfundim, u konstatua se rekomandimi i lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk është zbatuar.

2. Nga UK Durrës të hartohen dhe miratohen strategjia e riskut me qëllim realizimin e objektivave vjetor dhe strategjik. Mbi bazën e strategjisë së riskut të hartohet regjistri i riskut për çdo pjesë organizative të shoqërisë, si dhe plan veprimet për minimizimin e risqeve, në mënyrë që realizimi i objektivave të jenë në nivelet sa më optimale.

-Në bashkëpunim me Bashkitë, ku në zonat administrative të të cilave UK Durrës kryhen shërbimet dhe realizon funksionet e saja, të realizohet bashkërendimi i punës për organizimin e trajnimeve për stafin e UK Durrës në drejtim të implementimit të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, në lidhje me kërkesat e tij, duke përfshirë dhe rishikimin e sistemeve të brendshme të kontrollit, menaxhimin e riskut dhe kuptimin e tij, ngritjen e procedurave anti korrupsion sa më të efektshme, etj.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

-Titullari i Ujësjellës Kanalizime Durrës SH.A me urdhrin 2109/2, datë 07.08.2017, kangarkuar strukturat përkatëse të Shoqërisë për zbatimin e rekomandimeve. E vetmja strukturë që ka marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi është Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, e cila ka hartuar strategjinë e riskut dhe plan veprimet për minimizimin e risqeve.

3. Këshilli Administrativ i UK Durrës të analizojë me përgjegjshmëri arsyet e mosfunksionimit të kësaj strukture gjatë vitit 2016, për rrjedhojë dhe të moskryerjes së funksioneve të tija mbikëqyrëse dhe kontrolluese, si dhe të ndër marrë masa për ta kthyer strukturën e AB në strukturë funksionale dhe me kompetencë të plotë në realizimin e programeve të saja.

-Gjithashtu nga Këshilli i Administrimit, në vëmendje të funksioneve të tij, të jetë veprimtaria e



njësisë së auditimit të brendshëm si dhe rezultatet e auditimeve, me qëllim mbikëqyrjen dhe përmirësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, dhe realizimin e objektivave të shoqërisë, duke shfrytëzuar burimet njerëzore, materiale dhe financiare në mënyrë efektive.

Rekomandimi është realizuar pjesërisht.

Këshilli Administrativ i UK Durrës ka analizuar arsyet e mosfunksionimit të kësaj strukture gjatë vitit 2016, për rrjedhojë dhe të moskryerjes së funksioneve të tija mbikëqyrëse dhe kontrolluese, si dhe janë ndërmarrë masat nga ana e NJAB pranë UKD SH.A, duke përgatitur planin strategjik dhe vjetor dhe ja ka dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave me shkresën nr.2721/2, datë 18.10.2017 dhe për vitin 2018 i ka dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave me shkresën nr.1927/2 prot, datë 18.09.2018 për planin vjetor dhe strategjik për vetëm për NJAB për vitet 2019-2021. Si përfundim, ky rekomandim do të konsiderohet i realizuar pjesërisht për arsyen se, rekomandimi është realizuar vetëm nga Njësia e Auditimit të Brëndshëm në UKD sh.a. Nga ana e Këshillit të Administrimit nuk është marrë asnjë hap për zbatimin e këtij rekomandimi.

4. Nga departamenti i financës për llogarinë e klientëve, të bëhet rakordimi me departamentin e ndjekjes së debitorëve dhe diferencat e rezultuara të pasqyrohen në veprimet kontabile vijuese.

-Nga departamenti i financës të bëhet një vlerësim i arkëtimeve të klientëve për periudhën 2008-2014, të kryera deri në fund të 2016 dhe në bazë të përqindjes së provizionimit të klientëve në vitin 2013 dhe përqindjes së provizionimit të vitit 2014 të kryhen veprimet kontabël përkatëse.

-Nga administratori i shoqërisë në bashkëpunim me departamentin e ndjekjes së debitorëve të hartohet plan masash me afate konkrete në lidhje me identifikimin e të gjitha rasteve të klientëve jo ekzistencë, të dubluar apo pa shërbim të ofruar, si dhe hartimin e raportit përkatës për Këshillin e Administrimit për efekte të sistemimit dhe saktësimin të tyre në kontabilitet.

Rekomandimi është në proces.

-Nga departamenti i Financës në UKD sh.a, nuk është bërë vlerësimi i arkëtimeve të klientëve për periudhën 2008-2014, departamenti i Financës argumenton se arsye e zbatimit pjesërisht është kamata e cila rakordohet vetëm për në arkëtim por jo në faturim, gjithashtu mungesa e një analize mbi debitë e vjetra (vjetërsia e klientëve). Drejtoria Tregtare me shkresën 2916/1 prot, datë 08.11.2017 me lëndë “Mbi hartimin e Projekt Buxhetit 2018” i është drejtuar përgjegjësve të grupeve të task forcës për të evidentuar lidhjet e paligjshme, dhe për rastet e debitorëve etj. Meqë janë ndërmarrë këto hapa ky rekomandim do të konsiderohet në proces zbatimi.

5. Nga departamenti i financës të bëhet rakordim me Drejtorinë Tatimore në lidhje me vlerën e TVSH-së kreditore dhe të kryhen veprimet kontabël për sistemimin e diferencave të konstatuara.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

-Për mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2016 është bërë rakordimi ndërsa për sistemimin e diferencës nuk është realizuar në vitin 2017 dhe as në 2018 për arsye të mungesës së



dokumentacionit të dyanshëm për sistemimin e kësaj të fundit. Për këtë arsye rekomandimi do të konsiderohet i pazbatuar.

6. Nga drejtimi i shoqërisë të merren masa për plotësimin e regjistrit kontabël të shoqërisë për asetet dhe kryerjen e inventarizimit konform përcaktimeve në aktet në fuqi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

-Vështirësia në identifikimin e aktiveve të ardhur si vlerë në total me llogari kontabël e bën të vështirë identifikimin e aktivitetit me artikull duke u përplasur edhe me një prej parimeve kryesore të kontabilitetit për matjen e aktivitetit me vlerën e drejtë. Rivlerësimi i aktiveve do të ishte zgjidhja më e drejtë. Ndërkohë në daljet e materialeve nga magazina ose në rastin e shtrim linjash apo investimesh në dokumenta, nuk thuhet që linja apo materiali po zevëndesohet apo ndërrohet. Gjithashtu informacioni mbi grantet me buxhet shteti për aktive do të shërbente shumë në vlerësimin e aktiveve.

7. Nga drejtimi i shoqërisë të merren masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për marrjen e çertifikatave të pronësisë për pronat që UKD ka në zotërim.

Rekomandimi është në proces.

-Nga dokumentat e paraqitura nga UKD sh.a, u konstatua se rekomandimi është në proceszbatimi nga ana e UKD sh.a, duke kontraktuar shoqërinë "S. S. "K-SA" sh.p.k. E cila ka bërë plan rilevimet e të gjitha objekteve që UKD sh.a ka në përdorim. Gjithashtu është bërë kërkesa pranë ZRPP për pajisjen me çertifikatë pronësie për objektet që UKD sh.a ka në disponim. Ky rekomandim do të konsiderohet në proces.

8. Nga drejtimi i shoqërisë të merren masa për evidentimin kontabël sipas zërave dhe vlerave përkatëse të tyre në përbërje të vlerës totale të paraqitur në pasqyrat financiare, të regjistrit të aktiveve afatgjata materiale dhe paraqitjen me besueshmëri të tyre.

Rekomandimi është në proces.

-Vështirësia në identifikimin e aktiveve të ardhur si vlerë në total me llogari kontabel e bën të vështirë identifikimin e aktivitetit me artikull, duke u përplasur edhe me një mbi parimet kryesore të kontabilitetit për matjen e aktivitetit me vlerën e drejtë. Për këtë arsye në bashkëpunim me KreatX do të punohet për sistemimin e investimeve nga 2014 e në vazhdim për të hedhur në modulim e aktiveve për arsye se mund të analizojmë zërat për këto aktive në këto vite. Ndërsa për vitet më përpara do të ishte e nevojshme që shoqëria të bëjë një rivlersim të aktiveve, si edhe do të shërbente gjithashtu informacioni në mënyrë ligjore për grantet financiar nga shteti për investime ndër vite. Në Projekt Buxhetin 2018 është planifikuar për tu kryer rivlersimi i Aktiveve dhe ky rekomandim do të konsiderohet në proces.

9. Nga departamenti i financës të kryhen veprimet kontabilizuese në përputhje me SKK nr.5 në lidhje me investimet dhe riparimet që kryhen në tubacionet e ujësjellësve dhe kanalizimeve.

Rekomandimi është në proces.



-Vështirësia në identifikimin e aktiveve të ardhur si vlerë në total me llogari kontabël e bën të vështirë identifikimin e aktivitetit me artikull duke u përplasur edhe me një prej parimeve kryesore të kontabilitetit për matjen e aktivitetit me vlerën e drejtë. Rivlerësimi i aktiveve do të ishte zgjidhja më e drejtë. Me urdhërin nr. 2708/1 Prot, datë 26.09.2018 të nisë procedura e prokurimit me objekt "Rivlerësim i aktiveve të UKD". Në daljet e materialeve nga magazina ose në rastin e shtrim linjash apo investimesh në dokumenta, nuk përcaktohet që linja apo materiali po zevëndesohe tapo ndërrohet. Gjithashtu, informacioni mbi grantet me buxhet shteti për aktive do të shërbente shumë në vlerësimin e aktiveve. Duke filluar nga data 01.01.2017, Shoqëria po shikon me prioritet zbatimin regjistrimeve të aktiveve sipas standartit të kontabilitetit SKK nr.5.

10. Nga hartuesit e pasqyrave financiare të shoqërisë të merren masa për saktësimin e detyrimeve të shoqërisë, klasifikimin e saktë në detyrimet afatshkurtra dhe në afatgjata, si dhe korrigjimin e detyrimeve në valutë me kursin e fund vitit.

Nga UKD për paraqitjen në hartimin e pasqyrave financiare, të shifrave për detyrimet e identifikuar nga marrëveshjet e nën huave, të kryhet rakordimi me Ministrinë e Financave dhe ky proces, konform standardeve, të realizohet periodikisht.

Rekomandimi është zbatuar.

-Është mbyllur procesi i sistemimit të kredive në pasqyrat financiare të vitit 2016, si edhe është bërë aktrakordimi me Ministrinë e Financave sipas aktrakordimit me nr.1569/1, datë 23.06.2017.

11. Nga departamenti i financës të merren masa për saktësimin e vlerës së grandeve dhe kryerjen e veprimeve sipas standardeve në lidhje me të ardhurat nga grandit.

Rekomandimi është në proces.

-Në mbyllje e pasqyrave financiare të vitit 2016, janë sistemuar pjesërisht grantet për informacionin e mbledhur për kontratat e lidhura me furnitorë nga viti 2010 e në vazhdim. Në lidhje me grantet ndër vite ka patur parregullsi në mbajtjen e tyre qoftë edhe në njohjen e tyre në të ardhurat e shoqërisë për pjesën e amortizuar (konform rregullave dhe standarteve në fuqi) madje edhe për sistemimin e tyre nuk janë dhënë sqarime të hollësishme se mbi cilin grant janë bërë sistemimet. Për këtë arsye si edhe kohës në dispozicion shoqëria ka sistemuar parregullsitë për regjistrimin gabim të vitit 2014 dhe pjesërisht të vitit 2015, zgjidhja më e saktë do të ishte një aktrakordim me thesarin mbi kontratat e lidhura dhe të likuiduar nga thesari ndër vite, por kjo është e pamundur nga ana e tyre për shkak se Thesari bën rakordim vjetor, pra vetëm për shumatat që kalojnë atë vit dhe jo mbi financimet progresive. Për këtë arsye do të dërgohet shkresë Ministrisë së Financave për marrje informacioni mbi grantet e lëvruara ndër vite për UKD.

12. Nga departamenti i financës të merren masa për rakordimin e detyrimit me Drejtorinë Tatimore dhe korrigjimin e saj në pasqyrat financiare.

Rekomandimi është në proces.

-Nga sistemi i tatimeve është falur në vitin 2017 tatim fitimi 2010 -2012 për vlerën afro 23 milion



lekë. Pjesa tjetër është pjesa e njohur si “Tatim fitimi i shtyre”, i krijuar në regjistrat kontabël në vitin 2013 pa argumentimet përkatëse dhe për arsye kohe nuk është sistemuar në librat financiar të vitit 2016, por është lënë në vazhdim si prioritare për tu sistemuar.

13. Nga departamenti i financës të merren masa për sistemimin e vlerës 293,946,122 lekë duke e hequr nga llogaria e të ardhurave.

-Nga departamenti i financës të kryhen verifikimet e nevojshme në lidhje me këtë shumë.
-Duke u nisur nga fakti që në detyrime afatgjata shoqëria ka pasur kredi që janë marrë për investime në aktivet afatgjata materiale, klasa që mund t’i përkiste shuma përkatëse sa më sipër cituar, nëse nuk do të rezultonte nga analiza e mëtejshme, si detyrim, duhet të klasifikohet tek grandet, me identifikimin përkatës tek aktivet afatgjata materiale.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

-Pasi të bëhët rivlersimi i aktiveve nga UKD sh.a, do ti drejtohet Ministrise së Financave për marrje informacioni mbi grantet e lëvruara ndër vite për UKD sh.a. Ndarja e saktë e aktiveve të financuara me grante do të ndihmonte shoqërinë edhe në identifikimin e aktiveve të shoqërisë të financuara ndër vite. Për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar.

14. Nga drejtimi i shoqërisë të ndërmerren plan veprime afat shkurtra dhe afat gjata me përgjegjësi konkrete nga administrata e shoqërisë për përmirësimin e situatës së saj, me qëllim kthimin e kapitalit të shoqërisë në nivelet e kërkuara nga ligji, si dhe përmirësimin progresiv të performancës së saj në shërbim të popullatës.

Rekomandimi është në proces.

-Nga drejtimi i shoqërisë janë marrë masa për përmirësimin e situatës së saj, me qëllim kthimin e kapitalit të shoqërisë në nivelet e kërkuara nga ligji, si dhe përmirësimin progresiv të performancës së saj në shërbim të popullatës si: Plani i masave Task Forcë, Urdhërat e brendshëm për Buxhetin nr.2916, datë 08.11.2017, dërguar sektorëve të UKD SH.A.

15. Nga departamenti i financës të merren masa për kontabilizimin e kamatë vonesave në bazë të parimit të konstatimit të drejtave dhe detyrimeve.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

-Shoqëria UKD sh.a nuk ka marrë akoma asnjë vendim për kontabilizimin e kamatës, për këtë arsye rekomandimi do të konsiderohet si i pazbatuar.

16. Nga departamenti i financës të merren masa për korrigjimin e veprimeve të kryera tek zëri i të ardhurave nga grandit.

Rekomandimi është realizuar pjesërisht.

-Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2016 janë sistemuar grantet (pjesërisht) për informacionin e mbledhur për kontratat e lidhura me furnitore nga viti 2010 e në vazhdim. Në lidhje me grantet ndër vite ka patur parregullsi në mbajtjen e tyre qoftë edhe në njohjen e tyre në të ardhurat e shoqërisë për pjesën e amortizuar (konform rregullave dhe standarteve në fuqi).



Për këtë arsye, si edhe kohës në dispozicion shoqëria ka sistemuar parregullsitë për regjistrimin gabim të vitit 2014 dhe pjesërisht të vitit 2015. Zgjidhja më e saktë do të ishte një aktrakordim me thesarin mbi kontratat e lidhura dhe të likuiduar nga thesari ndër vite, por kjo është e pamundur nga ana e tyre për shkak se Thesari bën rakordim vjetor, pra vetëm për shumat që kalojnë atë vit dhe jo mbi financimet progresive. Nga verifikimi i dokumentacionit rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht për arsyen se standardi është aplikuar për vitet 2016, 2017 dhe për vitin 2018 është në proces. Për këtë arsye do të dërgohet shkresë Ministrisë së Financave për marrje informacioni mbi grantet e lëvruara ndër vite për UKD SH.A.

17. Nga departamenti i financës të merren masa për korigjimin e veprimeve të kryera tek të ardhurat dhe shpenzimet e periudhës.

Rekomandimi është zbatuar.

-Nga verifikimi i dokumentacionit u verifikua se është mbyllur procesi i sistemimit të kredive në pasqyrat financiare të vitit 2016 si edhe është bërë aktrakordimi me Ministrinë e Financave sipas aktrakordimit me nr. 8847/1 prot, datë 22.06.2017. Për vitin 2017 është bërë aktakordimi me Ministrinë e Financave sipas aktakordimit nr. 1306/1 prot, datë 06/06/2018. Në shtator të vitit 2018 Ministria e Financave ka sjellë njoftimin me nr.16295/1 Prot, datë 11.09.2018 “Mbi pagesën e detyrimeve për kredinë e financuar nga BEI për Projektin “Infrastruktura Ujore Bashkiake”.

18. Nga Drejtimi i shoqërisë të marren masa për aprovimin e normave menaxheriale, të mbështetura këto në studime dhe vlerësime për jetëgjatësinë e aktiveve afatgjata materiale nga specialistët e fushës dhe brenda limiteve ligjore.

Rekomandimi është në proces.

-Nga Janari 2017 çdo aktiv po hidhet sipas udhëzimit nr.30 mbi regjistrin e aktiveve por ka problematikë me aktivet e mbartura nga 2004 dhe në vazhdim, pasi janë mbajtur në vlerë totale dhe jo të detajuara. Për këtë arsye në bashkëpunim me KreatX po punohet për sistemimin e investimeve nga 2014 e në vazhdim për ti hedhur në modulën e aktiveve për arsye se mund të analizojmë zërat për këto aktive në këto vite. Ndërsa për vitet më përpara do të ishte e nevojshme që shoqëria të bëjë një rivlerësim të aktiveve, si edhe do të shërbente gjithashtu informacioni në mënyrë ligjore për grantet financuar nga shteti për investime ndër vite.

19. Në lidhje me kalimin në shpenzime të periudhes pjesë nga situacioni i punimeve për aktive e cila duhet të kalojë si vlerë totale në vlerën e aktivitetit.

Nga departamenti i financës të merren masa për korigjimin e veprimeve të kryera tek të ardhurat dhe shpenzimet e periudhës sipas citimeve në gjetjet sa mësipër.

Rekomandimi është zbatuar.

-Sa i përket kalimit të materialeve në kosto ndërkohë që janë aktive, janë bërë përparime në këtë aspekt duke filluar që nga viti 2017. Ndërsa në lidhje me furnitorët A.E., G. N. dhe F.A. janë veprime sistemuese që janë kryer në çeljen e vitit 2017 për veprimet e viteve të mëparshme.



20. Nga departamenti i financës të merren masa për korrigjimin e veprimeve të kryera tek shpenzimet e periudhës sipas standardit të mësipërm.

Rekomandimi është në proces.

-Janë marrë masat që në fund të vitit 2016 e në vazhdim dhe zbatimi i tyre evidentohet në raportimet progresive. I vetmi problem është mungesa e regjistrimit të aktiveve të viteve më përpara, mungesa e të cilit jep pamundësi në evidentimin e vlerës kontabël të tubacionit në të cilin po kryhet investimi. Ndërkohë, në punimet e sjella nga sektori i mirëmbajtjes në lidhje me investimet nuk është cituar që investimi në tubacion po ndërrohet, por arsyet e punimeve janë shtrirë linjash. Rivlersimi i aktiveve ndihmon në dhënien e një pasqyre të qartë të vlerës dhe identifikimit të aktivitetit. Nga ana e UKD sh.a është hapur prokurimi me objekt "Rivlersim i aktiveve të UKD" me nr. 2708/10 prot, datë 26.11.2018 dhe pritet pasi të bëhet rivlersimi i aktiveve, të bëhet dhe korrigjimi i veprimeve të kryera tek shpenzimet e periudhës. Për këtë arsye rekomandimi do të konsiderohet në proces zbatimi.

21. Nga nëpunësi zbatues dhe autorizues i shoqërisë të analizohet dokumentacioni i rezultuar nga procesi i inventarizimit. Të merren në analizë mangësitë e rezultuara nga ky proces dhe të nxirren dhe ndiqen përgjegjësitë për parregullsitë e kontatuara dhe mungesat materiale që do të saktësohen të tilla.

Nga nëpunësi zbatues me strukturat përkatëse të merret në analizë magazina mallra stok me vlerë 12,267,009 lekë, nga ku të rezultohet për veprimet në të ardhmen për këto mallra, konform legjislacionit, i cili akoma nuk është bërë.

Rekomandimi është realizuar pjesërisht.

-Nga Janari 2017 çdo aktiv po hidhet sipas udhëzimit nr.30 mbi regjistrimin e aktiveve por ka problematikë me aktivet e mbartura nga viti 2004 dhe në vazhdim, pasi janë mbajtur në vlerë totale dhe jo të detajuara. Për këtë arsye, në bashkëpunim me KreatX do të punohet për sistemimin e investimeve nga 2014 e në vazhdim për ti hedhur në modulën e aktiveve, për arsye se mund të analizojmë zërat për këto aktive në këto vite. Ndërsa për vitet më përpara do të ishte e nevojshme që shoqëria të bëjë një rivlerësim të aktiveve si dhe do të shërbente gjithashtu informacioni në mënyrë ligjore për grantet financuar nga shteti për investime ndër vite. Sa i përket kalimit të materialeve në kosto ndërkohë që janë aktive, janë bërë përparime në këtë aspekt duke filluar që nga viti 2017. Nuk janë marrë në analizë mangësitë e rezultuara nga ky proces dhe të saktësohen dhe të nxirren dhe ndiqen përgjegjësitë për parregullsitë e konstatuara dhe mungesat materiale që do të saktësohen të tilla. Ndërsa për të analizuar magazinat për mallra stok me vlerë 12,267,009 lekë nga ku të rezultohet për veprimet në të ardhmen për këto mallra, konform legjislacionit nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga ana e UKD sh.a. Për arsyet e cituara më lart, rekomandimi do të konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

22. Nga drejtimi i shoqërisë të merren masa për përditësimin dhe ndryshimin e manualit në përputhje me ndryshimet në strukturë dhe organikën e miratuar në datën 20.05.2016.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

-Titullari i UKD sh.a me urdhërin e brendshëm nr.2109 prot., datë 07.08.2017 ka urdhëruar



drejtoritë përkatëse për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH. Me shkresën nr. 2109/4 prot., datë 20.09.2017 drejtoria e burimeve njerëzore ka bërë kërkesë për përcaktimin e roleve dhe detyrave për secilin punonjës drejtuar drejtorive, degëve etj. Në këtë shkresë thuhet qartë se propozimet duhet të paraqitën pranë Degës së Burimeve Njerëzore brënda datës 15.12.2017. Në rast moszbatimi të këtij afati, ndaj drejtuesve të reparteve dhe sektorëve do të merret masë disiplinore. Nga verifikimi u konstatua se ky urdhër nuk është zbatuar nga asnjë prej drejtorive, reparteve, degëve apo sektorëve, gjithashtu u verifikua se nuk është ndërmarrë asnjë masë disiplinore për mos zbatimin e këtij urdhëri. Për të gjithë personat që nuk kanë zbatuar urdhërin e titullarit, të merren masa disiplinore për moszbatim urdhëri.

23. Të merren masa që të përfundojë dhe miratohet rregullorja e rekrutimit sipas kërkesave të vendeve të punës duke përcaktuar paraprakisht kriteret në lidhje formimin bazë profilin dhe nivelin arsimor, përvojën në punë, etj, për vendet vakante të punës. Rekrutimi I punonjësve kryhet conform proceduravetëvendosura nërregullore.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

-Pavarësisht urdhërit të nxjerrë nga administratori i UKD SH.A ku jep detyrat përkatëse drejtoriveqë të merren me hartimin e rregullores së rekrutimit të punonjësve, nuk kanë ndërmarrë hapat e duhur për të nisur procesin për përfundimin dhe miratimin e rregullores së rekrutimit sipas kërkesave të vendeve të punës duke përcaktuar paraprakisht kriteret në lidhje me formimin bazë, profilin dhe nivelin arsimor, përvojën në punë, etj, për vendet vakante të punës. Si përfundim, UKD sh.a nuk jep argumenta bindëse për mos marrjen e masave të duhura që rekomandimi i lënë nga KLSH nuk është zbatuar. Ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.

24. Nga UKD ti jepet fund praktikave të cilat rëndojnë akoma më shumë gjendjen financiare të shoqërisë të rezultuar me humbje dhe aq më tepër, kur indikatorët e performancës në terma vjetorë nuk janë arritur.

Tërheqja e vëmendjes nga titullari i UKD sh.a për indikatorët e pa arritur, dhe jo për shumën e dhëna në kundërshtim me aktet e miratuara, nuk justifikon shkeljen e konstatuar, kështu që nga Këshilli i Administrimit të merret në analize ky rast për efekte të nxjerrjes së përgjegjësive në këtë proces, si dhe vendimmarrjeve në drejtim të performancës negative të menaxherëve të lartë të UK Durrës.

Rekomandimi është zbatuar.

-Janë dhënë vërejtje me shkresën nr.736, datë 16.03.2017, për drejtuesit e sektoreve si dhe për vitin 2017, nuk është raportuar në nivel indikatorit për performancë shpërblimi.

25.UKD të marrë masa që në të ardhmen duke u bazuar dhe në vendimet e mëparshme të gjykatave të zbatohet me korrektësi kodin e punës për largimet nga puna.

Nga Drejtoria Juridike të shqyrtohen paraprakisht me përgjegjshmëri praktikat të cilat propozohen për largimet nga puna, me qëllim shmangien e humbjeve të proceseve ligjore, kur largimet nga puna kontestohen me rrugë ligjore. Ky funksion të shtohet specifikisht në detyrat



funksionale të kësaj drejtorie.

Rekomandimi është zbatuar.

-Nga verifikimi i dokumentacionit për të vërtetuar procedurën e ndjekur në rastet e largimit nga puna u konstatua se Dega juridike në bashkëpunim me Burimet Njerëzore ka marrë të gjitha masat lidhur me praktikën e rasteve të propozimeve për largim nga puna, duke zbatuar me korrektësi hap pas hapi këtë procedurë, konform Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë. Ky rekomandim do të konsiderohet i zbatuar.

26. Nga sektori i financës, në zbatim të akteve ligjore në fuqi, dokumentacioni origjinal i shpenzimit duhet të vihet bashkëlidhur urdhër shpenzimit, kjo dhe për efekt të transparencës dhe lehtësirave në drejtim të auditimit të likuidimeve për shërbimet dhe blerjet periodike të shoqërisë. Në rastet e likuidimeve pjesore, në fotokopjen e faturës origjinale duhet të shënohen referencat e urdhër pagesave të mëparshme dhe shumat përkatëse të likuidimit, si dhe informacioni se në cilën urdhër pagesë është vendosur dokumenti origjinal.

Rekomandimi është zbatuar.

-Sektori i financës pranë UKD, e ka realizuar këtë proces për vitin 2017, sipas rekomandimeve të KLSH.

27. Nga AK referuar dhe numrit të konsiderueshëm të punonjësve, të mjaftueshëm në Drejtorinë Juridike, të krijojë njësi prokurimi për blerjet me vlerë të vogël, që në fillim të vitit dhe me qëllim shmangien e riskut për gabimet në zbatim të legjislacionit, si dhe për efekt të specializimit dhe rritjes së nivelit profesional të punonjësve të njësisë të krijoj njësi prokurimi të qëndrueshme dhe të pandryshueshme gjatë vitit.

Rekomandimi është zbatuar.

28. Nga AK të shfuqizohet kompetenca e dhënë N/Z në drejtim të procesit të prokurimeve, si veprim në kundërshtim me ligjin dhe të ngarkojë NJPVV për përcaktimin e fondit limit apo strukturë tjetër konform kërkesave të ligjit.

-AK e ka në proces përmirësimin e procesit të prokurimeve konform kërkesave të ligjit për prokurimet publike.

Rekomandimi është në proces.

29. Nga Sektori i Financës të kryhet stornimi i veprimit nga regjistrimi i shumës së kontratës “Studim projektim ujësjellës në komunat Katundi i ri Rashbull, Ishëm” me vlerë kontrate 8,196,000 lekë regjistruar si shpenzim, në regjistrin e AQPT si aktiv, në zbatim të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit. Sa më sipër të kryhen veprimet kontabile përkatëse.

Rekomandimi është zbatuar.

-Veprimi është sistemuar në çelje të vitit 2017 më dt.02.01.2017 gjë e cila është shpjeguar edhe



nëpasqyrat financiare 2017 përkatësisht:

Debi: Llogaria 208004 "Të tjera AA jo-materiale-Studime, Projektme" 6'830'000 Lekë

Kredi: Llogaria 1080001 "Fitim/Humbje e pashpërndarë-Administrata" 6'830'000 Lekë

Kjo shumë duke qenë se është njohur shpenzim në vitet para Vitit 2017 rezultati i Fitim/humbje për ato vite është kaluar në llogarinë 1080001 "Fitim Humbje e pashpërndarë" dhe rimarrjen për ta sistemuar mund ta kryesh vetëm nëpërmjet asaj llogarie. Për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i zbatuar.

30. Nga UKD të realizohet procesi i planifikimit referuar arkëtimeve të mundshme dhe të argumentuara të të ardhurave dhe ai i shpenzimeve mbi bazën e aftësive paguese të shoqërisë për vitin përkatës.

- Të merren masa për pagesat e energjisë elektrike si pagesa prioritare dhe të hartohet plan veprimi për shlyerjen e detyrimeve të krijuara (borxhit të ri) nga mos pagesat e energjisë elektrike.

- Nga Këshilli i Administrimit të UK Durrës të merren në analizë penalizimet nga humbja e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna të punonjësve si dhe risqet e humbjeve të këtyre proceseve nga largimet e bëra gjatë viteve të fundit (2014, 2015, 2016) dhe të kihet parasysh këto tregues në vlerësimin e performancës së shoqërisë në bazë të mënyrës së menaxhimit të shoqërisë nga menaxhimi i lartë.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

- UKD SH.A. ka marrë masat e duhura për pagesat e energjisë elektrike si pagesa prioritare duke shlyer detyrimet për vitin 2017 me fondet e UKD sh.a, 21.412.431 lekë dhe me thesar 76.000.000 lekë. Për vitin 2018 UKD sh.a, ka bërë pagesat e energjisë elektrike me fondet e saj 257.934.850 lekë dhe më thesar 30.000.000 lekë. Nga Këshilli i Administrimit të UKD sh.a nuk janë marrë në analizë penalizimet nga humbja e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna dhe risqet e largimeve gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016.

31. Nga Drejtoria Ekonomike në zbatim të SKK të kalojë si aktive të qëndrueshme të trupëzuara të gjitha investimet në momentin e marrjes fillestare në dorëzim dhe vënies në shfrytëzim të aktivit.

- Për investimet të cilat janë ndërprerë, por ka vlera të likuiduara për situacione për punime të kryera dhe që nuk janë në proces gjyqësor apo ky ka përfunduar, pjesa e fondeve të likuiduar duhet të shtojë vlerën e aktivit (në rastet e rikonstruksioneve), ose të shtohet si aktiv i ri me vlerën që ka, kur ky rezulton si aktiv funksional. Në këtë proces duhet të ketë bashkëpunim dhe dhënie miratimi nga dega teknike, në lidhje me funksionin e aktivit.

Rekomandimi është realizuar pjesërisht.

- Rekomandimi është realizuar për AQT dhe investimet të cilat kanë përfunduar duke i kaluar nga aktive në proces në AQT dhe investime si edhe në vazhdim do të zbatohet praktika e njohjes si aktiv në momentin e marrjes në dorëzim nga i cili fillojmë të gjerojmë të ardhura. Rekomandimi konsiderohet në proces për ato investime të cilat janë ndërprerë, por ka vlera të likuiduara për institucione për punime të kryera dhe që nuk janë në proces gjyqësor apo kur procesi ka përfunduar. Ky proces do të kryhet në bashkëpunim dhe dhënie miratimi nga dega



teknike.

32. Drejtoria Ekonomike për një menaxhim më të mirë të fondeve në dispozicion, të tregohet e kujdesshme në drejtim të kërkesës së fondeve për detyrimet nga projekte të realizuara por të pa likuiduara, duke i qëndruar korrekt emërtimeve fillestare të projektit si dhe shumave reale të rezultuara të pa likuiduara. Në rastet e fondeve të vëna në dispozicion me pamundësi likuidimi, të kërkojë rialokimin e tyre për projekte të pa financuara akoma ose njoftimin për rikthimin e tyre në buxhetin e shtetit, në mënyrë që këto fonde të jenë efektive për projekte të tjera.

Rekomandimi është në proces.

-Ujësja e Kanalizime Durrës i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit me shkresën nr. 3349 prot., datë 29.12.2017 me kërkesë mbi tepricat e fondeve. Është kthyer përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 328/Iprot., datë 15.01.2018 ku sqaron se UKD sh.a duhet të paraqesë zyrtarisht kërkesën pranë degës së thesarit Durrës për anulimin e vlerës së plotë apo të pjesëshme të kontratave të konfirmuar dhe nga pala e tretë (operatori ekonomik). UKD sh.a akoma nuk i është drejtuar degës së thesarit Durrës me një shkresë zyrtare, dhe për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet si në proces zbatimi.

33. Nga N/A dhe N/Z i UK Durrës të përcaktohen rregulla të brendshme në lidhje me dokumentet e domosdoshme që duhet të ketë një praktikë e udhëtimit jashtë vendit, ku fatura e hotelit duhet të jetë e identifikuar në mënyrë të veçantë konform kërkesave të akteve në fuqi.

-Referuar rregullave të prokurimit publik blerja e biletave të udhëtimeve jashtë vendit, të realizohet me procedurë prokurimi, marrëveshje kuadër.

Rekomandimi është realizuar pjesërisht.

-UKD sh.a nuk kanë një rregullore të brendshme në lidhje me dokumentat e domosdoshme që duhet të ketë një praktikë udhëtimi jashtë vendit, ku fatura e hotelit duhet të jetë e identifikuar në mënyrë të veçantë konform kërkesave të akteve në fuqi. Nga verifikimi i dokumentacionit të rasteve të udhëtimeve jashtë vendit, u konstatua se në një udhëtim jashtë vendit përkatësisht në Budapest në vitin 2017, nuk ndodhën boarding pass gjithashtu dhe fatura e hotelit nuk tregon shumën e paguar për netët e qëndrimit, por është marrë si ofertë e plotë dhe jo e detajuar. Ndërsa nga verifikimi i një udhëtimi jashtë vendit përkatësisht në Valencia Spanjë është zbatuar praktika e udhëtimit duke paraqitur boarding pass dhe fatura e hotelit. Rekomandimi do të konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

34. Të ndërpritët faturimi i deritanishëm për tarifën e kolaudit të matësve të rinj, detyrim në bazë të ligjit sa më sipër cituam, i furnitorit.

Nga Drejtoria Ekonomike, hap pas hapi të ndiqen politika të kujdesshme dhe të miratohen tarifa shërbimi mbi faturime të argumentuara, gjithnjë mbi baza reale dhe ku baza e argumentit duhen të jenë kostot e shërbimit.

Rekomandimi është realizuar pjesërisht.



-UKD sh.a, ka ndërprerë tarifën e kolaudimit për matësata e rinj. UKD sh.a ka dalë me vendimin e Këshillit të Administrimit për çmimin e matësave të rinj të ardhura nga Projekti i Bankës Botërore si edhe një sërë tarifash të tjera për pika lidhjeje. Por nga ana e Drejtorisë Ekonomike, nuk janë ndjekur politika të kujdesshme dhe të miratohen tarifa shërbimi mbi faturime të argumentuara. Për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i realizuar pjesërisht për arsye se rekomandimi i lënë nga ana e KLSH-së nuk është zbatuar i plotë.

35. Nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë të merrren masat për shfuqizimin e akteve që bien ndesh me konstatimet e grupit të auditimit. Gjithashtu emërimet e personave të cilët ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të prokurimit të kryhen konform legjislacionit në fuqi.

Rekomandimi është në proces.

-Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë ka marrë masat për zbatimin e rekomandimeve të lëna me urdhrat nr.2109, datë, datë 07.08.2017, nr.2109/1, datë 07.08.2017, nr.2109/2, datë 07.08.2017, nr.2109/3, datë 07.08.2017 të Titullarit dhe për çdo rekomandim të lënë ka ngarkuar strukturat përkatëse të Shoqërisë për zbatimin e tyre.

36. Nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë dhe nëpunësi i caktuar me delegim funksionesh me qëllim realizimin e disa prej kompetencave të tij, të marren masat e duhura me qëllim që delegimi i kompetencave të bëhet tek strukturat e duhura dhe për ato kompetenca që lejon ligji.

Rekomandimi është realizuar.

-Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë ka marrë masat për zbatimin e rekomandimeve të lëna me urdhrat nr.2109, datë, datë 07.08.2017, nr.2109/1, datë 07.08.2017, nr.2109/2, datë 07.08.2017, nr.2109/3, datë 07.08.2017 të Titullarit dhe për çdo rekomandim të lënë ka ngarkuar strukturat përkatëse të Shoqërisë për zbatimin e tyre.

37. Nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë dhe strukturat mbështetëse të tij të merren masat e duhura, që të kryejnë procedura prokurimi jo vetëm duke u nisur nga nevojat të cilat në çdo rast duhet të jenë listuara si prioritare, por gjithnjë planifikimi i shpenzimeve të ketë në balancë dhe mundësitë financiare, me qëllim sigurimin e performancës së shoqërisë mbi bazën e një menaxhimi optimal e maksimal të burimeve njerëzore dhe financiare të saj.

Rekomandimi realizuar pjesërisht.

-Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë ka marrë masat për zbatimin e rekomandimeve të lëna me urdhrat nr.2109, datë, datë 07.08.2017, nr.2109/1, datë 07.08.2017, nr.2109/2, datë 07.08.2017, nr.2109/3, datë 07.08.2017 të Titullarit dhe për çdo rekomandim të lënë ka ngarkuar strukturat përkatëse të Shoqërisë për zbatimin e tyre.

38. Nga departamenti i financës të merren masa për hartimin e Planit Operacional dhe Financiar mbi njëjtat politika kontabël me të cilat shoqëria harton pasqyrat financiare. Në këtë mënyrë zbatimi i planit operacional e financiar është më real dhe mbështet në mënyrë optimale shpenzimet e planifikuara.



Rekomandimi është në proces zbatimi.

-Në buxhetin e 2017-2018 amortizimi është përlllogaritur mbi koston e mbetur të aktivitetit si edhe mbi hyrjen e aktiveve të reja të parashikuara në buxhet. Shpenzime financiare qëkonsistojnë kryesisht për shpenzimet e interesit dhe kamatvonesat e kredive si edhe humbjet nga kursi i këmbimit të kredive për 2016 janë regjistruar në pasqyrat financiare ndryshe nga vitit 2015 si edhe do regjistrohen edhe në pasqyrat financiare të vitit 2017. Shoqëria UKD sh.a ka hartuar Planin Operacional Financiar dhe për vitin 2018, nuk ka përlllogaritur provizione të llogarive të arkëtueshme, për arsye të pamundësisë për të hartuar një analizë të hollësishme për provizionin si edhe duke patur parasysh faktin që vlera Fakt e tyre në mbyllje të viteve të fundit ka qenë zero. Në këtë mënyrë zbatimi i planit operacional e financiar është më real në krahasim me shpenzimet e planifikuara.

39. Nga organet drejtuese dhe drejtimi i shoqërisë UKD të merren masa për hartimin e Planit Operacional dhe Financiar bazuar në parashikime reale, duke vlerësuar periudhat e mëparshme dhe të argumentuara për ndryshimet e kryera.

Rekomandimi është në proces zbatimi.

-Nëbuxhetin e 2017 amortizimiështëpërlllogariturmbikoston e mbetur tëaktivitsiedhembihyrjen e aktivevetërejatëparashikuara në buxhet. Shpenzime Financiare që konsistojnë kryesisht për shpenzimet e interesit dhe kamatvonesat e kredive si edhe humbjet nga kursi i këmbimit të kredive për 2016 janë regjistruar në pasqyrat financiare ndryshe nga 2015. Mbi provizionet e llogarive të arkëtueshme shoqëria duke u bazuar edhe tek humbjet ligjore (vendime gjyqesh) për faturim të padrejtë kanë konsistuar të gjitha për periudhat të cilat ka patur provizionim, pra LLA të herëshme dhe jo për vitet aktuale dhe për këtë arsye nuk është provizionuar në fund të vitit. Drejtoria Ekonomike, në bashkëpunim ndërmjet departamenteve në UKD SH.A është në proces të hartimit të projektbuxhetit të vitit 2018 dhe në fokus ka menaxhimin më të mirë të fondeve në dispozicion.

40. Nga drejtimi i shoqërisë UKD të përdoren të gjitha rrugët ligjore për rritjen e arkëtimit nga faturimet e kryera të shoqërisë. Gjithashtu shoqëria të rrisë nivelin e faturimeve kundrejt pakësimit të humbjeve nga lidhjet e paligjshme dhe humbjet në rrjet.

Rekomandimi është në proces.

-Gjatë vitit 2017 janë ngritur grupet task forcë për marrjen e masave si dhe janë përcaktuar rolet, detyrat dhe përgjegjësitë. Kanë vijuar edhe shkresat në hartimin e projekt buxhetit për vitin 2018.

41. Nga drejtimi i shoqërisë UKD të merren masa që procesi i planifikimit të programit ekonomik financiar, të mos jetë një proces formal me synimin e vetëm për krijimin e balancave për shpenzimet e planifikuara, por një proces mbi bazën e burimeve reale dhe të mundshme të shoqërisë, për një performancë të garantuar, referuar realizimit të treguesve.



Rekomandimi është në proces.

Drejtoria Ekonomike, në bashkëpunim ndërmjet departamenteve në UKD sh.a është në proces të hartimit të projektbuxhetit të vitit 2018 dhe në fokus ka menaxhimin më të mirë të fondeve në dispozicion.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Nga Drejtoria Ekonomike dhe Dega e Shitjes, për çdo muaj të kryhen rakordimet përkatëse të abonentëve aktiv me sasinë e faturave që printohen duke mbajtur aktet përkatëse.

*Nga administratori i UK Durrës të analizohet ky proces, të nxirren përgjegjësitë, të ndiqen procedurat e nevojshme administrative duke kaluar të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit në vlerën **266,221 lekë**, nga strukturat të cilat janë përgjegjëse për procesin e këtij rakordimi dhe kontrollit të tij.*

Rekomandimi nuk është zbatuar.

-Nga ana e administratorit të UKD sh.a nuk është analizuar ky proces dhe gjithashtu nuk janë nxjerrë përgjegjësit për dëmin e shkaktuar prej 266,221 lekë. U konstatua se nuk është ndërmarrë asnjë rrugë administrative duke kaluar të gjitha shkallët e gjykimit për dëmin e shkaktuar. Përderisa nuk është ndërmarrë asnjë vendim nga ana e drejtimin të UKD sh.a lidhje me këtë çështje, rekomandimi do të konsiderohet i pazbatuar.

*2. Nga struktura e Auditimit të Brendshëm të UKD-së të ndiqet plotësimi i praktikave me dokumentacionin e domosdoshëm justifikues të shërbimit dhe në pamundësi të vendosjes së këtij dokumentacioni, të rekomandohet ndjekja e rrugëve ligjore për arkëtimin e shumave prej **450 \$** dhe **711 Euro** në llogari të shoqërisë.*

Rekomandimi nuk është zbatuar.

-Dokumentacioni i paraqitur nga ana e subjektit nuk justifikon shumat e lartpërmendura, përkatësisht 450 dollarë dhe 711 euro. U konstatua se nuk është ndërmarrë asnjë hap ligjor për arkëtimin e këtyre shumave në llogarinë e shoqërisë UKD sh.a siç është rekomanduar nga ana e KLSH-së. Për këtë arsye ky rekomandim do të konsiderohet i pazbatuar.

C. MASA DISIPLINORE

“Paralajmërim për pushim nga puna” për:

1. Znj. M.H., në cilësinë e anëtares së Njesisë së Prokurimit

Me shkresën nr. 167/1 prot., datë 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore “Paralajmërim me shkrim për zgjidhje kontrate.

Rekomandimi është realizuar.

2. Znj. F.K., në cilësinë e anëtares së Njesisë së Prokurimit,



*Me shkresën nr. 1167/2 prot., datë 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore “**paralajmërim me shkrim për zgjidhje kontrate**”.*

Rekomandimi është realizuar.

3. Z. D.Gj., në cilësinë e anëtarit të KVO, me shkresën nr. 1166 prot., 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore “**Paralajmërim me shkrim**”.

Rekomandimi është realizuar.

4. Z. A.I., në cilësinë e anëtarit të KVO, me shkresën nr. 1166/2 prot., datë 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore “**Paralajmërim me shkrim**”.

Rekomandimi është realizuar.

5. Z. O.K., në cilësinë e anëtarit të KVO, me shkresën nr. 1167/3 prot., datë 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore “**Paralajmërim me shkrim për zgjidhje kontrate**”.

Rekomandimi është realizuar.

6. Znj. D.Sh., në cilësinë e anëtarit të KVO, me shkresën nr. 1167/4 prot., datë 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore “**Paralajmërim me shkrim për zgjidhje kontrate**”.

Rekomandimi është realizuar.

7. Z. M.U., në cilësinë e anëtarit të KVO, me shkresën nr. 1167/8 prot., datë 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore “**Paralajmërim me shkrim për zgjidhje kontrate**”.

Rekomandimi është realizuar.

8. Z. L.F., në cilësinë e anëtarit të KVO, me shkresën nr. 1167/7 prot., datë 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore “**Paralajmërim me shkrim për zgjidhje kontrate**”.

Rekomandimi është realizuar.

9. Z. D.Sh., në cilësinë e anëtarit të KVO, me shkresën nr. 1167/6 prot., datë 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore “**Paralajmërim me shkrim për zgjidhje kontrate**”.

Rekomandimi është realizuar.

10. Z. E.M., në cilësinë e anëtarit të KVO, me shkresën nr. 1167/5 prot., datë 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore “**Paralajmërim me shkrim për zgjidhje kontrate**”.

Rekomandimi është realizuar.

11. Z. L.C., në cilësinë e anëtarit të KVO, me shkresën nr. 1167 prot., datë 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore “**Paralajmërim me shkrim për zgjidhje kontrate**”.

Rekomandimi është realizuar.

12. Znj. N.D., në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjës në dorëzim të furnizimeve, me shkresën nr. 1166/12 prot., datë 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore “**Paralajmërim me shkrim për zgjidhje kontrate**”.

Rekomandimi është realizuar.



13. **Z. G.D.**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjës në dorëzim të furnizimeve, me shkresën nr. 1166/11 prot., datë 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore **“Paralajmërim me shkrim për zgjidhje kontrate”**.

Rekomandimi është realizuar.

14. **Znj. S.R.**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjës në dorëzim të furnizimeve, me shkresën nr. 1166/13 prot., datë 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore **“Paralajmërim me shkrim për zgjidhje kontrate”**.

Rekomandimi është realizuar.

“Vërejtje me shkrim” për:

1. **Z. G.S.**, në cilësinë e anëtarit të KVO, me shkresën nr. 1166/7 prot., datë 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore **“Vërejtje me shkrim”**.

Rekomandimi është realizuar.

2. **Z. Gj. K.**, në cilësinë e anëtarit të KVO, me shkresën nr. 1166/8 prot., datë 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore **“Vërejtje me shkrim”**.

Rekomandimi është realizuar.

3. **Znj. Q.Q.**, në cilësinë e anëtarit të KVO, me shkresën nr. 1166/9 prot., datë 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore **“Vërejtje me shkrim”**.

Rekomandimi është realizuar.

4. **Z. E.E.**, në cilësinë e anëtarit të KVO, me shkresën nr. 1166/10 prot., datë 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore **“Vërejtje me shkrim”**.

Rekomandimi është realizuar.

5. **Z. A.Zh.**, në cilësinë e anëtarit të KVO, me shkresën nr. 1166/2 prot., datë 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore **“Vërejtje me shkrim”**.

Rekomandimi është realizuar.

6. **Znj. R.P.**, në cilësinë e anëtarit të KVO, me shkresën nr. 1166/3 prot., datë 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore **“Vërejtje me shkrim”**.

Rekomandimi është realizuar.

7. **Z. E.S.**, me shkresën nr. 1166/4 prot., datë 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore **“Vërejtje me shkrim”**.

Rekomandimi është realizuar.

8. **Znj. E.K.**, me shkresën nr. 1166/6 prot., datë 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore **“Vërejtje me shkrim”**.

Rekomandimi është realizuar.

9. **Z. B.C.**, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të verifikimit të inventarit fizik, me shkresën nr. 1166/5 prot., datë 21/04/2016 është dhënë masa disiplinore **“Vërejtje me shkrim”**.



Rekomandimi është realizuar.

Argumenta dhe shpjegimenga subjekti i audituar, lidhur me akt konstatimin:

Në observacionin e dërguar me shkresën nr. 56/1 prot., datë 10.01.2019, protokolluar pranë UKD sh.a, nga S. K., D. Gj., G. D., F. K. dhe G. S. në lidhje me akt-konstatimin nr. 1, datë 28.12.2018, në të cilin citohet se:

1-“.....Masa organizative.....rekomandimi nr.1, 4, 5, 6, 8.....rekomandimi nr.9, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 18, 20, 21.....rekomandimet nr.23, 30, 31, 32, 33, 34, 38,39,40,41....”;

2-“.....Masa organizative.....rekomandimi nr. 37.....”;

3-“.....Masa shpërblim dëmi.....rekomandimi nr. 1 dhe rekomandimi 2....”;

Sqarime nga grupi i auditimit të KLSH-së, lidhur me akt konstatimin:

-Lidhur me pretendimet për rekomandimet nr.1, 4, 5, 6, 8,9, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 18, 20, 21,23, 30, 31, 32, 33, 34, 38,39,40,41 sqarohet se nuk merren në konsideratë pasi dokumentacioni i paraqitur në observacione është audituar njëherë nga audituesit. Gjithashtu nuk keni paraqitur dokumenta të reja ligjore që të vërtetojnë të kundërtën e akt konstatimit nr. 1.

-Lidhur me pretendimin për rekomandimin nr. 37, sqarohet se pretendimi juaj merret në konsideratë pasi keni sjellë dokumenta mbështetëse ligjore që vërtetojnë pretendimin tuaj. Për këtë arsye observacioni merret në konsideratë dhe rekomandimi do të konsiderohet i ezauruar.

-Lidhur me pretendimin për rekomandimet 1 dhe 2 në masat shpërblim dëmi, pretendimet nuk merren në konsideratë për arsye se dokumentacioni i paraqitur nuk justifikon mos arkëtimin e shumës.

Referuar observacioneve të dërguara nga UKD nr. 417 prot., datë 21.02.2019, protokolluar në KLSH nr. 1189 prot., datë 25.02.2019, konstatohet se AK nuk ka dërguar dokumentacion që të provojë dhe vërtetojë të kundërtën e konstatimit. Arstetimet dhe shpjegimet e dhëna, nuk gjenden të bazuara në ligj.

Pika 2.Mbi hartimin, shqyrtimin, zbatimin dhe raportimin e programit ekonomik - financiar.

-Programet ekonomik-financiare për vitet 2017 dhe 2018 janë hartuar duke u bazuar në realizimet e treguesve të viteve paraardhës, mundësive reale si dhe mbi realizimin e pritshëm të vitit ushtrimor.

Titulli i gjetjes: *Ndryshim i buxhetit të aprovuar nga AP prej KA, në kundërshtim me kompetencat e tij.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A. DURRËS

Situata: KA me Vendim nr. 26/1, datë 18.12.2017, “Për rialokimin e fondit 1,452,361.03 lek pa TVSH, dhe ndryshim e fondit për prokurimin “Shërbim i ruajtjes me roje private të UKD SHA”, ka ndryshuar pa një aprovim të AP.

Kriteri: Sipas përcaktimeve të VKM 63, datë 27.01.2016, neni 12, pika 3, gërma (c).

c) Të gjykojë paraprakisht biznesplanin e shoqërisë, të paraqitur nga administratori. Ky dokument duhet të miratohet e të nënshkruhet nga të gjithë e anëtarët e Këshillit të Administrimit për t’iu paraqitur Asamblesë së Përgjithshme për miratim;

KA miraton planbiznesin, dhe ja paraqet për ndryshim AP.

Shkaku: Është marrë kompetencë e AP nga KA.

Efekti: Vendimi dhe pasojat e tij janë nul.

Rëndësia: E lartë.

Observacion:

UKD SHA për akt konstatimin; Me observacionin nr. 56/3 datë 10.01.2019, pretendon se Ky vendim ka qenë i imponuar nga një VKM për pagën minimale, që rrejdhimisht ndryshonte fondet.

Audituesi për akt konstatimin: Shoqëria në observacionin esaj nuk ka asnjë shprehje mbështetëse se ka një lejim ligjor për miratimin e ndryshimit të buxhetit. Ndryshimi i destinacioni të fondeve është në fund të fundit ndryshim buxheti. Nga ana tjetër, AP me aksioner të vetëm Bashkinë Durrës, është mbledhur në datën 27.12.2017, pra 9 ditë më pas, dhe ky ndryshim kompetencë e saj, nuk është paraqitur në AP, pavarësisht legjitimitetit të AP, të cilën KA nuk mund ta dinte para se kjo të mbledhjet në mbledhjen e thirrur.

Observacioni i dërguar për projekt raportin nr. 417 prot., datë 21.02.2019 nuk qëndron dhe si i tillë, nuk merret në konsideratë, pasi gjendet i pabazuar në ligj.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: *Administratori, Kryetar i KA, dhe Zëvendës Kryetar i KA.*

Për vitin 2017, me shkresën nr. 2409/3 Prot., datë 02.12.2016 administratori i UKD sh.a i është drejtuar Kryetarit të Këshillit të UKD sh.a për “Planin Operacional dhe Financiar 2017”. Me vendimin nr. 16 prot., datë 16.12.2016 Këshilli i Administrimit të UKD sh.a ka miratuar Planin Operacional dhe Financiar për vitin 2017. Me shkresën nr. 16/1 Prot., datë 16.12.2016 Kryetari i Këshillit të Administrimit i ka propozuar Asamblesë së Aksionarëve “Planin Operacional dhe Financiar 2017” për miratim. Me vendimin nr. 8 prot., datë 23.12.2016, Asambleja e Aksionarëve të UKD sh.a ka miratuar Planin Operacional dhe Financiar të vitit 2017.

Të ardhurat e realizuara për vitin 2017 **1,242,785,734 lekë**, dhe janë planifikuar **1,323,573,500lekë**, pra janë realizuar në masën **93 %**.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave për vitin 2017. (Në lekë).

Nr	Zërat e të ardhurave	Plani 2016	Plani Rishikuar 2017	Realizimi 2017	% realizimit
1	Të ardhura ujë kanalizime	806,336,322	961,012,619	851,982,403	88



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS
KANALIZIME SH.A. DURRËS

2	Të ardhura nga sherbime (Kontrata, Ndërrim emri, Pikë lidhje, Shitje Matësash, Azhornim rrjeti, Autobot)	45,000,000	50,000,000	50,371,191	100
3	Të ardhura nga kamatvonesa	12,700,000	14,150,000	14,149,866	99
4	Të ardhura nga proçese gjyqsore, gjoba, penaltite	0	0	103,440	-
5	Të ardhura nga Grante/amortizim grante Projekti BB; Të ardhura amortizim grante të tjera qeveritare	5,570,000	10,100,000	21,355,813	211
6	Të ardhura të tjera(interesa bankare, këmb. valute, kom.bashkia ardhura amortizim granteve, grante qeveritare)		-	228,823,021	-
7	Të ardhura nga Subvencionet	73,000,000	288,310,881	76,000,000	26
	TOTALI	942,606,322	1,323,573,500	1,242,785,734	93

-Zërat që kanë ndikur në rritjen e të ardhurave për vitin 2017 janë zëri të ardhura nga grante e cila në buxhetin e rishikuar 2017 është planifikuar të jetë 10,100,000 lekë, por ka sjellur të ardhura në shumën 21,355,813 ose në masën 110% më shumë nga planifikimi. Ky ndryshim në realizim kundrejt parashikimit ka ardhur si pasojë e përfitimit të një tjetër granti, pas miratimit të ndryshimit të fundit të plan biznesit. Zëri të ardhura të tjera që përfshin **“Interesa bankare, kembim valute, komision bashkia etj”** është planifikuar që të ardhurat nga ky zë të jenë **0 lekë**, por ky zë ka sjellë për vitin 2017 një vlerë prej **228,823,021 lekë** të ardhura.

Nga zërat e të ardhurave që nuk janë realizuar sipas parashikimit janë:

-Zëri **“Të ardhura nga uji kanalizimime”** është planifikuar të jetë në shumën **961,012,619 lekë** dhe është realizuar në shumën **851,982,403 lekë** ose në masën **88%**. Zëri **“Të ardhura nga Subvencionet”** është planifikuar të jetë në shumën **288,310,881 lekë** dhe është realizuar në shumën **76,000,000 lekë** ose në masën **26%**.

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2017. (Në lekë)



Nr.	Zërat e shpenzimeve	Plani 2016	Plani Rishikuar 2017	Realizimi 2017	% Realizimit
1	Shpenzime për material të para	137,000,000	168,770,000	116,852,406	69
2	Materiale projekti Banka Boterore	-	-	11,251,530	-
3	Blerje Ujë me shumicë	9,800,000	12,000,000	12,666,200	105
4	Energji elektrike	505,000,000	510,000,000	572,071,720	112
5	Karburant	28,000,000	37,000,000	33,651,254	90
6	Kimikate	5,900,000	6,000,000	5,501,430	91
7	Sherbime riparimesh O&M	12,800,000	25,800,000	16,956,862	65
8	Sherbime roje	13,100,000	15,000,000	13,357,547	89
9	Sherbime të përgjithshme Shitje	13,200,000	16,215,000	12,062,009	74
10	Sherbime përgjith. administrative	25,000,000	36,430,000	22,078,227	60
11	Shpenzime për Personelin	333,671,500	352,684,145	321,294,826	91
12	Tatime Taksa	6,500,000	8,000,000	9,312,880	116
13	Gjoha, Penalitete, Dëmshpërblime	15,000,000	10,000,000	13,459,773	134
14	Shpenzime Financiare	40,000,000	40,000,000	52,531,511	131
15	Provizione llogarive të arkëtueshme	60,000,000	35,868,100	0	-
16	Shpenzime amortizim, zhvlerësim	45,000,000	60,000,000	55,409,348	92
	TOTALI	1,249,971,500	1,333,767,245	1,268,457,522	95

-Siç del nga pasqyra e mësipërme, disa nga zërat e shpenzimeve janë tejkaluar nga parashikimi i bërë në fillim të vitit. Më specifikisht zëri **“Shpenzime Banka Botërore”** është planifikuar që nuk do ketë shpenzime, por në fund të 2017 rezultoi të jetë në shumën **11,251,530 lekë**, Zëri **“Blerje uji me shumicë”** planifikuar **12,000,000 lekë** dhe realizuar **12,666,200 lekë** ose në masën **5%** mbi planifikimin. Zëri **“Energji Elektrike”** planifikuar **510,000,000 lekë** dhe realizuar **572,071,720 lekë** ose në masën **12%** më tepër, Zëri **“Tatim Taksa”** planifikuar **8,000,000 lekë** dhe realizuar **9,312,880 lekë** ose në masën **16%** më tepër. **“Gjithashtu zëri Gjoha, Penalitete”** është realizuar **34%** më shumë dhe **“Shpenzime Financiare”** është realizuar në masën **31%** më shumë.

Për vitin 2018, me shkresën nr. 2645/2 Prot., datë 17.09.2018 administratori i UKD sh.a ka miratuar “Rishikimin e Planin Operacional dhe Financiar 2018”. Me shkresën nr. 2645/3 Prot., datë 17.09.2018, i është drejtuar Këshillit të Administrimit për “Rishikimin e Planin Operacional



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS
KANALIZIME SH.A. DURRËS

dhe Financiar 2018”. Me vendimin nr. 13/1prot., datë 18.09.2018 Këshilli i Administrimit të UKD sh.a ka miratuar Planin Operacional dhe Financiar për vitin 2018 Me vendimin nr. 6/1 Prot., datë 21.09.2018, Asambleja e Aksionarëve të UKD sh.a ka miratuar Planin Operacional dhe Financiar të vitit 2018.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave për vitin 2018.(Në lekë)

Nr	Zërat e të ardhurave	Realizimi 2017	Plani Rishikuar 2018	Realizimi 10M 2018	% realizimit
1	Të ardhura ujë kanalizime	851,982,403	1,093,441,537	891,553,888	81
2	Të ardhura nga shërbime(Kontrata, Ndërrim emri, Pikë lidhje, Shitje Matësash, Azhornim rrjeti, Autobot)	50,371,191	96,834,908	86,740,667	89
3	Të ardhura nga kamatvonesa	14,149,866	21,267,613	17,219,058	80
4	Të ardhura nga proçese gjyqsore, gjoba, penaltete	103,440	0	0	0
5	Të ardhura të tjera(interesa bankare, këmb. valute, kom.bashkia ardhura amortizim granteve, grante qeveritare)	228,823,021	1,000,000	74,025,326	
6	Të ardhura nga Grante/amortizim grante Projekti BB; Të ardhura amortizim grante të tjera qeveritare	21,355,813	7,000,000	55,050,000	
7	Të ardhura nga Subvencionet	76,000,000	150,000,000	0	0
	TOTALI	1,242,785,734	1,369,544,058	1,124,588,939	82

Siç del nga pasqyra e mësipërme të ardhurat e realizuara për *10 mujorin e vitit 2018* të UKD sh.a, janë si më poshtë:

Zëri *“Të ardhura ujë dhe kanalizime”*, është planifikuar *1,093,441,537 lekë*, dhe është realizuar *891,553,888 lekë* ose në masën *81%*. Zëri *“Të ardhura nga shërbime”*, është planifikuar *96,834,908 lekë*, dhe është realizuar *86,740,667 lekë* ose në masën *89%*. Zëri *“Të ardhura nga*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS
KANALIZIME SH.A. DURRËS

kamatëvonesa”, është planifikuar **21,267,613lekë**, dhe është realizuar **17,219,058lekë** ose në masën **80%**.

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2018. (Në lekë)

Nr .	Zërat e shpenzimeve	Realizimi 2017	Plani Rishikuar 2018	Realizimi 10M 2018	% realizimit
1	Shpenzime për material të para	116,852,406	126,500,000	58,499,083	46
2	Materiale projekti Banka Botërore	11,251,530	0	45,324,720	-
3	Blerje Ujë me shumicë	12,666,200	46,200,000	30,929,280	66
4	Energji elektrike	572,071,720	514,500,000	421,245,191	81
5	Karburant	33,651,254	39,000,000	30,927,614	79
6	Kimikate	5,501,430	7,000,000	4,479,400	63
7	Sherbime riparimesh O&M	16,956,862	29,400,000	6,445,572	21
8	Sherbime roje	13,357,547	20,000,000	12,353,600	61
9	Sherbime të përgjithshme Shitje	12,062,009	15,555,000	11,707,489	75
10	Sherbime përgjith. administrative	22,078,227	41,100,000	26,655,975	64
11	Shpenzime për Personelin	321,294,826	353,914,510	277,667,174	78
12	Tatime Taksa	9,312,880	8,000,000	6,370,448	79
13	Gjoha, Penalitete, Dëmshpërblime	13,459,773	30,000,000	27,054,064	90
14	Shpenzime Financiare	52,531,511	70,000,000	42,386,798	60
15	Provizione llogarive të arkëtueshme	0	0	0	0
16	Shpenzime amortizim, zhvlerësim	55,409,348	60,000,000	47,941,048	79
	TOTALI	1,268,457,522	1,361,169,510	1,049,987,457	77

Siç del nga pasqyra e mësipërme shpenzimet e realizuara për **10 mujorin e vitit 2018** të UKD sh.a, janë si më poshtë:

Zëri **“Materiale projekti Banka Botërore”** në planin e rishikuar për vitin 2018 është planifikuar të jetë 0 por ka sjellë shpenzime në shumën **45,324,720 lekë**. Zëri **“Gjoha penalitete”** planifikuar në shumën **30.000.000 lekë** dhe për 10 mujorin e 2018 është realizuar në shumën **27,054,064 lekë ose në masën 90%**. Zëri **“Shpenzime amortizim, zhvlersim”** në planin e rishikuar për vitin 2018 është planifikuar të jetë **60.000.000 lekë** por ka sjellë shpenzime në shumën **47,941,048 lekë, ose në masën 79%**. Zëri **“Karburant”** në planin e rishikuar për vitin 2018 është planifikuar të jetë **39.000.000 lekë** por ka sjellë shpenzime në shumën **30,927,614 lekë, ose në masën 79%**.



Në konkluzion, në opinion të grupit të auditimit nga auditimi i kryer për hartimin dhe realizimin e programit ekonomik u konstatua se parashikimi fillestar i programit ekonomik flet për një rezultat pozitiv, ndërkohë në përfundim shoqëria del me rezultat negativ. Rezultati negativ që UKD sh.a ka patur gjatë viteve të fundit ka rrezikuar statusin juridik të saj. Nga auditimi i zbatimit të programit ekonomik deri në datën 31.10.2018, me shumë gjasa edhe rezultati i shoqërisë për këtë vit do të jetë me humbje. Në opinion të grupit të auditimit, drejtimi nuk ka marrë masat e nevojshme për nxjerrjen nga kjo situatë, duke mos e drejtuar drejt rezultateve pozitive.

Argumenta dhe shpjegime nga subjekti i audituar lidhur me akt konstatimin:

Sipas observacioneve të dërguara nga UKD sh.a. nr. 417 prot., datë 21.02.2019, protokolluar në KLSH nr. 1189/9 prot., datë 25.02.2019, me objekt: “Kthim përgjigje projekt raportit”, konstatohet se Ujësjellës Kanalizime Sh.a. nuk ka dërguar dokumentacion që të provojë të kundërtën e konstatimit, si dhe sqarimet dhe arsyetimet e dhëna, nuk gjenden të bazuara në ligj. Sa më sipër, observacioni i dërguar, nuk merret në konsideratë.

Pika 3.Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese (Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori) dhe përputhshmëria ligjore e vendimeve të marra.

(Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese (Asambleja e Përgjithëshme (AP), Këshilli i Administrimit(KA) dhe Administratorisi edhe përputhshmëria ligjore e vendimeve të marra).

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit “Nr. 794/1 datë 13.07.2018”, mbi “Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese (Asambleja e Përgjithëshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori) dhe përputhshmëria ligjore e vendimeve të marra”, Grupi i Auditimit kërkoi të vihet në dispozicion dokumentacioni si më poshtë:

1. Statuti i shoqërisë.
2. Rregullore e funksionimit të brendshëm të shoqërisë.
3. Rregjistri i aksionerëve të shoqërisë.
4. Dokumentacioni i plotë mbi përbërjen e AP, njoftimet e mbledhjeve, mbledhjet dhe vendimet e marra nga AP.
5. Dokumentacioni i plotë mbi përbërjen e KA, njoftimet e mbledhjeve, mbledhjet dhe vendimet e marra nga KA.
6. Ekstrakt historik i shoqërisë depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Shoqëria ka probleme ligjore lidhur me organet drejtuese të shoqërisë, që lidhen me legjitimitetin e zgjedhjes së tyre. KA është zgjedhur në datën 20.05.2016 nga të autorizuarët e bashkive, por jo nga kryetarët e bashkive që janë vetë aksionerët e përcaktuar nga VKM nr. 63 datë 27.01.2016 dhe Statuti i shoqërisë.

Nga Auditimi rezultoi se:

1.Titulli i gjetjes: *Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithëshme (AP) të UKD SHA, janë në kundërshtim me lejimet ligjore mbi mënyrën e mbledhjes dhe njoftimit.*



Situata: AP e UKD SHA, e cila ka në përbërjen e vet 5 anëtarë që përfaqësojnë aksionerët Bashkia Durrës, Bashkia Vorë, Bashkia Shkozë, Bashkia Krujë dhe Bashkia Kurbin, ka zhvilluar 5 mbledhje. Këto mbledhje rezultojnë se janë zhvilluar, dhe për to është mbajtur procesverbal i mbledhjes. Problemet e konstatuara janë:

-Mbledhja e datës 30.06.2017 është njoftuar në datën 14.06.2017. Në të nuk ka marrë pjesë asnjë kryetar bashkie. Kryetarët e bashkive Shijak, Kurbin, Vorë dhe Durrës, kanë dërguar përfaqësues të deleguar. Votimi është bërë vetëm nga këta 4 aksionerët e pranishëm, në kushtet kur njoftimi është më pak se 21 ditë. Nuk ka njoftim në faqen elektronike të shoqërisë, dhe as provë shkresore/postare që aksionerët janë njoftuar.

-Mbledhja e datës 27.12.2017 është njoftuar në datën 11.12.2017. Në të nuk ka marrë pjesë asnjë kryetar bashkie. Kryetari e Bashkisë Durrës, ka dërguar përfaqësues të deleguar. Nuk ka njoftim në faqen elektronike të shoqërisë, dhe as provë shkresore postare që aksionerët janë njoftuar.

-Mbledhja e datës 20.03.2018 është njoftuar në datën 23.02.2018, pra 25 ditë para. Në të nuk ka marrë pjesë asnjë kryetar bashkie. Kryetari e Bashkisë Durrës dhe Shkozë, ka dërguar përfaqësues të deleguar. Votimi është bërë vetëm nga këta 2 aksioner të pranishëm. Nuk ka njoftim në faqen elektronike të shoqërisë, dhe as provë shkresore postare që aksionerët Bashkia Vorë, Kurbin dhe Krujë janë njoftuar për këtë mbledhje.

-Mbledhja e datës 19.06.2018 është njoftuar në datën 23.05.2018, pra 26 ditë para. Në të nuk ka marrë pjesë asnjë kryetar bashkie. Kryetari e Bashkisë Durrës dhe Shkozë, ka dërguar përfaqësues të deleguar. Nuk ka njoftim në faqen elektronike të shoqërisë, dhe as provë shkresore postare që aksionerët Bashkia Vorë, Kurbin dhe Krujë janë njoftuar për këtë mbledhje.

-Mbledhja e datës 27.06.2018 është njoftuar në datën 11.06.2018, pra 16 ditë para. Në të nuk ka marrë pjesë asnjë kryetar bashkie. Kryetari e Bashkisë Durrës, ka dërguar përfaqësues të deleguar. Nuk ka njoftim në faqen elektronike të shoqërisë, dhe as provë shkresore postare që aksionerët janë njoftuar.

-Në datën 21.09.2018, aksioneri Bashkia Durrës ka prodhuar dy vendime, të cilat nuk janë të prodhuara nga një mbledhje aksionerësh. Për këtë datë nuk ka njoftim mbledhje as shkresor dhe as në faqen zyrtare të shoqërisë në internet, protokoll mbledhje. Këto vendime kanë të bëjnë me caktim të një eksperti auditues ligjor dhe rishikim të programit 2018.

Kriteri: AP e UKD SHA, mbledhet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, VKM nr. 63 datë 27.01.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” dhe statutit, sipas hierarkisë ligjore.

-Afati i njoftimit sipas VKM nr. 63, neni 6, pika 5, është i vlefshëm kur ai shkon tek aksionerët 15 ditë para mbledhjes me anë të një letre rekomande, ose publikohet.

5. Thirrja e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme bëhet nëpërmjet lajmërimit që botohet në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore dhe që i dërgohet me anë të një njoftimi me letër rekomande çdo anëtar të Asamblesë së Përgjithshme me shpenzimet e shoqërisë.

Afati i njoftimit sipas ligjit nr. 9901, neni 137, pika 1, është i vlefshëm kur ai dërgohet 21 ditë para mbledhjes së përcaktuar.

1. Asambleja e përgjithshme thërret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim, nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë aksionarëve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

I takon shoqërisë të publikoj në çdo rast, në faqen e saj në internet, ftesën për mbledhje ndaj aksionarëve, pavarësisht njoftimit me letër rekomande.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A. DURRËS

1. Asambleja e Përgjithshme përfaqësohet nga kryetari i bashkisë përkatëse, i cili merr vendime brenda kompetencave të parashikuara nga ligji për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.
2. Nëse shoqëria aksionare mbulon me shërbim më shumë se një bashki, Asambleja përbëhet nga kryetarët e bashkive përkatëse. Pësha e votës e secilit prej anëtarëve të Asamblesë është në përpjesëtim me përqindjen e aksioneve, sipas ndarjes territoriale-administrative.

Korumi i mbledhjes vlen edhe kur në të marrin pjesë aksionerët me mbi 30% të aksioneve, që në rastin konkret është vetëm Bashkia Durrës, por me kushtin që duhet të zbatohen procedurat e njoftimit sipas nenit 137, sipërcituar, të ligjit nr. 9901, sipas nenit 138, pika 4.

4. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas formaliteteve të këtij neni dhe të nenit 137 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vleshme vetëm nëse të gjithë aksionerët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Por vetë Statuti i shoqërisë, i cili është përshtaje e VKM nr. 63, nuk rezulton i aprovuar nga AP, sipas përcaktimeve të sipërcituara, por nga të autorizuarët e kryetarëve të bashkive, Durrës, Vorë dhe Kurbin. Në rastin e mungesës së Statutit drejtëpërdrejtë, VKM nr. 63 zbatohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë si Statut tip referuar Kreu II; Dispozita kalimtare e të fundit, citojmë:

Pika 1. Shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., organizohen në përputhje me statutin tip, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

Observacione:

UKD SHA; Me observacionin nr. 56/3 datë 10.01.2019 lidhur me akt konstatimin, pretendon se ka respektuar afatin e njoftimit të AP, votimi është marrë në përputhje me lejimet ligjore me 3/4 votave, dhe se kompetencat e delegimit lejohen nga ligji nr. 9901. Në konkluzion të observimit, çdo vendim i marrë nga AP është i rregullt.

Audituesi lidhur me akt konstatimin: Shoqëria nëobservacionin esaj nuk ka asnjë shprehje mbështetëse se aksionerët kanë marrë njoftim brenda 15 ditësh sipas VKM nr. 63, letër rekomande apo njoftim publik në një gazetë.

Në kushtet e mungesës së vërtetuar të njoftimit, shoqëria duhet të demonstroj nisjen 21 para datës së mbledhjes, të njoftimit, për të aplikuar rregullshmërinë e një mbledhje sipas ligjit nr. 9901, ku të aplikohet vendim marrja me 3/4 të votave të aksionerëve.

Mospërbushja e kushteve për një njoftim të rregullt, kërkon prezencën e të gjithë aksionerëve, që të vërtetojnë pjesëmarrje 100%, për të vijuar normalisht mbledhjen dhe të prodhojnë vendime të rregullta. Prania e reduktuar e aksionerëve në të gjitha rastet, pa plotësuar kushtet e njoftimit, nuk përmbush kushtin e nenit 138, pika 4 e ligjit nr. 9901, që të prodhojë një vendim të rregullt.

Lidhur me projekt raportin e dërguar, observacionet e dërguara nr. 417 prot., datë 21.02.2019, protokolluar në KLSH nr. 1189/9 prot., datë 25.02.2019 referuar edhe dokumentacionit dhe sqarimeve të dhëna, merren në konsideratë pjesërisht.

2. Titulli i gjetjes: Organizimi dhe funksionimi i KA dhe Administratorit.

Situata: KA sipas përcaktimeve të VKM nr. 63, përbëhet nga 3 anëtar të zgjedhur nga AP, ku njëri prej të cilëve është Administratori i UKD SHA. Me vendim nr. 4, datë 20.05.2016, pika 7 dhe 8, është bërë emërimi i dy anëtarëve të KA; Z. K.K. dhe Z. A.B., si edhe Administratorit Z. S.K., njëherazi anëtar i KA.

Të tre anëtarët e KA përmbushin kushtet për t'u zgjedhur.

Kriteri: KA zgjidhet nga AP sipas përcaktimeve të VKM nr. 63, neni 12, pika 3.

3. Anëtarët e Këshillit të Administrimit nëmomentin e emërimit lidhin me shoqërinë një kontratë pune, në të cilën janë parashikuar, ndër të tjera, kriteret e qarta performancelle që pritet të arrijë anëtari i Këshillit të Administrimit në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indikatorët) evendosur në këtë kontratë duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet të jenë të matshëm dhe në përputhje me biznes planet e shoqërisë.



në të cilën detyrat dhe të drejtat e tyre përcaktohen në kontratën individuale të punës, sipas Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”,

Neni 12. Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim. Kur marrëdhëniet midis dy palëve nuk janë qartësisht të përcaktuara, gjykata kompetente ose Agjencia e Punësimit të Përkohshëm, me kërkesë të palëve, duhet të përcaktojë natyrën e vërtetë të marrëdhënieve mes tyre, bazuar në dispozitat e këtij Kodi, si dhe fakteve që lidhen me aftësinë e punë dhe shpërblimin e punëmarrësit.

Observacion:

UKD SHA për akt konstatimin; Me observacionin nr. 56/3 datë 10.01.2019, pretendon se zgjedha e KA dhe Administratorit nga AP është e rregullt.

Shoqëria pretendon se citimi i togëfjalëshit “kontratë punë” është një lapsus i teknikës legjislativë të përdorur, në VKM nr. 63 dhe se KA së bashku me Administratorin lejohen të jenë të punësuar pa një kontratë pune në shoqëri.

Audituesi për akt konstatimin: Shoqëria në observacionin esaj nuk ka asnjë shkresë mbështetëse se në Vendimin nr. 4 të AP, datë 20.05.2016 kompetencat deleguese të lejuara në nenin 140/1 të ligjit nr. 9901, por të kufizuara me nenin 141/1, janë të pranueshme dhe shprehura në statutin e shoqërisë. Vetë statuti i shoqërisë është miratuar me kompetencë të deleguar me vendimin nr. 4 datë 20.05.2016, së bashku me Administratorin dhe KA.

Në kushte të tilla, VKM nr. 63, që shërben si statut tip i çdo shoqërie ujësjellësi në Republikën e Shqipërisë, që nuk lejon asnjë kompetencë deleguese, dhe KA si edhe Administratori quhen “të pazgjedhur”. Ky është kusht i mjaftueshëm për të vërtetuar parregullsinë në zgjedhje, por që evidentohet më tej edhe nga mungesa e kontratës së punës.

Mungesa e një kontrate punë është parakusht për qëndrimin në detyrë të Administratorit i cili është i punësuar, pas “zgjedhjes” nga AP.

Kompetenca për të gjykuar për vlerën juridike, apo “lapsuset” e një VKM-je, nuk është atribut e subjektit, por e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, ndaj nuk mund të pranohet si argument.

Kontrata e performancës, nuk është lidhur në momentin e pretenduar të emëruar të KA, por në datën 20.09.2018, pra pas dy vjetësh, që nuk legjitimon qëndrimin në detyrë të KA.

Referuar observacioneve të dërguara për projekt raportin, protokolluar në KLSH nr. 1189/9 prot., datë 25.02.2019, arsyetimet dhe pretendimet e dhëna merren në konsideratë pjesërisht, pasi gjenden të bazuar në ligj.

3. Titulli i gjetjes: *Vendim marrje jo e rregullt e AP në datën 27.12.2017*

Situata: AP e UKD SHA ka marrë një vendim për “ngrirjen e detyrimeve për 366 debitorë” të cilët nuk furnizohen me ujë nga kjo shoqëri. Vendimi nr. 4/3, datë 27.12.2017 është aprovuar nga KA, Administratori, Drejtori Teknik dhe Drejtori Tregtar i shoqërisë.

Nga verifikimi në terren, për disa nga këta konsumator të cilët rezultojnë në këtë listë, u konstatua se ata nuk kanë ende furnizim me ujë deri në datën 06.12.2018. Këta konsumatorë kanë ankimuar pranë shoqërisë për mosfurnizimin me ujë. Nga ana e UKD SHA ju është njohur “ngrirja e detyrimit” deri në 27.12.2017, por kanë vijuar të faturohen pa furnizim me ujë edhe pas datës 27.12.2018 e në vijim.

Vlera e ngrirë për këta debitorë është 39,239,693.00 Lek, ndërsa kanë paguar 3,230,696.00 Lek sipas Degës së Debive të UKD SHA, dhe kanë detyrimin për të paguar 4,997,481.00 Lek deri në



momentin e dhënies së informacionit për grupin e auditimit të KLSH-së. Në total vlera 47,467,870.00 Lek, si detyrim ndaj UKD, ndërkohë që ata nuk kanë shërbim të furnizimit me ujë të pijshëm. Ky vendim nuk specifikon në vlerën e “ngrirë”, numrin e konsumatorëve të cilët përfitojnë. Janë dy lloj dokumentash bashkëlidhur. Të cilët nuk kuadrojnë në vlera dhe numër kontratash, të llogatitura nga Drejtoria Teknike dhe nga Drejtoria Tregtare.

Kriteri: Sipas ligjit Nr. 8975, date 21.11.2002, “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv” fatura e lëshuar është titull ekzekutiv.

Neni 1 Fatura tatimore e konsumit të ujit të pijshëm, sipas modelit të përcaktuar nga Ministria e Financave, në bazë të nenit 36 të ligjit nr.7928, date 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", është titull ekzekutiv dhe ngarkohet zyra e përmbartimit për ekzekutimin e tij".

Përpilimi i kësaj fature bëhet sipas Ligjit Nr.7928, datë 27.04.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, në momentin e furnizimit.

*Neni 13 Momenti i furnizimit
1. Furnizimi quhet i kryer në momentin kur është e detyrueshme të lëshohet fatura, përveç rasteve që në këtë ligj përcaktohet ndryshe.
2. Personi që kryen një furnizim të tatueshëm, detyrohet të lëshojë një faturë për atë furnizim në momentin kur mallrat janë lëvruar ose kur ato bëhen të disponueshme, apo shërbimet janë kryer prej tij në lidhje me atë furnizim.*

Në fakt, AP, miraton një list që pranohet se nuk janë furnizuar me ujë, pra për të cilët nuk mund të lëshohet faturë tatimore. Ky proces i lëshimit të faturave të pasakta vijon. Në rastin e furnizimit me ujë, dorëzimi i mallit është atje ku merret furnizimi, sipas nenit 14 i të njëjtit ligj sipërcituar;

2. Furnizimi i energjisë elektrike, gazit, ujit, ngrohjes, ftohjes dhe ajrit të kondicionuar kryhet atje ku merret furnizimi.

Ndërsa sipas nenit 18, furnizimi konsiderohet i kryer, tërësisht ose pjesërisht me lëshimin e faturës ndaj konsumatorit.

1. Furnizimi konsiderohet i kryer kundrejt pagesës, tërësisht ose pjesërisht, në para a në natyrë, nëse furnizuesi direkt a indirekt merr apo ka të drejtë të marrë pagesë për atë furnizim, si prej personit të furnizuar apo ndonjë personi tjetër.

Shkaku: Materiali shoqërues për këta persona nuk përmban numrin e saktë të tyre dhe vlerën e detyrimit. Raportet mes Drejtorisë Teknike dhe Drejtorisë Tregtare, nuk përputhen me Degën e Debive nën vartësinë e Drejtrorisë Juridike.

Efekti: Vendimmarrja është paqartë.

Rëndësia: E lartë

Observacion:

UKD SHA për akt konstatimin; Me observacionin nr. 56/3 datë 10.01.2019, pretendon se vlera dhe numri i debitorëve pa furnizim me ujë është i saktë. Njëkohësisht pretendon se këta janë debitor, edhe pse nuk furnizohen me ujë, pasi janë njoftuar në media.

Lidhur me observacionin e dërguar nr. 417 prot., datë 21.02.2019, protokolluar në KLSH nr. 1189/9 prot., datë 25.02.2016 me objekt: “Kthim përgjigje projekt raportit”, konstatohet se UKD sh.a. nuk ka dërguar dokumentacion, lidhur me këtë pikë, që të provojë dhe vërtetojë të kundërtën e konstatimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: *ish-Drejtorët që nga krijimi i detyrimit, Z. A.I., dhe Z. D. A., si dhe të gjithë personat përgjegjës.*

4. Titulli i gjetjes: *Ndërpjerja e ujit të konsumatorëve familjar në kundërshtim me kodin e ujit dhe Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut.*



Situata: Shoqëria ka bërë ndërprerjen e ujit për konsumatorët debitorë. Nuk ka informacion mbështetës që provon në rastin e ndërprerjes së ujit për konsumatorët familjarë. Për vitin 2017 janë ndërprerë 2489 abonentë familjarë, dhe për vitin 2018 deri në datën 31 Tetor 2018, 1630 abonentë familjarë. Në total për periudhën nën auditim janë 4119 abonentë të shkëputur nga rrjeti i ujësjellësit. Nga verifikimi i listës së familjarëve që ju është ndërprerë ky furnizim rezulton se këto lista kanë këto probleme: Listat nuk janë zyrtare në formën e kërkuar për ruajtjen e dokumentacionit, i cili duhet të vijë në shoqëri nëpërmjet zyrës së protokollit, dhe me vulë të shoqërisë; Për këta abonentë nuk ka urdhër nga Admistratori për ekzekutimin e prerjes së furnizimit me ujë; Nuk ka informacion nga bashkitë përkatëse, ku janë këta konsumatorë me banim, për nivelin e tyre ekonomik, nëse marrin apo jo ndihmë ekonomike.

Kriteri: Referuar “Kodit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Rregullore për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të shoqërisë anonime” të aprovuar nga Enti Rregullator i Ujit (ERRU) ndërprerja e furnizimit me ujë kryhet duke përmbushur kriteret e pikës 4.5.2 të kodit, pika (2).

(2) Në çdo rast UK _____ sh.a. ndërpret furnizimin me ujë të pijshëm pas lajmërimit të konsumatorit, të cilit i jepet mundësia për të dhënë shpjegime. Me kërkesën e konsumatorit, UK _____ sh.a. bën rilidhjen e furnizimit me ujë brenda 5 ditëve, pasi konsumatori të ketë paguar detyrimet përkatëse ndaj UK _____ sh.a. përfshirë dhe të gjitha shpenzimet e kryera nga UK _____ sh.a. për rilidhjen e konsumatorit me rrjetin e furnizimit me ujë.

Njoftimi i abonentëve kryhet sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative, ku autoritetin e UKD SHA e ushtron Administratori, ose i autorizuari i tij, nëpërmjet një dokumenti për njoftimin zyrtar. Në protokollin e shoqërisë nuk ka asnjë dokument drejtuar konsumatorëve si për njoftim paraprak, por edhe për ndërprerjen ku të njoftohen abonentët zyrtarisht. Shoqëria për abonentët debitor, duhet të informohet nëse ata janë në ndihmë sociale, referuar pikës 4.5.2, pika (1), gërma (e), për t’ju siguruar atyre minimumin jetik, për ujë pa pagesë.

(e) Konsumatori me ndihmë sociale, do të furnizohet nga ndërmarrja 20l/person në ditë, falas, si dhe shoqëria do instalojë ujëmatësin me qëllim që konsumi i ujit përtej kësaj norme të paguhet. Lista e konsumatorit të favorizuar do të merret zyrtarisht nga bashkia/komuna(t) e zonës së shërbimit të shoqërisë.

Shkaku: Mosrespektim i afateve të njoftimit të konsumatorit për ndërprerje të furnizimit me ujë dhe mosfurnizim me minimumin jetik të tyre 20 litra në ditë për person.

Efekti: Shkelje të Kodit të Ujit dhe Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Rëndësia: E lartë.

Observacion:

UKD SHA për akt konstatimin; Me observacionin nr. 56/3 datë 10.01.2019, pretendon se njoftim paraprak quhet fatura e ujit. Ndërsa minimumin jetik nuk mund t’ju sigurojë, pasi nuk disponon matësa inteligjent.

Audituesi për akt konstatimin: Shoqëria në observacionin esaj nuk ka asnjë shkresë mbështetëse se ka njoftuar ndërprerjen si proces fizik. Sipas Kodit të Procedurës Administrative ky proces duhet të bëhet brenda 60 ditëve nga prerja e ujit, për t’ju dhënë mundësi alternative furnizimi me ujë konsumatorëve.

Ujësjellësat janë shoqëri e një rëndësie të veçantë dhe trajtohen të tillë dhe me VKM specifike, pikërisht se kanë të bëjnë me nevoja jetike të popullsisë, të parashikuara edhe në konventa ndërkombëtare. Duke përmbledhur, Observacioni i shoqërisë nuk merret parasysh si i pambështetur në fakte e prova.

Observacioni i dërguar për projekt raportin, protokolluar në KLSH nr. 1189/9 prot., datë 25.02.2019, nuk qëndron, si dhe nuk është i shoqëruar me dokumentacion që të provojë të kundërtën e konstatimit.



Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: *Administratori i Shoqërisë, Drejtoresha Juridike dhe Shefi i Degës së Mbledhjes së Debive.*

5. Titulli i gjetjes: *Mos shpallje e njoftimeve të AP si edhe rregjistrimit të aksionerëve.*

Situata: Nuk ka vendime të AP të shpallura në faqen “on-line” të Shoqërisë. Shoqëria ka patur ndryshime të vlerës së aktiveve në kuadër të investimeve në aksioner të ndryshëm të shoqërisë, por në asnjë rast, këto ndryshime nuk janë reflektuar në librin e aksioneve të shoqërisë. Për rrjedhojë përqindja e aksioneve që kanë bashkitë përbërëse në AP, merret me rezervë. Dy investime madhore që ka shoqëria nuk janë reflektuar si aktiv i aksionerëve goftë propozionalisht, goftë e plotë si vlerë ndaj një aksioneri. Këto investime janë Impianti i Trajtimit të Ujrave të Ndotur i cili nuk shërben për aksionerët Bashkia Vorë, Kurbin dhe Krujë, por për dy aksionerë Bashkia Durrës dhe Shkozet. Tubacioni kryesor nga Fushë-Kuqe në Durrës, nuk është efektiv propozionalisht për aksionerët. Përveç këtyre dy investimeve ka edhe të tjera, si Depo e shpërndarjes Arapaj, në funksion të Bashkisë Durrës, Investime në matësa, tubacione në Bashkinë Durrës, etj. Ky rregjistër aksionerësh duhet të shfaqet në faqen zyrtare në internet të shoqërisë, në mënyrë të përditësuar. Vendimet e AP, kanë vleshmëri sipas peshës së votës që ka çdo aksioner, pas përditësimit të përqindjeve të çdo aksioneri pjesëmarrës.

Kriteri: Vendimet e AP janë të detyrueshme të publikohen në faqen zyrtare të UKD SHA sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, neni 143, pika 1 dhe pika 5 e tij:

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e procesverbaleve.
5. Jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, administratorët janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në faqen e internetit të shoqërisë.

Ndryshimi i kapitalit të shoqërisë, sipas kontributit të çdo aksioneri duhet të vlerësohet dhe paraqitet çdo ndryshim si në Qendrën Kombëtare të Biznesit, por edhe në faqen zyrtare të shoqërisë në internet. Ky ndryshim duhet të reflektohet edhe në peshën e vendim marrjes së çdo aksioneri, në AP, sipas nenit 169 të ligjit për shoqëritë tregtare.

1. Administratorët detyrohen të njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për zmadhimin e kapitalit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Vendimi publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë tregtare.
2. Aplikimi për regjistrimin e vendimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni shoqërohet me raportin e ekspertit të autorizuar, ku verifikohet vlera e kontributeve në natyrë, sipas nenit 113 të këtij ligji.
3. Pas realizimit të zmadhimit të kapitalit, administratorët i njoftojnë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit realizimin e këtij veprimi. Informacioni shoqëruar duhet të përfshijë listën e personave, që kanë nënshkruar aksionet, së bashku me shumën e paguara. Kjo listë nënshkruhet nga administratorët.
4. Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Shkaku: Shoqëria nuk ka respektuar detyrimet ligjore për publikimin e të dhënave.

Efekti: Vlera e aksioneve në kushtet e mosmbajtjes së rregjistrimit të aksioneve të përditësuar, krijon bindjen e arsyeshme se nuk mund të jetë e saktë, nga ajo e dakluaruar.

Rëndësia: E mesme.

Observacion:

UKD SHA për akt konstatimin; Me observacionin nr. 56/3 datë 10.01.2019, pretendon se ka pasqyruar drejt aksionet e saj dhe se është në proces rivlerësimi të



aseteve. Vendimet janë publikuar në QKB.

Audituesi për akt konstatimin: Shoqëria nëobservacionin esaj nuk ka asnjë shkresë mbështetëse se ka publikuar vendimet e AP në faqen e saj zyrtare në internet si detyrim i drejtëpërdrejtë i ligjit nr. 9901, por është mjaftuar vetëm me publikimin e tyre në QKB.

Ky argumentim, lë pa përgjigje sesi duhet të informohet publiku kur AP merr vendime mbi konsumatorin, dhe kur këto vendime nuk publikohen në faqen e saj në internet, të parashikuar në ligj.

Nga ana tjetër, shoqëria pretendon se është në proces të rivlerësimit të aktiveve, në përfundim të së cilit do të përditësojë përqindjen e aktiveve të shoqërisë. Ky proces, automatikisht vlen edhe për peshën e çdo aksioneri në AP, dhe njëherazi lë pa përgjigje se çfarë ndodh nëse procesi rivlerësimit të aktiveve e zbrit nën 75% të aksioneve Bashkinë Durrës faktikisht. Çfarë vlere kanë vendimet e marra vetëm me një aksioner në AP?

Duke përmbledhur, Obsevacioni i shoqërisë nuk merret parasysh si i pambështetur në fakte e prova.

Observacioni i dërguar për projekt raportin nr. 417 prot., datë 21.02.2019 nuk qëndron dhe si i tillë, nuk merret në konsideratë.

6. Titulli i gjetjes: *Mënyra e protokollimit të vendimeve të AP dhe KA, jo sipas lejimeve të Udhëzimit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Arkivave.*

Situata: Shoqëria mban një protokoll të mbledhjeve të AP dhe KA për diskutimet e mbledhjes në formular të ndarë, jo të lidhur bashkërisht. Kjo krijon premisa për ndryshim të përmbajtjes së mbledhjes. Edhe pse grupi i auditimit, nuk konstatoi ndryshime në këto të dhëna, kjo lloj metode e mbajtjes së protokollit, nuk jep siguri të arsyeshme se përmbajtja e libër protokollit është e pandryshueshme. Vendosija e datës dhe numrit të protokollit të vendimeve të AP dhe KA, nuk vendoset nga Sekretarja/Arshivistja e shoqërisë, por nga Sekretarja e AP dhe KA, e cila nuk ka atributet e vendosjes së datës, numër protokollit së institucionit sipas lejimeve të Udhëzimit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Arkivave (DPA).

Kriteri: Sipas përcaktimeve të Vendimevetë Drejtorisë së Përgjithëshme të Arkivave, “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” neni 12 duhet që çdo dokumentacion i KA dhe AP të protokollohet si çdo dokument dalës i këtij institucioni.

Procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme. Ato protokollohen. Procesverbalet e mbledhjeve të forumit të organit shtetëror shtypen veças për çdo çështje dhe nënshkruhen nga mbajtësi dhe titullari ose zëvendësi i tij (përjashtim bëjnë procesverbalet e mbledhjes së këshillit të bashkisë, të qarkut e të komunës, që firmosen nga kryetari, sekretari ose i ngarkuari me drejtimin e mbledhjes dhe së paku nga 3 këshilltarë). Kur mbledhja është e përbashkët me përfaqësues të dy a më shumë subjekteve, procesverbali nënshkruhet nga mbajtësi dhe nga titullari ose zëvendësit e secilit subjekt.

Shkaku: Mosrespektim i procedurave të mbajtjes së protokollit të mbledhjeve kolegjiale.

Efekti: Mungesë e rregullshmërisë së mbajtjes së dokumentacionit.

Rëndësia: E ulët.

Observacion:

UKD SHA për akt konstatimin; Me observacionin nr. 56/3 datë 10.01.2019, pretendon se praktika e mëhershme ka prevaluar.

Audituesi për akt konstatimin: Shoqëria nëobservacionin esaj nuk ka sqaruar se lejimet e ligjit nr. 9901, neni 135 për mbajtjen e rregjistrit të vendimeve nuk pengohen nga mbajtja e tyre në protokollin e shoqërisë.

Rregjistri i vendimeve, është pjesa para se ky vendim të shtypet sipas nenit 12 të



udhëzimit të DPA. Aty aksionerët kanë të evidentuar çdo diskutim, dhe vendim të marrë dhe të firmosur nga ata. Më pas ky vendim shtypet, dhe firmoset nga aksionerët sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8480 dhe nga Sekretarja e AP.

Ky vendim merr formë të plotë ligjore pasi protokollohet sipas nenit 12, që do të thotë se çdo dokument protokollohet në arshivën e shoqërisë si dokument i brendshëm, duke vendosur në të numrin e protokollit dhe datën koresponduese në momentin e paraqitjes në arshivën e shoqërisë, Modulari 2.

Observacioni i dërguar për projekt raportin nr. 417 prot., datë 21.02.2019 nuk qëndron dhe si i tillë, nuk merret në konsideratë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: *Sekretarja e KA dhe AP, Znj. R.P..*

Nga auditimi resulton se:

Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Durrës SHA ka si objekt tregëtar, prodhimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm të bashkive Durrës, Shijak, Krujë, Vorë dhe Kurbin, si edhe largimin dhe përpunimin e ujrave të ndotur të këtyre bashkive. Sipas ekstraktit historik të UKD SHA të depozituar në QKB, përbërja e aksioneve në këtë shoqëri dhe kapitali është si më poshtë:

AP e UKD SHA, e cila ka në përbërjen e vet 5 anëtarë që përfaqësojnë aksionerët Bashkia Durrës, Bashkia Vorë, Bashkia Shkozë, Bashkia Krujë dhe Bashkia Kurbin, ka zhvilluar 5 mbledhje. Këto mbledhje rezultojnë se janë zhvilluar, dhe për to është mbajtur procesverbal i mbledhjes. Problemet e konstatuara janë:

-Mbledhja e datës 30.06.2017 është njoftuar në datën 14.06.2017, pra 16 ditë para. Në të nuk ka marrë pjesë asnjë kryetar bashkie. Kryetarët e bashkive Shijak, Kurbin, Vorë dhe Durrës, kanë dërguar përfaqësues të deleguar.

-Mbledhja e datës 27.12.2017 është njoftuar në datën 11.12.2017, pra 16 ditë para. Në të nuk ka marrë pjesë asnjë kryetar bashkie. Kryetari e Bashkisë Durrës, ka dërguar përfaqësues të deleguar. Nuk ka njoftim në faqen elektronike të shoqërisë, dhe as provë shkresore postare që aksionerët janë njoftuar.

-Mbledhja e datës 20.03.2018 është njoftuar në datën 23.02.2018, pra 25 ditë para. Në të nuk ka marrë pjesë asnjë kryetar bashkie. Kryetari i Bashkisë Durrës dhe Shkozë, ka dërguar përfaqësues të deleguar. Votimi është bërë vetëm nga këta 2 aksioner të pranishëm. Nuk ka njoftim në faqen elektronike të shoqërisë, dhe as provë shkresore postare që aksionerët Bashkia Vorë, Kurbin dhe Krujë janë njoftuar për këtë mbledhje.

-Mbledhja e datës 19.06.2018 është njoftuar në datën 23.05.2018, pra 26 ditë para. Në të nuk ka marrë pjesë asnjë kryetar bashkie. Kryetari i Bashkisë Durrës dhe Shkozë, ka dërguar përfaqësues të deleguar. Votimi është bërë vetëm nga këta 2 aksioner të pranishëm. Nuk ka njoftim në faqen elektronike të shoqërisë, dhe as provë shkresore postare që aksionerët Bashkia Vorë, Kurbin dhe Krujë janë njoftuar për këtë mbledhje.

-Mbledhja e datës 27.06.2018 është njoftuar në datën 11.06.2018, pra 16 ditë para. Në të nuk ka marrë pjesë asnjë kryetar bashkie. Kryetari e Bashkisë Durrës, ka dërguar përfaqësues të deleguar.

-Në datën 21.09.2018, aksioneri Bashkia Durrës ka prodhuar dy vendime, të cilat nuk janë të prodhuara nga një mbledhje aksionerësh. Për këtë datë nuk ka njoftim mbledhje as shkresor dhe as në faqen zyrtare të shoqërisë në internet, protokoll mbledhje. Këto vendime kanë të bëjnë me caktim të një eksperti auditues ligjor dhe rishikim të programit 2018.

Shoqëria nuk ka një rregjistër të aksionerëve. Investimet e realizuara si nga të ardhurat e shoqërisë, të buxhetit të shtetit ose të investimeve të huaja nuk janë reflektuar në ndryshimin e



kapitalit të sejcilit aksioner, për rrjedhojë duhet të ketë ndryshim edhe nëpërqindjen e posedimit të kapitaleve në shoqëri, dhe peshën e votës në AP sipas aksioneve.

KA sipas përcaktimeve të VKM nr. 63, përbëhet nga 3 anëtar të zgjedhur nga AP, ku njëri prej të cilëve është Administratori i UKD SHA. Me vendim nr. 4, datë 20.05.2016, pika 7 dhe 8, është bërë emërimi i dy anëtarëve të KA; Z. K.K. dhe Z. A. B., si edhe Administratorit Z. S.K., njëherazi anëtar i KA.

Anëtarët e KA nuk kanë kontratë pune, por një kontratë performance e datës 20.09.2018.

AP e UKD SHA ka marrë një vendim për “ngrirjen e detyrimeve për 366 debitorë” të cilët nuk furnizohen me ujë nga kjo shoqëri. Vendimi nr. 4/3, datë 27.12.2017 është aprovuar nga KA, Adminisratori, Drejtori Teknik dhe Drejtori Tregtar i shoqërisë.

Nga verifikimi në terren, për disa nga këta konsumator të cilët rezultojnë në këtë listë, u konstatua se ata nuk kanë ende furnizim me ujë deri në datën 06.12.2018. Këta konsumatorë kanë ankimuar pranë shoqërisë për mosfurnizimin me ujë. Nga ana e UKD SHA ju është njohur “ngridja e detyrimit” deri në 27.12.2017.

Vlera e ngridë për këta debitorë është 39,239,693.00 Lek, ndërsa kanë paguar 3,230,696.00 Lek sipas Degës së Debive të UKD SHA, dhe kanë detyrimin për të paguar 4,997,481.00 Lek deri në momentin e dhënies së informacionit për grupin e auditimit të KLSH-së. Në total vlera 47,467,870.00 Lek, si detyrim ndaj UKD, ndërkohë që ata nuk kanë shërbim të furizimit me ujë të pijshëm. Ky vendim nuk specifikon në vlerën e “ngridë”, numrin e konsumatorëve të cilët përfitojnë. Janë dy lloj dokumentash bashkëlidhur. Të cilët nuk kuadrojnë në vlera dhe numër kontratash, të llogatitura nga Drejtoria Teknike dhe nga Drejtoria Tregtare. Duke qenë se Drejtoria Teknike ka vetëm harta dhe listë konumatorësh, por të pafirmosura, merret për bazë raporti i dalë nga Drejtoria Tregtare.

Shoqëria ka bërë ndërprerjen e ujit për konsumatorët debitorë. Nuk ka informacion mbështetës që provon në rastin e ndërprerjes së ujit për konsumatorët familjarë. Për vitin 2017 janë ndërprerë 2489 abonentë familjarë, dhe për vitin 2018 deri në datën 31 Tetor 2018, 1630 abonentë familjarë. Në total për periudhën nën auditim janë 4119 abonentë të shkëputur nga rrjeti i ujësjellësit. Nga verifikimi i listës së familjarëve që ju është ndërprerë ky furnizim rezulton se këto lista kanë këto probleme: Listat nuk janë zyrtare në formën e kërkuar për ruajtjen e dokumentacionit, i cili duhet të vijë në shoqëri nëpërmjet zyrës së protokollit, dhe me vulë të shoqërisë; Për këta abonentë nuk ka urdhër nga Admistatori për ekzekutimin e prerjes së furnizimit me ujë; Nuk ka informacion nga bashkitë përkatëse, ku janë këta konsumatorë me banim, për nivelin e tyre ekonomik, nëse marrin apo jo ndihmë ekonomike.

Nuk ka vendime të AP të shpallura në faqen “on-line” të Shoqërisë. Shoqëria ka patur ndryshime të vlerës së aktiveve në kuadër të investimeve në aksioner të ndryshëm të shoqërisë, por në asnjë rast, këto ndryshime nuk janë reflektuar në librin e aksioneve të shoqërisë. Për rrjedhojë përqindja e aksioneve që kanë bashkitë përbërëse në AP, merret me rezervë. Dy investime madhore që ka shoqëria nuk janë reflektuar si aktiv i aksionerëve qoftë propocionalisht, qoftë e plotë si vlerë ndaj një aksioneri. Këto investime janë Impianti i Trajtimit të Ujrave të Ndotur i cili nuk shërben për aksionerët Bashkia Vorë, Kurbin dhe Krujë, por për dy aksionerë Bashkia Durrës dhe Shkozet. Tubacioni kryesor nga Fushë-Kuqe në Durrës, nuk është efektiv propocionalisht për aksionerët. Përveç këtyre dy investimeve ka edhe të tjera, si Depo e shpërndarjes Arapaj, në funksion të Bashkisë Durrës, Investime në matësa, tubacione në Bashkinë Durrës, etj. Ky rregjistër aksionerësh duhet të shfaqet në faqen zyrtare në internet të shoqërisë, në mënyrë të përditësuar. Vendimet e AP, kanë vleshmëri sipas peshës së votës që ka çdo aksioner, pas përditësimit të përqindjeve të çdo aksioneri pjesëmarrës.



Ka me Vendim nr. 26/1, datë 18.12.2017, “Për rialokimin e fondit 1,452,361.03 lek pa TVSH, dhe ndryshim e fondit për prokurimin “Shërbim i ruajtjes me roje private të UKD SHA”, ka ndryshuar pa një aprovim të AP.

Shoqëria mban një protokoll të mbledhjeve të AP dhe KA për diskutimet e mbledhjes në formular të ndarë, jo të lidhur bashkërisht. Edhe pse grupi i auditimit, nuk konstatoi ndryshime në këto të dhëna, kjo lloj metode e mbajtjes së protokollit, nuk jep siguri të arsyeshme se përmbajtja e libër protokollit është e pandryshueshme. Vendosja e datës dhe numrit të protokollit të vendimeve të AP dhe KA, nuk vendoset nga Sekretarja/Arshivistja e shoqërisë, por nga Sekretarja e AP dhe KA, e cila nuk ka atributet e vendosjes së datës, numër protokollit dhe vulës së institucionit sipas lejimeve të Udhëzimit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Arkivave. Të gjitha vendimet e zbardhura të AP dhe KA nuk kanë vulë.

U audituan vendimet e organeve drejtuese për periudhën objekt auditimi, nga të cilat u konstatua se:

- 1) Protokollimi i vendimeve të AP dhe KA të UKD SHA në kundërshtim me udhëzimin e DPA, për mënyrën e mbajtjes së protokollit.
- 2) Shoqëria nuk ka hartuar dhe dorëzuar Deklaratën e Cilësisë dhe Raportin e Vjetor në Ministrinë e Financës, brenda fundit të muajit Prill të çdo viti.
- 3) Shoqëria nuk menaxhon si duhet riskun, nuk ka GMS, Koordinator Risku, Rregullore të brendshme të përditësuar, Regjistër risku.
- 4) Shoqëria ka mangësi në mënyrën e delegimit të kompetencave dhe gjurmimin e realizimit të kompetencave të deleguara.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

- 1) Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
- 2) VKM nr. 63 datë 27.01.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.
- 3) Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”.
- 4) Ligjin nr. 131/2015, “Për qendrën kombëtare të biznesit”.
- 5) Ligjin nr. 8975, datë 21.11.2002, “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv”.
- 6) Udhëzimin e DPA, “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”
- 7) Ligjin nr.7928, datë 27.04.1995, i ndryshuar, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.
- 8) VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, “Për miratimin e modelit të rregullores “për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve sh.a.” (Kodi i Ujit),
- 9) Ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”.
- 10) Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.
- 11) Udhëzimin e Drejtorisë së Përgjithëshme të Arkivave, “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”.
- 12) Kodi i Etikës së UKD SHA.
- 13) Rregullore e funksionimit të UKD SHA (*Manual Operacional*).

Pika 4.Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënien e pagave dhe shpërblimeve.

(Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi dhe dhënien e pagave dhe shpërblimeve).



Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit “Nr. 794/1 datë 13.07.2018”, mbi “*Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi dhe dhënien e pagave dhe shpërblimeve*”, Grupi i Auditimit kërkoi të vihet në dispozicion dokumentacioni si më poshtë:

1. Struktura e shoqërisë.
2. Vendime të organeve drejtuese për ndryshim strukture.
3. Struktura e pagave.
4. List pagesat.
5. Shpërblimet.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Shoqëria nuk ka strukturë të miratuar të saj. Ndryshimet strukture të shoqërisë janë bërë me vendime të pjesëshme Këshillit të Administrimit (KA), apo Asamblesë së Përgjithëshme (AP), por pa i specifikuar pozicionet ku bëjnë pjesë punonjësit.

Nga Auditimi rezultoi se:

1. Titulli i gjetjes: *Shoqëria nuk ka strukturë të miratuar për periudhën nën auditim. Struktura të veçanta funksionojnë pa miratim të asnjë organi drejtues.*

Situata: Shoqëria ka një strukturë të miratuar me vendim të Këshillit Mbikqyrës (KM) nr. 2/1 datë 19.02.2010. Ky vendim përcakton Organigramën dhe numrin e punonjësve çdo drejtori, degë dhe sektor si edhe arsimin sipas vendit të punës. Po ky organ, KM me Vendim nr. 26, datë 07.06.2014 miraton strukturën e pagave, e cilë është ende nën funksion.

Me vendim të AP nr. 4, datë 20.05.2016, përcaktohet Organigrama e funksionimit të shoqërisë, por jo numri i punonjësve për çdo strukturë vartësie të shoqërisë. Për periudhën nën auditim shoqëria ka shtuar numrin e punonjësve në 675, por në asnjë rast nuk ka marrë ndonjë vendim për ndryshim të numrit të punonjësve në administratën e shoqërisë, pjesën drejtuese të sektorëve apo krijimin e strukturave të reja. Struktura Task Force e cila kryen kontrole në kuadër të reformës së ujit, dhe ndërprerje të ujit për konsumatorët debitor, ose të parregullt, nuk është e aprovuar nga AP e shoqërisë, por vetëm me urdhër të Administratorit.

Kriteri: Shoqëria duhet të miratoj në çdo vit strukturën e vet të funksionimit, ku të përcaktoj drejtë dhe kriteret e çdo pozicioni pune’ dhe pagën përkatë. Miratimi i kësaj strukture është përcaktuar në VKM nr. 63, datë 27.01.2016, “*Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura*”, neni 17, pika 7, gërma (c) si detyrë e Administratorit, që e paraqet për miratim KA.

c. Harton strukturën e organizimit dhe rregulloren e brendshme të veprimtarisë së shoqërisë e cila miratohet nga Këshilli i Administrimit. Struktura e organizimit të shoqërisë duhet të ketë patjetër një drejtor/departament teknik dhe një drejtor/departament tregtar, drejtuesit e të cilave zgjidhen nga administratori (Drejtori i Përgjithshëm) sipas neneve 19 dhe 20, të këtij statuti.

Kjo strukturë në çdo moment që ndryshon duhet të aprovohet gjithashtu në AP sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, i cili në nenin 135, mbi shoqëritë aksionere saktëson në pikën 2, gërma (h) mbi riorganizimin.

*2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:.....
h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;*

Pra, në kuadër të këtij riorganizimi edhe krijimi i strukturës Task Force, duhej të ishte miratuar në KA dhe AP. Kjo detyrë i takon të zhvillohet nga Dega e Burimeve Njerëzore, e cila sipas rregullores së brendshme të funksionimit, është përgjegjëse për respektimin e strukturës së miratuar.



Plotëson dokumentacionin përkatës për pranimet në punë të punonjësve të shoqërisë, në mbështetje dhe në zbatim të strukturës organizative dhe fuqisë punëtore të miratuar nga Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë.

Është detyrë e shefit të degës së burimeve njerëzore mbikqyrja e strukturave që ai ka në vartësi, dhe zbatimi i detyrave të përcaktuara, sipas pikës 6 të detyrave të përcaktuara për të.

Shkaku: Shoqëria nuk ka bërë miratim të strukturave dhe nuk ka përcaktuar numrin e punonjësve për çdo njësi të saj, nëpërmjet AP.

Efekti: Është rritur numri i punonjësve në administratën e shoqërisë, por pa ndryshim strukturor të kësaj administrate.

Rëndësia: E mesme.

Observacione:

UKD SHA për akt konstatimin; Me observacionin nr. 56/4 datë 10.01.2019, pretendon se shoqëria po punon për ndryshimin e strukturës, konform Raportit Përfundimtar të KLSH, nr. 298/7, datë 31.07.2017.

Struktura Task Force, e cila nuk është reparat i ri, por bashkërendim i disa sektorëve.

Audituesi për akt konstatimin: Kjo detyrë e lënë nga KLSH ka patur një afat fundor deri në 15.12.2017, sipas urdhërave të brendshëm të Administratorit, që dyhet të paraqiteshin për miratim në mbledhjen e thirrur nga AP nëdatën 27.12.2017. Ky detyrim nuk është përmbushur. Pas afatit të përcaktuar, shoqëria paraqet para KLSH, detyra të ndërmjetme, që i ka paraqitur edhe më herët në KLSH, në fazën e "Kontroll për zbatim rekomandimesh", dhe përsëri situata është e njëjtë.

Struktura Task Force, nuk ka kompetenca të cituara në "Manualin Operacional" (Rregullore e funksionimit të brendshëm), detyra të së cilës parashikohet t'i miratoj AP. Këto kompetenca të cituara në urdhrat cituar në observacion, konvergjojnë me detyrat që ka në këtë manual Inspektoriati i Ujit. Pra, kur egziston një stukturë e aprovuar nga Këshilli Mbikqyrës (shprehës i vullnetit propocional i aksionerëve), me detyra të specifikuara, Administratori nuk ka asnjë kompetencë t'i deformat, por thjesht duhet t'i zbatojë.

Kjo strukturë e re, quhet e tillë, pasi krijon një vartësi të trefishtë nga Drejtori Tregtar, Drejtori Teknik dhe Drejtori Ligjor, pa treguar se cili prej tyre drejton, duke i kthyer tre drejtorat sipërcituar, në një organ kolegial, kompetencë kjo drejtim-raportimi që i takon Administratorit.

Ky lloj modeli drejtimi nuk autorizohet as nga ligji nr. 9901 dhe as nga rregullorja e brendëshme, as nga Statuti i shoqërisë.

Observacioni i dërguar për projekt raportin nr. 417 prot., datë 21.02.2019 nuk qëndron dhe si i tillë, nuk merret në konsideratë, në kushtet kur nuk gjendet I bazuar në ligj.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Për veprimet dhe mosveprimet e cituara më sipër mban përgjegjësi Administratori i SHA UKD, si edhe Z. G.S. me detyrë Shef i Departamentit të burimeve njerëzore të shoqërisë.

2. Titulli i gjetjes: Mospërputhje e numri të punonjësve të aprovuar në Administratë dhe nivelit të arsimit.

Situata: Numri i punonjësve në administratë.

Shoqëria ka ndryshime në numrin e punonjësve në administratë, të cilat nuk janë të përcaktuara me vendime të AP. Ndryshimet në strukturën e shoqërisë nga AP janë bërë pa përcaktuar saktësisht pozicionet e punës së punonjësve të rinj të rekrutuar. Administrata e shoqërisë në vitin 2018 është zgjeruar me 15 punonjës të rinj, në ndryshim nga administrata e vitit 2010. Në total numri i punonjësve të UKD SHA është në përputhje me numrin e aprovuar nga AP e shoqërisë.



Kriteti: Ndryshimet në strukturën e shoqërisë duhet të miratohen nga KA dhe AP e UKD SHA, vendi ku do të bëhen punësime në administratë apo si punonjës të thjeshtë dhe më pas ato bëhen ekzekutive për të rekrutuar punonjës të rinj.

Shkaku: Shoqëria nuk ka bërë miratim të strukturave dhe nuk ka përcaktuar numrin e punonjësve për çdo njësi të saj, nëpërmjet AP.

Efekti: Është rritur numri i punonjësve në administratën e shoqërisë, por pa ndryshim strukturor të kësaj administrate.

Rëndësia: E mesme.

Observacione:

UKD SHA për akt konstatimin; Me observacionin nr. 56/4 datë 10.01.2019, pretendon se Administratori ka kompetencë në hartimin e strukturës.

Audituesi për akt konstatimin: Administratori i ka kompetencat e hartimit, por jo të aprovimit. Struktura e ndryshuar në numër punonjësish, dhe vendet e punës për ta në çdo sektor, apo administratë, është riorganizim, sipas nenit 135, pika 2, gërma (h) e ligjit nr. 9901, e cila do aprovim të AP.

Pikërisht, kjo nuk ka ndodhur.

Observacioni i dërguar për projekt raportin nr. 417 prot., datë 21.02.2019 nuk qëndron dhe si i tillë, nuk merret në konsideratë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: *Për veprimet dhe mosveprimet e cituara më sipër mban përgjegjësi Administratori i SHA UKD, si edhe Shefi i Departamentit të burimeve njerëzore të shoqërisë.*

3. Titulli i gjetjes: *Shoqëria ka të miratuar nga AP një rritje në strukturë të numrit total të punonjësve, por pa specifikuar ku do të punësohen ata.*

Situata: Shoqëria ka shtim të numrit të punonjësve me 45 punëmarrës të rinj, të aprovuar nga AP dhe KA i shoqërisë, për strukturën e vitit 2017 dhe vitit 2018. Respektivisht me vendimet e AP nr. 12/1, nr. 5 dhe nr. 25. këto vendime nuk specifikojnë nevojën ku do të punësohen këta punonjës. Nga auditimi i dosjeve të personelit, si edhe nga të dhënat e Degës së Burimeve Njerëzore, paraqitur për informacion, konstatohet se në këtë periudhë ka shtim të numrit të punonjësve edhe në administratën e shoqërisë.

Kriteti: Ndryshimet në strukturën e shoqërisë duhet të miratohen nga KA dhe AP e UKD SHA, dhe më pas ato bëhen ekzekutive për të rekrutuar punonjës të rinj. Në vendim të KA dhe AP duhet të specifikohet saktësisht struktura për zbatim sipas lejimeve ligjore sipërcituar.

Shkaku: Shoqëria nuk ka bërë miratim të strukturave dhe nuk ka përcaktuar numrin e punonjësve për çdo njësi të saj, nëpërmjet AP.

Efekti: Është rritur numri i punonjësve në administratën e shoqërisë, por pa ndryshim strukturor të kësaj administrate.

Rëndësia: E mesme.

Observacione:

UKD SHA për akt konstatimin; Me observacionin nr. 56/4 datë 10.01.2019, pretendon se Administratori ka kompetencë në hartimin e strukturës.



Audituesi për akt konstatimin: Administratori i ka kompetencat e hartimit, por jo të aprovimit. Struktura e ndryshuar në numër punonjësish, dhe vendet e punës për ta në çdo sektor, apo administratë, është riorganizim, sipas nenit 135, pika 2, gërma (h) e ligjit nr. 9901, e cila do aprovim të AP.

Aprovimi nga AP në total të numrit të punonjësve, jo specifikisht lejon shoqërinë t'i punësoj ata ku të dëshirojë. Vendimet e mëhershme të KM kanë përcaktuar numrin e punonjësve në Administratë, për çdo Drejtori. Ky vendim i KM nuk është zhvlerësuar nga AP.

Observacioni i dërguar për projekt raportin nr. 417 prot., datë 21.02.2019 nuk qëndron dhe si i tillë, nuk merret në konsideratënë kushtet kur nuk gjendet i bazuar në ligj.

Për veprimet dhe mosveprimet e cituara më sipër mban përgjegjësi: *Administratori i SHA UKD si edhe Z. G.S. me detyrë Shef i Departamentit të burimeve njerëzore të shoqërisë.*

4. Titulli i gjetjes: *Raste të mbajtjes së 79 punonjësve mbi kodin e punës, në orë jashtë orari.*

Situata: Shoqëria ka të punësuar në punë me turne në 79 raste punonjës që kanë problet më poshtë të evidentuara:

-Sektori Shijak me përgjegjës Z. I.D..

Stacioni 330 Fushë Krujë 4 punonjës, Stacioni Qendror Fushë Krujë 8 punonjës, Stacioni Pjezë 4 punonjës, që janë angazhur në 30 ditë punë nga 8 orë punë ditore, të alternuar mes tre ditëve ku dita e parë pushim, dita e dytë turn i parë dhe dita e tretë 16 orë punë turn i dytë dhe i tretë së bashku. Në total 12 punonjës.

Depo Shilore, janë 4 punonjës që kanë punuar në sistem 24 orësh me 2 ditë pushim, e barasvleshme me 30 ditë pune çdo muaj, plus një ditë ekstra pushim në muaj.

-Sektori i kanalizimeve me përgjegjës Z. B.M..

Stacioni nr. 7, Stacioni nr. 8, Stacioni nr. 9, Stacioni nr. 6, së bashku kanë 17 punonjës që punojnë 24 ditë pa ndërprerje duke alternuar turnet, e cila pasohet me 7 ditë radhë pushim.

Stacioni nr. 4, Stacioni nr. 5, Stacioni nr. 1 nga auditimi rezultojnë 6 punonjës që punojnë 6 ditë nga 8 orë çdo javë, në total 48 orë në javë, e cila pasohet nga 1 ditë pushim.

-Dega e Shpërndarjes me përgjegjës Z. E.K.

Dispeçeria dhe manovrator Qyteti Durrës 13 punonjës që janë mbajtur në punë 27 ditë punë nga 8 orë çdo ditë.

Depo 1, Depo 2, Manovratorët Xhafzotaj, Depo 3, Depo 4, Depo e Re Arapaj janë 23 punonjës që kanë punuar 24 ditë pa ndërprerje, duke konsumuar 7 ditë pushim më pas.

Depo e Re, Depo Rashbull, Depo Shën Vlash, janë 3 punonjës që janë angazhuar në punë në 6 ditë të javës nga 8 orë, dhe më pas 1 ditë pushim. Në total 48 orë punë në javë.

Paga në të gjitha rastet është konsideruar si pagë në kohë normale pune, përjashtuar rastet kur kanë punuar turn i tretë.

Kriteri: Shoqëria nuk duhet të mbajë në punë punonjësit që ata të ushtrojnë mbi 40 orë punë në javë. Shoqëria për të mbajtur numrin e punonjësve në kuotën e aprovuar prej 675 punonjësish, nuk ka bërë rishpërndarje të drejtë të fuqisë punëtore. Orët e punës së lejuara sipas nenit 83 të Kodit të Punës janë 40 orë në javë.

Shkaku: Mbajtja e këtyre punonjësve mbi orët e lejuara të punës, ka ardhur si pasojë e mos shpërndarjes së drejtë të fuqisë punëtore.

Efekti: Puna e kryer nga këta punonjës, mbi orët e lejuara, ka fshehur faktin që këta punonjës kanë kryer punën e 34 punonjësve që sqarohet në observacion.

Rëndësia: E lartë.

Observacione:



UKD SHA për akt konstatimin; Me observacionin nr. 56/4 datë 10.01.2019, pretendon se pompat janë të automatizuar dhe se ata janë manovratorë dhe se nuk kanë bërë asnjë ankesë. Shkurtimi i orëve të punës do të rris me 34 punonjës strukturën.

Audituesi për akt konstatimin: Së pari, auditimi nuk merr në konsideratë se meqënëse nuk ka ankesë nga pala e dëmtuar, problemi i shkeljes së Kodit të Punës është i panueshëm. Jo. Shkelja ligjore prevalon mbi ankimimin si e drejtë e pa ushtruar e punonjësve.

Natyra e punës së punonjësve, manovrimi i saraqineskave, është dakordësuar mes palëve, por brenda kushteve të Kodit të Punës, mes kontratës individuale e kolektive të palëve.

Risistemimi në punë i punonjësve, jo rrjedhimisht bëhet me shtesë të fuqisë punëtore, por edhe në këtë rast, puna mbi orarin e lejuar nuk është asgjë më shumë se rritje "de facto" e fuqisë punëtore. Po, 136 punonjës në total kanë kryer punën e 170 punonjësve të programueshëm, por a nuk është kjo fshehje e rritjes së fuqisë punëtore, thjesht pa u pasqyruar me emra të rinj!?

Observacioni i dërguar për projekt raportin nr. 417 prot., datë 21.02.2019 nuk qëndron dhe si i tillë, nuk merret në konsideratë, si i pambështetur në fakte e prova.

Për veprimet dhe mosveprimet e cituara më sipër mban përgjegjësi: *Administratori i SHA UKD si edhe Z. G.S. me detyrë Shef i Departamentit të burimeve njerëzore të shoqërisë. Specialisti i pagave në Departamentin e Burimeve Njerëzore Z. D. R., përgjegjësat respektiv Z. I.D., Z. B.M., Z. E.K..*

5. Titulli i gjetjes: *Struktura e re e Task Force e pa autorizuar nga organet drejtuese.*

Situata: *Task Force operon në terren në bazë disa urdhëresave të lëshuar nga Administratori, por pa lëshuar njoftime paraprake mbi abonentët mbi mënyrë dhe llojin e penalteteve deri në ndërprerje të furnizimit me ujë në rastet e debitorëve. Kjo strukturë nën vartësinë e Degës së Debitive, nuk ka asnjë gjurmë në protokolin e shoqërisë për aktivitetin që kryen, njoftimin paraprak dhe ndërprerjen e debitorëve, pa një plan të detajuar dhe koordinuar me Administratorin.*

Kriteri: *Struktura e re e shoqërisë duhet të autorizohet nga AP dhe KA. Kjo strukturë edhe pse nuk ka impakt në shtimin e numrit të punonjësve, funksionimi i saj nuk parashikohet në rregulloren e funksionimit të brendshëm të shoqërisë e cila miratohet nga KA i UKD SHA. Ndërprerja e ujit sipas përcaktimeve të Kodit të Ujit, bëhet me kundërfirmën e abonentit, në rastet e ndërprerjes së ujit, duke respektuar afatet e njoftimit.*

Shkaku: *Është krijuar një strukturë që merr kompetencat e tre drejtorive të UKD SHA.*

Efkti: *Ky model riorganizimi i shoqërisë krijon mbivendosje kompetencash me Inspektoriatin e Ujit, të autorizuar si detyrë nga Rregullorja e brendëshme e UKD SHA.*

Rëndësia: *E mesme.*

Observacione:

UKD SHA për akt konstatimin; Me observacionin nr. 56/4 datë 10.01.2019, pretendon se Struktura Task Force, e cila nuk është repart i ri, por bashkërendim i disa sektorëve.

Audituesi për akt konstatimin: Struktura Task Force, nuk ka kompetenca të cituara në "Manualin Operacional" (Rregullore e funksionimit të brendshëm), detyrat e së cilës parashikohet t'i miratoj AP. Këto kompetenca të cituara në urdhërat cituar në observacion, konvergjojnë me detyrat që ka në këtë manual Inspektoriati i Ujit. Pra, kur egziston një stukturë e aprovuar nga Këshilli Mbikqyrës (shprehës i vullnetit propocional i aksionerëve), me detyra të specifikuara, Administratori nuk ka asnjë kompetencë t'i deformojë, por thjesht duhet t'i zbatojë.

Kjo strukturë e re, quhet e tillë, pasi krijon një vartësi të trefishtë nga Drejtori



Tregtar, Drejtori Teknik dhe Drejtori Ligjor, pa treguar se cili prej tyre drejton, duke i kthyer tre drejtorat sipërcituar, në një organ kolegjal, kompetencë kjo drejtim-raportimi që i takon Administratorit.

Ky lloj modeli drejtimi nuk autorizohet as nga ligji nr. 9901 dhe as nga rregullorja e brendëshme, as nga Statuti i shoqërisë.

Observacioni i dërguar për projekt raportin nr. 417 prot., datë 21.02.2019 nuk qëndron dhe si i tillë, nuk merret në konsideratë. si i pambështetur në fakte e prova.

Për veprimet dhe mosveprimet e cituara më sipër mban përgjegjësi: *Administratori i SHA UKD si edhe Përgjegjësi i Degës së Debive, Z. K.L.*

6. Titulli i gjetjes: *Shoqëria nuk ka një kontratë të rregullt kolektive të punës.*

Situata: Shoqëria ka një kontratë kolektive të dakordësuar me Këshillin Sindikal të Federatës së Sindikatave të Ndërtimit, Zhillimit Urban dhe Administratës Publike të Shqipërisë (FSNZHUAPSH), e përfaqësuar nga Z. Ilirjan Kuçi, dhe UKD SHA e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm në cilësinë e punëdhënësit. Kjo kontratë e vleshme prej datës 11.03.2015 deri në datën 11.03.2018, për një periudhë tre-vjeçare.

Pas përfundimit të kësaj kontrate Shoqëria ka një kontratë kolektive me Sindikatën e Punonjësve të Administratës dhe Shërbimeve Publike (SPASHPD), Durrës të dakordësuar mes përfaqësueses së SPASHPD dhe punëdhënësit. Të dyja këto kontrata kanë mospërputhje me Kodin e Punës.

Neni 11 i kontratës parashikon “*Kohëzgjatja normale e javës së punës është jo më pak se 40 orë, e ndarë kjo në 5 ditë nga e hëna në të premte*”. Ky nen është diskriminues sepse lejon punësimin e punonjësve mbi 40 orë në javë, në kundërshtim me Kodin e Punës.

Neni 13 i kontratës parashikon “*Punonjësit që punojnë me 3 turne gëzojnë të drejtën e jo më pak se 2 ditë pushim në muaj të barasvleshme me ditën e diela për punonjësit e ditës*”. Ky nen i kontratës është diskriminues, pasi krijon mundësinë e heqjes së 6 ditëve pushim, nga minimumi 8 që duhet të ketë një punonjës në muaj. Fenomen ky i ndodhur realisht në UKD SHA, siç është cituar më sipër.

Kriteri: Shoqëria në lidhjen e kontratës kolektive të punës, duhet të zbatoj ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i cili parashikon se:

Neni 83 (i ndryshuar) kohëzgjatja normale e javës së punës është jo më shumë se 40 orë. Ajo përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në kontratën kolektive ose në kontratën individuale të punës.

Neni 11 i kontratës së punës dhe neni 83 i Kodit të Punës, nuk përputhen, pasi koha normale e punës është 0-40 orë pune, ndërsa çdo orë mbi 40 deri në 50 orë pune në javë konsiderohet orë shtesë pune dhe paguhet jo më pak se 25% më tepër se orët e normale të punës, ose brenda dy muajve duhet t’i kompesoj me pushim. Ka një kufizim për në Kodin e Punës për orët shtesë mbi 50 orë në javë.

Neni 90 KOHEZGJATJA MAKSIMALE E OREVE SHITESË

(1) Kohëzgjatja maksimale e orëve shtesë përcaktohet në kontratën kolektive ose kontratën individuale të punës.

(2) Nuk mund të kërkohet kryerja e orëve shtesë javore kur punëmarrësi ka kryer 50 orë pune në javë.

(3) Këshilli i Ministrave vendos rregulla të veçanta për kryerjen e orëve shtesë për punët që janë veçanërisht të vështira ose të dëmshme për shëndetin.

(4) Me autorizimin e Inspektoratit të Punës, kohëzgjatja maksimale e orëve shtesë mund të tejkalohet në rastet e forcës madhore ose të punëve urgjente në dobi të popullsisë.



Njëkohësisht, neni 13 i kontratës kolektive të punës që parashikon 2 dhe më tepër ditë pushim, për punonjësit është në kundërshtim me nenin 85 të Kodit të Punës:

Neni 85 PUSHIMI JAVOR

(1) Pushimi javor është jo më pak se 36 orë, prej të cilave 24 orë pa ndërprerje.

(2) Pushimi javor përfshin ditën e diel.

(3) Pushimi javor nuk është i pagueshëm.

(4) Përjashtimet rregullohen me VKM.

Minimumi i ditëve pushim duhet të ishte për turnin e tretë; 4×36 orë = 144 orë, e shprehur në ditë jo më pak se 6 ditë pushim.

Trajtimi juridik i kontratës dhe pospërputhjes së saj me Kodin e Punës, është detyrë e Departamentit Ligjor, i cili është përgjegjës sipas rregullores së brendshme për:

Departamenti Ligjor...jep ndihmë juridike të gjithë punonjësve të shoqërisë, për problemet ligjore që ata mund të kenë me shoqërinë.

Pra, në një rast të evidentuar si shkelje e Kodit të Punës për orë mbi orarët e lejuara të punës në javë dhe ditët pushim, kjo drejtori nuk është shprehur.

Shkaku: Kontrata kolektive e punës është në tejkalim të Kodit të Punës, në nenin 11 dhe 13 të saj, duke krijuar premisa për lejim të punës mbi orarët e lejuara javore, të konstatuara edhe në auditim.

Efekti: Mbi këto ndryshime shoqëria ka mbajtur në punë 79 punonjës mbi 40 orë në javë.

Rëndësia: E mesme.

Observacione:

UKD SHA për akt konstatimin: Me observacionin nr. 56/4, pika 6, datë 10.01.2019, pretendon se Kodi i Punës lejon maksimumi 50 orë në javë punë.

Audituesi për akt konstatimin: Kodi i Punës lejon se orë normale pune janë 40 orë në javë. Maksimumi i lejueshëm i mbajtjes në punë të punonjësve është 50 orë në javë, ku 10 orë janë të pagueshme së paku 25% më tepër se orët e zakonshme, ose ekuivalentohen me pushim brenda 2 muajve.

Njëkohësisht nuk jepet përgjigje për punonjësit që në javë nuk konsumojnë asnjë ditë pushim, por pas 24-27 ditë punë pa pushim marrin një javë leja apo edhe më pak 2-3 ditë leje, apo punonjësit që kryejnë 24 orë punë pa ndalesë, me dy ditë pushim mes tyre, por që në total janë 30 ditë në punë.

Kodi i punës lexohet i plotë në frymën dhe gërmën e tij.

Observacioni i dërguar për projekt raportin nr. 417 prot., datë 21.02.2019 nuk qëndron dhe si i tillë, nuk merret në konsideratë, si i pambështetur në fakte e prova.

Për veprimet dhe mosveprimet e cituara më sipër mban përgjegjësi: Administratori i shoqërisë UKD SHA Zdrejtoresha Juridike Znj. F.K., dhe Përfaqësuesja e SPASHPD, Znjsh. Xh. Xh., përfaqësuesi i FSNZHUAPSH, Z. I.K..

7. Titulli i gjetjes: Nuk ka rregulla për punësimet e reja në shoqëri, dhe kërkesat për vendet e punës së këkuara për formimin profesional dhe arsimin e kërkuar.

Situata: Për periudhën nën auditim janë punësuar 102 punonjës për vitin 2017 dhe 68 punonjës për vitin 2018. Në asnjë rast nuk ka njoftime nga ana e shoqërisë për kriteret e këtyre punësimeve, as në zyrën e punës dhe as në faqen zyrtare të shoqërisë në internet. Shoqëria nuk ka një praktikë të konsoliduar për kërkesat që ka për rekrutimet e reja në personelin e punonjësve.

Kriteri: Në bazë të strukturës së miratuar të shoqërisë, pozicioneve vakant të punës, dhe rregullores së funksionimit të brendshëm, shoqëria duhet të njoftoj vakancat në zyrën e punës. Dega e Burimeve njerëzore të UKD SHA duhet të shikoj përputhshmërinë e vendit të punës me arsimin, formimin profesional të aplikantit, para marrjes në provë. Në rregulloren e shoqërisë



duhet të përcaktohet profesioni që duhet të ketë çdo aplikant, për të përmbushur detyrën për të cilën ai aplikon.

Shkaku: Shoqëria nuk ka një praktikë njoftimesh.

Efekti: Punësimet e reja janë subjekt i përzgjedhjes së shoqërisë pa njoftim.

Rëndësia: E mesme.

Observacione:

UKD SHA për akt konstatimin; Me observacionin nr. 56/4, pika 7, datë 10.01.2019, pretendon se vendet e reja të punës njoftohen në ambjetet e shoqërisë dhe se punëkërkuessit aplikojnë direkt në shoqëri.

*Audituesi për akt konstatimin: Mungesa e një njoftimi publik, që është Qendra e Publikimeve Zyrtare, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Faqja on-line e shoqërisë, të lirë, të aksesueshëm nga të gjithë, nuk është përdorur asnjëherë nga shoqëria. Kjo mangësi e alternuar me mungesën e një strukture të aprovuar, krijon bindjen e arsyeshme se punësimet janë subjekt i preferencave të punëdhënësit, pa patur kufizim mbi aftësitë e punëmarrësit. Pra, nuk ka kriter mbi arsimin, eksperiencën, etj. **Observacioni i dërguar për projekt raportin nr. 417 prot., datë 21.02.2019 nuk qëndron dhe si i tillë, nuk merret në konsideratë, si i pambështetur në fakte e prova.***

Për veprimet dhe mosveprimet e cituara më sipër mban përgjegjësi: Administratori i shoqërisë UKD SHA dhe Shefi i Degës së Burimeve njerëzore.

8. Titulli i gjetjes: *Ndërprerjet e marrëdhënieve të punës.*

Situata: Shoqëria ka bërë ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për 28 punonjës në vitin 2017 dhe për 21 punonjës në vitin 2018 deri në datën 31.10.2018. Në asnjë rast nuk janë zbatuar procedurat e njoftimit dhe të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, sipas procedurave të Kodit të Punës. Mbajtja e vendimit të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, nuk bëhet në protokollin modular Mod. 1, por në protokollin e brendshëm. Ky veprim nuk lejon të krijohet bindje e arsyeshme për rigorozitet në zbatim të vendimeve të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës dhe afatet e njoftimit. Në asnjë rast nuk ka kundër firmë të punonjësit të cilit i ndërpritet marrëdhënia e punës. Për këtë arsye një numër prej 8 personash janë në proces gjyqësor me shoqërinë për të ankimuar ndërprerjen e njëanëshme të marrëdhënieve të punës. Nuk ka masa paraprake ndaj punonjësve, para se t'ju zgjidhet marrëdhënia e punës nga ana e shoqërisë.

Kriteri: Shoqëria sipas Kontratës kolektive të punës, duhet të zbatoj të gjitha procedurat paraprake të masave, para se të aplikoj ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Në rregjistrin e vendimeve në protokollin e shoqërisë në rastet kur punonjësit nuk paraqiten, duhet të jepen sipas kontratës kolektive neni 48, të shkallëzuara;

Masat disiplinore jepen të shkallëzuara. Dhënia e shkallëzuar e masave nuk aplikohet në rastet e shkeljes së detyrimeve kontraktuale të punës. me faj të rëndë të punëmarrësit, ose të shkeljeve me pasoja të ndjeshme.

Në rastet e mosparaqitjes në punë, shoqëria duhej t'i jepte më herët masat e shkallëzuara, vrejte, paralajmërim deri në largim nga puna. Kjo procedurë nuk egziston në UKD SHA.

Shkaku: Shoqëria nuk ka praktikë njoftimesh paraprake mbi zgjidhjet e kontratave të punës.

Efekti: Zgjidhjet e kontratës së punës, janë kryer në të gjitha rastet e evidentuara brenda 5 deri 7 ditësh, pa firmat e personave të cilëve ju është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Rëndësia: E mesme.

Observacione:

UKD SHA për akt konstatimin; Me observacionin nr. 56/4, pika 8, datë 10.01.2019, pretendon se ka respektuar procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës. Nuk janë cituar nga audituesët raste konkrete.

Audituesi për akt konstatimin: Argumenti se nuk kanë ankimuar të gjithë personat që



ju është ndërprerë marrëdhënia e punës nuk përbën fakt. Është fakt, se të gjithë personat të cilëve ju është ndërprerë marrëdhënia e punës, dhe që kanë shkuar në gjykatë nuk kanë ankimim administrativ, në shoqëri. Është fakt, se të gjithë personat që janë thirrur për t'ju komunikuar ndërprerjen e marrëdhënies të punës, nuk rezultonte të kishin marrë takim në një mbledhje, të protokolluar në Degën e Burimeve Njerëzore, kopjo e së cilës të ishte arshivuar. Është parë dokumentacioni i gjithë punonjësve të cilëve ju është ndërprerë marrëdhënia e punës në arshivën e shoqërisë, dhe në asnjë rast, punonjësit e larguar nuk kanë firmosur marrjen e njoftimit paraprak, apo përfundimtar të largimit nga puna.

Observacioni i dërguar për projekt raportin nr. 417 prot., datë 21.02.2019 nuk qëndron dhe si i tillë, nuk merret në konsideratë, si i pambështetur në fakte e prova.

Për veprimet dhe mosveprimet e cituara më sipër mban përgjegjësi: Administratori i shoqërisë UKD SHA dhe Shefi i Degës së Burimeve njerëzore.

9. Titulli i gjetjes: Detyrim ndaj punonjësve për ndërprerje të njëanëshme të marrëdhënies të punës nga ana e UKD SHA.

Situata: Për periudhën nën auditim nga ana e shoqërisë janë paguar për ndërprerje të marrëdhënies të punës, vlera prej **4,125,144 lek** e cila është e likuaduar plotësisht, si detyrim ndaj vendimeve gjyqësore. Ndërkohë janë dy punonjës të cilët kanë ankimuar në gjykatën e apelit për një vlerë respektive 28,000 lek dhe 40,000 lek, dëmshpërblim.

Kriteri: Shoqëria nuk ka respektuar Kodin e Punës në ndërprerjen e marrëdhënies të punës, dhe është gjetur fajtores në shkeljet e njëanëshme të këtyre marrëdhënies dhe e detyruar të kryej pagesën prej 4,125,144 lek, e cila përbën një efekt negativ ndaj shoqërisë.

Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" parashikon personin që ka përgjegjësi për këtë dëm në nenin 163.

3. Administratorët apo anëtarët e këshillit të administrimit, që veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet e kujdesit, të përmendura në pikat 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i shpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga shkeljet, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët apo anëtarët e këshillit të administrimit kanë barrën e provës, për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator dhe/ose anëtar i këshillit të administrimit, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në këtë rast, marrëdhëniet e punës në cilësinë e punëdhënësit i takojnë Administratorit.

Shkaku: Vendime të gjykatave për pagesat e personave të larguar nga puna.

Efekti: Kjo pagesë është paguar totalisht.

Rëndësia: E lartë.

Observacione:

UKD SHA për akt konstatimin; Me observacionin nr. 56/4, pika 9, datë 10.01.2019, pretendon se vendimet e gjykatave janë të viteve më herët.

Audituesi për akt konstatimin: KLSH auditon jo vetëm vendimet e kohës audituese, por edhe vendimet e mëhershme që efektet e tyre i shfaqin në periudhën audituese, ndaj si një e drejtë e garantuar nga standartet ndërkombëtare ISSAI, kjo aplikohet edhe nga audituesit në subjekt.

Janë dy vendime në pritje shqyrtimit të gjykatës së apelit, të cilat janë të cituara, por që janë objekt auditimi i periudhave të mëvonëshme.

Observacioni i dërguar për projekt raportin nr. 417 prot., datë 21.02.2019 nuk qëndron dhe si i tillë, nuk merret në konsideratë, si i pambështetur në fakte e prova.

10. Titulli i gjetjes: Respektimi i marrëdhënies të punës.



Situata: Gjatë periudhës nën auditim u konstatua se shoqëria nëpërmjet Degës së Burimeve Njerëzore ka dhënë masa disiplinore për 76 punonjës në vitin 2017 dhe 30 masa disiplinore për vitin 2018. Këto masa janë shprehur me vendim të administratorit. Grupi i auditimit gjeti parregullsi në dokumentimin e këtyre masave, shkaqeve dhe arsyeve të dhënies së masave. Mungojnë raportet e plota të llojit të shkeljes dhe ballafaqimi me punonjësit.

Kriteri: Sipas kontratës kolektive të punës neni 47.

Masat disiplinore i jepen punëmarrësit nga punëdhënësi me motivin përkatës, të shprehur qartë dhe në prani të tij. Janë ansolutisht të pavleshme dhe nuk prodhojnë asnjë efekt juridik mbi punonjësit masat disiplinore që nuk plotësojnë elementet e mëposhtëm:

-Nuk jepen me shkrim.

-Nuk plotësojnë argumentin përkatës.

Çdo masë disiplinore jepet në prani të punonjësit, në Degën e Burimeve Njerëzore, për të cilën mbahet një protokoll mbledhje, ku palët shprehin qëndrimet e tyre.

Shkaku: Vendime të gjykatave për pagesat e personave të larguar nga puna.

Efekti: Kjo pagesë është paguar totalisht.

Rëndësia: E lartë.

Observacione:

UKD SHA për akt konstatimin; Me observacionin nr. 56/4, pika 10, datë 10.01.2019, pretendon se punonjësit janë njohur me masat nga përgjegjësat.

Audituesi për akt konstatimin: Grupi i Auditimit ka marrë në arshivë dokumentacionin për çdo rast, edhe pse nuk ja ka kërkuar Degës së Burimeve Njerëzore. Masa disiplinore si akt administrativ, merr formë kur paraqitet e plotë në aktin final administrativ (aktet e ndërmjetme administrative duhet të përmenden në aktin final), ku në të gjitha rastet personat ndaj të cilëve ishin marrë masat, nuk kishin marrë nga protokollin njoftim, por edhe në konceptimet e akteve individuale, nuk përmendej asnjë e drejtë e punonjësve për kundërshtitë ndaj aktit "masa disiplinore"

Observacioni i dërguar për projekt raportin nr. 417 prot., datë 21.02.2019 nuk qëndron dhe si i tillë, nuk merret në konsideratë. si i pambështetur në fakte e prova.

Për veprimet dhe mosveprimet e cituara më sipër mban përgjegjësi: Administratori i shoqërisë UKD SHA dhe Shefi i Degës së Burimeve njerëzore.

11. Titulli i gjetjes: *Mbajtja e dosjeve të personelit.*

Situata: Nga auditimi i dosjeve të personelit u konstatua se në to ka mangësi, në një pjesë të dosjeve lidhur me përmbajtjen e inventarit të dosjes. U morën me përzgjedhje 50 dosje të personelit të shoqërisë dhe konkludoi, se një pjesë e tyre kishin mangësi në dokumentacionin e inventarit të dosjeve. Në 8 raste mungonin diplomat e të punësuarve, të noterizuara. Ky dokumentacion u plotësua gjatë auditimit. Kishte mungesa në dokumentacione të tjera shtese, për dosjet e personelit që kanë paraqitur dëshmi penaliteti nëpërmjet gjykatës, dhe prokurorisë. Kryesisht këto mungesa kishin të bënin me rekrutime të herëshme në UKD, para se dëshmia e penalitetit të lëshohej Drejtoria e Përgjithëshme e Burgjeve, në Ministrinë e Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë.

Kriteri: Plotësimi i plotë i dosjeve të personelit nga ana Degës së Burimeve Njerëzore është përcaktuar në rregulloren e brendëshme të shoqërisë që lidhet me detyrat e kësaj dege.

Kjo degë është nën vartësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë dhe konkretisht:

Administron dhe plotëson dosjet personale të punonjësve, plotëson dhe ruan rregjistrin themeltar të punonjësve në baze të legjislacionit në fuqi.

Shkaku: Mangësi në dokumentacion të dosjeve të personelit.



Efekti: Shmangie nga detyrimet nën ligjore.

Rëndësia: E lartë.

Observacione:

Observacioni i dërguar për projekt raportin nr. 417 prot., datë 21.02.2019 nuk qëndron dhe si i tillë, nuk merret në konsideratë.

Për veprimet dhe mosveprimet e cituara më sipër mban përgjegjësi: Shefi i Degës së Burimeve njerëzore Z. G.S..

Auditimi konkludoi se:

Shoqëria UKD SHA ka si fushë veprimi në 5 bashki, Durrës, Kurbin, Krujë, Vorë, Shijak, për furnizimin me ujë të pijshëm dhe lagimin e ujrave të ndotur. Kjo shoqëri funksionon sipas një Organigrame të aprovuar me vendim të Këshillit Mbikqyrës (KM) nr. 2/1 datë 19.02.2010. Kjo strukturë është e aprovuar për 462 punonjës dhe 3 auditues, në total 465 punonjës. Shoqëria nuk ka një strukturë të miratuar vjetore të punonjësve sipas programit të vitit 2017 dhe të vitit 2018. Ndryshimi i mëvonshëm i kësaj strukture është bërë me vendim të AP nr. 4, datë 20.05.2016, ku përcaktohet Organigrama e funksionimit të shoqërisë, por jo numri i punonjësve për çdo strukturë vartësie të shoqërisë.

Struktura e pagave të shoqërisë mbetet e pandryshuar nga mbledhja e Këshillit Mbikqyrës të vitit 2014, i cili është Vendim nr. 26, datë 07.06.2014. Gjatë periudhës objekt auditimi marrëdhëniet e punës janë të rregulluara me kontratën kolektive nr. 470/1 prot., datë 11.09.2015 midis UKD SHA të përfaqësuar nga Administratori i UKD dhe Sindikatave të Punonjësve të Ndërtimit, Zhvillimit Urban dhe Administratës Publike të Shqipërisë (anëtare e Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë) përfaqësuar nga Z. I.K. për një periudhë tre vjeçare, deri në datën 11.09.2018, pas përfundimit të së cilës shoqëria ka lidhur një kontratë të re kolektive me Sindikatën e Punonjësve të Administratës së Shërbimeve Publike Durrës, me prot. Nr. 2071/1, datë 11.10.2018, të përfaqësuar nga Znj. Xh. Xh.. Struktura e shoqërisë në fillim të auditimit ka qenë e aprovuar në vitin 2017 është 645 punonjës, nga të cilët 635 janë aktualisht në fillim viti 2017, ndërsa priten të shtohen 10 punonjës të rinj në vijim të vitit.

Në datën 13.06.2017, KA i kërkon një ndryshim të ri shoqërisë për të rritur numrin e punonjësve nga 645 në 665, pra duke kryer edhe 20 punësime të reja.

Ky vendim hyn në fuqi në datë 30.06.2017 kur është kaluar për miratim në AP të shoqërisë.

Në programin ekonomik të vitit 2018, është planifikuar një rritje edhe prej 10 punonjësish, duke çuar në 675 numrin e përgjithshëm të tyre në shoqëri.

Shoqëria është e strukturuar në dy drejtori dhe një departament, përkatësisht:

-Drejtoria Teknike ka në vartësinë e saj; Degën teknike; Degën e Sigurisë së Shërbimit të Ujit; Degën e sistemit të ujësjellësit; Degën e kanalizimeve; Impiantin e trajtimit të ujrave të ndotur; Repartin mekanik. Drejtoria Tregtare ka në vartësi të vet; Degën e shitjes, dhe njëherazi Sektorin e lexuesve; Degën e Financ-kontabilitetit, që ka dy sektor nën vartësi atë të shërbimit ndaj klientit dhe Sektroin e Axhornimit. Departamenti Ligjor që ka në vartësinë e vet; Sektorin e Prokurimeve; Degën e mbledhjes së debive dhe inspektoriatit të ujit.

-Dega e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse varet nga Administratori i shoqërisë Sipas organigramës së miratuar në vitin 2010 këto drejtori kanë 413 numër punonjësish. Nga list pagesat deri në 31 Tetor 2018 rezulton se nuk përputhen strukturat e miratuara në vitin 2010 me ato aktuale. Dega e Shpërndarjes, Impianti i Trajtimit të Ujrave të Ndotur (ITUN) si pjesë e Degës së Kanalizimeve rezulton më vete si strukturë. Sektorët e Mirëmbajtjes, Axhornimit dhe Matësive nuk rezultojnë të aprovuar në strukturë.



Rregjistrat themeltar të punonjësve janë 5, që përkojnë sipas viteve në të cilën këta punonjës kanë ardhur, dhe që aktualisht vijojnë të jenë në marrëdhënie pune.

-Rregjistri nr. 6 fillon më datë 15 Janar 2005 me numër rendor 1720 dhe përfundon më datë 13 Korrik 1989 me numër rendor 1915. I kompletuar. Rregjistri nr. 5 fillon më datë 8 Mars 2012 me numër 1322 dhe përfundon më datë 11 Shator 2017, me numër rendor 1719. I kompletuar. Rregjistri nr. 4 fillon më datë 2 Shkurt 1979 me numër rendor 932 dhe përfundon më 12 Prill 2012, me numër rendor 1321. I kompletuar. Rregjistri nr. 2, fillon më datë 29.05.2017 me numër rendor 176 dhe përfundon më 11 Dhjetor 2018, me numër rendor 276. Në përpunim. Rregjistri nr. 1, fillon me numrin 1, datë 10 Shtator 1977 dhe përfundon më datë 03 Gusht 2017 me numër rregjistri 175. I kompletuar.

-Rregjistrat nr, 1, 4, 5, 6 janë të plotësuar në të gjitha faqet konform udhëzimeve përkatëse, ndërsa në rregjistrin nr. 2 vijon të punohet në të, për punësimet e reja.

-Shoqëria ka të miratuar në administratën e saj 81 punonjës, nga të cilët 81 me arsim të lartë. Shoqëria nuk ka të përcaktuar ndryshimin e punonjësve në zgjerimin në numrin e punonjësve me arsim të lartë. Shtimi i punonjësve në administratë, dhe në drejtim të sektorëve pa një miratim të KA sipas përcaktimeve sipërcituar dhe AP. Në total janë 96 persona me arsim të lartë që mbajnë pozicione drejtuese. Impiantit i Trajtimit të Ujrave të Ndotur, Drejtoria Juridike, Drejtimi i degëve, Dega e Burimeve Njerëzore etj, kanë personel të pa përcaktuar me vendim të organeve drejtuese, që rit edhe numrin punonjësve në administratën e shoqërisë.

-Shoqëria ka shtim të numrit të punonjësve me 45 punëmarrës të rinj, të aprovuar nga AP dhe KA i shoqërisë, për strukturën e vitit 2017 dhe vitit 2018. Respektivisht me vendimet e AP nr. 12/1, nr. 5 dhe nr. 25. këto vendime nuk specifikojnë nevojën ku do të punësohen këta punonjës. Nga auditimi i dosjeve të personelit, si edhe nga të dhënat e Degës së Burimeve Njerëzore, paraqitur për informacion, konstatohet se në këtë periudhë ka shtim të numrit të punonjësve edhe në administratën e shoqërisë.

-Shoqëria ka të punësuar në punë me turne në 79 raste punonjës që kanë problet më poshtë të evidentuara: -Sektori Shijak me përgjegjës Z. I.D..

Stacioni 330 Fushë Krujë 4 punonjës, Stacioni Qendror Fushë Krujë 8 punonjës, Stacioni Pjezë 4 punonjës, që janë angazhur në 30 ditë punë nga 8 orë punë ditore, të alternuar mes tre ditëve ku dita e parë pushim, dita e dytë turn i parë dhe dita e tretë 16 orë punë turn i dytë dhe i tretë së bashku. Në total 12 punonjës. Depo Shilore, janë 4 punonjës që kanë punuar në sistem 24 orësh me 2 ditë pushim, e barasvleshme me 30 ditë pune çdo muaj, plus një ditë ekstra pushim në muaj.

-Sektori i kanalizimeve me përgjegjës Z. B.M..

Stacioni nr. 7, Stacioni nr. 8, Stacioni nr. 9, Stacioni nr. 6, së bashku kanë 17 punonjës që punojnë 24 ditë pa ndërprerje duke alternuar turnet, e cila pasohet me 7 ditë radhë pushim.

Stacioni nr. 4, Stacioni nr. 5, Stacioni nr. 1 nga auditimi rezultojnë 6 punonjës që punojnë 6 ditë nga 8 orë çdo javë, në total 48 orë në javë, e cila pasohet nga 1 ditë pushim.

-Dega e Shpërndarjes me përgjegjës Z. E.K.

Dispeçeria dhe manovrator Qyteti Durrës 13 punonjës që janë mbajtur në punë 27 ditë punë nga 8 orë çdo ditë.

Depo 1, Depo 2, Manovratorët Xhafzotaj, Depo 3, Depo 4, Depo e Re Arapaj janë 23 punonjës që kanë punuar 24 ditë pa ndërprerje, duke konsumuar 7 ditë pushim më pas.

Depo e Re, Depo Rashbull, Depo Shën Vlash, janë 3 punonjës që janë angazhuar në punë në 6 ditë të javës nga 8 orë, dhe më pas 1 ditë pushim. Në total 48 orë punë në javë.



Paga në të gjitha rastet është konsideruar si pagë në kohë normale pune, përjashtuar rastet kur kanë punuar turn i tretë.

-Task Forca operon në terren në bazë disa urdhëresave të lëshuar nga Administratori, por pa lëshuar njoftime paraprake mbi abonentët mbi mënyrën dhe llojin e penaliteteve deri në ndërprerje të furnizimit me ujë në rastet e debitorëve. Kjo strukturë nën vartësinë e Degës së Debitive, nuk ka asnjë gjurmë në protokolin e shoqërisë për aktivitetin që kryen, njoftimin paraprak dhe ndërprerjen e debitorëve, pa një plan të detajuar dhe koordinuar me Administratorin.

-Shoqëria ka një kontratë kolektive të dakordësuar me Këshillin Sindikal të Federatës së Sindikatave të Ndërtimit, Zhillimit Urban dhe Administratës Publike të Shqipërisë (FSNZHUAPSH), e përfaqësuar nga Z. I.K., dhe UKD SHA e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm në cilësinë e punëdhënësit, Z. S.K.. Kjo kontratë e vleshme prej datës 11.03.2015 deri në datën 11.03.2018, për një periudhë tre-vjeçare.

Pas përfundimit të kësaj kontrate Shoqëria ka një kontratë kolektive me Sindikatën e Punonjësve të Administratës dhe Shërbimeve Publike (SPASHPD), Durrës të dakordësuar mes përfaqësueses së SPASHPD Znjsh. Xh. Xh., dhe punëdhënësit. Të dyja këto kontrata kanë mospërputhje me Kodin e Punës.

Neni 11 i kontratës parashikon *“Kohëzgjatja normale e javës së punës është jo më pak se 40 orë, e ndarë kjo në 5 ditë nga e hëna në të premte”*. Ky nen është diskriminues sepse lejon punësimin e punonjësve mbi 40 orë në javë, në kundërshtim me Kodin e Punës.

Neni 13 i kontratës parashikon *“Punonjësit që punojnë me 3 turne gëzojnë të drejtën e jo më pak se 2 ditë pushim në muaj të barasvleshme me ditën e diela për punonjësit e ditës”*. Ky nen i kontratës është diskriminues, pasi krijon mundësinë e heqjes së 6 ditëve pushim, nga minimumi 8 që duhet të ketë një punonjës në muaj. Fenomen ky i ndodhur realisht në UKD SHA, siç është cituar më sipër. Për periudhën nën auditim janë punësuar 102 punonjës për vitin 2017 dhe 68 punonjës për vitin 2018. Në asnjë rast nuk ka njoftime nga ana e shoqërisë për kriteret e këtyre punësimeve, as në zyrën e punës dhe as në faqen zyrtare të shoqërisë në internet. Shoqëria nuk ka një praktikë të konsoliduar për kërkesat që ka për rekrutimet e reja në personelin e punonjësve.

-Për periudhën nën auditim nga ana e shoqërisë janë paguar për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, vlera prej 4,125,144 lek e cila është e likuaduar plotësisht, si detyrim ndaj vendimeve gjyqësore. Ndërkohë janë dy punonjës të cilët kanë ankimuar në gjykatën e apelit për një vlerë respektive 28,000 lek dhe 40,000 lek, dëmshpërblim.

-Shoqëria ka bërë ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për 28 punonjës në vitin 2017 dhe për 21 punonjës në vitin 2018 deri në datën 31.10.2018. Në asnjë rast nuk janë zbatuar procedurat e njoftimit dhe të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, sipas procedurave të Kodit të Punës. Mbajtja e vendimit të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, nuk bëhet në protokollin modular Mod. 1, por në protokollin e brendshëm. Ky veprim nuk lejon të krijohet bindje e arsyeshme për rigozitetin në zbatim të vendimeve të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës dhe afatet e njoftimit. Në asnjë rast nuk ka kundër firmë të punonjësit të cilit i ndërpritet marrëdhënia e punës. Për këtë arsye një numër prej 8 personash janë në proces gjyqësor me shoqërinë për të ankimuar ndërprerjen e njëanëshme të marrëdhënieve të punës. Nuk ka masa paraprake ndaj punonjësve, para se t'ju zgjidhet marrëdhënia e punës nga ana e shoqërisë.

Gjatë periudhës nën auditim u konstatua se shoqëria nëpërmjet Degës së Burimeve Njerëzore ka dhënë masa disiplinore për 76 punonjës në vitin 2017 dhe 30 masa disiplinore për vitin 2018. Këto masa janë shprehur me vendim të administratorit. Grupi i auditimit gjeti parregullsi në



dokumentimin e këtyre masave, shkaqeve dhe arsyeve të dhënies së masave. Mungojnë raportet e plota të llojit të shkeljes dhe ballafaqimi me punonjësit.

-Nga auditimi i dosjeve të personelit u konstatua se në to ka mangësi, në një pjesë të dosjeve lidhur me përmbajtjen e inventarit të dosjes. U morën me përzgjedhje 50 dosje të personelit të shoqërisë dhe konkludoi, se një pjesë e tyre kishin mangësi në dokumentacionin e inventarit të dosjeve. Në 8 raste mungonin diplomat e të punësuarve, të noterizuara. Ky dokumentacion u plotësua gjatë auditimit. Kishte mungesa në dokumentacione të tjera shtese, për dosjet e personelit që kanë paraqitur dëshmi penaliteti nëpërmjet gjykatës, dhe prokurorisë. Kryesisht këto mungesa kishin të bënin me rekrutime të herëshme në UKD, para se dëshmia e penalitetit të lëshohej Drejtoria e Përgjithëshme e Burgjeve, në Ministrinë e Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë. Dosjet përgjithësisht ishin të plota dhe aty përmbahen si: karta e identitetit, certifikat familjare, dëftesa/diploma e studimeve të kryera (fotokopje të noterizuara), për kurset e trajnimit, gjuhët e huaja, dëshmi penaliteti, etj. Nuk ka mungesa të dokumentacionit në dosjet e personelit në pjesën më të madhe të tyre, si dhe ato janë të inventarizuara në përmbajtjen e tyre bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” në Republikën e Shqipërisë.

- Në procedurën për mbledhjen e të dhënave për ditët e punës së kryer nga çdo punonjës hartohet listë prezenca dhe nënshkruhet nga drejtuesit përkatës të sektorëve, ku me pas hartohet borderoja mbi bazën e nivelit të pagës, vjetërisë në punë, ushqimit, kryer llogaritjet për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore plotësohet listë-pagesa përkatëse dhe dërgohet në bankë për pagesë.

Janë kryer ndalesat për tatimin e të ardhurave personale nga punësimi sipas përcaktimeve në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe janë paguar brenda datës 20 të muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa. Është përlllogaritur, ndalur dhe derdhur në organet tatimore kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mbi bazën e pagës minimale dhe maksimale si dhe përqindjeve përkatëse punëdhënës e punëmarrës sipas VKM nr. 1114, datë 30.7.2008 i ndryshuar “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nr. 9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 26, datë 16.4.2009 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” i ndryshuar. Afatet e deklarimit dhe pagesës së kontributeve janë në varësi të statusit të personit që detyrohet të paguajë kontributet dhe përcaktohen në nenet 10 dhe 11 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i përcaktuar jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës. Pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi, si dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, është sipas tabelës.

PERMBLEDHESE SHPERBLIM JANAR - TETOR 2018

NR	Muaji	Ndihme Ekonomike	Shperblim Pensioni	Shperblim Pune te mire	Shperblim Lindje	Totali Mujor
----	-------	---------------------	-----------------------	---------------------------	---------------------	-----------------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS
KANALIZIME SH.A. DURRËS

1	Janar	-	50,000	-	50,000	100,000
2	Shkurt	-	-	-	50,000	50,000
3	Mars	33,000	164,000	-	50,000	247,000
4	Prill	35,000	140,000	-	50,000	225,000
5	Maj	101,000	120,000	-	50,000	271,000
6	Qershor	133,000	113,000	-	-	246,000
7	Korrik	-	120,000	-	-	120,000
8	Gusht	55,000	-	225,000	-	280,000
9	Shtator	135,000	-	-	78,000	213,000
10	Tetor	198,000	-	-	25,000	223,000
11						-
12						-
	Total	690,000	707,000	225,000	353,000	1,975,000

Burimi: Të dhëna të UKD Sha, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH Tabela 4; Shpërblimet 2018

Përsa i përket borderove nga muaji Janar 2017 deri në muajin Dhjetor 2017, janë vënë në dispozicion borderotë orgjinale (bashkangjitur listëprezencat e paraqitur nga përgjegjesit e Sektoreve). Listëpagesat dorezuar online pranë Drejtorisë së Tatimeve Durrës për periudhën Janar 2017 – Dhjetor 2017. Përsa i përket fondit të pagave sipas Programit Ekonomik të miratuar me vendim të KA dhe AP për vitin 2017 ka qenë 326.684.145 leke nga të cilat 279.935.000 lek fond page dhe 46.749.145 lek fond sigurime shoqërore + shëndetësore.

Për vitin 2017 janë ezauruar 273.528.816 lek për fond page dhe 45.533.510 lek për fond sigurimesh në total 319.062.326 lek (Sipas Tabelës 5)

Tabela 5. Pagat 2017

EMËRTIMI	VITI 2017
Fondi paga sipas Programit	326.684.145
Fondi i pagave Gjithesëj	319.062.326
Fondi i pagave të punonjësve	273.528.816
Fondi për sig. shoqërore 15 %	40.878.148
Fondi për sig. shëndetsore 1.7%	4.655.362
% Realizimit të Fondit	97.67%
Detyrim për TAP	6.361.400
Gjoha për pagesë me vonesë	0
Interesa për pagesë me vonesë	0
Detyrim për sigurime shoq.+ shënd 29.7 %	76.070.478
Gjoha për pagesë me vonesë	0
Interes për pagesë me vonesë	0

Burimi: Të dhëna të UKD Sha, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH Tabela 5; Pagat 2017

**Tabela 6. Shpërblimet për periudhën Janar 2017 – Dhjetor 2017**

FORMA E SHPERBLIMIT	SHUMA NE LEKE
Total shperblim sipas programit ekonomik 2017	26.000.000
Ndihma Ekonomike	636.000
Shperblime per pension	930.000
Shpenzime per Pune te Mire	400.500
Shperblime Lindje	266.000
TOTALI	2.232.500
TATIM SHPERBLIMI 15 %	334.875
SHPERBLIM NETO	1.897.625
% Realizimit te Fondit Shperblimit	8.59%

Burimi: Të dhëna të UKD Sha, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH Tabela 6; Shpërblimet 2017

Përsa i përket borderove nga muaji Janar 2018 deri në muajin Tetor 2018 janë vënë në dispozicion borderotë orgjinale (*bashkangjitur listëprezencat e paraqitur nga përgjegjesit e Sektoreve*). Listëpagesat janë dorëzuar online pranë Drejtorisë së Tatimeve Durrës për periudhën Janar 2018 – Tetor 2018. Përsa i përket fondit të pagave sipas Programit Ekonomik të miratuar me vendim të KA dhe AP për vitin 2018 është 336.810.204 lek nga të cilat 288.612.000 lek fond page dhe 48.198.204 leke fond sigurime shoqërore + shëndetsore .

Për periudhën janar – tetor 2018 janë ezauruar 236.330.425 lek për fond page dhe 39.361.749 leke për fond sigurimesh ne total 275.692.174 lek. (Sipas Tabelës 7).

Tabela 7

EMRTIMI	JANAR – TETOR 2018
Fondi Paga Sipas Programit Janar - Tetor	280.675.170
Fondi I Pagave Gjithesej	275.692.174
Fondi I pagave te pononjesve	236.330.425
Fondi per sig.shoqerore 15 %	35.340.417
Fondi per sig.shendetsore 1.7%	4.021.332
% Realizimit te Fondit	98.22%
Detyrim per TAP	5.585.424
Gjoha per pagese me vonese	0
Interesa per pagese me vonese	0
Detyrim per sigurim shoq.+ shend 29.7 %	65.767.384
Gjoha per pagese me vonese	0
Interes per pagese me vonese	0

Burimi: Të dhëna të UKD Sha, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH Tabela 7; Pagat 2018

Shpërblimet per periudhen Janar 2018 – Tetor 2018



FORMA E SHPERBLIMIT	SHUMA NE LEKE
Shpërblim sipas programit ekonomik	7.000.000
Ndihma Ekonomike	690.000
Shperblime per pension	707.000
Shpenzime per Pune te Mire	225.000
Shperblime Lindje	353.000
TOTALI	1.975.000
TATIM SHPËRBLIMI 15 %	296.250
SHPËRBLIM NETO	1.678.750
% Realizimit te Fondit te Shpërblimit	28.21%

Burimi: Të dhëna të UKD Sha, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH Tabela 8; Shpërblimet 2018

Me vendim nr. 581/1, datë 06.03.2017 janë dhënë shpërblime për 21 punonjës, me vendim të Administratorit, në një vlerë prej 210,000 lek.

Me vendim nr. 3487/2, datë 29.12.2017 janë dhënë shpërblime nga Administratori për 3 punonjës, në një vlerë prej 101,000 lek.

Me vendim nr. 3312/2, datë 21.12.2017, ju është dhënë gjysëm page shpërblim 8 punonjësve, me vendim të Administratorit, në një vlerë prej 140,000 lek.

Me vendim nr. 2400/2, datë 15.08.2018, të Administratorit janë dhënë shpërblime për 5 punonjës, në një vlerë prej 225,000 lek.

Këto shpërblime u gjetën në përputhje me kontratën kolektive të punës.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

- 1) Shoqëria nuk ka strukturë të miratuar për periudhën nën auditim, që të përputhet numrin e punonjësve me vendet e aprovuara të punës për çdo drejtori/degë/sector.
- 2) Shoqëria nuk ka të përcaktuar nivelin arsimor, dhe profilin arsimor për çdo vend pune.
- 3) Shoqëria ka të miratuar nga AP një rritje në strukturë të numrit total të punonjësve, por pa specifikuar ku do të punësohen ata.
- 4) Shoqëria në 79 raste ka mbajtur në punë punonjësit në orare të tejzgjatura mbi 40 orë në javë, pa pagesë suplementare, pa respektuar ditët e pushimit për ata.
- 5) Struktura e re e Task Force e pa autorizuar nga organet drejtuese.
- 6) Shoqëria nuk ka një kontratë të rregullt kolektive të punës.
- 7) Nuk ka rregulla për punësimet e reja në shoqëri. Kërkesat për vendet e punës së kërkuara nuk janë të specifikuara mbi formimin profesional dhe arsimin e kërkuar të punonjësve të rinj. Mungojnë njoftimet zyrtare për vendet e lira të punës.
- 8) Ndërprerjet e marrëdhënieve të punës në disa raste janë në kundërshtim me Kodin e Punës.
- 9) Shoqëria ka një detyrim financiar ndaj punonjësve për ndërprerje të njëanëshme të marrëdhënieve të punës nga ana e UKD SHA.
- 10) Masat disiplinore ndaj punonjësve nuk janë të verifikueshme se janë marrë në respektim të kontratës kolektive të punës.
- 11) Shoqëria ka mangësi në dokumentacion të dosjeve të personelit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

- 1) Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".



- 2) Rregulloren e funksionimit të shoqërisë, (*Manual i Organizimit*).
- 3) VKM nr. 63 datë 27.01.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”
- 4) Kontratën kolektive të punës.
- 5) Kodin e Etikës së UKD.
- 6) Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”
- 7) Ligjin nr. 131/2015, “Për qendrën kombëtare të biznesit”.

Pika 5. Mbi mbajtjen e evidencës kontabël, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, evidentimin, ndjekjen dhe pasqyrimin e debitorëve dhe kreditorëve, si dhe përlllogaritjen, njohjen, regjistrimin dhe pagesën e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Nga auditimi u konstatua se:

Me vendim nr. 5/1, datë 27.06.2018 të Asamblesë së Aksionerëve “Për miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë UK Durrës sha për vitin 2017”, janë miratuar pasqyrat financiare të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Durrës sha për periudhën që u mbyll më 31 dhjetor 2017.

Me vendim nr. 9 prot, datë 11.06.2018 të Këshillit të Administrimit “Për miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë UK Durrës sha për vitin 2017”, janë miratuar pasqyrat financiare të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Durrës sha për periudhën që u mbyll më 31 dhjetor 2017, sipas materialit dhe raportit të ekspertëve kontabël të regjistruar bashkëlidhur vendimit.

Me shkresën nr. 2008/1 prot, datë 08.06.2018 “Propozim për miratimin e pasqyrave financiare për periudhën që u mbyll më 31.12.2017” të Administratorit të UKD, i janë dërguar Asamblesë pasqyrat financiare të vitit 2017 sëbashku me shënimet shpjeguese të tyre, si dhe raporti i ekspertëve kontabël të regjistruar.

Me shkresën nr. 1999 prot, datë 08.06.2018 “Pasqyrat financiare për periudhën që u mbyll më 31.12.2017” të Drejtorit Tregtar i janë dërguar Administratorit të UKD, pasqyrat financiare të vitit 2017 sëbashku me shënimet shpjeguese të tyre.

Informacion Ligjor

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sha, është krijuar me vendimin e gjykatës Durrës nr. 24509/0 datë 30/08/2000 në vijim të vendimit të Gjykatës së Rrethit Durrës, bazuar në vendimin e aksionerit të vetëm, Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për krijimin e Ndërmarrjes Ujësjiellës Kanalizime Qytet Sha, me kapital aksioner prej 261,772,000 lekë, Aksione 261,772 me vlerë nominale 1,000 Lek/aksion, tërësisht i paguar me kontribute në natyrë. Kompania operon në aktivitetin e Furnizimit me ujë të pijshëm të konsumatorëve, shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impiantit të pastrimit të tyre.

Krijimi i saj është realizuar në bazë të urdhërit të Ministrit të Ekonomisë dhe Privatizimit, vendim i marrë në vijim të nenit 2, të ligjit nr 8237 datë 01.09.1997 “Për disa ndryshime të Ligjit nr.7926 datë 20.04.1995 “Për Transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregëtare”, i ndryshuar me dekretin Nr 1195 datë 14.08.1995, Ligjin Nr 8099 datë 28.03.1996, dekretin 1631 datë 1.11.1996 dhe ligjin 8158 datë 7.11.1996, ligjin nr 8158 datë 7.11.1996”, dhe VKM Nr 58 datë 24.2.2000 “për Kriteret e Vlerësimit të Kapitalit Themeltar të shoqërive shtetërore që do të krijohen nga shndërrimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregëtare”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS
KANALIZIME SH.A. DURRËS

Aksionerët në UKD janë si vijon:

Nr.	Emertimi I Aksionerit	Nr. Aksioneve	Vlera e kapitalit	% Aksioneve
1	Bashkia Durres	341,483.55	341,483,552	76.4
2	Bashkia Shijak	51,848.29	51,848,288	11.6
3	Bashkia Kruje	30,393.82	30,393,824	6.8
4	Bashkia Vore	12,515.10	12,515,104	2.8
5	Bashkia Kurbin	10,727.23	10,727,232	2.4
	TOTAL Aksione	446,968.00	446,968,000	100

Liçensa e shoqërisë është rinovuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator i Ujit me vendim Nr.28 datë 18.07.2017 i KKRr, pas një procesi monitorimi dhe vlerësimi të përmbushjes së të gjitha kërkesave për këtë liçencë nga Enti Rregullator i Ujit në bazë të Ligj Nr. 8102 datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura”.

Adresa ligjore e saj është në Rr. “Dlip Peza” Lgj. 17, Durrës, shoqëria është subjekti i regjistruar me TVSH dhe është pajisur me NIPT J61819502V. Me 31 Dhjetor 2017 shoqëria kishte 674 punonjës.

Bilanci i shoqërisë:

DETYRIMET DHE KAPITALI		Shenimet	2017	2016
Detyrime afatshkurtra:		5	3,412,178,485	2,574,433,322
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	5.1	1,147,491,751	1,039,649,669
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit (furnitore)	5.2	2,247,188,175	1,520,436,228
8	Të pagueshme ndaj punonjësve	5.3	16,872,065	12,904,398
9	Të pagueshme për detyrimet tatimore	5.4	626,494	1,443,027
Totali i Detyrimeve afatshkurtera			3,412,178,485	2,574,433,322
Detyrime afatgjata:		6	1,587,533,060	1,727,276,947
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	6.1	1,005,236,975	1,264,226,749
8	Të tjera të pagueshme	6.2	582,296,086	463,050,198
Detyrime tatimore të shtyra		6.3	33,341,382	56,385,223
Totali i Detyrimeve afatgjata			1,620,874,442	1,783,662,170
DETYRIMET TOTALE			5,033,052,927	4,358,095,492
Kapitali i Nënshkruar		8	446,968,000	446,968,000
Rezerva rivlerësimi		9	514,229,468	514,229,468
Fitimi i pashpërndarë		10	-1,495,043,180	-1,471,893,197
Fitim / Humbja e Vitit		11	-25,671,788	-32,011,119
Totali i Kapitalit			-559,517,500	-542,706,848
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT			4,473,535,427	3,815,388,644



A K T I V E T		Shënimet	2017	2016
Aktivitet Afatshkurtra			1,488,469,645	1,174,175,970
▶	Aktivitet monetare	1	55,967,701	46,064,969
▶	Të drejta të arkëtueshme	2	1,217,625,121	1,008,728,731
▶	Inventarët	3	214,876,823	119,382,270
TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA			1,488,469,645	1,174,175,970
Aktivitet Afatgjata			2,985,065,782	2,641,212,674
▶	Aktivitet materiale	4	2,985,065,782	2,641,212,674
TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA			2,985,065,782	2,641,212,674
A K T I V E T O T A L E			4,473,535,427	3,815,388,644

Politikat kontabël

1) Raportimi i Segmenteve të Biznesit.

UKD Sha drejton aktivitetin e tij nëpërmjet segmenteve kryesore;

-Aktivitetet e Rregulluara (ku përfshijnë: shpërndarjen e ujit të pijshëm, instalimin e matësve, instalimin e pikëlidhjeve me rrjetin, azhornimin e rrjetit, largim e ujërave të ndotur, shitjen e ujit me bot

-Aktivitetet e Parregulluara (ku përfshihen: Pastrimi i Kanaleve /Pusetave me Bote, mirëmbajtje për llogari të tretëve etj)

-Veprimtaria administrative e Kompanisë.

2) Konvertimi i transaksioneve në monedhe të huaj

(i) Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësia (“monedha funksionale”). Pasqyrat financiare në Shqipëri paraqiten në Lekë (All), e cila është dhe monedha e paraqitjes.

(ii) Transaksionet dhe tepricat

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në fund të periudhës kontabël, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj date. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin “të tjera të ardhura (shpenzime) financiare”.

Datë / Currency	31 dhjetor 2017
Euro	132.95
USD	111.10

Referuar shënimeve shpjeguese të UKD:

Për përcaktimin e kostos së inventarëve është zgjedhur metoda "FIFO" (hyrje e parë, dalje e parë). (SKK4)

Vlerësimi fillestar i një elementi të AAM që plotëson kriteret për njohje si aktiv në bilanc është vlerësuar me kosto. (SKK5)

Për prodhimin ose krijimin e AAM kur kjo financohet nga një hua, kostot e huamarrjes (dhe interesat) është ndjekur metoda e kapitalizimit në koston e aktivit për periudhën. (SKK5).



Për vlerësimin e mëposhtëm të AAM është zgjedhur modeli i kostos duke i paraqitur në bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar. (SKK5).

Për llogaritjen e amortizimit të AAM (SKK 5:) është përcaktuar si metodë e amortizimit të A.Agj.M. metoda e amortizimit mbi bazën e vleftës së mbetur ndërsa normat e amortizimit i përmbahen atyre të përcaktuara nga sistemi fiskal në fuqi dhe konkretisht:

- Për ndërtesat, Rrjete Ujësjellës Kanalizime me 1.5 % të vleftës së mbetur.
- Për Makineri dhe Pajisje Pune me 3% të vleftës së mbetur.
- Për Mjete Transporti me 7% të vleftës së mbetur.
- Për Kompjuterat e Sisteme Informacioni me 25% të vleftës së mbetur.
- Për Mobilje dhe Pajisje Zyre me 20% të vleftës së mbetur.

Informacion mbi veprimtarinë

a. Informacion mbi produktet kryesore dhe shërbimet e UKD

Bazuar në vendimin Nr. 28 të KKRR në datë 18.07.2017 i KKRR, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë, liçenca është e vlefshme deri me dt.17.07.2021 Objekti i Liçensës sipas Ligjit Nr. 8102, datë 28.03.1996. Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” si dhe VKM nr. 958, datë 06.05.2009 “Për miratimin e kategorive të liçencimit dhe të procedurave për aplikim për liçencë.....” është të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

-Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

-Kategoria C, Për largimin e ujrave të ndotura

-Kategori D: Për Trajtimin e ujrave të ndotura

në zonat e shërbimit të këtij operatori që janë:

Bashkia: Durrës, Shijak, Vorë, Bupq, Fushë Kuqe, Thumanë

Përsa bazuar në liçensë UKD ofron shërbimet e mëposhtme:

furnizimin e ujit të pijshëm

instalimin e matësve

instalimin e pikëlidhjeve me rrjetin

azhurnimin e rrjetit

largimin e ujërave të ndotura

trajtimin e ujërave të ndotura

shitjen e ujit me bote etj.

Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare përgatiten duke u bazuar në koston historike, me përjashtim të disa kategorive të aktiveve dhe detyrimeve, në përputhje me Standartet Kombëtare të Raportimit Financiar. (SKK).

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK kërkon që të përdoren disa vlerësime kontabël të rëndësishme. Gjithashtu kërkohet që Drejtimi të ushtrojë gjykimin e vet përsa i përket politikave kontabël që aplikohen në kompani. Këto fusha përfshijnë një shkallë të lartë gjykimi dhe kompleksiteti, ose janë fusha ku supozimet ose vlerësimet janë të domosdoshme për pasqyrat financiare të konsoliduara.

Ato përfshijnë standartet e aprovuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK) dhe interpretimet e standarteve të botuara nga Komiteti i Interpretimeve të Standarteve të Raportimit Financiar.

Aktivitet monetare



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A. DURRËS

Emërtimi i llogarise	Gjendje 31.12.2017	Gjendje 31.12.2016
Llogaria bankare	55,967,701.46	46,064,968.88
Llogaria Arkë	0.00	0.00
Shuma	55,967,701.46	46,064,968.88

1.1 Bankat

Llogaritë me bankat përfaqësojnë gjendjen e mjeteve monetare pranë bankave në fund të periudhës ushtrimore si vijon klasifikuar llogari arkëtimelesh dhe llogari shpenzimesh:

Banka dt 31.12.2017	Llog arkëtime	Llog shpenzime	Total
Banka Raiffeisen	-250.00	4,100,348.54	4,100,098.54
Banka Credins	2,415,835.87	14,633,907.84	17,049,743.71
Banka Procredit	320,738.74	4,924,566.48	5,245,305.22
Banka Kombëtare Tregtare	9,396,452.91	233,690.30	9,630,143.21
Banka Intesa San Paolo	786,215.55	817,904.88	1,604,120.43
Banka Union	5,528,820.51	2,992,715.48	8,521,535.99
Banka Tirana	568,547.98	2,972,746.94	3,541,294.92
Banka Alpha	3,930,259.06	0.00	3,930,259.06
American Bank of Investments	737,769.85	677,841.38	1,415,611.23
Banka Societe Generale Albania	476,299.62	330,265.99	806,565.61
Banka Kombëtare Greke	0.00	0.00	0.00
First Investment Bank Albania	123,023.54		123,023.54
TOTALI	24,283,713.63	31,683,987.83	55,967,701.46

2. Të drejta të arkëtueshme.

Përfaqësojnë respektivisht të drejtat ndaj klientëve të shitjes së shërbimit si dhe të drejta që lidhen me llogari të tjera të arkëtueshme:

Përshkrimi i llogarive	31.12.2017	31.12.2016
Klientë për mallra produkte&shërbime vlera e mbetur	1,030,702,272	881,239,389
Llogari të tjera të arkëtueshme	186,922,850	127,489,342
TOTAL	1,217,625,121	1,008,728,731

2.1 Llogaritë e Arkëtueshme nga Klientët për Furnizimin me Shërbime

Llogaritë e arkëtueshme përfshijnë shuma e të drejtave që i kanë lindur Kompanisë nga aktiviteti i shitjes të shërbimit ujë dhe kanalizime si edhe shërbime të tjera të cilat i ofron kjo shoqëri. Krahas vlerës së klientëve nga vitet e kaluara mbartet një zhvlerësim i klientëve sipas kategorive të tyre shprehur si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS
KANALIZIME SH.A. DURRËS

Emërtimi i klientëve	31.12.2017	31.12.2016
Klientë familjarë	1,950,820,147	1,782,873,702
Klientë private	291,126,759	273,271,753
Klientë buxhetorë	113,223,001	105,007,810
Klientë për shërbime tjera/sistemime	-210,810,334	-163,378,844
Shuma e klientëve	2,144,359,574	1,997,774,420
Proviz. për zhvlerës. e aktiveve financiare -KL Familiar	954,313,402	954,598,903
Proviz. për zhvlerës. e aktiveve financiare -KL Privat	105,938,063	108,530,291
Proviz. për zhvlerës. e aktiveve financiare -KL Ente	53,405,837	53,405,837
Totali gjendja provizioneve për zhvlerësimin e klientëve	1,113,657,302	1,116,535,031
Gjendje klientë neto	1,030,702,272	881,239,389

Në vitin 2017 ndërmarrja ka humbur nëpërmjet vendimeve të gjykatës 2,937,849 lekë për faturime ndër vite për pesë klientë nga të cilat 2,877,729 lekë i përkasin faturimeve 2008-2014 të cilat janë provizionuar për humbje të vlerës dhe kanë rënduar koston e atyre viteve dhe për këtë arsye sistemohen vlera e klientëve me vlerën e provizioneve. Ndërkohë, 60'120 lekë i përkasin humbjeve në vlerë për vitet 2015-2017 për të cilat nuk ka provizione dhe për këtë arsye janë kaluar në shpenzime të periudhës.

Gjithashtu në fund të vitit ushtrimor, për vlerën e arkëtimeve dhe faturimeve për klientë merren dhe krahasohen raportet në sistemin Billing me sistemin në kontabilitet dhe kryhen veprime sistemuese midis klasave përkatësisht me dt. 31.12.2017 është kryer veprim sistemues për arkëtimet. Vlera e arkëtuar në Billing me vlerën e arkëtuar në kontabilitet nuk ka diferencë por janë kryer sistemime ndërmjet klasave të artikujve pra ndërmjet klasës “Klientë” me klasat “Taksë Bashkie” dhe “Kamatvonesa” për total vlerën 238 mijë lekë.

Klientë në shifra totale

Përshkrimi i llogarive	31.12.2017	31.12.2016
Klientë për mallra produkte e shërbime	2,144,359,574	1,997,774,420
Zhvlerësim të drejta dhe detyrime për klientë	-1,113,657,302	-1,116,535,031
Klientë vlerë të mbetur	1,030,702,272	881,239,389

2.2 Llogari të tjera të arkëtueshme.

Llogaritë e arkëtueshme përfshijnë të drejtat që i kanë lindur kompanisë nga paradhënie të ndryshme për shpenzime të parapaguara si edhe të drejta ndaj shtetit apo punonjësve të shoqërisë si edhe ndaj Institucioneve Financiare për arkëtime të faturave UKD.

Përshkrimi i llogarive	31.12.2017	31.12.2016
Parapagime të mara zyra përmbar/Punonjës	574,522	574,522
Personeli debitor e kreditor	819,079	904,253
Sig shoq për raporte	0	0
Dega e përfitimeve afatshkurtra sigurime detyrime për tu arkëtuar	438,447	759,374
TVSH	138,122,972	87,780,883
Të drejta detyrime ndaj aksionerëve	664,224	841,106
Debitorë vendim gjykate	0	1,037,218
Debitorë të tjerë	14,852,304	14,876,304
Garanci përmbarues privat	24,520,429	19,231,083



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS
KANALIZIME SH.A. DURRËS

Debitorë ish punonjës	312,202	216,078
Institucione Financiare për tu arkëtuar Posta,UFT,etj	10,059,606	4,709,456
Likuidime nga Posta dhe Unioni Financiar në 2016 për arkëtime të faturave të ujit të Vitit 2015	-3,440,935	-3,440,935
TOTAL	186,922,850	127,489,342

3. Inventarët

Llogaritë e inventarëve përfshijnë gjendjet e materialeve që përdoren për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve specifike, pjesët e këmbimit për riparimin e makinerive të punës dhe mjeteve të transportit etj, të shprehura neto nga humbja e vlerës apo konsumi i tyre mbartur nga vitet e kaluara. Për vitin 2015-2017 nuk është llogaritur humbje në vlerë e tyre.

EMERTIMI	31.12.2017	31.12.2016
Iventar i imët	37,172,662	33,104,932
Zhvlerësim inventari të imët mbartur para 2015	-14,800,702	-14,800,702
Iventar i imët neto	22,371,960	18,304,230
Mallra	283,990,630	192,563,807
Zhvlerësim mallra mbartur para 2015	-91,485,767	-91,485,767
Mallra neto	192,504,863	101,078,040
TOTAL NETO	214,876,823	119,382,270

3.1 Iventar i imët

Iventari i imët në pasqyrat financiare është paraqitur me vlerën neto të tij pra pra si diferencë me zhvlerësimin e bërë nga vitet e tjera.

3.2 Mallrat, materialet

Mallrat, materialet janë paraqitur në pasqyrat financiare me vlerën neto të tyre pra si diferencë me zhvlerësimin e bërë nga vitet e kaluara.

4. Aktive afatgjata materiale

Në këtë zë paraqiten aktivet materiale me kohë përdorimi mbi një vit. Një paraqitje e aktiveve me vlerën e tyre fillestare si edhe amortizuar dhe me vlerën e tyre të mbetur, të UKD paraqitet në vijim:

Aktive sipas vlerës së tyre fillestare.

Aktivet Afatgjata Materiale me vlerë fillestare 2017

Nr	Emërtimi	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		1/1/2017			12/31/2017
1	Toka	347,500,430	0	0	347,500,430
2	Ndërtime	177,959,733	6,764,160	0	184,723,893
3	Rrjete Ujësjellësi	2,255,412,833	181,927,154	0	2,437,339,987
4	Rrjete Kanalizim	1,951,134,994	41,441,457	0	1,992,576,451
5	Makineri,paisje pune	329,937,096	132,430,001	7,800	462,359,297
6	Mjete transporti	195,901,381	16,543,000	0	212,444,381
7	Paisje Informatike	78,916,634	11,616,746	0	90,533,380
8	Mobileri Paisje Zyre	14,108,402	742,492	0	14,850,894
9	Aktive jomateriale në proces & pa amortizueshme	66,551,271	217,259,795	233,423,995	50,387,071
10	Aktive të tjera afatgj.jomateriale	24,415,970	24,633,667	664,221	48,385,416



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS
KANALIZIME SH.A. DURRËS

	TOTALI	5,441,838,744	633,358,472	234,096,016	5,841,101,200
--	---------------	----------------------	--------------------	--------------------	----------------------

Amortizimi vitit 2017 dhe ai i akumuluar në vite

Amortizimi A.A.Materiale 2017

Nr	Emërtimi	% amortizimit	Gjendje	Amortizimi 2017	Gjendje
			12/31/2016		31/12/2017
1	Toka	0	0	0	0
2	Ndërtime	1.5	20,865,742	2,946,899	23,812,641
3	Rrjete Ujësjiellësi	1.5	1,299,114,640	16,931,117	1,316,045,757
4	Rrjete Kanalizim	1.5	1,268,410,623	10,516,669	1,278,927,292
5	Makineri,paisje pune	3	28,926,952	10,833,015	39,759,967
6	Mjete transporti	7	118,347,055	6,179,859	124,526,914
7	Paisje Informatike	25	56,359,179	6,881,110	63,240,289
8	Mobileri Paisje Zyre	20	8,601,879	1,120,679	9,722,558
9	Aktive jomateriale në proces & pa amortizueshme	0	0	0	0
10	Aktive të tjera afatgj.jomateriale (Sistemi)	0	0	0	0
	TOTALI		2,800,626,070	55,409,347	2,856,035,417

Vlera e mbetur e aktiveve afatgjata materiale

Vlera Kontabël Neto e A.A.Materiale 2017

Nr	Emërtimi	Vlera Neto	Shtesa 2017	Pakesime 2017	Gjendje
		1/1/2017			12/31/2017
1	Toka	347,500,430	0	0	347,500,430
2	Ndërtime	157,093,991	6,764,160	2,946,899	160,911,252
3	Rrjete Ujësjiellësi	956,298,193	181,927,154	16,931,117	1,121,294,230
4	Rrjete Kanalizim	682,724,371	41,441,457	10,516,669	713,649,159
5	Makineri,paisje pune	301,010,144	132,430,001	10,840,815	422,599,330
6	Mjete transporti	77,554,326	16,543,000	6,179,859	87,917,467
7	Paisje informatike	22,557,455	11,616,746	6,881,110	27,293,091
8	Mobileri Paisje Zyre	5,506,523	742,492	1,120,679	5,128,336
9	Aktive jomateriale në proces & pa amortizueshme	66,551,271	217,259,795	233,423,995	50,387,071
10	Aktive të tjera afatgj.jomateriale (Sistemi)	24,415,970	24,633,667	664,221	48,385,416
	TOTALI	2,641,212,674	633,358,472	289,505,363	2,985,065,782

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme përfaqësojnë detyrimet tregtare që i kanë lindur Kompanisë gjatë aktivitetit të saj. Këto detyrime tregtare kanë një afat maturimi i cili varion në varësi të llojit të shërbimit apo aktivitetit që është blerë. Një paraqitje e detyrimeve tregtare dhe shpenzimeve të përlllogaritura për fatura për të mbërritur jepet në tabelën në vijim:

Përshkrimi i llogarive	31.12.2017	31.12.2016
Detyrime afatshkurtër	3,412,178,485	2,574,433,322



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS
KANALIZIME SH.A. DURRËS

Detyrime afatgjatë	1,620,874,442	1,783,662,170
TOTAL	5,033,052,927	4,358,095,492

5. Detyrime afatshkurtra

Përshkrimi i llogarive	Viti 2017	Viti 2016
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	1,147,491,751	1,039,649,669
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit (furnitorë)	2,247,188,175	1,520,436,228
Të pagueshme ndaj punonjësve	16,872,065	12,904,398
Të pagueshme për detyrimet tatimore	626,494	1,443,027
TOTAL	3,412,178,485	2,574,433,322

5.1 Huaja ndaj Institucioneve të kredisë

Huamarrja ndaj institucioneve të kredisë përfaqëson kontratat e nënhuasë që UKD sha ka firmosur me Ministrinë e Financave për financimin e ndërtimit të aktiveve afatgjata dhe përkatësisht:

OPEC-2002 - Marrëveshja e Nënhuasë e dt.10.10.2002 për "Projektin e Rehabilitimit të Furnizimit me Ujë" me vlerë të disbursuar deri në 31.12.2017 në vlerën 2,672,938.24 USD

BEI 2004- Marrëveshja e Nënhuasë e dt.04.05.2004 për Projektin "Infrastruktura Ujore Bashkiake" në vlerën 6,907,556.33 Euro të disbursuara deri në 31.12.2017.

IDA- 2003- Marrëveshja e Nënhuasë dt .07.07.2003 për "Projektin Bashkiak të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime" me vlerë të disbursuar 5,607,909.13 USD.

Të dhënat dhe afatet e kontratave të nënhuasë vijojnë:

INST	Dt.KONTRAT	SHUMA	FCY	AFATI	FILLIMI RIPAGES	NORMA INTERESIT	PENALITETI	KESTI MESATAR
OPEC	10.10.2002	2,672,938.24	USD	20 vjet	2007	2.75%	2.25% mbi detyrimin e pashlyer	90,000
BEI	15.04.2004	6,907,556.33	EUR	22 vjet	2013	2.12%	2.37% mbi detyrimin e pashlyer	255,978
IDA	07.07.2003	5,607,909.13	USD	20 vjet	2013	1.5%	0.00%	280,395

Për detyrimet për kreditë sipas marrëveshjeve të nënhuave janë marrë parasysh përveç kontratave të nënhuave edhe shkresat e njoftimeve të ministrisë ndër vite. Në këto shkresa jepej informacion progresiv mbi detyrimet e pashlyera si edhe për fondet e disbursuara për ato periudha.

Ndërkohë, vlen të theksohet se për kontratën e Nënhuasë IDA edhe pse kontrata fillimisht ka vlerën në SDR në vazhdim të saj, në skesionin 5.03 shprehet qartë për monedhën e huamarrjes e pohuar kjo edhe në shkresat e njoftimeve të ministrisë ku të gjitha njoftimet janë në valutën USD. Për tepricat e kredive në lidhje me detyrimet janë marrë të gjitha shkresat e ministrisë ndër vite, është hartuar plan pagesa mbi detyrimet sipas kushteve të përcaktuara në kontrata dhe njoftimeve progresive të ministrisë si edhe duke kryer rakordim me Ministrinë në lidhje me detyrimet sipas shkresave me nr.10359 prot. datë 29.05.2018 të Ministrisë si edhe tonën me nr.1306/1 datë 06.06.2018 sipas tabelës së mëposhtme.

Monedha	Projektet	Vlera e disbursuar	principal i paguar	Stoku
EUR	BEI- Infrastruktura Ujore Bashkiake	6,907,556.33	0.00	6,907,556.33



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS
KANALIZIME SH.A. DURRËS

USD	IDA-Projekti Bashkiak i Furnizimit me Ujë dhe kanalizime	5,607,909.13	0.00	5,607,909.13
USD	OPEC- Rehabilitimi i Furnizimit me Ujë	2,672,938.24	160,000.00	2,512,938.24

Monedha	Projektet	Detyrimet e Prapambetura të UK Durrës deri më 31.12.2017			Penalite me 31.12.2017	Totali i Detyrimit të UKD ndaj Ministrisë më 31.12.2017
		Interes (valutë)	Principal (valutë)	Total i Detyrimit Interes+Kamatë (valutë)		
EUR	BEI-Infrastruktura Ujore Bashkiake	984,319.41	2,299,942.87	3,284,262.28	206,754.67	3,491,016.95
USD	IDA-Projekti Bashkiak i Furnizimit me Ujë dhe kanalizime	684,543.84	2,856,601.06	3,541,144.90	0.00	3,541,144.90
USD	OPEC-Rehabilitimi i Furnizimit me Ujë	626,195.12	1,730,000.00	2,356,195.12	253,524.51	2,609,719.63

Paraqitja e Huave është realizuar duke evidentuar në zëra afatshkurtër dhe afatgjatë përkatësisht:
 -Pjesa Afatshkurtër përfaqëson shumën e detyrimit për principal dhe interesa të maturuara dhe papaguara nga UKD dhe që janë paguar nga Ministria e Financave.
 -Pjesa Afatgjatë-përfaqëson shumën e principalit të mbetur për tu paguar deri në maturim.

HUA ME MIN FIN	31.12.2017	31.12.2016	Veprimet sistemuese dt.02.01.2017	Bilanci korrigjuar në çelje
Min Fin Principali Opec	192,203,000	198,663,500		198,663,500
Min Fin Principali Bei	305,777,405	241,789,321		241,789,321
Min Fin Principal Ida	317,368,378	294,253,986		294,253,986
Min Fin Principali Interesa Opec	97,736,852	97,001,554		97,001,554
Min Fin Principali Interesa Bei	158,353,296	131,396,081		131,396,081
Min Fin Principali Interesa Ida	76,052,820	76,545,227	6,409	76,551,636
TOTALI	1,147,491,751	1,039,649,669	6,409	1,039,656,077

* Sipas veprimeve sistemuese pas aktrakordimit me ministrinë, mbi shpenzimet për interesa njohur 50 euro më pak.

5.2 Llogari të pagueshme

Përshkrimi i llogarive	31.12.2017	31.12.2016	Veprimet sistemuese dt.02.01.2017	Bilanci korrigjuar në çelje
Furnitorë	2,110,550,392	1,413,878,267	1,417,163	1,415,295,430
Kreditorë për shpronësime/Detyrime për transferimin e taksave të bashkisë	47,745,151	17,835,329	0	17,835,329
Debitorë e kreditorë të ndryshëm	88,892,632	88,722,632	0	88,722,632
TOTALI	2,247,188,175	1,520,436,228	1,417,163	1,521,853,391



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS
KANALIZIME SH.A. DURRËS

*vlera prej 1,417,163 është veprim sistemues mbi detyrimet e panjohura ndaj ERRU konfirmuar kjo edhe nëpërmjet shkresës nr.803/11 Prot. Dt.31.05.2018 si edhe shkresës së ERRU me nr.295/1 Prot. Dt. 31.05.2018.

Furnitorë

Paraqet gjendjen e furnitorëve në fund të periudhave çka tregon detyrimet që kjo shoqëri detyrohet të paguajë për shërbime apo materiale të faturuar prej tyre.

Furnitorë	31.12.2017	31.12.2016	Veprimet sistemuese dt.02.01.2017	Bilanci korrigjuar ne çelje
Furnitorë për Ndërtime & Aktive	83,130,016	45,423,500		45,423,500
Furnitorë për shërbime UKDurrës	21,614,677	13,015,544		13,015,544
Furnitorë për Materiale / Mallra	186,420,480	124,922,388		124,922,388
Energji, Telefoni, Ujë, Karburant, Roje, Qera	1,806,212,565	1,218,512,784		1,218,512,784
Institucione etj	13,172,653	12,004,052	1,417,163	13,421,215
Total	2,110,550,392	1,413,878,267	1,417,163	1,415,295,430

*Veprim sistemues për njohjen e detyrimeve të mbartura ndaj Entit Rregullator shpjeguar më lart në vlerën 1,417,163 Lekë.

5.3 Të pagueshme ndaj punonjësve.

Në këtë zë paraqiten detyrimet për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore të punonjësve dhe të antarëve të këshillit mbikqyrës.

Përshkrimi i llogarive	31.12.2017	31.12.2016
Paga punonjësve, Këshilli mbikqyrës	10,364,542	6,842,092
Sigurime shoqërore e shëndetësore	6,507,523	6,062,306
TOTALI	16,872,065	12,904,398

5.4 Të pagueshme për detyrimet tatimore

Paraqet detyrimet në fund të vitit për tatim në burim dhe Tatim mbi të ardhurat personale të punonjësve.

Përshkrimi i llogarive	31.12.2017	31.12.2016
Tatim në burim, TAP	626,494	1,443,027
TOTALI	626,494	1,443,027

6. Detyrime Afatgjata

Përshkrimi i llogarive	Viti 2017	Viti 2016	Veprimet sistemuese dt.02.01.2017	Bilanci korrigjuar ne çelje
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	1,005,236,975	1,264,226,749	-23,975,706	1,240,251,043
Të tjera të pagueshme	582,296,086	463,050,198		463,050,198
TOTALI	1,587,533,060	1,727,276,947	-23,975,706	1,703,301,241



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A. DURRËS

6.1 Huamarrje afatgjatë.

Përfaqëson shumën e principalit të mbetur për tu paguar deri në maturim.

EMERTIMI KREDISË	31.12.2017	31.12.2016	Veprimet sistemuese dt.02.01.2017	Bilanci korrigjuar ne çelje
Kredia Opec	86,984,438	147,395,500	-23,975,706	123,419,794
Kredia Bei	612,582,210	692,319,521		692,319,521
Kredia Ida	305,670,327	424,511,728		424,511,728
TOTAL	1,005,236,975	1,264,226,749	-23,975,706	1,240,251,043

*Sistemim i Kredisë Opec mbi vlerën e disbursuar më pak nga plan pagesa dhe të pa zbritur nga stoku në vlerën USD 27,061.76 (90,000-62938.24) si dhe sistemim mbi vlerën e paguar ndër vite por të pa zbritur nga stoku në vlerën USD 160,000. Referuar shkresës së MF me Nr.10359 Prot Dt 29.05.2018, dhe tonën me Nr.1306 Prot Dt 31.05.2018

6.2 Grante dhe Ndhima Qeveritare

Përfaqësojnë Grante të dhëna nga Qeveria shqiptare Nga Donatorë të Huaj për Ndërtimin e Aktiveve.

Në përgjithësi grantet që vë në dispozicion Qeveria Shqiptare nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshëm të Ujësjellës-Kanalizime në Ministrinë e Infrastrukturës janë për Ndërtimin e Aktiveve dhe për rimbursimin e shpenzimeve të energjisë.

Në vitin 2016 Shoqëria ka përfituar grante sipas Projektit Investimit nga Banka Botërore të cilët kanë vijuar edhe në vitin 2017 dhe për të cilat shoqëria ka amortizuar grantet me të njëjtën % që është amortizuar aktivi (kur destinacioni ka qenë aktiv), ndërsa kur destinacioni ka qenë inventar granti është amortizuar (pra ka kaluar në të ardhura periudhe) me vlerën e kostos së materialeve të përdorur nga shoqëria.

EMËRTIMI GRANTIT	31.12.2017	31.12.2016	Veprimet sistemuese dt.02.01.2017	Bilanci korrigjuar në çelje
Grante afatshkurtër Rrjete	0	0		0
Grante afatshkurtër Ndërtesa	0	0		0
Grante afatgjatë -Rrjete	-478,226,639	-450,754,235		-450,754,235
Grante afatgjatë shuma për tu arkëtuar	7,491,256	7,491,256		7,491,256
Grante Afatgjatë Amortizim	49,404,007	42,743,743		42,743,743
Grant Afatgjatë (5% garanci punimesh)	1,338,891	3,764,708		3,764,708
Grante afatgjatë Projekti Investimit BB ëater sector investment Project	-174,753,486	-66,295,670		-66,295,670
Grantë afatgjatë - Mjete Transporti	-2,476,835	0	-2,476,835	-2,476,835
Grante Afatgjatë Amortizim Mjete Transporti	404,550	0	231,171	231,171
Grante afatgjatë Amortizim Projekti Investimit BB Èater Sector Investment Project	14,522,171	0		0
TOTALI	-582,296,086	-463,050,198	-2,245,664	-465,295,862

*Sistemim veprimi për Automjetin Ford Ranger, dhuruar Shoqërisë me kontratë dhurimi nr.964 dt 20.05.2015 i kaluar në të ardhura të periudhës të vitit 2015. Sistemuar në grante të Shoqërisë duke prekur llogarinë e granteve dhe kapitalit të pronarit.

* Vlera me - është vendosur për të treguar balancën kreditore.

6.3 Tatim fitimi i shtyrë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A. DURRËS

3	Bashkia Krujë	30,393.82	30,393,824	6.8
4	Bashkia Vorë	12,515.10	12,515,104	2.8
5	Bashkia Kurbin	10,727.23	10,727,232	2.4
	TOTAL Aksione	446,968.00	446,968,000	100

9. Rezerva Rivlerësimi Aktivet

Këto rezerva përfaqësojnë rezultatin e rivlerësimit të tokave dhe ndërtesave në vitin 2011
Këto rezerva mund të transferohen në Llogarinë Fitim (Humbje) e Pashpërndarë:
- me nxjerrjen jashtë përdorimit ose shitjen e aktiveve për diferencën midis vlerës neto kontabël përlllogaritur mbi koston historike me vlerën neto kontabël përlllogaritur mbi vlerën e drejtë
- ose në total për vlerën e tokës dhe ndërtesës.

10. Fitimi i pashpërndarë

Përfaqëson fitim/humbjen e akumuluar deri 31.12.2016.

11. Fitim humbja e vitit

Përfaqëson humbjen e vitit 2017 në vlerën 25,671,788 lekë.

PASQYRA TË ARDHURA SHPENZIME

Shpenzime 2017

Shpenzime personeli	321,294,826 Lekë
Shpenzime Amortizimi	55,409,348 Lekë
Shpenzime për interesa Kreditë	52,529,713 Lekë
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	839,221,835 Lekë
Shpenzime Financiare	1,800 Lekë (përfshin luhatjet e kursit të këmbimit dhe shpenzime të tjera financiare)

Detajimi i Shpenzimeve	Viti 2017
Materiale	116,852,406
Materiale Projekti Banka Botërore	11,251,529
Blerje Ujë me shumicë	12,666,200
Energji Elektrike	572,071,720
Karburant	33,651,254
Kimikate	5,501,430
Shërbime Riparime O&M	16,956,862
Roje Private	13,357,547
Shpenzime të Përgjithshme Shitje	12,062,009
Shpenzime të Përgjithshme Administrative	22,078,227
Shpenzime Personeli	321,294,826
Tatime Taksa	9,312,880
Gjoha, Penalitete, Dëmshpërblime	13,459,773
Shpenzime për interesa Kreditë AGJ	52,529,713
Humbje nga Kursi i Këmbimit	1,415
Shpenzime Tjera Financiare	385
Amortizim i Aktiveve	55,409,348

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS
KANALIZIME SH.A. DURRËS****TOTALI****1,268,457,522**

Të ardhura 2017

Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit 916,503,460 Lekë

Të ardhura të tjera financiare 326,282,274 Lekë

Detajimi i të Ardhurave	Viti 2017
Të Ardhura Shitje Ujë, Kanalizime, Tarifë Shërbimi	851,982,403
Të Ardhura Ujë me Bot	1,273,939
Të Ardhura Kontrata	18,142,059
Të Ardhura NdërrimEmri	379,800
Të Ardhura Pikë Lidhje	11,391,037
Të Ardhura Shitje Matësash	16,262,627
Të ardhura nga Kolaudimi	901,625
Të Ardhura të Tjera	2,020,104
Të ardhura Kamatvonesa	14,149,866
Të ardhura nga amortizimi i grantit	21,355,813
Të ardhura nga falja e detyrimeve tatimore	23,043,841
Të Ardhura nga Subvencionet	76,000,000
Të Ardhura Gjoha dhe penalitete	103,440
Të Ardhura Agjentë Bashkia	1,772,911
Të ardhura nga kursi i këmbimit	203,679,014
Të ardhura të tjera, financiare	327,255
TOTALI	1,242,785,734

Pasqyra Cash Floë:

Gjendja e mjeteve monetare në datën 31.12.2016 paraqitet në shumën 46,064,968.88 lekë ndërsa në datën 31.12.2017 në shumën 55,967,701.46 lekë dhe në këtë ndryshim prej 9,902,732.46 lekë kanë ndikuar flukset hyrëse dhe flukset dalëse si më poshtë:

(Flukset dalëse)

Fitim humbje e vitit 2017 me	(25,671,788) lekë
Rritje të kërkesave të arkëtueshme me	(208,896,390) lekë
Rritje në gjendjen e inventarit	(95,494,553) lekë
Blerje AAM	(399,262,456) lekë
Pagesa të huave	(162,787,728) lekë
Total flukse	(892,112,915) lekë

Flukset hyrëse

Amortizimi	55,409,348 lekë
Rritje të detyrimeve të pagueshme	837,745,163 lekë
<u>Kap.pronarit/ Fitim Humbje pashpërndarë</u>	<u>8,861,136 lekë</u>
Total flukse	902,015,647 lekë

Rezultantja e flukseve hyrëse dhe atyre dalëse kanë çuar në rritjen e gjendjes së mjeteve monetare 55,967,701 lekë.

Inventarizimi

Nga grupi i auditimit u auditua dokumentacioni shkresor i paraqitur në lidhje me inventarizimin vjetor të aktiveve të shoqërisë. Në përfundim të këtij procesi është mbajtur një relacion përmbledhës nga ana e personit përgjegjës R.B. në cilësinë e Kontabilistes së AAGJ dhe



Inventarizimit. Në fund të këtij relacioni është cituar: “Gjatë procedurës grupet e punës evidentuan: 1. Aktive të reja të cilat i kanë pasqyruar në fleët përkatëse të Inventarit; 2. Probleme me vendndodhjen e materialeve; 3. Probleme me emërtimin e aktiveve; 4. Probleme me nxjerrjen jashtë përdorimit të pajisjeve të zyrës”. Për këto përfundime nuk është bërë asnjë analizë, si dhe nuk shpjegohen në mënyrë të detajuar fenomenet e vërejtura, arsyet apo edhe përgjegjësitë për to.

Opinionit në raportin e audituesve të pavarur për periudhën auditimin e pasqyrave financiare për Janar – Dhjetor 2017 është si më poshtë:

“Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31.12.2017, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në kapital dhe në pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e përfunduar në këtë datë dhe një përmbledhëse të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të besueshme të pozicionit të shoqërisë në datën 31.12.2017, si dhe të performacës financiare e pasqyrës së flukseve të parasë për ushtrimin e mbyllur në atë datë, në pajtim me SKK”.

PERFUNDIM

Nga auditimi u konstatua se:

1. Gjatë viteve të kaluara shoqëria ka shpallur si debitorë individë të cilët:

- Nuk kanë patur asnjëherë lidhje me tubacionet e ujit të pijshëm;

apo

- Kanë lidhje me tubacionet e ujit të pijshëm, por nuk kanë patur asnjëherë furnizim me ujë në banesat e tyre.

Këto raste janë faturuar për një periudhë të gjatë kohore, madje një pjesë vijnë të faturohen, duke krijuar detyrime të pritshme për shoqërinë, pa dijeninë e personave të interesuar, e për pasojë janë rregjistruar fillimisht në aktivet e shoqërisë si të drejta të arkëtueshme, e më vonë pasi është zbuluar si problematikë, Asambleja e Përgjithshme me vendimin nr. 4/3, datë 27.12.2017 ka ngrirë detyrimin e rasteve të evidentuara në shumën 39,239,693 lekë, duke u provigjonuar në bilancin e shoqërisë. Grupi i auditimit verifikoi në terren me zgjedhje të rastësishme 6 raste debitorësh, dhe konstatoi se atje vijon dërgimi i faturave në mungesë të furnizimit me ujë. Për pasojë, vlera e ngrirë nga Asambleja e Përgjithshme, edhe pse grupi i auditimit e vlerëson si vendim që nuk i jep zgjidhje përfundimtare situatës, me shumë gjasa nuk përputhet me vlerën reale të debive të krijuara nga vitet e kaluara.

2. Shoqëria nuk disponon një regjistër aktivesh përpara vitit 2017. Vlera e aktiveve afatgjata, saktësisht kategoritë e ndërtesave dhe trojeve janë të shënuara si numër aktivesh dhe si vlerë totale, dhe jo të ndara me artikuj. Gjatë viteve, për këto janë kryer rivlerësime në grup për të gjithë klasën, dhe jo për secilin artikull. Gjithashtu kjo problematikë ka sjellë përlogaritjen e amortizimit në shkallë klase dhe jo në shkallë artikulli. Kjo problematikë ka ardhur gjithashtu edhe si pasojë e mungesës së certifikatës së pronësisë për të gjitha këto aktive. Pra, aktualisht shoqëria nuk ka të saktësuar se cilat janë të gjitha aktivet e saj konkretisht, si dhe cila është vlera e secilës prej tyre.

3. Për periudhën objekt auditimi nuk u konsatuan raste të asgjësimit të aktiveve (për pjesën e aktiveve që janë të asgjësueshme), edhe pse ka artikuj të cilët janë jashtë përdorimit. Në këtë mënyrë aktivet e shoqërisë janë të ngarkuara me vlera të cilat faktikisht nuk duhet të ngarkoheshin.



Si përfundim, nga sa trajtuar më sipër, grupi i auditimit vlerëson se gjendja kontabël e paraqitur në pasqyrat financiare për vitet objekt auditimi, nuk jep siguri të arsyeshme se përputhet me gjendjen reale të shoqërisë. Mungesa e dokumentacionit dhe evidencave të mjaftueshme në lidhje me aktivet e shoqërisë, si rregjistri i aktiveve dhe certifikatat e pronësisë, pasaktësia mbi evidentimin dhe përcaktimin e debitorëve në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm duke u kaluar më pas si provigjone, kryerja e investimeve duke mos i pasqyruar ato në bilanc (impianti i ujrave të zeza me vlerë 11.5 ml Euro), anomali të cilat konstatohet se janë materiale dhe të përhapura, ndikojnë në dhënien e opinionit me reserve nga grupi i auditimit.

Shënim: Impianti i trajtimit të ujrave të ndotur, investim i përfunduar në vitin 2011 me vlerë 11.5 milion Euro, edhe pse aktualisht është në përdorim të plotë që prej vitit 2013 nga ana e UKD, nuk rezulton të jetë marrë në dorëzim. Edhe pse nga stafi i UKD në mënyrë verbale pretendohet se është marrë në dorëzim, për këtë nuk ka asnjë dokumentacion vërtetues. Ky impiant, gjithashtu dhe vetë trualli i vendndodhjes së impiantit, aktualisht nuk janë pjesë e aktiveve të shoqërisë. Në mungesë të kohës së mjaftueshme dhe dokumentacionit të nevojshëm, grupi i auditimit nuk mund të shprehet lidhur mbi këtë çështje. Drejtimi i shoqërisë duhet të qartësojë situatën e krijuar, lidhur me impiantin, duke vepruar konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Përgjigje observacionesh

Për Aktkonstatimin nr. 5 me nr. 2540/4 prot, datë 28.12.2018 të grupit të auditimit mbi auditimin e ushtruar në UKD mbi mbajtjen e evidencës kontabile, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, evidentimin, ndjekjen dhe pasqyrimin e debitorëve dhe kreditorëve, si dhe përlllogaritjen, njohjen, regjistrimin dhe pagesëm e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore., është paraqitur observacioni ardhur me shkresën nr. 56/5 prot, datë 10.01.2019.

Në lidhje konstatimin mbi procesin e inventarizimit, në observacion është sqaruar situata e shoqërisë që ka ndikuar në rezultatet e inventarizimit. Situatë e cila është trajtuar edhe nga grupi i auditimit. Sidoqoftë, vetë këto problematika të evidentuara në inventarizim, në opinion të gupit të auditimit, kërkojnë një analizë post inventarizimit, e cila mungon. Një veprim i tillë është evidentuar jo vetëm për rastin në fjalë, por edhe si një parapritë në të ardhmen, ku pas çdo problematike, është e nevojshme një analizë, si dhe bërjen pjesë në rregjistrin e riskut të shoqërisë.

Në lidhje me observacionin mbi krijimin e debitorëve në të kaluarën dhe provigjonimin e tyre, sqarojmë se grupi i auditimit, në asnjë rast nuk është shprehur se provigjonimi është veprim jo në përputhje me standartet e kontabilitetit. Si dhe duke ditur problematikën, e cila është e ndikuar në mënyrë material nga veprime të kaluara, nuk ka ngarkuar përgjegjësi individuale apo menaxheriale në lidhje me gjendjen e shoqërisë. Megjithatë, për pos kësaj, këto veprime kanë trashëguar një situatë që ndikon në paraqitjen me vërtetesi të bilancit aktualisht, dukë bërë që grupi i auditimit të japë opinion me rezervë.

Në lidhje me observacionin mbi rregjistrin e aktiveve të shoqërisë, impiantin e ujrave të ndotura dhe aktiveve të asgjësueshme, observacionet nuk janë kundërshtuese por sqarojnë masat e marra dhe që do të merren nga shoqëria në të ardhmen, të cilat grupi i auditimit i vlerëson që janë me të njëjtën frymë të asaj çka grupi i auditimit ka dashur të përcjellë nga auditimi i pasqyrave financiare të UKD.

Nga sa më sipër, grupi i auditimit mban të njëjtin opinion të shprehur në Aktkonstatim.

Observacioni i dërguar për projekt raportin nr. 417 prot., datë 21.02.2019, protokolluar në KLSH nr. 1189/9 prot., datë 25.02.2019, nuk qëndron dhe si i tillë, nuk merret në konsideratë.



Pika 6. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

Procedurat e prokurimit janë audituar bazuar në rëndësinë e objektit të prokurimit, vlerës së fondit limit, riskut të zbatimit të kontratave, përqindjes së realizimit kundrejt fondit limit, numrit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, si dhe eksperiencës së punës audituese mbi fushat me risk në prokurimet publike, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si akteve nënligjore në zbatim të tij.

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore në 27 raste të procedurave të prokurimeve e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, u konstatua se:

-Nuk janë kryer trajnime të stafit për prokurimin publik, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 83/2.

-Në 14 raste, nuk konstatohet të jetë argumentuar dhe dokumentuar vendosja e kriterëve për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

- Në 12 raste, nga njësia e prokurimit janë vendosur kriterë për kualifikim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20 dhe neni 46.

- Në 4 raste, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 53, pika 3.

- Në 13 raste, zbatimi i kontratave për mallra, shërbime dhe punë, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1.

-Në 3 raste, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, në dosjen e procedurave të prokurimit, nuk u gjetën deklaratat e konfliktit të interesit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 64, pika 2.

- Në 4 raste, në kundërshtim me nenin 68 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në kushtet kur në raportin përmbledhës mungojnë të dhëna kryesore si, referenca e procedurës së prokurimit dhe përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve, titullari i autorizuar AK, bazuar në dispozitën e sipërcituar nënligjore, në kushtet e mungesës së elementëve thelbësorë të sipërpërmendur, nuk duhej të kishte bërë miratimin e këtij raporti përmbledhës (në fuqi në kohën e kryerjes së procedurës).

-Në 14 raste, procedurat e përfunduara nuk ishin të inventarizuara dhe të arkivuara, në kundërshtim me nenin 42 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

- Në 3 raste, kontrata me operatorët ekonomikë fitues, nuk është lidhur me bashkimin e operatorëve ekonomikë që është shpallur fitues, por vetëm me kryesuesin e bashkimit të shoqërive, në kundërshtim me nenin 74 pika 2 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

- Në 3 raste, kontratat e nënshkuara sipas dispozitave të prokurimit publik, janë lidhur për vlerën fituese pa TVSH, në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

1. Në procedurën e prokurimit me objekt: ***“Blerje materiale hidraulike”***, me të dhëna si më poshtë vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS
KANALIZIME SH.A. DURRËS

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër Prokurimi i titullarit të autoritetit kontraktor Nr. 41/5 Prot., datë 19.01.2017.	D.Gj., Kryetar, M.B. Anëtare, D.Sh. Anëtare.	J..V., D. B., T. S..
Vlera e përlogaritur e kontratës: 118,460,000 lekë pa TVSH.		
Lloji i procedurës: Procedurë e hapur me mjete elektronike.		
Operatori ekonomik fitues “M.P. & S. CO” sh.p.k. Vlera e ofertës 109,109,550 lekë pa TVSH. Ulja nga fondi limit: 9,350,450 lekë pa TVSH.		
Kontrata Nr. 651 Prot., datë 27.03.2017, vlera 109,109,550 lekë pa TVSH.		
Raporti përmbledhës i hartuar nga KVO, Nr. 41/16 Prot., datë 27.02.2017. Vendim Nr. 41/17 Prot., datë 27.02.2017 i titullarit të AK, mbi miratimin e procedurës së prokurimit.	Formulari i njoftimit të fituesit datë 27.02.2017.	Tenderi i zhvilluar më datë: 13.02.2017.
Titullari i AK: Z. S. K., me autorizim prej tij Z. A. I..	Grupi i punës për ndjekjen e kontratës: G. D. Kryetar, S. R. anëtare, B. M. anëtar, sipas urdhërit Nr. 41/10 Prot., datë 19.01.2017.	Kualifikuar 1 OE. Pjesëmarrës 4 OE.
Kanë marrë pjesë në tender: Shoqëria “Sh.90” Sh.p.k. me ofertë 114,000,000 lekë pa TVSH; asnjë dokument tjetër i dorëzuar, skualifikuar. Shoqëria “V.” Sh.p.k. pa ofertë; skualifikuar. Shoqëria “T... Ch. D.” Sh.p.k. pa ofertë; skualifikuar.	Njoftimi i klasifikimit datë 17.02.2017. Grupi i punës për ndjekjen e kontratës: G.D. Kryetar, S. R. anëtare, B. M. anëtar, sipas urdhërit Nr. 41/10 Prot., datë 19.01.2017.	Njoftim i kontratës së nënshkruar: Publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. 13, datë 03.04.2017.

Me urdhërin Nr. 41/1 Prot., datë 09.01.2017 është urdhëruar Z. A. Zh., Z. L. F. dhe Z. B. M. të hartojnë specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe kriteret e veçanta për kualifikim,



Drejtorinë Ekonomike të përllogarisë vlerën e fondit limit, si dhe njësinë e prokurimit të fillojë procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale hidraulike”.

Ky urdhër është nënshkruar nga titullari i UKD, ndërkohë që me urdhërin nr. 4352 prot., datë 30.10.2014 është autorizuar Z. A. I. mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.

Gjithashtu, në urdhërin e sipërcituar nuk përcaktohet se çfarë kompetencash delegohen mbi prokurimet publike, si dhe sa është afati për autorizimin e dhënë.

Përcaktimi i bërë se, njësia e prokurimit duhet të fillojë procedurën e prokurimit, nuk gjen mbështetje ligjore, kjo në kushtet kur njësia e prokurimit është ngritur nga titullari i autorizuar në datë 19.01.2017.

Në dosje nuk dokumentohet dhe argumentohet mbi sasitë e pretenduara, duke sjellë si pasojë një fond limit të paargumentuar, për të cilat mbajnë përgjegjësi personat të cilët kanë bërë përllogaritjet e sasive përkatëse.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, hartimi dhe miratimi i specifikimeve teknike nuk është bërë nga i gjithë grupi i ngritur pasi, sipas dokumentacionit të administruar, rezulton se ky dokumentacion është vetëm me nënshkrimin e z. L. F., ndërkohë që dy anëtarët e tjerë z. A. Zh. dhe z. B. M. nuk kanë nënshkruar.

Në këto kushte, kur më shumë se gjysma e anëtarëve të ngritur nuk kanë nënshkruar në specifikimet teknike, sjell si pasojë vendosjen e tyre në kundërshtim me nenin 23 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Gjithashtu, deklarata e dhënë nga z. L. F. mbi konfliktin e interesit nuk është e saktë, pasi nuk ka deklaruar nëse është ose jo në kushtet e konfliktit të interesit.

Referuar përllogaritjes së vlerës së fondit limit, konstatohet se, në dosje nuk administrohet dokumentacion mbi mënyrën e përzgjedhjes së shoqërive për marrje ofertash në treg, si dhe mënyrën e njoftimit të shoqërive, administrimin fizik të ofertave, si dhe nuk dokumentohet nëse shoqërive i janë vënë në dispozicion edhe specifikimet teknike.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i ofertave të marra rezulton se, oferta e dhënë nga shoqëria “A. G.” sh.p.k. është një ofertë e cila nuk plotëson kërkesat e AK, pasi referuar ekstraktit të rregjistrimit tregtar të kësaj shoqërie konstatohet se, kjo shoqëri nuk ka objekt të aktivitetit, objektin e prokurimit.

Në kushtet e mësipërme, vlera e fondit limit, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, sipas mënyrës së bërë nga AK është: $(117,999,380 + 117,690,000)/2 = 117,844,690$ lekë pa TVSH.

Sa më sipër, vlera prej $118,460,000 - 117,844,690 = 615,310$ lekë pa TVSH, përbën një vlerë të paargumentuar dhe padokumentuar nga AK, lidhur me përllogaritjen e vlerës së fondit limit. Gjithashtu konstatohet se, vlera e paargumentuar nga AK, është shumë më e vogël se vlera e uljes së ofertës fituese nga vlera e fondit limit, e cila është në vlerën 9,350,450 lekë pa TVSH.

Për sa më sipër, lidhur me hartimin dhe miratimin e specifikimeve teknike mbajnë përgjegjësi z. L. F., si personi i vetëm që ka nënshkruar në hartimin e tyre, si dhe nuk ka plotësuar formularin e deklaramit të konfliktit të interesit.

Referuar urdhërit të prokurimit nr. 41/5 prot., datë 19.01.2017, konstatohet se, në kundërshtim me legjisllacionin e prokurimit publik në këtë urdhër mungojnë emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit, si dhe arsyet e përdorimit të procedurës, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi z. A. I., në cilësinë e ish titullarit të autorizuar të AK.

Në dosjen e prokurimit, mungojnë deklaratat e konfliktit të interesit nga anëtarët e KVO, në kundërshtim kjo me LPP, ku në dosje administrohet vetëm deklarata e kryetarit të KVO, z. D. Gj..



Sa më sipër, për mos deklarim të konfliktit të interesit mbajnë përgjegjësi Znj. M. B. dhe Znj. D. Sh., në cilësinë e anëtarëve të KVO.

Në dosje, administrohen dokumentet standarte të tenderit, të nënshkruara në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit.

Nga shqyrtimi i kërkesave për kualifikim, të nënshkruara nga anëtarët e njësisë së prokurimit konstatohet se, janë hartuar kërkesa për kualifikim në kundërshtim me nenin 20, 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, konkretisht si më poshtë vijon:

AK ka kërkuar që shoqëritë pjesëmarrëse duhet të paraqesin bilancin e tre viteve të fundit, por nuk kanë përcaktuar vitet konkrete që kërkohen.

Në dosje mungon hartimi, vendosja dhe miratimi i kërkesave për kualifikim, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës që prokurohet, ku të jenë të argumentuara dhe dokumentuara vendosja e tyre.

Lidhur me furnizimet e ngjashme, AK ka kërkuar që të paraqitet kontrata dhe vërtetimi i realizimit, ndërkohë që LPP parashikon vërtetim (dhe/ose) faturë tatimore shitje.

AK ka kërkuar që fusha e veprimtarisë së kompanisë prodhuese ose tregtimit të mallrave të ofruar, duhet të jetë prodhim ose tregtim i pajisjeve, për të cilën kërkohet një përshtetje në shkurtër të profilit të kompanisë, ndërkohë që një kërkesë e tillë nuk gjen mbështetje ligjore, referuar kërkesës së mësipërme.

Kërkesa për kualifikim, lidhur me standartet e kërkuara ku, është përcaktuar edhe kërkesa për prodhimin e pajisjeve dhe mirëmbajtjen e tyre, nuk gjen mbështetje ligjore, referuar kjo objektit dhe mallit që kërkohet të prokurohet.

Në kriteret specifike për kualifikim, AK ka kërkuar që operatori ekonomik duhet të ketë si pjesë të stafit minimalisht një inxhinier mekanik vërtetuar kjo me listpagesat e shoqërisë gjatë vitit të fundit. Një kërkesë e tillë është e pasaktë, si dhe shkakton konfuzion në vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse, pasi së pari nuk është përcaktuar periudha kohore për të cilën kërkohet, si dhe dokumenti i kërkuar, nuk provon profesionin e inxhinierit mekanik.

Në kërkesat specifike për kualifikim, AK ka kërkuar që ofertuesit duhet të paraqesin çertifikata që vërteton rezistencën e tyre në presione të larta, por nuk ka përcaktuar konkretisht kërkesat se sa janë presionet e larta, si dhe, si do të vërtetohet nga çertifikata që produkti është i përshtatshëm për ujë të pijshëm, kërkesa këto të cilat shkaktojnë konfuzion në vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse, si dhe nuk i vënë ofertuesit në kushte të barabarta konkurimi dhe vlerësimi.

Sa më sipër, lidhur me kërkesat për kualifikim, mbajnë përgjegjësi të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit.

Me urdhërin e brendshëm nr. 41/10 prot., datë 19.01.2017, është ngritur komisioni për ndjekjen e kontratës me përbërje G.D., S. R. dhe B. M..

Me urdhërin nr. 41/7 prot., datë 19.01.2017, është krijuar komisioni i vlerësimit të ofertave me përbërje D.Gj., M.B. dhe D. Sh..

Deklaratat e konfliktit të interesit me shoqëritë pjesëmarrëse mbajnë datën 19.01.2017, si dhe Znj. Daniela Shero nuk ka nënshkruar nëse është ose jo në kushtet e konfliktit të interesit me operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Referuar ankesës së shoqërisë “J.” sh.a. konstatohet se ankesa e bërë nuk është marrë në konsideratë nga AK, me arsyetimin se është ankesë jashtë afatit. Shoqëria ankuuese, lidhur me përgjigjen e marrë, nuk ka ndjekur më tej shkallët e ankimit pranë KPP.

Sipas pretendimeve të ngritura në ankesë konstatohet se, pika e parë e ankesës, për pikën 7 të kërkesave për kualifikim qëndron, *pasi nuk është detyrë dhe përgjegjësi e shoqërisë ofertuese që*



të vërtetojë dhe provojë se subjekti lëshues i çertifikimeve ISO është i akredituar ose jo nga institucionet përkatëse, vendase ose të huaja.

Ky është një kriter, i cili duhet të verifikohet nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave gjatë procesit të vlerësimit të ofertave pjesëmarrëse.

Lidhur me këtë pikë, ngarkohen me përgjegjësi të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit.

E njëjta gjë vlen për analogji edhe për kërkesën për të gjitha çertifikimet e kërkuara.

Pretendimi i ngritur në ankesë për inxhinierin mekanik qëndron, pasi shoqëritë ofertuese nuk kanë asnjë detyrim ligjor për të patur në staf inxhinier mekanik, referuar kjo objektit konkret të prokurimit, si dhe për më tepër, kur është një person i cili edhe mund të kontraktohet gjatë fazës së zbatimit të kontratës.

Sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Gjithashtu, ngarkohen me përgjegjësi edhe anëtarët e komisionit të cilët kanë shqyrtuar ankesën, konkretisht G. S., A. B. dhe R. P., të cilët, pavarësisht se nuk kanë marrë në konsideratë ankesën për arsye të afatit, duhej të kishin ndërmarrë hapat e duhur ligjor, duke u ndodhur përpara faktit të kërkesave të pasakta, si dhe duke vënë në dijeni njëkohësisht edhe titullarin e autorizuar të AK. Gjithashtu, në dosje mungojnë deklaratat e konfliktit të interesit, të të gjithë anëtarëve të komisionit, të cilët kanë shqyrtuar ankesën, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi Z. G. S., Znj. A.B. dhe Znj. R. P..

Lidhur me procesin e hapjes, shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave pjesëmarrëse konstatohet se, më datë 13.02.2017 është hapur procedura e mësipërme e prokurimit.

Referuar procesverbaleve të mbajtura rezulton se, komisioni i vlerësimit të ofertave, konkretisht procesverbalit nr. 41/14 prot., datë 13.02.2017, nuk ka evidentuar ofertat e shoqërive pjesëmarrëse, si dhe nuk ka përshkruar specifikisht mostratat e pretenduara të dorëzuara nga operatori ekonomik “Muho Plus LTD” (ndërkohë që është bashkim operatorësh ekonomikë).

Raporti përmbledhës, nr. 41/16 prot., datë 27.02.2017, në kundërshtim me nenin 68 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nuk ka të përcaktuar të gjithë elementët konkretë që duhej të përmbante ky raport, konkretisht numrin e referencës së procedurës, ofertat e shoqërive pjesëmarrëse, datën e klasifikimit etj.

Në kushtet e mësipërme, titullari i autorizuar i AK z. A. I. nuk duhej të kishte bërë miratimin e raportit përmbledhës nr. 41/17 prot., datë 27.02.2017.

Referuar kontratës së nënshkruar midis palëve konstatohet se vlera e sigurimit të kontratës është kërkuar vlera e ofertës fituese pa TVSH, në kundërshtim kjo me LPP, ku parashikohet se kontrata për procedurat e zhvilluara sipas legjislacionit të prokurimit publik, lidhen me TVSH, si dhe kontrata nuk është nënshkruar nga BOE, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi personi nënshkrues i kontratës.

Neni 56 i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrat të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit”*.

Neni 59 i VKM së mësipërme parashikon se: *“Përlllogaritja e vlerësimit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.*



2. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës”.

Pika 2 e nenit 57 të VKM së mësipërme, parashikon se:

“Njësia e prokurimit është përgjegjëse për:

- sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave tëprokurimit publik;

- përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti);

- përlllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;

- hartimin e urdhrit të prokurimit;

- përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;

- hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;

- administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;

- llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti”.

Neni 53, pika 3 i LPP, parashikon se: Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

Neni 23 i LPP, mbi specifikimet teknike, parashikon se:

“1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:

a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve



teknike kombëtare ose specifitimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;

b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specififikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevoje, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specififikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t'u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specififikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshatshme për mjedisin.

5. Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime".

Neni 60 i VKM së mësipërme, parashikon se:

Kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;
- fondin e përlllogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përlllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër;
- llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti);
emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit".

Neni 58 i VKM parashikon se:

Komisioni është përgjegjës vetëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Komisioni duhet të zbatohet detyrat në pavarësi të plotë dhe nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Komisioni nuk kryen asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla.

Me shkresën Nr. 651 Prot., datë 27.03.2017, është lidhur kontrata midis Autoritetit Kontraktor, përfaqësuar nga z. A.I. dhe BOE "M.P. & S. C." Sh.p.k. përfaqësuar nga Znj. A. M. (jo nga secili prej anëtarëve të BOE).

Formulari i sigurimit të kontratës mban datën 27.03.2017 në vlerën 13,093,146 lekë.

Sipas observacioneve të dërguara nr. 56 prot., datë 10.01.2019 nga administratori, lidhur me akt konstatimin është sqaruar se: "Fillimisht shprehemi se çdo gjetje dhe sugjerim, krijon premisat



për përmirësim dhe do të jetë në vëmendje të punës tonë. Bashkëlidhur janë dërguar observacionet, për secilën prej pikave të akt konstatimeve të prokolluara në UKD datë 28.12.2018. Gjithashtu, kërkohet marrjen në konsideratë të observacioneve, si të bazuara në ligj”.

Referuar observacioneve të dërguara nr. 56/6 prot., datë 10.01.2019 për akt konstatimin përkatës, me objekt: “*Observacion mbi akt konstatimin nr. 06, datë 28.12.2018*”, në projekt raport është sqaruar se: Arsyetimet dhe sqarimet e dhëna, lidhur me sasisë e pretenduara qëndrojnë pjesërisht, në kushtet kur dokumentacioni duhej të ishte vënë i plotë në dispozicion, në momentin e auditimit në AK. Gjithashtu, personat përgjegjës të cilët kanë bërë përlllogaritjet e sasisë, duhej të kishin saktësuar, dokumentuar dhe argumentuar të gjitha nevojat përkatëse, ku të argumentonin të detajuara të gjitha sasisë për këtë procedurë.

Lidhur me nënshkrimin të specifikimeve teknike vetëm nga një anëtar, sqarimet e dhëna nuk janë të shoqëruara me dokumentacion, që të provojnë të kundërtën e konstatimit. Gjithashtu, lidhur me sqarimin që janë tre kopje specifikime teknike, nuk argumenton të kundërtën për sa është konstatuar, kjo në kushtet kur specifikimet teknike në dosjen e prokurimit, janë me nënshkrimin e vetëm të një anëtari.

Lidhur me deklaratën e konfliktit të interesit për Z. L. F., arsyetimi i dhënë se, nënshkrimi nënkupton që nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, nuk gjendet i bazuar në ligj, si dhe nuk argumenton të kundërtën për sa është konstatuar. I njëjti sqarim vlen edhe për dy anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, të cilët nuk plotësuar saktë deklaratën përkatëse.

Sqarimet dhe argumentimet e dhëna nga komisioni i cili ka shqyrtuar ankesën, nuk argumenton të kundërtën për sa është konstatuar, si dhe nuk gjenden të bazuara në ligj. Lidhur me pretendimin që nuk ka bazë ligjore lidhur me deklarimin e konfliktit të interesit, ju bëjmë me dije se, konstatimi i grupit të auditimit mbështetet në nenin 56 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se çdo nënpunës qëmerr pjesë në procesin e prokurimit, duhet të deklarojë nëse ndodhet ose jo në kushtet e konfliktit të interesit, ku për mos deklarim konflikti i interesit mbajnë përgjegjësi G. S., A. B. dhe R.P.. Arsyetimet e dhëna lidhur me shqyrtimin e ankesës qëndrojnë pjesërisht, por nuk argumentojnë të kundërtën për sa është konstatuar.

Lidhur me arsyetimet e dhëna për mostrat, të cilat janë evidentuar në shkresat nr. 799/16 prot., 799/17 datë 16.04.2018 dhe nr. 799/18 prot.,, datë 18.04.2018, sqarojmë se pretendimet e dhëna qëndrojnë, referuar kjo procesverbalit nr. 799/17 prot., datë 16.04.2018, ku theksojmë se ky dokumentacion duhej të ishte vënë në dispozicion të grupit të auditimit gjatë fazës së auditimit. Lidhur me procesverbalin e dorëzuar nr. 799/18 prot., datë 18.04.2018 konstatohet se, dispozita nënligjore e dhënë në fund të tij është një dispozitë e shfuqizuar.

2. Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje vegla, pajisje mekanike dhe rroba pune”, viti 2017, me të dhëna si më poshtë vijon:

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër Prokurimi i titullarit të autoritetit kontraktor Nr. 42/5 Prot., datë 24.01.2017.	D. Gj., Kryetar,	J. V.,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS
KANALIZIME SH.A. DURRËS

Vlera e përlogaritur e kontratës: 29,567,626 lekë pa TVSH.	M. B. Anëtare, G.D., Anëtar.	D. B., T.S..
Lloji i procedurës: Procedurë e hapur me mjete elektronike.		
Operatori ekonomik fitues “P. I. & MB K.” sh.p.k. Vlera e ofertës 28,752,230 lekë pa TVSH. Ulja nga fondi limit: 815,396 lekë pa TVSH.		
Kontrata Nr. 728 Prot., datë 31.03.2017, vlera 28,752,230 lekë pa TVSH.		
Raporti përmbledhës i hartuar nga KVO, Nr. 42/16 Prot., datë 10.03.2017. Vendim Nr. 42/17 Prot., datë 10.03.2017 i titullarit të autorizuar të AK, mbi miratimin e procedurës së prokurimit.	Formulari i njoftimit të fituesit datë 10.03.2017.	Tenderi i zhvilluar më datë: 16.02.2017.
Titullari i AK: Z. S.K., me autorizim prej tij Z. A. I.	Grupi i punës për ndjekjen e kontratës: L.F. Kryetar, I. K. anëtar, I. K. anëtar, sipas urdhërit Nr. 42/10 Prot., datë 24.01.2017.	Kualifikuar 1 OE. Pjesëmarrës 4 OE.
Kanë marrë pjesë në tender: Shoqëria “M.” Sh.p.k.; asnjë dokument i dorëzuar (përveç NIPT), pa ofertë, skualifikuar. Shoqëria “T.. C. D.” Sh.p.k. pa ofertë; skualifikuar. Shoqëria “V. C.” Sh.p.k. me ofertë 29,499,639 lekë pa TVSH; skualifikuar.	Njoftimi i klasifikimit datë 10.03.2017.	Njoftim i kontratës së nënshkruar: Publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. 14, datë 10.04.2017.

Me shkresën Nr. 42 Prot., datë 09.01.2017, është kërkuar fillimi i procedurës së prokurimit, referuar kjo parashikimeve të bëra në plan buxhetin e vitit 2017, në vlerën 30,000,000 lekë. Me urdhërin Nr. 42/1 Prot., datë 09.01.2017 është urdhëruar z. I.K., z. J.N. dhe z. I.K. të hartojnë specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe kriteret e veçanta për kualifikim, Drejtorinë Ekonomike të përlogarisë vlerën e fondit limit, si dhe njësinë e prokurimit të fillojë procedurën e prokurimit me objekt “Blerje vegla, pajisje mekanike dhe rroba pune”. Ky urdhër është nënshkruar nga titullari UKD, ndërkohë që me urdhërin nr. 4352 prot., datë 30.10.2014, është autorizuar z. A.I. mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.



Gjithashtu, në urdhërin e sipërcituar nuk përcaktohet se ç'farë kompetencash delegohen mbi prokurimet publike, si dhe sa është afati për autorizimin e dhënë.

Përcaktimi i bërë se, njësia e prokurimit duhet të fillojë procedurën e prokurimit, nuk gjen mbështetje ligjore, kjo në kushtet kur njësia e prokurimit është ngritur nga titullari i autorizuar në datë 24.01.2017.

Në dosje nuk dokumentohet dhe argumentohet mbi sasitë e pretenduara, duke sjellë si pasojë një fond limit të paargumentuar, për të cilën mbajnë përgjegjësi personat të cilët kanë bërë përlllogaritjet për sasitë përkatëse.

Referuar përlllogaritjes së vlerës së fondit limit, konstatohet se, në dosje nuk administrohet dokumentacion mbi mënyrën e përzgjedhjes së shoqërive për marrje ofertash në treg, mënyrën e njoftimit të shoqërive, administrimin fizik të ofertave, si dhe nuk dokumentohet nëse shoqërive i janë vënë në dispozicion edhe specifikimet teknike.

Për më tepër, në ofertën e shoqërisë MB K. ka nënshkruar në emër të administratorit z. Xh. S., ndërkohë që sipas ekstraktit të rregjistrimit tregtar, nuk figuron ky person si administrator i kësaj shoqërie.

Referuar urdhërit të prokurimit nr. 42/5 prot., datë 24.01.2017, konstatohet se, në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik në këtë urdhër mungojnë emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit, si dhe arsyet e përdorimit të procedurës, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi z. A.I., në cilësinë e ish titullarit të autorizuar të AK.

Në dosjen e prokurimit, mungojnë deklaratat e konfliktit të interesit nga anëtarët e KVO me operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në kundërshtim kjo me LPP, konkretisht nga anëtari z. G.D., i cili nuk ka plotësuar shtojcën përkatëse duke vërtetuar nëse është ose jo në kushtet e konfliktit të interesit.

Në dosje, administrohen dokumentet standarte të tenderit, të nënshkuara në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit.

Nga shqyrtimi i kërkesave për kualifikim, të nënshkuara nga anëtarët e njësisë së prokurimit konstatohet se janë hartuar kërkesa për kualifikim në kundërshtim me nenin 20, 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, konkretisht si më poshtë vijon:

AK ka kërkuar që shoqëritë ofertuese duhet që në fushën e veprimtarisë së tyre duhet të kenë objektin e prokurimit, kërkesë kjo e cila nuk qëndron, referuar zërave të preventivit që kërkohen të realizohen.

AK ka kërkuar që shoqëritë pjesëmarrëse duhet të paraqesin bilancin e tre viteve të fundit, por nuk kanë përcaktuar vitet konkrete që kërkohen.

Në dosje mungon hartimi, vendosja dhe miratimi i kërkesave për kualifikim, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës që prokurohet, ku të jenë të argumentuara dhe dokumentuara vendosja e tyre.

Lidhur me furnizimet e ngjashme, AK ka kërkuar që të paraqiten furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të madhe se 35% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, kërkesë kjo e cila është evazive, konfuze e cila nuk i vë ofertuesit në kushte të barabarta konkurimi dhe vlerësimi.

Gjithashtu është kërkuar që të paraqiten vërtetime dhe/ose fatura tatimore të shitjes, ku përcaktimi i të dy lidhëzave shkakton konfuzion në vlerësimin e ofertave.

Në kërkesat për kualifikim janë kërkuar 15 punonjës, ndërkohë që nuk administrohet asnjë dokumentacion provues mbi këtë numër të kërkuar.

Sa më sipër, lidhur me kërkesat për kualifikim, mbajnë përgjegjësi të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit.



Me urdhërin e brendshëm nr. 42/10 prot., datë 24.01.2017 është ngritur komisioni për ndjekjen e kontratës me përbërje L. F., I. K. dhe I. K..

Referuar ankesës së shoqërisë “T. T. C.” sh.a. konstatohet se ankesa e bërë nuk është marrë në konsideratë nga AK, me arsyetimin se është ankesë jashtë afatit. Shoqëria ankuese, lidhur me përgjigjen e marrë, nuk ka ndjekur më tej shkallët e ankimit.

Sipas arsyeve të ngritura në ankesë konstatohet se, pretendimi i ngritur për inxhinierin mekanik qëndron, pasi shoqëritë ofertuese nuk kanë asnjë deymim ligjor për të patur në staf inxhinier mekanik, të siguar të paktën 6 muajt e fundit, referuar kjo objektit konkret të prokurimit, si dhe për më tepër, kur është një person i cili edhe mund të kontraktohet gjatë fazës së zbatimit të kontratës.

Sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit për vendosjen e një kriteri të tillë për kualifikim.

Gjithashtu, ngarkohen me përgjegjësi edhe anëtarët e komisionit të cilët kanë shqyrtuar ankesën, konkretisht G.S., A.B. dhe R.P., të cilët, pavarësisht se nuk kanë marrë në konsideratë ankesën për arsye të afatit, duhej të kishin ndërmarrë hapat e duhur ligjor, duke u ndodhur përpara faktit të kërkesave diskriminuese, si dhe duke vënë në dijeni njëkohësisht edhe titullarin e AK. Gjithashtu, në dosje mungojnë deklaratat e konfliktit të interesit, të të gjithë anëtarëve të komisionit, të cilët kanë shqyrtuar ankesën, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi G.S., A. B. dhe R. P..

Lidhur me procesin e shqyrtimit të ankesës, referuar dokumentacionit të administruar konstatohet se, ankesa e dorëzuar pranë AK mban datën 30.01.2017, si dhe është protokolluar në AK në datë 01.02.2017, si dhe data e publikimit të procedurës është data 25.01.2017.

Për më tepër, bashkëlidhur ankesës, operatori ekonomik ankues ka paraqitur edhe disa vendime të KPP, sipas të cilave nga ky institucion është marrë vendimi për modifikimin e kriterëve për kualifikim, ku për analogji është edhe kërkesa për inxhinier mekanik.

Për më tepër, një kërkesë e tillë është diskriminuese, konfuze, e cila ul konkurrencën në prokurim, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi të gjithë anëtarët e KSHA, për mosveprim, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

Lidhur me procesin e hapjes, shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave pjesëmarrëse konstatohet se, më datë 16.02.2017 është hapur procedura e mësipërme e prokurimit.

Referuar procesverbaleve të mbajtura rezulton se, komisioni i vlerësimit të ofertave, konkretisht procesverbalit nr. 42/14 prot., datë 16.02.2017, nuk ka përshkruar specifikisht mostratat e pretenduara të dorëzuara nga operatorët ekonomikë ofertues.

Raporti përmbledhës, nr. 42/16 prot., datë 10.03.2017, në kundërshtim me nenin 68 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nuk ka të përcaktuar të gjithë elementët konkretë që duhej të përmbante ky raport, konkretisht numrin e referencës së procedurës, ofertat e shoqërive pjesëmarrëse, datën e klasifikimit, etj.

Në kushtet e mësipërme, titullari i autorizuar i Autoritetit Kontraktor. A.I. nuk duhej të kishte bërë miratimin e raportit përmbledhës nr. 42/17 prot., datë 10.03.2017, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi.

Referuar kontratës së nënshkruar midis palëve konstatohet se vlera e sigurimit të kontratës është kërkuar vlera e ofertës fituese pa TVSH, në kundërshtim kjo me LPP, ku parashikohet se kontrata për procedurat e zhvilluara sipas legjislacionit të prokurimit publik, lidhen me TVSH, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi personi nënshkruar z. A.I., si dhe personat përgjegjës, të cilët kanë hartuar kontratën.



Bashkimi i operatorëve ekonomike pjesëmarrës “P.I. & M.K.” Sh.p.k. me të cilin është lidhur edhe kontrata, konstatohet se është kualifikuar në kundërshtim me nenin 53/3 të LPP si dhe dokumentet e tenderit, përfshirë edhe kërkesat për kualifikim, si më poshtë vijon:

Kontrata e bashkëpunimit e paraqitur në tender, në kundërshtim me nenin 74 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nuk ka të përcaktuar elementët konkretë që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi shoqërisht.

I gjithë dokumentacioni i paraqitur në tender, lidhur me katalogët, autozimin e prodhuesit etj, nuk janë të rregullta, pasi në të gjitha rastet mungon nënshkrimi dhe vërtetimi i noterit që është dokument i njëjtë me origjinalin.

Ky bashkim operatorësh ekonomikë, nuk plotëson me dokumentacion të gjitha specififikimet teknike të kërkuara, pjesë e dokumenteve të tenderit.

Ky bashkim operatorësh ekonomikë, nuk plotëson në raport me përqindjen e marrësë përsipër kriteret specifike për kualifikim, konkretisht për shërbimet e ngjashme, çertifikimet, si dhe autorizimet e prodhuesit, dhe makineritë e kërkuara.

Nga ana e këtij bashkimi shoqërisht, në kundërshtim me kërkesat për kualifikim nuk është paraqitur në tender dokumentacion që provon dhe vërteton lidhjen midis shoqërisë prodhuese ZKL dhe distributorit A.. Përcaktimi që ky dokument është kërkuar më pas dhe është paraqitur, nuk qëndron pasi është një dokument i cili nuk është paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit publik.

Gjithshtu, nuk është paraqitur në procedurën e prokurimit edhe bilanci i shoqërisë “P.I.” sh.p.k.

Sa më sipër, mbajnë përgjegjësi të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Në kushtet e mësipërme, kjo procedurë prokurimi duhej të ishte anuluar, në kushtet kur në garë nuk ngelet asnjë ofertë e vlefshme.

Neni 56 i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: **“Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrat të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit”**.

Neni 59 i VKM së mësipërme parashikon se: **“Përlllogaritja e vlerësimit të kontratës bëhet nga njëra e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukturë të posaçme.**

2. Në përlllogaritjen e vlerësimit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrat të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerësimit të kontratës”.

Pika 2 e nenit 57 të VKM së mësipërme, parashikon se:

“Njëra e prokurimit është përgjegjëse për:



- sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;
- përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti);
- përlogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;
- hartimin e urdhrat të prokurimit;
- përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;
- hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;
- administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;
- llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti”.

Neni 53, pika 3 i LPP, parashikon se: Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

Neni 23 i LPP, mbi specifikimet teknike, parashikon se:

- “1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.
2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.
3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:
 - a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;
 - b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;
 - c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj.
4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo



vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t'u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin.

5. Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime”.

Neni 24/1 i LPP, parashikon se:

1. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm:

- a) për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik;
- b) nëse nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore;
- c) kur në fazën e parë të procedurës së kufizuar dhe me negociim me shpallje paraprake të njoftimit kualifikohen më pak se 2 kandidatë;
- ç) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit;
- d) nëse të gjitha ofertat e paraqitura përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të parashikuar për një kontratë të caktuar;
- dh) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji.

Neni 60 i VKM së mësipërme, parashikon se:

Kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, pas përllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;
- fondin e përllogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër;
- llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti);
- emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit”.

Neni 58 i VKM parashikon se:

Komisioni është përgjegjës vetëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Komisioni duhet të zbatojë detyrat në pavarësi të plotë dhe nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Komisioni nuk kryen asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla.

Sipas observacioneve të dërguara nr.56/10 prot., datë 10.01.2019 për akt konstatimin me objekt: “Observacion mbi akt konstatimin nr. 10, datë 28.12.2018”, është sqaruar se:

Lidhur me autorizimin për zhvillimin e procedurave sqarohet se: “Neni 64 e në vijim i ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shprehet qartë që i përfaqësuari ka të drejtë të rimarrë të drejtat dhe atributet nga përfaqësuesi në çdo moment.



Më konkretisht, neni 68 shprehet: “Kur për kryerjen e një veprimi juridik janë caktuar dy ose më shumë përfaqësues, secili prej tyre mund ta kryejë atë pa pjesëmarrjen e përfaqësuesve të tjerë, përveç kur në prokurë është parashikuar ndryshe”. Në kuptim të këtij neni, tagrin për ta nënshkruar urdhërin e prokurimit e ka si administratori i shoqërisë (i përfaqësuari) dhe personi i autorizuar prej tij (përfaqësuesi).

Sqarimet e dhëna lidhur me sasinë qëndrojnë pjesërisht, referuar arsyetimeve dhe dokumentacionit bashkëlidhur të dërguar, por nuk argumentojnë të kundërtën e konstatimit, lidhur me argumentimin dhe dokumentimin e sasisë së kësaj procedurë prokurimi. AK ka detyrimin ligjor të saktësojë dhe dokumentojë të gjitha nevojat, pjesë e të cilave janë edhe sasia përkatëse.

Lidhur me sqarimet e dhëna për mënyrën e përzgjedhjes së shoqërive për marrje ofertash në treg, nuk argumentohet e kundërta e konstatimit, si dhe observacioni i dërguar mbi njësinë e prokurimit, nuk gjendet i bazuar në ligj.

Sqarimet e dhëna mbi kërkesat për kualifikim dhe nga anëtarët e KSHA, nuk argumentojnë dhe dokumentojnë të kundërtën e konstatimit.

Sqarimi i dhënë për kontratën e lidhur qëndron pjesërisht, kjo në kushtet kur formulari i sigurimit të kontratës është për vlerën me TVSH, por AK në çdo rast, për kontratat e lidhura sipas një procedure prokurimi, bazuar në LPP, duhet të lidhen për vlerën totale të ofertuar me TVSH.

Gjithashtu, sqarimet dhe arsyetimet e dhëna, nuk argumentojnë të kundërtën për sa është konstatuar si shkelje e LPP.

3. Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale hidraulike”, viti 2018, me të dhëna si më poshtë vijon:

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër Prokurimi i titullarit të autoritetit kontraktor Nr. 799/4 Prot., datë 05.03.2018.	D.Gj., Kryetar,	B. M.,
Vlera e përlogarit e kontratës: 109,420,000 lekë pa TVSH.	M.B. Anëtare,	D. B.,
Lloji i procedurës: Procedurë e hapur me mjete elektronike.	D.Sh., Anëtare.	A. B..
Operatori ekonomik fitues “P. I.” sh.p.k. Vlera e ofertës 105,998,620 lekë pa TVSH. Ulja nga fondi limit: 3,421,380 lekë pa TVSH.		
Kontrata Nr. 1459 Prot., datë 25.06.2018, vlera 105,998,620 lekë pa TVSH.		
Raporti përmbledhës i hartuar nga KVO, Nr. 799/19 Prot., datë	Formulari i njoftimit të fituesit datë 26.04.2018.	Tenderi i zhvilluar më datë: 16.04.2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A. DURRËS

26.04.2018. Vendim Nr. 799/20 Prot., datë 26.04.2018 i titullarit të autorizuar të AK, mbi miratimin e procedurës së prokurimit.		
Titullari i AK: Z. S.K, me autorizim prej tij Znj. F.K.	Grupi i punës për ndjekjen e kontratës: G. D. Kryetar, L.F anëtar, D.Danëtar.	Kualifikuar 1 OE. Pjesëmarrës 3 OE.
Kanë marrë pjesë në tender: Shoqëria “E.” Sh.p.k.; asnjë dokument i dorëzuar, pa ofertë, skualifikuar. Shoqëria “Rr. M.” Sh.p.k. pa ofertë; skualifikuar.	Njoftimi i klasifikimit datë 18.04.2018.	Njoftim i kontratës së nënshkruar: Publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. 26, datë 02.07.2018.

Me shkresën nr. 1459 prot., datë 25.06.2018 është lidhur kontrata midis shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Sh.a. Durrës” dhe operatorit ekonomik Pover Industries me NIPT 51706022H. Në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, kontrata e mësipërme është lidhur për vlerën pa TVSH, ndërkohë që kontrata duhej të ishte lidhur me TVSH, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi ish titullari i autorizuar i AK, Znj. F.K.

Në nenin 3 të kontratës, parashikohet se, afati i saj është 12 javë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, nga data e nënshkrimit të kontratës.

Pra, referuar kushteve të kontratës, afati maksimal i dorëzimit të mallit ka qenë data 14.09.2018. Ndërkohë, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresës nr. 799/5 prot., datë 24.09.2018, përcaktohet se fatura tatimore e fundit që është dorëzuar malli i prokuruar është data 24.09.2018, datë në të cilën edhe grupi i ngritur për mbikqyrjen e kontratës ka bërë marrjen në dorëzim të tij.

Relacioni i mësipëm mbi ndjekjen e zbatimit të kontratës është nënshkruar nga grupi me përbërje G.D, L.F dhe D. D..

Referuar dokumentacionit të administruar konstatohet se, malli është dorëzuar në AK, me 10 ditë vonesë.

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi edhe observacionin e dërguar nr. 56/11 prot., datë 10.01.2019 mbi akt konstatimin e lënë, ka sqaruar se:

Malli është dorëzuar pranë AK sipas faturave tatimore me vlerat përkatëse me TVSH, si më poshtë sqaruar:

Faturë tatimore shitje nr. 26, datë 02.08.2018 me vlerë 28,360,082 lekë me TVSH.

Faturë tatimore shitje nr. 30, datë 04.09.2018 me vlerë 82,691,527 lekë me TVSH.

Faturë tatimore shitje nr. 09, datë 24.09.2018 me vlerë 16,146,734 lekë me TVSH.

Pra, ashtu sikurse sqaruar edhe më sipër, malli është dorëzuar pranë AK (pjesa e fundit sipas faturës së tretë) më datë 24.09.2018, pra me 10 ditë vonesë. Sqarojmë se, dy faturat e para janë dorëzuar brenda afatit kohor të parashikuar në kontratën e nënshkruar dhe rënë dakort midis



palëve, ndërkohë që pjesa e fundit e mallit, pra fatura e tretë është dorëzuar pranë AK me 10 ditë vonesë.

Në kushtet e mësipërme, pasi u ribënë edhe një herë përlllogaritjet përkatëse, atëhere vlera e penalitetit të pambajtur është:

Vlera prej $16,146,734 \times 25\% = 4,036,683 \times 4/1000 = 16,146$ lekë $\times 10$ ditë = 161,467 lekë përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të Shtetit, si pasojë e mosmbajtjes së penaliteteve për dorëzim të mallit jashtë afateve të përcaktuara në kontratë.

Lidhur sa më sipër, mbajnë përgjegjësi, Z. G.D, Z. L.F, Z. D.D, kontraktori, si dhe personat përgjegjës të financës të cilët kanë nënshkruar në dokumentacionin për pagesën ndaj kësaj shoqërie, ndërkohë që nuk janë mbajtur penalitetet përkatëse, si pasojë e dorëzimit të mallit me 10 ditë vonesë.

Veprimet e mësipërme, bien në kundërshtim me nenet 59, 60 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Neni 56 i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: ***“Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrat të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit”***.

Nga shqyrtimi i observacionit të dërguar nr. 56/11 prot., datë 10.01.2019 mbi akt konstatimin e lënë, me objekt: “Observacion mbi akt konstatimin nr. 11, datë 28.12.2018”, është sqaruar se:

Lidhur me pjesën e konstatimit për lidhjen e kontratës për vlerën pa TVSH, sqarohet se fondet limite të procedurave të prokurimit janë vlera pa TVSH. Në të gjitha rastet vlerat e kontratave janë përcaktuar me dhe pa TVSH, por gjithsesi, vlera e sigurimit të kontratës është mbajtur për vlerën totale me TVSH. Referuar sqarimit të dhënë për këtë pikë, sqarojmë se në kushtet kur vlera e sigurimit të kontratës është prerë për vlerën totale me TVSH, atëhere observacioni i dërguar merret në konsideratë pjesërisht. Por, sqarojmë AK se, bazuar në LPP, nëçdo rast, vlera totale e kontratës së nënshkruar sipas zhvillimit të një procedurë prokurimi, është vlera totale e ofertuar me TVSH.

Lidhur me vlerën e penalitetit të pretenduar, sqarojmë se argumentimi i dhënë për afatin 10 ditor nuk qëndron, si dhe bazuar në dokumentacionet shoqëruese të dërguara, të cilat duhej të ishin vënë në dispozicion të grupit të auditimit gjatë fazës audituese, janë bërë reflektimet përkatëse, konkretisht bazuar në faturën tatimore të fundit, e cila është dorëzuar pranë AK me 10 ditë vonesë, ndërkohë që dy faturat e para kanë qenë brenda afatit të parashikuar në kontratë.

4. Në procedurën e prokurimit me objekt: ***“Blerje pajisje makineri”, viti 2018***, me të dhëna si më poshtë vijon:

Kontrata lidhur nr. 1738 prot., datë 09.08.2018, me numër reference 66025-04-30-2018.
Çmimi i kontratës së lidhur 19,306,000 lekë pa TVSH, 23,167,200 lekë me TVSH.
Afati i kontratës është 4 javë, sipas kërkesave të ndërmarrjes, nga data e lidhjes së kontratës.
Kontraktori “D.” Sh.p.k. me NIPT J82401502P.



Objekti i kontratës: “Blerje pajisje makineri”.
Proces verbal i marrjes në dorëzim nr. 2568 prot., datë 06.11.2018.
Grupi i ndjekjes së kontratës: L.F, N. V., E.S..
Formulari i sigurimit të kontratës: Numër serial 59124075, datë 08.08.2018.
Amendament kontrate nr. 2568/3 prot., datë 12.09.2018, nënshkuar nga F.K.

Me shkresën nr. 1738 prot., datë 09.08.2018 është lidhur kontrata midis shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Sh.a. Durrës” dhe operatorit ekonomik D. sh.p.k. me NIPT J82401502P.

Në kushtet e kontratës, së nënshkuar dhe rënë dakort midis palëve është përcaktuar se, afati për lëvrimin e mallit është 4 javë sipas kërkesave të ndërmarrjes, nga data e lidhjes së kontratës. Pra, afati maksimal për dorëzimin e mallit ka qenë data 06.09.2018.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, me shkresën nr. 2568/3 prot., datë 12.09.2018 është lidhur një amendament kontrate, sipas së cilës përcaktohet se, afati i përcaktuar në kontratën bazë për objektin e mësipërm, shtyhet me dy muaj.

Pra, referuar sa më sipër, konstatohet se është lidhur një amendament kontrate, pasi ka kaluar afati përfundimtar i kontratës bazë për lëvrimin e mallit. Në nenin 30 të kontratës fillestare përcaktohet se, nëse AK është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkuar nga autoriteti kontraktor dhe kontraktuesi. Neni 32 i kontratës përcakton se, asnjë amendament i kontratës nuk është i vlefshëm, nëse ai nuk bëhet me shkrim apo nuk ka një datë të përcaktuar, si dhe nëse ai nuk i referohet shprehimisht kontratës apo nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i kontraktuesit dhe AK.

Referuar sa më sipër, afati i kontratës bazë ka përfunduar në datë 06.09.2018, ndërkohë që amendamenti i kontratës është lidhur me shkrim më datë 12.09.2018, pasi ka përfunduar afati maksimal për dorëzimin e mallit.

Referuar dosjes së zbatimit, kontraktori ka prerë faturën tatimore të shitjes në datë 06.11.2018, si dhe po këtë datë është bërë edhe akt marrja në dorëzim e tij, shkresë kjo e nënshkuar nga grupi i ndjekjes së kontratës L.F, N. V. dhe E. S..

Referuar dokumentacionit të administruar konstatohet se, malli është dorëzuar në AK, me 2 muaj vonesë, pra 60 ditë.

Referuar observacioneve të dërguara për akt konstatimin, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur rezulton se, për objektin e mësipërm të prokurimit AK ka nënshkuar edhe kontratën shtesë, por në mospërputhje me konstatimet e përcaktuara në akt konstatimin e lënë.

Sa më sipër, vlera prej $23,167,200 \times 4/1000 = 92,668$ lekë $\times 60$ ditë = 5,560,080 lekë përbën efekt negativ financiar, si pasojë e mosdokumentimit në afatet kohore për kontratën shtesë.

Lidhur sa më sipër, mbajnë përgjegjësi, L.F, N. V., E. S., kontraktori, si dhe personat përgjegjës të financës të cilët kanë nënshkuar në dokumentacionin për pagesën ndaj kësaj shoqërie.

Neni 56 i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrat të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit”.*

Veprimet e mësipërme, bien në kundërshtim me nenet 59, 60 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.



Në kundërshtim me nenin 24 të kushteve të përgjithshme të kontratës, kontraktuesi ka detyrimin ligjor të furnizojë AK me mallin sipas specifikimeve teknike, kusht ky i cili nuk rezulton të jetë zbatuar.

Sipas observacioneve të dërguara nr. 56/12 prot., datë 10.01.2019 mbi akt konstatimin me objekt: “*Observacion mbi akt konstatimin nr. 12, datë 28.12.2018*”, është sqaruar se: Në gjetjen lidhur me amendimin e kontratës, ju sqarojmë se UKD ka lidhur kontratë me kontraktorin në datë 09.08.2018, me afat zbatimi 4 javë nga data e nënshkrimit të kontratës. Këto makineri do të montohen pranë ITUND.

Drejtori i ITUND me shkresën nr. 2568 prot., datë 30.09.2018, ka kërkuar shtyrjen në afat të montimit të makinerisë, me arsyetimin se në rast vendosje në këto ditë, pesha e madhe e makinerisë që do të instalohet, do të dëmtojë argjenaturat dhe do të bëjë të pakalueshme hyrjen në ITUN.

Grupi i ndjekjes së kontratës, pas njoftimit të marrë, më datë 04.09.2018 ka kryer verifikimin në terren, ku ka mbajtur procesverbal konstatimi me nr. 2568/1 prot., datë 04.09.2018, si dhe ky grup pune është shprehur se makineria nuk mund të futet brenda territorit të impiantit. Nga sa më sipër, është njoftuar kontraktori me shkresën nr. 1880 prot., datë 06.09.2018, ku i është kërkuar shtyrja e afatit të dorëzimit të makinerisë. Kjo pasi, nuk mund të realizohet në këto momente montimi, sepse nuk janë kushtet e përshtatshme për shkak të forcës madhore dhe nuk mund të merret në dorëzim një makineri pa u vënë në punë.

Me shkresën nr. 1880/1 prot., datë 12.08.2018, kontraktori ka kthyer përgjigje, në të cilën ka marrë në konsideratë kërkesën e UKD dhe mbetet në pritje të përcaktimit të një date për dorëzimin e makinerisë.

Me vendimin nr. 2568/2 prot., datë 12.08.2018 të AK, është bërë shtyrja e afatit të dorëzimit të makinerisë, për një periudhë dy mujore, duke filluar nga data 12.09.2018.

Me shkresën nr. 2568/3 prot., datë 12.09.2018 është lidhur amendimi i kontratës, referuar nenit 30, 32 të kontratës.

Me shkresën nr. 1738/1 prot., datë 30.10.2018, grupi i ndjekjes së kontratës, i ka bërë kërkesë kontraktorit për dorëzimin e makinerisë, pasi janë krijuar kushtet për montimin e saj.

Me shkresën nr. 2568/6 prot, datë 06.11.2018, mbahet relacioni përfundimtar i grupit të punës, për montimin dhe kolaudimin e makinerisë, objekt kontrate.

Lidhur me mosplotësimin e specifikimeve teknike sqarohet se gjatësia nga prodhuesi është 8190, por grupi i punës i ka kërkuar kontraktorit që tubacionin e shkarkimit ta zgjasi sipas specifikimeve teknike me një gjatësi prej 310mm.

Referuar sqarimeve të dhëna, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur observacionit të dërguar, në kushtet kur shtyrja e afatit të mospërfundimit të punimeve të kontratës në afat, ka ardhur si pasojë e kërkesave të AK, atëhere pretendimet e dhëna merren në konsideratë pjesërisht.

5. Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Rikonstruksion sheshi në ambjentet e Impiantit të trajtimit të ujrave të ndotur*”, me të dhëna si më poshtë vijon:

Kontrata lidhur nr. 2177 prot., datë 19.10.2018, me numër reference 86466-09-19-2018.
Çmimi i kontratës së lidhur 10,978,857 lekë pa TVSH, 13,174,628 lekë me TVSH.
Afati i kontratës është 30 ditë kalendarike duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A. DURRËS

Kontraktori "A.L. – A." Sh.p.k. me NIPT K81511508A.
Objekti i kontratës: "Rikonstrukcion sheshi në ambientet e Impiantit të trajtimit të ujrave të ndotur" .
Grupi i punës së ndjekjes së kontratës: L.F, O.G., E. S..
Procesverbal lidhur me situacionin nr. 1, dhe fatura tatimore, nr. 2227/3 prot., datë 06.11.2018.
Faturë tatimore shitje nr. 241, datë 06.11.2018.
Situacion pjesor nr. 1, nënshkruar nga mbikqyrësi i punimeve Ing. M. K..

Me shkresën nr. 2177 prot., datë 19.10.2018 është lidhur kontrata midis shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Sh.a. Durrës" dhe operatorit ekonomik A.L. – A. sh.p.k. me NIPT K81511508A.

Në kushtet e kontratës, së nënshkruar dhe rënë dakort midis palëve është përcaktuar se, afati për përfundimin e punimeve është 30 ditë kalendarike duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës. Pra, afati maksimal për përfundimin e punimeve ka qenë data 18.11.2018.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, në dosje administrohet vetëm situacioni pjesor nr. 1, për të cilën është prerë edhe fatura tatimore e shitjes nr. 241, datë 06.11.2018 për vlerën totale 4,591,200 lekë me TVSH.

Gjithashtu, nuk administrohet dokumentacion për shtyrje të afatit të zbatimit të punimeve.

Referuar sa më sipër, afati i kontratës bazë ka përfunduar në datë 18.11.2018, ndërkohë që ka përfunduar afati maksimal për përfundimin e punimeve.

Për sa më sipër konstatohet se, punimet nuk kanë përfunduar, me një afat të paargumentuar dhe padokumentuar, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga AK.

Sipas observacioneve të dërguara nga AK nr. 56/13 prot., datë 10.01.2019 për akt konstatimin, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur, i cili theksojmë që nuk është vënë në dispozicion të grupit të auditimit, është sqaruar se:

Sipas shkresës së mbikqyrësit të punimeve datë 29.10.2018, protokolluar në AK nr. 2227/1 prot., datë 29.10.2018, sqarohet se punimet në objektin e mësipërm kanë filluar në datë 29.10.2018. Bashkëlidhur është dërguar akt dorëzimi i sheshit të ndërtimit, i mbajtur më datë 29.10.2018, shkresë kjo e nënshkruar nga mbikqyrësi i punimeve, sipërmarrësi i punimeve dhe investitori. Po më datë 29.10.2018 është mbajtur një procesverbal mbi fillimin e punimeve në objektin e mësipërm, i cili është nënshkruar nga mbikqyrësi, kontraktori dhe investitori.

Me shkresën nr. 2227/8 prot., datë 29.11.2018 nga grupi i punës së ndjekjes së kontratës është mbajtur procesverbali, nga ku sqarohet se në këtë datë janë kryer punimet sipas zërave të paraqitur në situacionin përfundimtar, ku bashkëlidhur është fatura tatimore nr. 904, datë 29.11.2018, si dhe situacioni përfundimtar i punimeve.

Me shkresën nr. Extra prot., datë 27.11.2018, protokolluar në AK nr. 2227/6 prot., datë 27.11.2018, mbikqyrësi i punimeve ka njoftuar investitorin mbi përfundimin e punimeve në objektin e mësipërm.

Me shkresën nr. 2227/9 prot., datë 21.12.2018 është mbajtur relacioni mbi zbatimin e kontratës së mësipërme.

Me shkresën nr. 3195/4 prot., datë 21.12.2018 është bërë akt marrja e përkohshme e punimeve në dorëzim, shkresë kjo e nënshkruar nga kontraktori, mbikqyrësi i punimeve, komisioni i marrjes në dorëzim, kolaudatori dhe investitori.

Referuar dokumentacionit të dërguar bashkëlidhur observacionit, grupi i auditimit i tërheq vëmendjen AK, pasi të gjitha dokumentacionet e mësipërme, duhej të ishin vënë në dispozicion të grupit të auditimit, gjatë fazës audituese.

Pavarësisht sa më sipër, AK në kushtet e kontratës së nënshkruar midis palëve ka rënë dakort me kontraktorin që, përfundimi i punimeve do të jetë 30 ditë kalendarike, duke filluar nga data e



nënshkrimit të kontratës. Pra, sipas kushteve të rëna dakort midis palëve, punimet duhej të kishin përfunduar në datë 18.11.2018. Ndërkohë, sheshi i ndërtimit i është vënë në dispozicion kontraktorit në datë 29.10.2018, si dhe afati 30 ditor duke nisur nga data e lirimimit të sheshit tëndërtimit është 28.11.2018. Ndërkohë, referuar dokumentacionit dërguar bashkëlidhur obserbacioneve, punimet kanë përfunduar në datë 27.11.2018.

Sqaruar hollësisht sa më sipër, mospërputhjet në datat e mësipërme, kanë ardhur si rezultat i kushteve kontradiktore, sipas kontratës nr. 2177 prot., datë 19.10.2018, ku është rënë dakort midis palëve që punimet duhet të fillonin menjëherë nga data e nënshkrimit të kontratës, me një afat 30 ditor. Pra, referuar kushteve të kontratës, ku punimet duhej të përfundonin në datë 18.11.2018, si dhe dokumentacionit të përfundimit të punimeve, ku punimet kanë përfunduar në datë 27.11.2018, pra me një afat kohor prej 9 ditë, referuar kjo kushteve të kontratës, atëhere $vlera\ prej\ 13,174,628 - 4,591,200 = 8,583,428 \times 4/1000 = 34,333\ lekë \times 9\ ditë = 308,997\ lekë$ përbën efekt negativ financiar, si pasojë e mosdokumentimit, si dhe kushteve kontradiktore të përcaktuara nga palët, në kontratën e mësipërme.

Lidhur sa më sipër, mbajnë përgjegjësi, mbikqyrësi i punimeve, grupi i punës së ndjekjes së kontratës, kontraktori.

Neni 56 i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrat të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit”*.

Veprimet e mësipërme, bien në kundërshtim me nenet 59, 60 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

6. Në procedurën e prokurimit me objekt: “Lidhja e objekteve me rrjetin e ri, Lagja Nr. 13, Durrës”, me të dhëna si më poshtë vijon:

Kontrata lidhur nr. 1352 prot., datë 29.05.2017, me numër reference 856/4-31-03-2017.
Çmimi i kontratës së lidhur 21,697,544 lekë pa TVSH, 26,037,053 lekë me TVSH.
Afati i kontratës është 120 ditë kalendarike duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.
Kontraktori “K. K.” Sh.p.k. me NIPT K41416033P.
Objekti i kontratës: “Lidhja e objekteve me rrjetin e ri, Lagja Nr. 13, Durrës” .
Mbikqyrësi i punimeve “S. S. K-S.” sh.p.k. me administrator K. S..
Situacion pjesor nr. 1, sipas faturës tatimore nr. 36, datë 05.07.2017.
Situacion përfundimtar punimesh sipas faturës tatimore të shitjes nr. 57, datë 07.11.2017.
Situacion punimesh shtesë, sipas faturës tatimore të shitjes nr. 58, datë 07.11.2017.
Grupi i marrjes së punimeve në dorëzim: G.D, L.F, A. K..
Kontrata shtesë nr. 1353/10 prot., datë 19.06.2017, me vlerë 3,683,406 lekë pa TVSH, 4,420,087 lekë me TVSH.
Titullari i autorizuar i AK, Z. A. I..

Me shkresën nr. 1352 prot., datë 29.05.2017 është lidhur kontrata midis shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Sh.a. Durrës”, përfaqësuar nga Z. A.I. dhe operatorit ekonomik “K. K.” sh.p.k. me NIPT K41416033P, me vlerë 21,697,544 lekë pa TVSH, 26,037,053 lekë me TVSH.



Në kushtet e kontratës, së nënshkruar dhe rënë dakort midis palëve është përcaktuar se, afati për përbarimin e punimeve është 120 ditë kalendarike duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës. Pra, afati maksimal për përfundimin e punimeve, sipas kontratës bazë ka qenë data 25.09.2017.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, në dosje administrohet situacioni pjesor nr. 1, sipas faturës tatimore nr. 36, datë 05.07.2017, me vlerë 13,719,502 lekë me TVSH, situacioni përfundimtar sipas faturës nr. 57, datë 07.11.2017 me vlerë 12,317,551 lekë me TVSH, si dhe situacioni përfundimtar për kontratën shtesë, sipas faturës tatimore nr. 58, datë 07.11.2017, me vlerë 4,420,087 lekë me TVSH.

Referuar procedurës së mësipërme të prokurimit, në dosje administrohet edhe shtesa e kontratës sipas shkresës nr. 1353/10 prot., datë 19.06.2017, kontratë kjo e nënshkruar nga personi i autorizuar, z. A. I.

Në nenin 5 të kësaj kontrate shtesë parashikohet se, të gjitha termat dhe kushtet e vendosura në kontratën nr. 1352 prot., datë 29.05.2017, mbeten të pandryshuara.

Pra, referuar sa më sipër, afati maksimal për përfundimin e punimeve fillestare dhe atyre shtesë, ka qenë data 25.09.2017.

Referuar sa më sipër, afati i kontratës bazë dhe shtesë ka përfunduar në datë 25.09.2017, ndërkohë që situacioni përfundimtar dhe situacioni i kontratës shtesë mbajnë datën 07.11.2017, pra me një afat të paargumentuar dhe padokumentuar prej 43 ditë me vonesë.

Sipas observacioneve të dërguara nr. 56/14 prot., datë 10.01.2019 mbi akt konstatimin, me objekt: “*Observacion mbi akt konstatimin nr. 14, datë 28.12.2018*”, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur, është sqaruar se:

Me shkresën nr./ 1786 prot., datë 25.09.2017, mbikqyrësi i punimeve ka bërë njoftimin e përfundimit të punimeve, në respektim të afateve të kontratës. Nga grupi i punës i autorizuar nga AK, me urdhërin nr. 856/9 prot., datë 31.03./2017, është kryer verifikimi në terren dhe është konstatuar që punimet kanë përfunduar sipas kontratës, si dhe më pas, në zbatim të detyrave ligjore, kryhen procedurat për kolaudimin e objektit.

Referuar kontratës nr. 1353/9 prot., datë 26.09.2017, nga data 25.10.2017 deri më datë 26.10.2017 është kryer kolaudimi i objektit dhe është mbajtur akti i kolaudimit nr. 1591/6 prot., datë 26.10.2017. Pas përfundimit të akt kolaudimit të kryer më datë 26.10.2017, mbikqyrësi ka përpiluar situacionin përfundimtar të objektit dhe kontraktori i punimeve depoziton faturën tatimore të shitjes, pra më datë 07.11.2017. Me shkresën nr. 2463/2 prot., datë 07.11.2017, mbahet akti i përkohshëm i marrjes në dorëzim të objektit, si dhe praktika e plotë i dërgohet drejtorisë financiare për likuidim.

Referuar dokumentacionit të dërguar, konstatohet se ky dokumentacion nuk është vënë në dispozicion të grupit të auditimit, gjatë fazës audituese, për të cilat i tërhiqet vëmendja AK.

Referuar dokumentacionit të dërguar si dhe sqarimeve të dhëna konstatohet se, gjatë fazës së dërgimit të observacioneve, janë dërguar dokumentacioni shoqërues, konkretisht mbi gjendjen dhe fazat e zbatimit të objektit, përfshirë edhe kolaudimin e tij.

Gjatë shqyrtimit të këtij dokumentacioni, referuar edhe bazës ligjore të dhënë nga AK, konkretisht Udhëzimit Nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, rezulton se nga AK, si situacioni përfundimtar i objektit, ashtu edhe situacioni për realizimin e punimeve shtesë, pretendohet se janë realizuar në datë 07.11.2017, datë në të cilën është bërë edhe akt marrja në dorëzim e punimeve.

Sa më sipër, grupi i auditimit, duke marrë për bazë të gjithë dokumentacionin e administruar gjykon se, vlera prej $12,317,551 + 4,420,087 = 16,737,638 \times 4/1000 = 66,950 \text{ lekë} \times 43 =$



2,878,850 lekë përbën efekt negativ financiar, si pasojë e mosdokumentimit, si dhe kushteve kontradiktore të përcaktuara nga palët, në kontratën e mësipërme.

Lidhur sa më sipër, mbajnë përgjegjësi, mbikqyrësi i punimeve, grupi i punës së ndjekjes së kontratës dhe kontraktori.

Neni 56 i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: “Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrat të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit”.

Veprimet e mësipërme, bien në kundërshtim me nenet 59, 60 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Gjithashtu, titullari i autorizuar i AK, ka nënshkruar një kontratë fillestare dhe shtesë ku në kundërshtim me LPP, ka rënë dakort që sigurimi i kontratës shtesë duhet të jetë vlera e ofertuar pa TVSH, ndërkohë që kontratat lidhen për shumën me TVSH.

Sipas observacioneve të dërguara nr. Extra prot., datë 07.01.2019 për akt konstatimin, është sqaruar se, nuk është marrë parasysh dokumentacioni i plotë tekniko ligjor i dosjes, për të cilën sqarohet se, vlerësimi është bërë në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga UKD. Gjithashtu sqarohet se, të gjitha argumentimet e dhëna në observacion janë të mjaftueshme dhe si të tilla duhet të merren në konsideratë, duke marrë parasysh të gjithë dokumentacionin e dosjes teknike, bazuar në legjisllacionin në fuqi për zbatimin e punimeve në ndërtim dhe për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve ndërtimore.

7. Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Blerje materiale dhe pajisje elektrike”, viti 2017**, me të dhëna si më poshtë vijon:

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër Prokurimi i titullarit të autoritetit kontraktor Nr. 43/4 Prot., datë 23.01.2017.	D.Gj., Kryetar, Q. Q.Anëtare,	J. V., D.B.,
Vlera e përlogarit e kontratës: 58,961,158 lekë pa TVSH.	D. Sh., Anëtare.	T. S.
Lloji i procedurës: Procedurë e hapur me mjete elektronike.		
Operatori ekonomik fitues “L. & A. E.” sh.p.k. Vlera e ofertës 56,960,000 lekë pa TVSH. Ulja nga fondi limit: 2,001,158 lekë pa TVSH.		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A. DURRËS

Kontrata Nr. 726 Prot., datë 31.03.2017, vlera 56,960,000 lekë pa TVSH.		
Raporti përmbledhës i hartuar nga KVO, Nr. 43/12 Prot., datë 02.03.2017. Vendim Nr. 43/13 Prot., datë 02.03.2017 i titullarit të autorizuar të AK, mbi miratimin e procedurës së prokurimit.	Formulari i njoftimit të fituesit datë 02.03.2017.	Tenderi i zhvilluar më datë: 15.02.2017.
Titullari i AK: Z. S.K, me autorizim prej tij Z. A. I..	Formulari i sigurimit të kontratës datë 31.03.2017 me vlerë 6,835,200 lekë.	Kualifikuar 1 OE. Pjesëmarrës 4 OE.
Kanë marrë pjesë në tender: Shoqëria "S. & C." Sh.p.k. me ofertë 57,890,856 lekë pa TVSH, skualifikuar. Shoqëria "B. 3." Sh.p.k. pa ofertë; skualifikuar. Shoqëria "P." Sh.p.k. pa ofertë; skualifikuar.	Njoftimi i klasifikimit datë 22.02.2017.	Njoftim i kontratës së nënshkruar: Publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. 14, datë 10.04.2017.

Me shkresën nr. 43/1 prot., datë 09.01.2017, është urdhëruar A.S., O. K. që të hartojnë në mënyrë të detajuar edhe specifikimet teknike, shkresë kjo e nënshkruar nga titullari, ndërkohë që me autorizim të posaçëm është autorizuar z. A. I. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor. Në dosje administrohen shkresat nga të dy personat e mësipërm, mbi deklarinimin që nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.

Me shkresën nr. 43/2 prot., datë 13.01.2017 janë hartuar specifikimet teknike të procedurës së mësipërme të prokurimit, shkresë kjo e nënshkruar nga Ing. Elektrik O.K.dhe Drejtori Teknik A. Zh..

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, konstatohet se nuk ka asnjë argumentim dhe dokumentim mbi përcaktimin e sasive, mbi bazën e të cilave është bërë dhe përlllogaritja e vlerës së fondit limit, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi Z. O.K. dhe Z. A. Zh..

Në pjesën e relacionit teknik të mbajtur nga grupi i mësipërm, konstatohet se Drejtori Teknik Z. A. Zh. nuk ka nënshkruar.

Gjithashtu, referuar specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor, rezulton se nuk ka asnjë argumentim dhe detajim mbi kriteret e përcaktuara, për të cilat ngarkohet me përgjegjësi grupi i hartimit të specifikimeve teknike.

Me shkresën nr. 43/3 prot., datë 23.01.2017 është bërë përlllogaritja e vlerës së fondit limit, si dhe në dosje administrohet formulari i deklarinimit të konfliktit të interesit.

Në dosjen e prokurimit të vënë në dispozicion, administrohet seti i dokumentave standarte të tenderit, set ky i cili është i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit.



Me shkresën nr. 43/4 prot., datë 23.01.2017 është nxjerrë Urdhëri Prokurimit, në të cilin konstatohet se nuk janë përcaktuar edhe anëtarët e njësisë së prokurimit, në kundërshtim kjo me legjislacionin e prokurimit publik, për të cilën mban përgjegjësi z. A.I., në cilësinë e ish titullarit të autorizuar të autoritetit kontraktor dhe personi përgjegjës që ka nxjerrë këtë urdhër.

Me shkresën nr. 43/5 prot., datë 23.01.2017 është urdhëruar ngritja e njësisë së prokurimit me përbërje J. V., D. B. dhe T. S.. Ky urdhër është nënshkruar nga titullari i autorizuar i autoritetit kontraktor. Në dosje administrohen formularët e deklaramit të konfliktit të interesit nga anëtarët e njësisë së prokurimit.

Në formularin e deklaramit të vënë në dispozicion, konstatohet se asnjë prej anëtarëve të mësipërm, nuk ka plotësuar në këtë formular që deklaron si anëtar i njësisë së prokurimit, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi J. V., D. B. dhe T. S..

Me urdhërin nr. 43/6 prot., datë 23.01.2017, është urdhëruar krijimi i komisionit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, me përbërje D.Gj. Kryetar, Q. Q. anëtare dhe D. Sh. anëtare.

Referuar deklaratave të konfliktit të interesit të administruara në dosjen e prokurimit, konstatohet se anëtari i KVO, Znj. D. Sh. nuk ka plotësuar nëse ndodhet ose jo në kushtet e konfliktit me operatorët ekonomikë pjesëmarrës, pasi nuk ka plotësuar pjesën e operatorëve ekonomikë, për të cilën mban përgjegjësi Znj. D. Sh..

Me procesverbalin nr. 43/7 prot., datë 23.01.2017 janë hartuar dhe miratuar kërkesat për kualifikim nga anëtarët e njësisë së prokurimit.

Nga shqyrtimi i kërkesave, konstatohet se:

Njësia e prokurimit ka kërkuar që, fusha e veprimtarisë së operatorit ekonomik duhet të jetë sipas objektit të prokurimit, vërtetuar sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar dhe Historik, kërkesë kjo e cila nuk gjen mbështetje ligjore, referuar kërkesës që objekti i prokurimit duhet të jetë i pasqyruar në ekstraktin e mësipërm.

Lidhur me kërkesën për bilancin, njësia e prokurimit nuk ka përcaktuar edhe vitet konkretë që kërkon, kërkesë kjo e cila shkakton konfuzion në vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse.

Lidhur me kërkesën për kapacitetin teknik, kërkesa që, distributori dhe prodhuesi duhet të vërtetohen me anë të një letre angazhimi ose akt marrëveshje, nuk gjen mbështetje ligjore. Kjo për faktin se, distributori është shoqëri e cila është e autorizuar nga prodhuesi që të tregtojë mallrat e saj.

Lidhur me përvojën e mëparshme janë kërkuar dëshmi në një vlerë jo më të madhe se 35% të vlerës së përlogarit të kontratës që prokurohet, kërkesë kjo e cila është evazive, si dhe nuk i vë ofertuesit në kushte të barabarta konkurimi dhe vlerësimi. Gjithashtu, përcaktimi i të dy lidhëzave dhe/ose shkakton konfuzion në vlerësimin e ofertave.

Njësia e prokurimit ka kërkuar që operatori ekonomik duhet të paraqesë në tender çertifikatën e menaxhimit të cilësisë së prodhuesit, ndërkohë që në DST është kërkuar edhe obsioni për distributorin, kërkesa këto të cilat bien në kundërshtim me njëra tjetrën.

Kërkesa që, objekti i prokurimit duhet të jetë në çertifikatat e menaxhimit të cilësisë është një kërkesë e cila nuk gjen mbështetje ligjore.

Kërkesa për kualifikim, lidhur me inxhinierin elektrik është një kërkesë e cila nuk është e argumentuar nga AK.

Në dosjen e prokurimit, mungon argumentimi dhe dokumentimi i vendosjes së kriterëve për kualifikim, në kundërshtim kjo me LPP.

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit.

Me shkresën nr. 43/8 prot., datë 23.01.2017 i është dërguar nga njësia e prokurimit, komisionit të vlerësimit të ofertave dokumentacioni i miratuar, mbi procedurën e mësipërme të prokurimit.



Me urdhërin e brendshëm nr. 43/9 prot., datë 23.01.2017 është urdhëruar ngritja e grupit të punës për ndjekjen e kontratës me përbërje A.Zh., O. K. dhe I. K..

Në dosje administrohet formulari i njoftimit të kontratës, formular i cili është publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 4, datë 30 Janar 2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Me shkresën nr. 43/10 prot., datë 15.02.2017, është mbajtur procesverbali mbi procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale elektrike”, sipas së cilës sqarohet se në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë katër operatorë ekonomikë, konkretisht “L. & A. E.” Sh.p.k. me ofertë 56,960,000 lekë pa TVSH, shoqëria “S. & C.” Sh.p.k. me ofertë 57,890,856 lekë pa TVSH, shoqëria “B. 3.” Sh.p.k. e cila nuk ka paraqitur asnjë dokument dhe nuk ka paraqitur ofertë, si dhe shoqëria “P.” Sh.p.k. e cila ka paraqitur në tender vetëm NIPT dhe nuk ka paraqitur ofertë. Ky procesverbal është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Më datë 22.02.2017, komisioni i vlerësimit të ofertave ka bërë vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse, ku ka kualifikuar ofertën më të ulët të paraqitur, si dhe ka skualifikuar tre ofertat e tjera të paraqitura në tender.

Me shkresën nr. 43/12 prot., datë 02.03.2017, komisioni i vlerësimit të ofertave i është drejtuar titullarit të AK, mbi miratimin e procedurës së mësipërme të prokurimit, si dhe me shkresën nr. 43/13 prot., datë 02.03.2017, nga titullari i autorizuar i AK, z. A.I. është bërë miratimi i procedurës së prokurimit, i cili në rastin konkret, referuar përcaktimeve në LPP, duhej të ishte saktësuar raport përmbledhës.

Me shkresën datë 02.03.2017 është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit, formular i cili është publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 9, datë 06 Mars 2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Me shkresën nr. 43/14 prot., datë 31.03.2017 është mbajtur procesverbali mbi verifikimin e dokumentacionit të procedurës “Blerje materiale elektrike”.

Me shkresën nr. 726 prot., datë 31.03.2017 është nënshkruar kontrata midis palëve, nga shqyrtimi i së cilës konstatohet se kjo kontratë nuk është nënshkruar me bashkimin e operatorëve ekonomikë që është shpallur fitues, si dhe vlera në këtë kontratë është pa TVSH, për të cilën mban përgjegjësi z. A. I., në cilësinë e personit të autorizuar të titullarit të AK.

Në dosje administrohet formulari i sigurimit të kontratës nr. Serie 46452504, datë 31.03.2017, i cili rezulton se është për vlerën totale të ofertës fituese me TVSH.

Në dosje administrohet formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar, formular i cili është publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 14, datë 10 Prill 2017 të APP.

Neni 56 i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrat të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit”*.

Neni 59 i VKM së mësipërme parashikon se: *“Përlllogaritja e vlerësimit të kontratës bëhet nga njëësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.*

2. Në përlllogaritjen e vlerësimit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave



(INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës”.

Pika 2 e nenit 57 të VKM së mësipërme, parashikon se:

“Njësia e prokurimit është përgjegjëse për:

- sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;

- përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti);

- përlllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;

- hartimin e urdhrit të prokurimit;

- përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;

- hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;

- administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;

- llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti”.

Neni 23 i LPP, mbi specifikimet teknike, parashikon se:

“1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:

a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;

b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;



c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj.

4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t’u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin.

5. Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime”.

Neni 60 i VKM së mësipërme, parashikon se:

Kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, pas përllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;
- fondin e përllogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër;
- llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti);
- emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit”.

Sipas observacioneve të dërguara nr. 56/15 prot., datë 10.01.2019 mbi akt konstatimin, me objekt: “Observacion mbi akt konstatimin nr. 15, datë 28.12.2018”, është sqaruar se, AK nuk ka dërguar dokumentacion që të provojë dhe vërtetojë të kundërtën mbi të gjitha konstatimet e mësipërme. Gjithashtu, sqarimet e dhëna nuk janë të mbështetura në akte shoqëruese dokumentuese dhe provuese.

8. Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Rikonstruksion i linjës furnizuese në depon nr. 3 Arapaj, Rr. Shkolla Arapaj, Njësia Admin. Rrashbull, Bashkia Durrës”**, me të dhëna si më poshtë vijon:

Kontrata lidhur nr. 2488 prot., datë 12.09.2017, me numër reference 908/16-29-05-2017.
Çmimi i kontratës së lidhur 10,358,618 lekë pa TVSH, 12,430,341 lekë me TVSH.
Afati i kontratës është 30 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.
Kontraktori “K. & A. I.” Sh.p.k.
Objekti i kontratës: “Rikonstruksion i linjës furnizuese në depon nr. 3 Arapaj, Rr. Shkolla Arapaj, Njësia Admin. Rrashbull, Bashkia Durrës” .
Faturë tatimore shitje nr. 68, datë 12.10.2017, me vlerë 2,537,640 lekë me TVSH, nr. 62, datë 29.09.2017 me vlerë 9,299,940 lekë me TVSH dhe nr. 69, datë 12.10.2017 me vlerë 591,894 lekë me TVSH.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A. DURRËS

Grupi i punës për ndjekjen e kontratës: A. Zh., L.F, B. M..

Titullari i autorizuar i AK, Z. A. I.

Mbikqyrësi i punimeve shoqëria “S. S. K.-S.” Sh.p.k. me administrator K. S..

Me shkresën nr. 2488 prot., datë 12.09.2017 është lidhur kontrata midis shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime Sh.a. Durrës”, përfaqësuar nga Z. A. I. dhe operatorit ekonomik “K. & A. I.” sh.p.k. me vlerë 12,430,341 lekë ME TVSH, përfaqësuar nga Z. Sh. K..

Në kundërshtim të plotë me legjislacionin e prokurimit publik, kontrata e mësipërme është lidhur vetëm me një operator ekonomik, ndërkohë që fitues në procedurën e mësipërme të prokurimit është bashkimi i mësipërm i operatorëve ekonomikë, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi ligjore ish titullari i autorizuar z. A. I.

Në kushtet e kontratës, së nënshkruar dhe rënë dakort midis palëve është përcaktuar se, afati për mbarimin e punimeve është 30 ditë kalendrike duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

Në kushtet e mësipërme, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, punimet kanë përfunduar në datë 12.10.2017, datë në të cilën janë prerë edhe faturat tatimore të shitjes.

Referuar kushteve të kontratës së rënë dakort midis palëve, punimet duhej të kishin përfunduar në datë 11.10.2017, pra kanë përfunduar 1 ditë me vonesë.

Sa më sipër, vlera prej $12,430,341 - 9,299,940 = 3,130,401 \times 4/1000 \times 1 = 12,521$ lekë përbën dëm ekonomik ndaj Buxhetit të Shtetit, si pasojë e mosmbajtjes së penaliteve, sipas kushteve të rëna dakort midis palëve.

Neni 56 i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrat të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit”*.

Veprimet e mësipërme, bien në kundërshtim me nenet 59, 60 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Sa më sipër, mbajnë përgjegjësi ligjore Z. L.F, në cilësinë e personit përgjegjës të AK që ka nënshkruar në faturat tatimore të shitjes, grupi i marrjes në dorëzim, mbikqyrësi i punimeve dhe kontraktori.

Sipas observacioneve të dërguara nr. 56/16 prot., datë 10.01.2019 mbi akt konstatimin, me objekt: *“Observacion mbi akt konstatimin nr. 16, datë 28.12.2018”*, konstatohet se observacioni i dërguar nuk është i shoqëruar me dokumentacion, që të provojë dhe vërtetojë të kundërtën e konstatimit, si dhe sqarimet e dhëna nuk gjenden të bazuara në ligj.

9. Në procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtim i rrjetit të ri në lagjen Gramsh, Njësia Adm. Rrashbull, Bashkia Durrës”, me të dhëna si më poshtë vijon:

Kontrata lidhur nr. 1300 prot., datë 06.06.2017, me numër reference 855/4-04-04-2017.
Çmimi i kontratës së lidhur 11,723,040 lekë pa TVSH, 14,067,648 lekë me TVSH.
Afati i kontratës për mbarimin e punimeve është 60 ditë kalendrike duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.
Kontraktori “L. VII” Sh.p.k. me NIPT K01730502Ë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS
KANALIZIME SH.A. DURRËS

Objekti i kontratës: “Ndërtim i rrjetit të ri në lagjen Gramsh, Njësia Adm. Rrashbull, Bashkia Durrës”.
Mbikqyrësi i punimeve “G. C. E.” sh.p.k. me administrator G. B..
Situacion pjesor nr. 1, sipas faturës tatimore nr. 60, datë 30.06.2017, me vlerë 7,458,840 lekë, si dhe situacion përfundimtar punimesh nr. 83, datë 24.08.2017 me vlerë 6,604,080 lekë.
Grupi i marrjes së punimeve në dorëzim: L.F, B.M., D. Sh..
Titullari i autorizuar i AK, Z. A. I..

Me shkresën nr. 1300 prot., datë 06.06.2017 është lidhur kontrata midis shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Sh.a. Durrës”, përfaqësuar nga Z. A. I. dhe operatorit ekonomik “L.VII” sh.p.k. me vlerë 11,723,040 lekë pa TVSH, 14,067,648 lekë me TVSH.

Në kushtet e kontratës, së nënshkruar dhe rënë dakort midis palëve është përcaktuar se, afati për mbarimin e punimeve është 60 ditë kalendarike duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës. Pra, afati maksimal për përfundimin e punimeve, sipas kontratës bazë ka qenë data 04.08.2017.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, në dosje administrohet situacioni pjesor nr. 1, sipas faturës tatimore nr. 60, datë 30.06.2017, me vlerë 7,458,840 lekë me TVSH, si dhe situacioni përfundimtar sipas faturës nr. 83, datë 24.08.2017 me vlerë 6,604,080 lekë me TVSH.

Referuar sa më sipër, afati i kontratës bazë ka përfunduar në datë 24.08.2017, pra me një afat të paargumentuar dhe padokumentuar prej 20 ditë me vonesë, në kundërshtim kjo me kushtet e kontratës së rënë dakort midis palëve.

Sa më sipër, vlera prej 6,604,080 x 4/1000 = 26,416 lekë x 20 ditë = 528,320 lekë përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të Shtetit, si pasojë e mosmbajtjes së penaliteteve për mos përfundim të punimeve sipas afateve të përcaktuara në kontratë.

Lidhur sa më sipër, mbajnë përgjegjësi, mbikqyrësi i punimeve, grupi i punës së ndjekjes së kontratës dhe kontraktori.

Neni 56 i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: “Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrat të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit”.

Veprimet e mësipërme, bien në kundërshtim me nenet 59, 60 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Sipas observacionit të dërguar nr. 56/17 prot., datë 10.01.2019 mbi akt konstatimin, me objekt: “Observacion mbi akt konstatimin nr. 17, datë 28.12.2018”, është sqaruar se, AK nuk ka dërguar dokumentacion që të provojë dhe vërtetojë të kundërtën e konstatimit, si dhe sqarimet e dhëna nuk janë të shoqëruara me dokumentacion provues. Në këto kushte, observacioni i dërguar nuk merret në konsideratë.

10.Në procedurën e prokurimit me objekt: :“*Blerje pajisje kompjuterike dhe informatike*”, me të dhëna si më poshtë vijon:

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
-----------------------	------------------------------------	---------------------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS
KANALIZIME SH.A. DURRËS

Urdhër Prokurimi i titullarit të autoritetit kontraktor Nr. 960/11 Prot., datë 08.05.2017.	D.Gj., Kryetar, M. H. Anëtare, D. Sh., Anëtare.	J. V., D. B., A. B..
Vlera e përlogaritur e kontratës: 9,870,533 lekë pa TVSH.		
Lloji i procedurës: Procedurë e hapur me mjete elektronike.		
Operatori ekonomik fitues “S.&T. A.” sh.p.k. Vlera e ofertës 9,536,249 lekë pa TVSH. Ulja nga fondi limit: 334,284 lekë pa TVSH.		
Kontrata Nr. 1780 Prot., datë 03.07.2017, vlera 9,536,249 lekë pa TVSH.		
Raporti përmbledhës i hartuar nga KVO, Nr. 960/3 Prot., datë 27.06.2017. Vendim Nr. 960/24 Prot., datë 27.06.2017 i titullarit të autorizuar të AK, mbi miratimin e procedurës së prokurimit.	Formulari i njoftimit të fituesit datë 27.06.2017.	Tenderi i zhvilluar më datë: 16.06.2017.
Titullari i AK: Z. S.K, me autorizim prej tij Z. A. I..	Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike Z. S. K. dhe Z. M. U., sipas urdhërit datë 28.04.2017.	Kualifikuar 1 OE. Pjesëmarrës 2 OE.
Kanë marrë pjesë në tender: Shoqëria “I. S.” Sh.p.k.; asnjë dokument i, pa ofertë, skualifikuar.	Njoftimi i klasifikimit datë 19.06.2017.	Njoftim i kontratës së nënshkruar: Publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. 27, datë 10.07.2017.

Me urdhërin nr. 960/12 prot., datë 08.05.2017, të ish titullarit të autorizuar të AK, z. A. I. është urdhëruar ngritja e njësisë së prokurimit me përbërje Znj. J. V., Znj. D.B. dhe Znj. A. B..

Në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, anëtarët e njësisë së prokurimit, nuk janë përcaktuar në urdhërin e prokurimit, por në urdhërin për ngritjen e njësisë së prokurimit, për të cilën mban përgjegjësi z. A.I., në cilësinë e titullarit të autorizuar të AK.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, lidhur me hartimin dhe miratimin e kërkesave për kualifikim, administrohen tre shtojca nr. 1, mbi formularin e deklaramit të konfliktit të interesit,



nga shqyrtimi i të cilave konstatohet se *Znj. A. B. nuk ka deklaruar nëse ndodhet ose jo në kushtet e konfliktit të interesit.*

Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me LPP, ku parashikohet se çdo zyrtar që merr pjesë në një procedurë prokurimi, duhet të deklarojë nëse ndodhet ose jo në kushtet e konfliktit të interesit.

Sa më sipër, mban përgjegjësi ligjore Znj. A. B., për mosdeklarim të konfliktit të interesit.

Gjithashtu, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, me shkresën nr. 960/12 prot., datë 08.05.2017 është urdhëruar ngritja e njësisë së prokurimit, ku është përcaktuar që, këta anëtarë, në përputhje me LPP si dhe dokumentet e miratuara nga njësia e prokurimit, të nisin procedurën elektronike për objektin e sipërpërmendur. Ndërkohë, procesverbali nr. 1, me nr. 960/14 prot., është mbajtur në datë 08.05.2017, pra pas daljes së këtij urdhëri, ndërkohë që përcaktohet se janë miratuar më parë, *për të cilën ngarkohen me përgjegjësi ligjore të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit konkretisht Znj. J. V., Znj. D. B. dhe Znj. A. B.*

Referuar kërkesave për kualifikim, të hartuara dhe miratuara nga njësia e prokurimit me shkresën nr. 960/14 prot., datë 08.05.2017, konstatohet se kërkesat për kualifikim të hartuara nga AK janë diskrimnuese, konfuze, si dhe ulin konkurrencën në prokurim, si më poshtë vijon:

Në kriteret specifike për kualifikim është kërkuar që: *“Fusha e veprimtarisë së operatorit ekonomik duhet të jetë sipas objektit të prokurimit. Për të vërtetuar këtë, operatori ekonomik duhet të paraqesë Ekstraktin e Rregjistrimit Tregtar dhe Historik”.*

Një përcaktim i tillë nuk është i saktë si dhe nuk gjen mbështetje ligjore.

Pra, njësia e prokurimit nuk mund të kërkojë që për procedura të shumta dhe të ndryshme prokurimi që zhvillon, të kërkojë që objekti i prokurimit të jetë i pasqyruar në Ekstraktin e Rregjistrimit Tregtar, pasi objekti konkret i prokurimit është *“Blerje pajisje informatike dhe kompjuterike”.* Pra, nuk mundet kurrësi që operatorët ekonomikë të përfshijnë çdo objekt prokurimi që marrin pjesë, në rast se do të merret si e mirëqenë kjo kërkesë për kualifikim.

Në kërkesat specifike për kualifikim, njësia e prokurimit ka kërkuar që *“OE duhet të paraqesë bilancin e tre viteve të fundit të çertifikuar nga tatimet”*, kërkesë kjo e cila duhej të ishte më e plotë, duke specifikuar edhe vitet konkretë që kërkohen.

Në kriteret specifike për kualifikim, AK ka kërkuar që *“OE duhet të jetë i çertifikuar me çertifikatën ISO 9001:2008, e cila të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e produkteve që prokurohen”*, kërkesë kjo e cila nuk është e saktë, referuar përcaktimit të bërë, pasi nuk mundet që organizma të ndryshme, të japin çertifikime të tilla, duke specifikuar çdo produkt që një autoritet kontraktor prokuron.

Lidhur me kërkesën për kualifikim që, OE duhet të deklarojë që merr përsipër paraqitjen e çertifikatës CE dhe çertifikatës së origjinës së mallit, të cilat duhet të dorëzohen pranë AK në momentin e dorëzimit të mallrave është një kërkesë e cila nuk i përket kriterëve për kualifikim, por fazës së zbatimit të kontratës.

Në kriteret specifike për kualifikim, lidhur me shërbimet e ngjashme, në kundërshtim të plotë me LPP, njësia e prokurimit nuk ka përcaktuar dokumentacionin konkret që duhet të paraqesin ofertuesit për plotësimin e këtij kriteri për kualifikim, pra si për rastin kur shërbimet janë kryer me institucione publike, ashtu edhe kur janë kryer me ente private.

Pra, në këtë mënyrë, nga njësia e prokurimit janë kufizuar të gjitha shoqëritë, jo vetëm, për kontrata të realizuara me privatë, por edhe për dokumentacionin konkret që duhet të dorëzohet për plotësimin e këtij kriteri për kualifikim.

Kriteri për kualifikim, lidhur me stafin e kërkuar, nuk është argumentuar, si dhe në raport me kontratën që kërkon të realizojë. Gjithashtu, periudha e kërkuar është një periudhë e cila kufizon



pjesëmarrjen e OE në tender, referuar kjo objektit konkret që kërkon të prokurohet, pasi stafi mund të kontraktohet edhe me kontrata pune, kjo në kushtet kur procedua e prokurimit është blerje malli.

Lidhur sa më sipër, nga njësia e prokurimit janë hartuar kritere për kualifikim diskriminuse, të cilat ulin konkurrencën në prokurim, nuk nxitin pjesëmarrjen e shoqërive në prokurim, si dhe nuk i vendosin shoqëritë në kushte të barabarta konkurimi dhe vlerësimi.

Lidhur sa më sipër, mbajnë përgjegjësi ligjore të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit konkretisht Znj. J.V., Znj. D.B. dhe Znj. A. B..

Lidhur me kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike, pranë AK është paraqitur ankesë nga operatori ekonomik "I. S." Sh.p.k. duke argumentuar lidhur me pretendimet e ngritura, që specifikimet teknike të hartuara nga AK janë të modelit DELL Storage SCV2000 Series.

Për trajtimin e ankesës është ngritur grupi i punës me përbërje Z. G.S., Znj. T.S. dhe Z. E. E., ku konstatohet se në përbërje të këtij grupi nuk janë të gjithë specialistë të fushës, për sa do të shqyrtonin ankesën mbi specifikimet teknike, konkretisht për pajset informatike dhe kompjuterike, për të cilën mban përgjegjësi titullari i autorizuar i AK.

Me shkresën nr. 960/16 prot, datë 09.05.2017, grupi i punës i ngritur për shqyrtimin e ankesës, nuk ka pranuar ankesën e bërë, ndërkohë që këto specifikime teknike i përkasin markës së mësipërme.

Lidhur me këtë pikë, mbajnë përgjegjësi të gjithë anëtarët e grupit të hartimit të specifikimeve teknike konkretisht S. K., Z. M.U., si dhe të gjithë anëtarët e grupit që kanë shqyrtuar ankesën konkretisht Z. G.S., Znj. T.S. dhe Z. E. E..

Referuar dokumentacionit të zbatimit të kontratës, të vënë në dispozicion nga AK, konstatohet se: Me shkresën nr. 1780 prot., datë 03.07.2017, është lidhur kontrata midis palëve, me vlerë totale 9,536,249 lekë pa TVSH, ku në kundërshtim me LPP, kontrata duhej të ishte lidhur për vlerën totale të pagueshme me TVSH, pra në vlerën 11,443,498 lekë me TVSH.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, sipas kontratës së rënë dakort midis palëve përcaktohet se afati i dorëzimit të mallit është 45 ditë kalendarike, pra afati maksimal për dorëzimin e mallit ka qenë data 16.08.2017.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga kontraktori, si dhe të marrë në dorëzim nga grupi i punës me përbërje S.K., M. U. dhe N. D. konstatohet se, për zërin "Printer Multifunction B & E + 1 set boje", nga kontraktori nuk është dorëzuar 1 set boje, pra nuk janë përbushur detyrimet kontraktuale.

Gjithashtu, ky zë nuk është bërë as hyrje në magazinë, sipas specifikimeve dhe kërkesave të kërkuara nga AK.

Në kushtet e mësipërme, kontraktori nuk ka dorëzuar mallin e prokuruar dhe për të cilin ka rënë dakort, me një afat vonese prej 137 ditë (deri në datë 31.12.2017).

Për sa më sipër, vlera prej $11,443,498 \times 25\% = 2,860,874 \times 4/1000 = 11,443 \times 137 = 1,567,691$ lekë, vlerë e cila përbën një vlerë të paargumenuar dhe paarkëtuar nga AK, lidhur me mosmbajtjen e penaliteteve, për mos dorëzim të mallit sipas kushteve të kontratës së rënë dakort midis palëve.

Gjithashtu, AK ka detyrimin ligjor të bëjë përllogaritjet përkatëse mbi penalitetin për të gjithë periudhën e mëpasshme, duke kërkuar nga kontraktori dorëzimin e mallit sipas specifikimeve teknike dhe kushteve të kontratës, përfshirë dokumentet e tenderit.

Lidhur me këtë pikë, mbajnë përgjegjësi grupi i marrjes së mallit në dorëzim, si dhe kontraktori. Neni 56 i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikon se: "**Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është**



përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrat të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit”.

Neni 59 i VKM së mësipërme parashikon se: *“Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.*

2. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrat të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës”.

Pika 2 e nenit 57 të VKM së mësipërme, parashikon se:

“Njësia e prokurimit është përgjegjëse për:

- sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;

- përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti);

- përlllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;

- hartimin e urdhrat të prokurimit;

- përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;

- hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;

- administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;

- llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti”.

Neni 23 i LPP, mbi specifikimet teknike, parashikon se:

“1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:



a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;

b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t'u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin.

5. Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime".

Neni 60 i VKM së mësipërme, parashikon se:

Kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;
- fondin e përlllogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përlllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër;
- llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti);
- emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit".

Veprimet e mësipërme, bien në kundërshtim me nenet 59, 60 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Sipas observacionit të dërguar nr. 56/18 prot., datë 10.01.2019 mbi akt konstatimin, me objekt: "Observacion mbi akt konstatimin nr. 18, datë 28.12.2018", është sqaruar se:

Sqarimi i dhënë nga Znj. A. B. që, fakti se zyrtari i prokurimit nuk ka shkruar as që ndodhet dhe as që nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit për procedurën e prokurimit në fjalë, nuk do të thotë automatikisht se zyrtari ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, është një sqarim i cili nuk gjen mbështetje ligjore, si dhe nuk argumenton për sa është konstatuar si shkelje e legjislacionit të prokurimit publik.



Sqarimi i dhënë nga anëtari i njësisë së prokurimit se, zyrtari nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe ka nënshkruar formularin pa i kushtuar rëndësinë që duhet, për shkak të shpejtësisë, është një arsyetim dhe shpjegim absurd, i cili jo vetëm nuk mund të provohet nga ana juaj, por nuk gjen mbështetje ligjore.

Sqarimi i dhënë nga anëtari i njësisë së prokurimit se, në rast të kundërt do të tregonte më shumë vëmendje për të deklaruar se ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, është një sqarim i pambështetur në ligj dhe në prova.

Sqarimi i dhënë nga Znj. A. B. se, formularët e deklarimit të konfliktit të interesit janë akte pa numër protokoll që mund të plotësohen apo ndryshohen lehtësisht në çdo kohë është një sqarim absurd, i cili përbën një precedent shumë të rrezikshëm antiligjor, konkretisht mbi arsyetimin e dhënë që këta formularë mund të ndryshohen lehtësisht në çdo kohë.

Sqarimi i dhënë se, urdhëri i ngritjes së njësisë së prokurimit në çdo procedurë vjen përpara procesverbalit nr. 1 dhe duket qartë se është izoluar konteksti i aktit dhe është një lapsus në hartimin e tij, nuk argumenton të kundërtën për sa është konstatuar, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi njësi e prokurimit.

Gjithashtu, të gjitha arsyetimet e tjera të dhëna nuk qëndrojnë, në kushtet kur nuk janë të shoqëruara me dokumentacion, që të provojnë të kundërtën e konstatimit.

Gjithashtu ju sqarojmë se, lidhur me mosdorëzimin e mallit, të gjitha konstatimet dhe sqarimet e nevojshme, janë bërë në prani të të gjithë personave përgjegjës të AK.

Në kushtet e mësipërme, observacioni i dërguar për këtë pikë, nuk qëndron, pasi nuk është i shoqëruar me dokumentacion që të provojë dhe vërtetojë të kundërtën e konstatimit, si dhe nuk është i bazuar në ligj.

11.Në procedurën e prokurimit me objekt: :**“Blerje materiale kancelarie dhe të ngjashme”**, me të dhëna si më poshtë vijon:

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër Prokurimi i titullarit të autoritetit kontraktor Nr. 200/5 Prot., datë 01.03.2018.	D. Gj., Kryetar, M. U. Anëtar,	A. B., B. M.,
Vlera e përlllogaritur e kontratës: 6,999,896 lekë pa TVSH.	D. Sh., Anëtare.	D. B..
Lloji i procedurës: Kërkesë për propozim me mjete elektronike.		
Operatori ekonomik fitues “I. O.” sh.p.k. Vlera e ofertës 6,200,000 lekë pa TVSH. Ulja nga fondi limit: 799,896 lekë pa TVSH.		
Kontrata Nr. 973 Prot., datë 19.04.2018, vlera 6,200,000 lekë pa TVSH.		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A. DURRËS

Raporti përmbledhës i hartuar nga KVO, Nr. 960/3 Prot., datë 27.06.2017. Vendim Nr. 200/21 Prot., datë 10.04.2018 i titullarit të autorizuar të AK, mbi miratimin e procedurës së prokurimit.	Formulari i njoftimit të fituesit datë 10.04.2018.	Tenderi i zhvilluar më datë: 26.03.2018.
Titullari i AK: Z. S.K, me autorizim prej tij Znj. F.K.	Formulari i sigurimit të kontratës datë 16.04.2018.	Kualifikuar 2 OE. Pjesëmarrës 3 OE.
Kanë marrë pjesë në tender: Shoqëria "I. Gj. K." Sh.p.k.me ofertë 6,791,000 lekë pa TVSH, kualifikuar. Shoqëria "A." Sh.p.k. skualifikuar, pa ofertë.	Njoftimi i klasifikimit datë 30.03.2018.	Njoftim i kontratës së nënshkruar: Publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. 16, datë 23.04.2018.

Me urdhërin nr. 200/2 prot., datë 17.01.2018, sipas urdhërit të titullarit të autorizuar të AK, z. A. I. është urdhëruar ngritja e grupit të punës për hartimin dhe miratimin e specifikimeve teknike me përbërje S. K. dhe M. Xh..

Me shkresën nr. 200/3 prot., datë 26.02.2018, grupi i punës i mësipërm ka hartuar specifikimet teknike, duke përcaktuar njëkohësisht edhe sasinë për objektin e mësipërm. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se nuk ka asnjë argumentim dhe dokumentim mbi sasinë e përcaktuara, si dhe specifikimet teknike nuk janë dhënë të detajuara për secilin zë, për të cilën mbajnë përgjegjësi Z. S.K. dhe Znj. M. Xh..

Me urdhërin nr. 200/5 prot., datë 01.03.2018 është hartuar urdhëri i prokurimit, në të cilin konstatohet se mungojnë emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit, për të cilin mban përgjegjësi titullari i autorizuar i AK, pavarësisht se njësia e prokurimit është ngritur me urdhër të veçantë nr. 200/6 prot., datë 01.03.2018 me përbërje A.B., B.M. dhe D.B..

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga AK, për hartimin dhe miratimin e kërkesave për kualifikim, rezulton se kriteret e miratuara nuk janë të gjitha të njëjta me ato të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik, për të cilën mbajnë përgjegjësi ligjore të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit konkretisht Znj. A.B., Z. B.M. dhe Znj. D.B..

Nga shqyrtimi i kërkesave për kualifikim konstatohet se, njësia e prokurimit ka hartuar kërkesa të cilat janë diskriminuese, konfuze, të cilat ulin konkurrencën në prokurim, si më poshtë vijon:

Në kriteret specifike për kualifikim, njësia e prokurimit ka kërkuar që OE duhet të paraqesë bilancin e tre viteve të fundit por, referuar edhe datës së hapjes së procedurës, AK duhej të kishte specifikuar vitet konkretë që kërkon, me qëllim që ofertuesit të vihen në kushte të barabarta konkurimi dhe vlerësimi.

Në kriteret specifike për kualifikim, njësia e prokurimit ka kërkuar që vlera e xhiros të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit, ndërkohë që në procedura të tjera prokurimi, nuk ka mbajtur të njëjtin qëndrim, *ku për më tepër anëtarët A.B. dhe D.B. janë anëtarë të njëjtë.*



Lidhur me ISO e kërkuara, AK duhej të kishte kërkuar të detajuar çertifikimet që kërkon.

Lidhur me kërkesat e kërkuara tek kapaciteti teknik, konstatohet se shumë prej tyre i përkasin fazës së zbatimit të kontratës, dhe jo kritereve për kualifikim.

Lidhur me shërbimet e ngjashme, kërkesa e AK bie në kundërshtim me sa është parashikuar nga ligjvënësi në VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në dosje mungon argumentimi dhe dokumentimi i vendosjes së kritereve për kualifikim, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës që prokurohet.

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi ligjore të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit konkretisht A. B., B. M. dhe D. B..

Referuar dokumentacionit të zbatimit të kontratës, të vënë në dispozicion nga AK, konstatohet se, me shkresën nr. 973 prot., datë 19.04.2018, është lidhur kontrata midis palëve, me vlerë totale 6,200,000 lekë pa TVSH, ku në kundërshtim me LPP, kontrata duhej të ishte lidhur për vlerën totale të pagueshme me TVSH, pra në vlerën 7,440,000 lekë me TVSH.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, sipas kontratës së rënë dakort midis palëve përcaktohet se afati i dorëzimit të mallit është 30 ditë kalendarike.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga kontraktori, si dhe të marrë në dorëzim nga grupi i punës me përbërje S. K., S. N. dhe N. D. konstatohet se:

Për zërin HP FOTOPAPER GLOSS 36... AK ka kërkuar dhe ka prokuruar sasinë për 1 rulon, ndërkohë që kontraktori ka dorëzuar sasinë 1 copë.

Për zërin MARKER KOMPLET ME 4 NGJYRA PËR TABELË SHËNIMESH, AK ka kërkuar dhe ka prokuruar sasinë prej 200 kuti, pra për 800 copë, ndërkohë që ka marrë në dorëzim 200 copë.

Për zërin KAPSE DOKUMENTASH BINDER CLIPP 199MM, PAKETIM 12 COPË, AK ka marrë në dorëzim, sipas faturës tatimore të shitjes të kontraktuesit, paketim me një copë.

E njëjta gjë vlen për analogji edhe për zërat nr. Rendor 28 dhe 30, ku AK ka kërkuar paketim me 12 copë, ndërkohë që ka marrë në dorëzim paketim me një copë.

Në zërin KONICA MINOLTA MAGIC COLOR.... AK ka kërkuar dhe ka prokuruar sasinë për 1 set me 4 copë, ndërkohë që ka marrë në dorëzim sasinë prej 1 copë.

Gjithashtu, zërat e mësipërm nuk janë bërë as hyrje në magazinë, sipas specifikimeve dhe kërkesave të kërkuara nga AK.

Në kushtet e mësipërme, kontraktori nuk ka dorëzuar mallin e prokuruar dhe për të cilin ka rënë dakort, me një afat vonese prej 104 ditë (deri në datë 31.08.2018).

Për sa më sipër, vlera prej 7,440,000 x 25% = 1,860,000 x 4/1000 = 7,440 x 104 = 773,760 lekë, vlerë e cila përbën një vlerë të paargumenuar dhe paarkëtuar nga AK, lidhur me mosmbajtjen e penalteteve, për mos dorëzim të mallit sipas kushteve të kontratës së rënë dakort midis palëve.

Gjithashtu, AK ka detyrimin ligjor të bëjë përlllogaritjet përkatëse mbi penaltetin për të gjithë periudhën e mëpasshme, duke kërkuar nga kontraktori dorëzimin e mallit sipas specifikimeve teknike dhe kushteve të kontratës, përfshirë dokumentet e tenderit.

Lidhur me këtë pikë, mbajnë përgjegjësi grupi i marrjes së mallit në dorëzim, si dhe kontraktori.

Neni 56 i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrat të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e*



dokumente të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit”.

Neni 59 i VKM së mësipërme parashikon se: *“Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.*

2. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës”.

Pika 2 e nenit 57 të VKM së mësipërme, parashikon se:

“Njësia e prokurimit është përgjegjëse për:

- sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;

- përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti);

- përlllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;

- hartimin e urdhrin të prokurimit;

- përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;

- hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;

- administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;

- llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti”.

Neni 23 i LPP, mbi specifikimet teknike, parashikon se:

“1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:

a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve



teknike kombëtare ose specifitimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;

b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specififikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specififikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t'u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specififikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshatshme për mjedisin.

5. Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime".

Neni 60 i VKM së mësipërme, parashikon se:

Kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;
- fondin e përlllogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përlllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër;
- llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti);
- emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit".

Veprimet e mësipërme, bien në kundërshtim me nenet 59, 60 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Sipas observacioneve të dërguara nr. 56/19 prot., datë 10.01.2019 mbi akt konstatimin, me objekt: "Observacion mbi akt konstatimin nr. 19, datë 28.12.2018" është sqaruar se, AK nuk ka dërguar dokumentacion, që të provojë dhe vërtetojë të kundërtën e konstatimit. Gjithashtu, observacioni i dërguar nuk gjendet i bazuar në ligj dhe në prova.

12.Në procedurën e prokurimit me objekt: "**Projekt Magazina**", me të dhëna si më poshtë vijon:

Kontrata lidhur nr. 383 prot., datë 21.02.2017, me numër reference 3359/4-21-12-2016.
Çmimi i kontratës së lidhur 6,656,263 lekë me TVSH.
Afati i kontratës është 60 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.
Kontraktori "M. & Xh." Sh.p.k.
Objekti i kontratës: " Projekt Magazina ".



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A. DURRËS

Titullari i autorizuar i AK, Z. A. I.

Shtesë kontrate nr. 73/10 prot., datë 07.04.2017, me vlerë 1,107,302 lekë pa TVSH, 1,328,762 lekë me TVSH.

Mbikqyrësi i punimeve shoqëria “J. P.” Sh.p.k. me administrator Fadil Borishi.

Me shkresën nr. 383 prot., datë 21.02.2017 është lidhur kontrata midis shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Sh.a. Durrës”, përfaqësuar nga Z. A.I. dhe operatorit ekonomik “M. & Xh.” sh.p.k. me vlerë 6,656,263 lekë me TVSH, përfaqësuar nga Z. N. L..

Në kundërshtim të plotë me legjislacionin e prokurimit publik, kontrata e mësipërme është lidhur vetëm me një operator ekonomik, ndërkohë që fitues në procedurën e mësipërme të prokurimit është bashkimi i mësipërm i operatorëve ekonomikë, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi ligjore ish titullari i autorizuar i AK, Z. A.I.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga AK, konstatohet se:

Bashkimi i mësipërm i operatorëve ekonomikë është kualifikuar në këtë procedurë prokurimi, duke paraqitur në tender kontratën e bashkëpunimit nr. 93 prot., nr. 23 kol, datë 12.01.2017. Sipas kësaj kontrate bashkëpunimi, palët kanë rënë dakort që, shoqëria “M.” Sh.p.k. do të kryejë 40% të punimeve për çdo zë në preventiv, kurse shoqëria “Xh.” do të kryejë 60% të punimeve për çdo zë në preventiv.

Gjithashtu, sipas prokurës së posaçme të paraqitur në tender, shoqëria “M.” Sh.p.k. është autorizuar si përfaqësues, duke patur të drejtën e nënshkrimit të dokumentacionit të nevojshëm, deri në dorëzimin e punimeve.

Referuar dokumentacionit të administruar dhe të vënë në dispozicion nga AK, konstatohet se, pranë AK është prerë fatura tatimore e shitjes nr. 7, datë 02.03.2017, lidhur me situacionin nr. 1, protokolluar në AK nr. 407/5 prot., datë 02.03.2017, me vlerë totale 3,014,580 lekë me TVSH.

Në dosje administrohet fatura tatimore e shitjes nr. 8, datë 21.04.2017, situacion përfundimtar, me vlerë totale 3,308,839 lekë me TVSH.

Me shkresën nr. 73/10 prot, datë 07.04.2017 është lidhur kontrata shtesë, për vlerën 1,107,302 lekë pa TVSH, ku në kundërshtim me LPP, kjo kontratë nuk është lidhur me TVSH, si dhe me bashkimin e OE të cilët janë shpallur edhe fitues, për të cilën mban përgjegjësi ish titullari i autorizuar AK.

Në dosje administrohet fatura tatimore e shitjes nr. 11, datë 02.05.2017, situacion kontrata shtesë, me vlerë 1,328,762 lekë.

Referuar sa më sipër dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, krijimi i bashkimit të mësipërm të OE nuk është i saktë, pasi të gjitha faturat tatimore janë prerë vetëm nga shoqëria “M.” Sh.p.k. si për kontratën bazë, ashtu edhe për kontratën shtesë.

Sa më sipër, kjo shoqëri është paguar për zëra të pakryer prej saj, pasi në total, referuar faturave tatimore të prera, shoqëria “M.” sh.p.k. ka marrë përsipër:

$3,014,580 \times 40\% = 1,205,832$ lekë.

$3,308,839 \times 40\% = 1,323,535$ lekë.

$1,328,762 \times 40\% = 531,504$ lekë.

Pra, shoqëria “M.” Sh.p.k. është paguar për një vlerë prej $7,652,181 - 3,060,871 = 4,591,310$ lekë, e cila përbën një shpenzim të paligjshëm, të përfituar nga shoqëria “M.” Sh.p.k.

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi kontraktori, mbikqyrësi i punimeve, si dhe grupi i punës L.F, A.K. dhe B. M..



Neni 56 i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrat të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit”*.

Veprimet e mësipërme, bien në kundërshtim me nenet 59, 60 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Sqaruar sa më sipër, shoqëria M. Sh.p.k. ka prerë të gjithë faturën tatimore ndaj AK, në vlerën totale të kontratës, duke bërë në këtë mënyrë një deklaram të pasaktë edhe pranë organit tatimor. Gjithashtu, operatori tjetër ekonomik, shoqëria Xh. Sh.p.k. e cila ka marrë përsipër të realizojë 60% të kontratës, nuk ka bërë asnjë deklaram pranë organit tatimor, duke fshehur në këtë mënyrë deklaramet ndaj Shtetit.

Gjithashtu, në kundërshtim me nenin 13 të LPP, shoqëria Xh. Sh.p.k. nuk ka realizuar kontratën, sipas përqindjes të marrë përsipër, sipas kontratës së bashkëpunimit.

Lidhur me këtë pikë, AK duhet të procedojë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në kushtet e mësipërme, Drejtoria e Financës nuk duhej të kishte bërë pagesën ndaj kësaj shoqërie.

Gjithashtu, përgjegjësi ligjore mban edhe kolaudatori i objektit.

Sipas observacioneve të dërguara nr. 56/20 prot., datë 10.01.2019 për akt konstatimin, me objekt: *“Observacion mbi akt konstatimin nr. 20, datë 28.12.2018”*, është sqaruar se, AK nuk ka dërguar dokumentacion që të provojë dhe vërtetojë të kundërtën e konstatimit, si dhe arsyetimet e dhëna nuk qëndrojnë.

Arsyetimet dhe sqarimet e dhëna sipas observacionit të dërguar nr. 1 prot., datë 09.01.2019 se, të gjitha detyrimet tatimore janë paguar dhe deklaruar në organet tatimore nga shoqëria “Meni” sh.p.k. nuk qëndrojnë, si dhe nuk argumentojnë dhe dokumentojnë të kundërtën për sa është konstatuar.

Referuar observacioneve të dërguara nga AK nr. 417 prot., datë 21.02.2019, protokolluar në KLSH nr. 1189/9 prot., datë 25.02.2019 me objekt: “Kthim përgjigje projekt raportit”, konstatohet se nuk është dërguar observacion, për sa është trajtuar hollësishtëm në projekt raportin e dërguar.

Referuar observacionit të dërguar nga shoqëria M. sh.p.k. protokolluar në KLSH nr. 1189/8 prot., datë 21.02.2019, me objekt: “Observacion lidhur me projekt raportin e auditimit të KLSH në UKD sh.a.”, sqarojmë se:

Referuar pretendimeve tuaja për projekt raportin, si dhe nga shqyrtimi edhe i dokumentacionit bashkëlidhur kundërshtimeve të dërguara, në asnjë rast nga ana juaj si bashkim operatorësh ekonomikë nuk është rënë dakort që faturat tatimore do të lëshohen për AK vetëm nga një shoqëri (pavarësisht se ky pretendim i juaji nuk gjen mbështetje ligjore).

Sa më sipër, provohet dhe vërtetohet se bashkimi juaj i shoqërive është bërë në mënyrë të pasaktë, me qëllim kualifikimin në këtë procedurë prokurimi, pasi zërat që ju keni marrë përsipër sipas kontratës së bashkëpunimit, në kundërshtim të plotë me nenin 74 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nuk janë kryer nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi shoqërisht, por vetëm nga një operator ekonomik. Për rrjedhojë, deklarimi që shoqëria kryesuese ka bërë pranë organit tatimor nuk është e saktë dhe e



vërtetë, pasi përqindja që ka marrë përsipër të realizojë, për të cilën është shpallur edhe fituese, nuk është e njëjtë me atë të deklaruar pranë tatimeve. E njëjta gjë vlen për analogji edhe për anëtarin tjetër të këtij bashkimi shoqërisht, i cili përqindjen që ka marrë përsipër të realizojë sipas kontratës së bashkëpunimit, nuk e ka kryer, duke sjellë si pasojë një kontratë bashkëpunimi të lidhur jo në proporcionin e duhur.

Referuar faturës tuaj tatimore të prerë vetëm nga një shoqëri, sjell si pasjë deklarim në procedura të tjera prokurimi (ku për mallrat kërkohet vetëm faturë tatimore) të një vlerë nga kryesuesi i këtij bashkimi, çka përbën deklarim të rremë, në kushtet kur ju jeni krijuar si bashkim operatorësh ekonomikë sipas kontratës së bashkëpunimit nr. 93 rep, nr. 23 Kol, datë 12.01.2017, ku në prani të noterit keni rënë dakort që shoqëria M. sh.p.k. do të realizojë 40% të punimeve për çdo zë, kurse shoqëria Xh. 60% të punimeve për çdo zë.

Pra, në këto kushte, vërtetohet se bashkimi juaj i operatorëve ekonomikë nuk është krijuar realisht për të kryer secili pjesën për të cilën keni rënë dakort, duke paraqitur në këtë mënyrë në tender dokumentacion që përmban të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, si dhe duke fshehur pjesërisht detyrimet tatimore për anëtarin e këtij bashkimi, si dhe duke deklaruar më shumë pranë tatimeve nga kryesuesi i këtij bashkimi.

Arsyestimi i dhënë nga ana juaj se, pagat e punës (për anëtarin e BOE) janë kryer nga operatori ekonomik kryesues është një pretendim absurd, i cili nuk gjen mbështetje ligjore. Kjo për faktin se, secila shoqëri, paguan detyrimet tatimore sipas përqindjes që ka marrë përsipër, si dhe po më vete kryhen edhe pagesat për punonjësit. Pra, nuk mundet kurrsesi të pretendobni se pagat edhe për anëtarin e këtij bashkimi shoqërisht janë kryer nga përfaqësuesi.

Lidhur me nenin 59, 60 të LPP, ju bëjmë me dije se, janë dispozita ligjore, në të cilat përcaktohet se kushtet e kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga dokumentet e tenderit dhe nga oferta fituese. Në këto kushte, bashkimi juaj i shoqërive është shpallur fitues si BOE, ku keni dhënë edhe përqindjen përkatëse, çka nuk provon ndarjen e operatorëve ekonomikë.

Lidhur sa më sipër, AK ka detyrimin ligjor të procedojë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

13. Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Blerje pjesë këmbimi për automjete 2018”**, me të dhëna si më poshtë vijon:

Kontrata lidhur nr. 1418 prot., datë 20.06.2018, me numër reference 53859-03-06-2018.
Çmimi i kontratës së lidhur 12,632,500 lekë pa TVSH, 15,159,000 lekë me TVSH.
Afati i kontratës është 30 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.
Kontraktori “L.B. & R.-M. K.” Sh.p.k.
Objekti i kontratës: “Blerje pjesë këmbimi për automjete” .
Titullari i autorizuar i AK, Znj. F.K.
Grupi i punës: I.K., I. K., D. D..

Me shkresën nr. 1418 prot., datë 20.06.2018 është lidhur kontrata midis shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Sh.a. Durrës”, përfaqësuar nga Znj. F.K dhe operatorit ekonomik “L. B. & R.-M. K.” Sh.p.k. me vlerë 12,632,500 lekë pa TVSH.

Në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, kontrata e mësipërme është lidhur vetëm me një operator ekonomik dhe pa TVSH, ndërkohë që fitues në procedurën e mësipërme të prokurimit është bashkimi i mësipërm i operatorëve ekonomikë, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi titullari i autorizuar i AK.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga AK, konstatohet se:



Bashkimi i mësipërm i operatorëve ekonomikë është kualifikuar në këtë procedurë prokurimi, duke paraqitur në tender kontratën e bashkëpunimit nr. 885 rep., nr. 616 kol, datë 24.03.2018. Sipas kësaj kontrate bashkëpunimi të vënë në dispozicion nga sektori i prokurimeve, palët kanë rënë dakort që, shoqëria “L. B.” Sh.p.k. do të kryejë 80% të vlerës së kontratës, kurse shoqëria “R.-M.-K.” do të kryejë 20% të vlerës së kontratës.

Gjithashtu, sipas prokurës së posaçme të paraqitur në tender, shoqëria “L. B.” Sh.p.k. është autorizuar si përfaqësues, duke patur të drejtën e nënshkrimit të dokumentacionit ligjor në funksion të zbatimit të marrëveshjes për bashkimin e operatorëve ekonomikë.

Referuar dokumentacionit të administruar dhe të vënë në dispozicion nga AK, konstatohet se, pranë AK është prerë fatura tatimore e shitjes nr. 42, datë 20.07.2018, me vlerë totale 15,159,0000 lekë me TVSH.

Referuar sa më sipër dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, krijimi i bashkimit të mësipërm të OE nuk është i saktë.

Sa më sipër, kjo shoqëri është paguar për zëra të parealizuar prej saj, pasi në total, referuar faturës tatimore të prerë, shoqëria “L. B.” sh.p.k. ka marrë përsipër:

$15,159,000 \times 80\% = 12,127,200$ lekë

Pra, shoqëria “M.” Sh.p.k. është paguar për një vlerë prej $15,159,000 - 12,127,200 = 3,031,800$ lekë.

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi kontraktori, si dhe grupi i punës I. K., I.K., D.D..

Veprimet e mësipërme, bien në kundërshtim me nenet 59, 60 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Sqaruar sa më sipër, shoqëria L.B. Sh.p.k. ka prerë të gjithë faturën tatimore ndaj AK, në vlerën totale të kontratës, duke bërë në këtë mënyrë një deklaram të pasaktë, si dhe nuk administrohet dokumentacion mbi përqindjen e marrë përsipër nga shoqëria tjetër, anëtare e këtij bashkimi shoqërisht.

Lidhur me këtë pikë, AK duhet të vepronte konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në kushtet e mësipërme, Drejtoria e Financës nuk duhej të kishte bërë pagesën ndaj kësaj shoqërie.

Sipas observacioneve të dërguara nr. 56/21 prot., datë 10.01.2019 për akt konstatimin, me objekt: “Observacion mbi akt konstatimin nr. 21, datë 28.12.2018”, është sqaruar se: *“Tek formulari i kontratës, tek kushtet e veçanta dhe të përgjithshme, në të gjitha rastet është cituar qartë se, UKD ka lidhur kontratë me bashkimin e operatorëve ekonomikë. Referuar prokurës së posaçme të marrëveshjes së bashkëpunimit, palët kanë rënë dakort që bashkimi i operatorëve ekonomikëka si përfaqësues shoqërinë L. B. sh.p.k. duke patur të drejtën e nënshkrimit të dokumentacionit të nevojshëm deri në dorëzimin e punimeve.*

Referuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, AK miraton rregjistrin e prokurimit me fonde limite të parashikuar në vlera pa TVSH. Në të gjitha rastet në kontratat e nënshkruara nga UKD me operatorët ekonomikë pjesëmarrës, vlerat e kontratave janë të përcaktuara me dhe pa TVSH.

Theksojmë faktin se, në të gjitha procedurat e prokurimit, sigurimi i kontratës në të gjitha rastet ka qenë me TVSH.

Grupi i punës i ngritur ka verifikuar me rigorozitet mallrat, duke u bazuar në specifikimet teknike të përcaktuara nga specialistët përkatës, mbajtjen e procesverbalit të detajuar, si dhe vënien në dijeni të Drejtorisë së Përgjithshme.



Nga ana e grupit të punës janë ndjekur të gjitha procedurat për ndjekjen e kontratës, sipas nënshkrimit të operatorit, deri në marrjen në dorëzim të punimeve.

Gjithashtu, referuar nenit 56 të VKM së mësipërme, titullari i AK ose zyrtari i autorizuar prej tij, mban përgjegjësi vetëm për ngritjen e grupit të punës, pasi përgjegjësinë ligjore për çdo veprim apo mosveprim e mbajnë personat e autorizuar prej tij”.

Sipas observacionit të dërguar nr. 01 prot., datë 04.01.2019 për akt konstatimin nga shoqëria R. M. kompani sh.p.k. është sqaruar se, lider në këtë procedurë prokurimi ka qenë shoqëria L. B. sh.p.k. sipas kontratës dhe prokurës së posaçme të paraqitur në tender. Në asnjë pikë të këtyre dokumenteve nuk është e përcaktuar se shoqëria jonë do të ketë kontakte me AK, apo do të dorëzojë mallin pranë AK, shoqëruar me faturë tatimore. Lider ka qenë shoqëria tjetër, e cila e ka dorëzuar mallin pranë UKD dhe ka prerë edhe faturën...

14. Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Blerje pjesë këmbimi për automjete, 2017”**, me të dhëna si më poshtë vijon:

Kontrata lidhur nr. 727 prot., datë 31.03.2017, me numër reference 40/4-20-01-2017.
Çmimi i kontratës së lidhur 13,898,720 lekë pa TVSH, 16,678,464 lekë me TVSH.
Afati i kontratës është 5 javë nga data e nënshkrimit të kontratës.
Kontraktori “S. & C. C.” Sh.p.k.
Objekti i kontratës: “Blerje pjesë këmbimi për automjete, 2017” .
Titullari i autorizuar i AK, Z. A. I.
Grupi i punës: I.K., I.K., S. R..

Me shkresën nr. 727 prot., datë 31.03.2017 është lidhur kontrata midis shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Sh.a. Durrës”, përfaqësuar nga Z. A. I. dhe operatorit ekonomik “S.&C. C.” Sh.p.k. me vlerë 13,898,720 lekë pa TVSH.

Në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, kontrata e mësipërme është lidhur për vlerën pa TVSH, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi titullari i autorizuar i AK.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga AK, për zërat me përzgjedhje, konstatohet se:

1. Lidhur me zërin graso e zezë, në specifikimet teknike kërkohet:

GRASO ZEZE

Karakteristikat	Metoda e testimit	Njesia	Vlerat
Konsistenca	-	-	
Tipiisapunit	-	-	
Temperaturaepikëzimit	ASTMD-2265	°C	185
Penetracioninë25°C	ASTMD-217	Mm	
Temperaturaoperimit	-	°C	-25deri+130

Referuar dokumentacionit të administruar rezulton se, nuk ka asnjë dokumentacion që të provojë dhe vërtetojë lidhur me plotësimin e specifikimeve teknike.

Në këto kushte, vlera prej 102,000 lekë, përbën një shpenzim të paligjshëm, për një mall i cili nuk është sipas specifikimeve teknike.

**2. Lidhur me zërin graso FSK e kuqe, në specifikimet teknike, kërkohet:****GRASO SKF**

Karakteristikat	Metoda e testimit	Njesia	Vlerat
Konsistenca	-	-	NLGI2
Tipiisapunit	-	-	Lithium
Temperaturaepikëzimit	ASTMD-2265	°C	198
Penetracioninë25°C	ASTMD-217	Mm	
Temperaturaepërimit	-	°C	-25deri+120

Referuar dokumentacionit të administruar rezulton se nuk ka asnjë dokumentacion që të provojë dhe vërtetojë lidhur me plotësimin e specifikimeve teknike.

Në këto kushte, vlera prej 360,000 lekë, përbën një shpenzim të paligjshëm, për një mall i cili nuk është sipas specifikimeve teknike.

3. Lidhur me zërin vaj motorii SAE 15-40, në specifikimet teknike kërkohet:**VAJ MOTORI 15-40**

Karakteristikat	Metoda e testimit	Njesia	Vlerat
Densitetinë15°C	ASTMD-1298	Kg/l	0,887
Viskozitetikinematiknë40°C	ASTMD-445	CSt	107,9
Viskozitetikinematiknë100°C	ASTMD-445	CSt	15,6
Indeksiviskozitetit	ASTMD-2270	-	129
Temperaturaeflakërimit	ASTMD-92	°C	218
Temperaturangriritjes	ASTMD-97	°C	-25
Përmbajtjahirit	ASTMD-874	%	0,9

Referuar dokumentacionit të administruar rezulton se nuk ka asnjë dokumentacion që të provojë dhe vërtetojë lidhur me plotësimin e specifikimeve teknike.

Në këto kushte, vlera prej 2,040,000 lekë, përbën një shpenzim të paligjshëm, për një mall i cili nuk është sipas specifikimeve teknike.

Sa më sipër, vlera totale, referuar zërave të verifikuar prej 2,502,000 lekë përbën një shpenzim të paligjshëm, për një mall i cili nuk provon dhe dokumenton se plotëson specifikimet teknike, si dhe nuk provohet se është konform dokumentacionit, për të cilat kjo shoqëri është kualifikuar dhe shpallur fituese.

Sa më sipër, mbajnë përgjegjësi të gjithë anëtarët e grupit të cilët kanë marrë mallin në dorëzim, si dhe kontraktori.

Neni 56 i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: **“Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrat të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të**



sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit”.

Veprimet e mësipërme, bien në kundërshtim me nenet 59, 60 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Referuar observacionit të dërguar nr. 56/22 prot., datë 10.01.2019 për akt konstatimin me objekt: “*Observacion mbi akt konstatimin nr. 22, datë 28.12.2018*”, është sqaruar se, dokumentacioni shoqëruar që keni dërguar, nuk provon të kundërtën për sa është konstatuar. Pra, malli i marrë në dorëzim është një mall i cili nuk plotëson të gjitha specifikimet teknike, pjesë e dokumenteve të tenderit dhe kontratës së nënshkruar midis palëve.

Pika 7. Mbi auditimin me zgjedhje të pagesave të kryera me anë të arkës dhe bankës, shpenzimeve administrative dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve me vlerë të vogël.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua:

Ujësllës Kanalizime Durrës ka llogari në 12 banka të nivelit të dytë, saktësisht: Credins, Raiffeisen, BKT, Banka Amerikane, Tirana Bank, FBI, Procredit, Intesa San Paolo, Alfa, Union, Societe General dhe NBG.

Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës u konstatuan problematikat e mëposhtme:

1. Për periudhën objekt auditimi Ujësllës Kanalizime Durrës ka përfituar shërbim ndaj Albtelekom për përdorimin e telefonave fiks. Për këtë shërbim UKD ka paguar vlerën totale 305,205.19 lekë. Nga auditimi u konstatua se për këtë shërbim nuk është zhvilluar asnjë procedurë prokurimi, për më tepër nuk ka asnjë kontratë të lidhur ndërmjet palëve. Pagesa për këto shërbime kryhet vetëm me dorëzimin e faturave mujore nga operatori ekonomik Albtelekom. Vlera 305,205.19 përbën një vlerë të pajustificuar. Marrja e shërbimit të telefonisë fikse nga Albtelekom pa kryer procedurë prokurimi është në kundërshtim me Nenin 4 “Fusha e zbatimit” të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Për këtë mbajnë përgjegjësi personat që kanë autorizuar pagesën, si dhe personat përgjegjës të sektorit të financës të ngarkuar me këtë praktikë.

2. Për periudhën objekt auditimi Ujësllës Kanalizime Durrës ka përfituar shërbim ndaj T. (A.) për përdorimin e numrit celular të titullarit të UKD. Për këtë shërbim UKD ka paguar vlerën totale 4,924,799.28 lekë. Nga auditimi u konstatua se për këtë shërbim nuk është zhvilluar asnjë procedurë prokurimi, për më tepër nuk ka asnjë kontratë të lidhur ndërmjet palëve. Pagesa për këto shërbime kryhet vetëm me dorëzimin e faturave mujore nga operatori ekonomik Telekom. Vlera 4,924,799.28 përbën përdorim pa ekonomikitet, efikasitet dhe eficiencë të fondeve nga UKD. Marrja e shërbimit të telefonisë celulare nga Telekom pa kryer procedurë prokurimi është në kundërshtim me Nenin 4 “Fusha e zbatimit” të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Për këtë mbajnë përgjegjësi personat që kanë autorizuar pagesën, si dhe personat përgjegjës të sektorit të financës të ngarkuar me këtë praktikë.

3. Kontrata e qerasë e lidhur ndërmjet UKD dhe qeradhënësit S. K. nuk ka afate. Në të gjithë kontratën e firmosur nga palët afati i saj është lënë i paplotësuar, duke humbur kështu vlerën për tu cilësuar si “Kontratë”, e për pasojë nuk mund të kryhen veprime bazuar në këtë kontratë.

4. Në datën 18.07.2018 në bankën Credins është kryer pagesa prej 10,000 lekë në favor të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, si gjobë për paraqitjen me vonesë të pasqyrave financiare.



Vlera **10,000 lekë përbën dëm ekonomik** për UKD. Për shkaktimin e kësaj vonese me pasojë dëm ekonomik, nga ana e titullarit nuk rezulton të jetë evidentuar asnjë person përgjegjës.

5. Nga auditimi u konstatua se shlyerjet e detyrimeve ndaj operatorëve ekonomik nuk kryhen sipas parimit FIFO (first in first out), duke krijuar seleksionim preferencial. Në disa raste shlyerjet bëhen brenda ditës, dhe në disa raste të tjera shlyerjet arrijnë edhe 4 vite më vonë. Një situatë e tillë në kushtet kur operatorët nuk trajtohen në mënyrë të barabartë, sjell jo vetëm diskriminim ndaj këtyre operatorëve, por njëkohësisht mbart risk ekonomik. Në kushtet e pagesës të kontratave e lidhura nga ana e UKD është e shprehur qartë se: *“Pagesa për mallrat do të bëhet brenda 12 muajve duke filluar nga data e lidhjes së kontratës”*. Gjithashtu në kontratë është shprehur në mënyrë eksplicite se: *“Dëmet e llogaritura, të shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë, konsistojnë në kamatën që fillon nga data e vonesës së debitorit (Autoritetit Kontraktues), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamatës parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti, interesi i maturuar i shtohet shumës totale, mbi të cilën është llogaritur interesi i maturuar. Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (kontraktuesin) të provojë ndonjë dëm. Në se kreditori (kontraktuesi) provon se ka pësuar një dëm më të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktues) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit”*. Pra, me këto veprime, nga ana e UKD është provokuar një risk i lartë me pasojë dëm ekonomik për shoqërinë, i cili referuar kontratës nuk ka një limit maksimal pasi lejon edhe dëme të tjera të paparashikuara nga kamata ligjore.

Për këtë mbajnë përgjegjësi të gjithë punonjësit e sektorit të financës që janë pjesë e praktikave të kryerjes së pagesave, si dhe personat autorizues të pagesave.

6. Në datën 06.02.2017 në Bankën Kombëtare Tregtare është kryer pagesa prej 18,900 lekë në favor të “A. M. G.”, për shërbimin rregullimit të mjetit tip Ford me targa AA439LP, faturuar me nr. 494 datë 06.02.2017. Në relacionin me nr. 298 prot, datë 06.02.2017 bashkëlidhur pagesës me objekt “Procesverbal konstatimi” të mbajtur nga grupi i punës i përbërë nga I. K., I. K., R. Ç. dhe E. Sh., ndër të tjera është shkruar: *“..Ky defekt nuk ka ardhur si shkak i përplasjes, keqpërdorimit apo mbingarkesës së mjetit dhe meqënëse mjete është brenda kushteve të garancisë, kërkojmë të merren masa për riparimin e mjetit pa pagesë pranë shitësit të autorizuar “A. M. C.”. Kjo shkresë i është dërguar Drejtorit Teknik A. Zh., Drejtorit Tregtar D. Gj. dhe është vënë në dijeni Drejtori i Përgjithshëm i UKD. Por referuar dokumentacionit të bankës, rezulton se ky shërbim është paguar, edhe pse mjete (referuar relacionit) është brendë periudhës së garancisë. Për pasojë, **vlera 18,900 lekë** e paguar për rregullimin e mjetit është përfituar në mënyrë të padrejtë nga “A. M. G.” dhe **përbën dëm ekonomik**.*

7. Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi, UKD edhe pse në stafin e vet ka punonjës saldatorë, ka kryer prokurime për shërbimin e saldimit në 2 raste, saktësisht:

Data e pagesës	Banka	Nr. i faturës	Vlera (me TVSH)	Objekti	Operatori ekonomik
28.02.2017	Credins	1	51,600	Saldim skatulle, brokulle, suporti	E. L.
03.09.2017	BKT	242	216,000	Riparim, Saldim tubi çeliku 711	A. M.

Për pasojë nga grupi i auditimit, vlera totale prej 267,600 lekë e përdorur për shërbim saldimi konsiderohet efekt financiar negativ për UKD pasi ka staf të vetin që e mbulon këtë shërbim.

8. Në datën 12.03.2018 është kryer pagesa prej 498,928 lekë në favor të Drejtorisë Rajonale të Transportit Rrugor për likuidim të taksës vjetore të qarkullimit për mjetet e UKD. Pjesë e pagesës është edhe vlera 23,000 lekë si gjobë (23 automjete X 1000 lekë). Për këto gjoba nuk



janë caktuar përgjegjësi dhe janë paguar nga të ardhurat e UKD. Vlera **23,000 lekë** përbën **dëmekonomik** për UKD. Për marrjen e këtyre gjobave me pasojë dëm ekonomik, nga ana e titullarit nuk rezulton të jetë evidentuar asnjë person përgjegjës.

9. Nga auditimi i pagesave ndaj operatorëve ekonomik u konstatua se nga ana e Ujësjellës kanalizime Durrës nuk janë mbajtur penalitete për dorëzime me vonesë të mallrave apo shërbimeve. Në mënyrë të detajuar trajtohen më poshtë:

a) Operatori ekonomik “M. K. shpk”, nëpërmjet kërkesës drejtuar UKD në datën 30.01.2017, ka kërkuar likuidimin e vlerës 5% të kontratës, përkatësisht vlerën 2,322,000 lekë, pasi pretendohet se kontrata është përmbushur. Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se:

Kontrata është lidhur ndërmjet OE “M. K. shpk” dhe UKD me nr. 840 prot, datë 30.04.2015 me objekt “Blerje pjesë këmbimi dhe vegla pune”. Afati i realizimit të kontratës është 60 ditë. Vlera e kontratës është 38,700,000 lekë pa TVSH, ose 46,440,000 lekë me TVSH. Operatori ekonomik e ka dorëzuar mallin e prokuruar me dy pjesë. Pjesa e parë me vlerë totale prej 15,873,309 lekë është dorëzuar në datën 30.05.2015, ndërsa pjesa e dytë me vlerë 30,566,690 lekë është dorëzuar në datën 30.06.2015. Pjesa e dytë rezulton të jetë dorëzuar 61 ditë pas lidhjes së kontratës, pra 1 ditë me vonesë. Grupi i punës i përbërë nga G.D, I. K. dhe B. M., me shkresën me nr.1365/3 prot, datë 02.07.2015, i ka relatuar Drejtorit të Përgjithshëm dhe Shefit të Departamentit Juridik A. I. për përfundimin e kontratës në datën 30.06.2015 dhe se materialet janë në përputhje me atë që është kërkuar. Por, nga ky dokument konstatohet se nga grupi është dakortësuar me faktin se nga OE është zbatuar afati i kontratës, saktësisht shprehet: *“Kjo kontratë është lidhur me datë 30.04.2015 dhe ka përfunduar me datë 30.06.2015 pra 2 muaj nga data e nënshkrimit ashtu siç është kërkuar në DST”*. Por, këto dy muaj në ditë kalendarike korrespondojnë me 61 të tilla, e për pasojë 1 ditë me vonesë. Për këtë, nga UKD duhet të mbahej vlera **126,267 lekë (0.004 * 30,566,690 lekë)**, si penalitet për vonesë në zbatimin e kontratës. Kjo vlerë përbën dëm ekonomik për Ujësjellës Kanalizime Durrës, dhe duhet të dëmshpërblehet nga OE “M. K. shpk”. Për mosmbajtjen e penalitetit ndaj OE “M. K. shpk” mban përgjegjësi grupi i punës i përbërë nga G.D, I. K. dhe B. M..

b) Në datën 31.03.2017 është bërë likuidimi për operatorin ekonomik “F.” shpk i vlerës 8,090,924 lekë. Kjo vlerë përbën garancinë prej 5% të punimeve për kontratën me nr. 535 prot, datë 21.03.2012 me objekt “Përmirësimi i furnizimit me ujë lagja 13, zona Shkozet – Plepa” me vlerë 105,471,944 pa TVSH ose 126,566,332 lekë me TVSH. Për këtë kontratë është bërë shtesë kontrate me nr. 1383 prot, datë 21.06.2012 me vlerë 21,093,270 lekë pa TVSH ose 25,311,924 me TVSH. Në procesverbalin të mbajtur në datën 30.07.2012 nga Sipërmarrësi shoqëria “F.” shpk, mbikëqyrësi i punimeve E.Z. grupi kolaudator M. B. dhe D. K., ndër të tjera është cituar në mënyrë eksplicite se: *“... Kolaudimi ka zgjatur 10 ditë...”, “...Koha e ndërtimit të objektit ka qënë 120 ditë dhe ky afat nuk ka ndryshuar dhe ka përfunduar më datë 20.07.2012. Punimet dorëzohen në datë 20.07.2012...”, “...vlera e shpenzimeve sipas situacionit përfundimtar pas kolaudimit është 126,564,313 lekë...”*.

Situacioni përfundimtar me vlerë 126,564,313 lekë është me datë 20.07.2012 dhe është nënshkruar nga sipërmarrësi shoqëria “F.” shpk, mbikëqyrësi i punimeve E. Z. dhe Drejtori Teknik i UKD F. S.. Situacioni përfundimtar i punimeve të kontratës shtesë është me vlerë 25,311,684 lekë. Pra vlera totale e këtij investimi është 151,875,997 lekë me TVSH. Nga sa më sipër, konstatohet se punimet janë dorëzuar 121 ditë pas lidhjes së kontratës, pra 1 ditë me vonesë. Për këtë vonesë, nga ana e UKD nuk janë mbajtur penalitet kundrejt operatorit ekonomik. Ndërkohë shlyerja e detyrimit rezulton të jetë bere disa vite me vone nga UKD SHA, çka mund të rezikojë kerkimin e demshperblimit per shlyerje me vonese.



c) Në datën 13 prill 2017 në bankën Raiffeisen, është paguar vlera 494,219 lekë në favor të operatorit ekonomik “L. VII” sha, si likuidim garancie 5% në përfundim të afatit të garancisë për kontratën me objekt “Rehabilitim i rrjetit të ujësjellësit L18” me nr. 9285 prot, datë 30.12.2015. Vlera e kontratës 8,236, 972 lekë pa TVSH. Afati i zbatimit: 20 ditë kalendarike nga nënshkrimi i kontratës. Punimet për këtë kontratë kanë përfunduar në datën 29.02.2016, dhe janë dorëzuar me dy pjesë me situacionet respektive.

Pjesa e parë është dorëzuar në datën 29.01.2016 me vlerë punimesh 5,519,850 lekë me TVSH, pra 10 ditë më vonë nga afati maksimal për mbarimin e punimeve.

Situacioni i dytë dhe njëkohësisht përfundimtar është në datën 29.02.2016 me vlerë 4,364,516 lekë, pra 41 ditë më vonë nga afati maksimal për mbarimin e punimeve.

Vlera e penalitetit për dorëzimet e vonuara përlogaritet si më poshtë:

Situacioni i parë: $5,519,850 \text{ lekë} \times 0.004 \times 10 \text{ ditë} = 220,794 \text{ lekë}$.

Situacioni përfundimtar: $4,364,516 \text{ lekë} \times 0.004 \times 41 \text{ ditë} = 715,781 \text{ lekë}$.

Në total **vlera 936,575 lekë përbën dëm ekonomik** për UKD, si penalitet i pambajtur për moszbatimin e afateve të kontratës, dhe duhet të dëmshpërblehet nga operatori ekonomik “L. VII” sha.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi grupi i marrjes në dorëzim i përbërë nga G.D, B. M., E. E., L.F dhe mbikqyrësi i punimeve.

d) Për kontratën me nr. 1467 prot, datë 24.06.2016 me objekt “Blerje materiale Hidraulike” është lidhur një shtesë kontratë me nr. 3167 prot, datë 29.12.2016 me vlerë 15,056,100 lekë pa TVSH ose 18,067,320 lekë. Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se dorëzimi i mallrave për këtë shtesë kontrate është kryer jashtë afatit të përcaktuar. Afati për zbatimin e kontratës është 5 javë, e cila përkon me datën 2 shkurt 2017. Ndërkohë në datën 06.02.2017 është dorëzuar sasia përfundimtare e mallrave me vlerë 11,644,320 lekë me TVSH, pra 4 ditë me vonesë. Për këtë vonesë nga ana e UKD nuk është mbajtur penalitet. Vlera e penalitetit e përlogaritur për këtë vonesë është 186,309 lekë ($11,644,320 \text{ lekë} \times 0.004 \times 4 \text{ ditë}$). Vlera **186,309 lekë përbën dëm ekonomik** për UKD dhe duhet të dëmshpërblehet nga bashkimi i operatorëve ekonomik “F.-G.” & “A.-R.” shpk. Për këtë mbajnë përgjegjësi grupi i marrjes në dorëzim i përbërë nga L.F, I. K. dhe S.R..

Gjatë observacioneve të aktkonstatimit, është paraqitur fatura e arkëtimit të kësaj shume nga OE në favor të UKD. Për pasojë gjetja konsiderohet e ezauruar.

e) Në datën 12.06.2017 në BKT është kryer likuidimi pjesor i faturës nr. 75, datë 03.05.2017 të operatorit ekonomik “I.” shpk për kontratën nr. 386 prot, datë 21.02.2017 me objekt “Fond për studim projektme të investimeve”. Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se nga ana e operatorit ekonomik është vonuar zbatimi i kontratës. Afati i zbatimit të kontratës është 60 ditë, pra zbatimi duhet të përfundonte në datën 23.04.2017. Ndërkohë ka përfunduar në datën 03.05.2017, pra 10 ditë me vonesë. Për këtë vonesë nga ana e UKD nuk rezulton të jetë mbajtur penalitet, i cili konsiston në vlerën 189,861 lekë ($4,746,535.2 \text{ lekë} \times 0.004 \times 10 \text{ ditë}$). **Vlera 189,861 lekë përbën dëm ekonomik** për UKD dhe duhet të dëmshpërblehet nga operatori ekonomik “Invictus” shpk. Për këtë mbajnë përgjegjësi grupi i marrjes në dorëzim i përbërë nga A. Zh., L.F dhe D. Sh..

f) Ndërmjet UKD dhe operatorit ekonomik “A. shpk” është lidhur kontrata me nr. 2925 prot, datë 30.10.2017 me objekt “Pastrim pusesh”. Vlera e kontratës 5,880,000 lekë pa TVSH, ose 7,056,000 lekë me TVSH. Afati për zbatimin e kontratës është 15 ditë nga data e lidhjes së kontratës. Nga grupi i punës është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim me nr. 2820/2 prot, datë 05.12.2017 duke cituar se punimet kanë përfunduar në datën 15.11.2017. Nga auditimi



u konstatua se si procesverbali i grupit të punës ashtu edhe fatura tatimore nr. 53 e lëshuar nga operatori ekonomik kanë datën 05.12.2017. Për pasojë grupi i auditimit e vlerëson përfundimin e kontratës në datën 05.12.2017. Pra operatori e ka përmbushur kontratën me 21 ditë vonesë. Për këtë vonesë nuk rezulton të jetë mbajtur penalitet. Penaliteti i përlogaritur nga grupi i auditimit është 592,704 lekë ($21 \times 0.004 \times 7,056,000$ lekë). Vlera **592,704 lekë përbën dëm ekonomik** për UKD dhe duhet të dëmshpërblehet nga “A. shpk”. Për këtë mbajnë përgjegjësi grupi i punës të marrjes në dorëzim i përbërë nga L.F, B. M. dhe G.D.

Blerjet e vogla

Me urdhrin e brendshëm nr. 421/1 prot, datë 14.02.2017 është ngritur komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: A.B., J. V., D. B. dhe D. H..

Komisioni ka ndryshuar me urdhrin e brendshëm nr. 2249/2 prot, datë 23.08.2017, me përbërje: F.K, A.B. dhe D.B..

Me urdhër të brendshëm nr. 350, datë 19.01.2018 është ngritur Komisioni për prokurimin me vlerë të vogël për vitin 2018 me përbërje A. B., D. B. dhe D. Sh..

Regjistri i parashikimeve për vitin 2017 është dërguar në APP me shkresën nr. 57 prot, datë 13.01.2017. Në këtë parashikim konstatohet se blerjet e vogla dhe emergjencat janë parashikuar në një zë të vetëm me vlerë prej 27,000,000 lekë e cila është e padetajuar.

Ndërsa për vitin 2018 kjo vlerë parashikohet të jetë 20,000,000 lekë.

Nga auditimi i blerjeve me vlera të vogla për periudhën objekt auditimi u konstatuan mangësitë e mëposhtme:

1. Nisur nga realizimi i procedurave me vlerë të vogël u konstatua se për vitin 2017 janë kryer në total blerje të mallrave dhe pajisjeve hidraulike mbi vlerën 800,000 lekë pa TVSH, duke copëzuar fondin, veprim në kundërshtim me Nenin 28, pika 2 të ligjit 9643 datë 20.11.2016, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku citohet: “*Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj*”. Për këtë mbajnë përgjegjësi Komisioni i Prokurimit të Blerjeve të vogla për periudhën objekt auditimi, A. B., J. V., D. B., D. H., D. Sh. dhe F.K.

2. Nga auditimi i dokumentacionit bashkëlidhur janë konstatuar disa mangësi të përgjithshme në lidhje me vendosjen e datave si:

- Deklaratat e lëshuara nga punonjësi i magazinës në lidhje me gjendjen e magazinës për mallin e kërkuar janë pa datë, çka nuk vërteton plotësisht mungesën e këtyre mallrave në kohën kur kërkohen.

- Ofertat ekonomike të marra nga operatorë ekonomikë për përlogaritjen e fondit limit janë pa datë, duke krijuar një rezervë mbi saktësinë e vlerave për datën në të cilën kërkohet ajo. Gjithashtu mungesa e datës rrit riskun e përdorimit të këtij dokumenti në procedura të tjera.

- Kërkesa për materiale e cila kryhet nga punonjësit në rast të lindjes së nevojës është pa datë, duke krijuar të njëjtin risk të trajtuar më sipër.

Veprimet e mësipëme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzim nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

3. Në datën 12.10.2017 është kryer pagesa prej 66,000 lekë në BKT në favor të operatorit ekonomik “S. & T. A.” shpk, si likuidim i faturës nr. 201 datë 15.05.2017 me përshkrim “Shërbim riparimi MC4597 SN:14223521640195 Ekran me probleme”. Urdhëri i prokurimit nr. 1293/1, datë 15.05.2017. Për këtë procedurë janë marrë 3 oferta ekonomike me përshkrim



“Ekran PDA riparim”. Komisioni i përbërë nga J.V., D. B. dhe A. B.. ka mbajtur procesverbalin e prokurimeve me vlerë nën 100,000 lekë, duke shpallur fitues operatorin ekonomik “S. & T. A.” shpk. Procesverbali i mbajtur nga përgjegjësi i sektorit IT S.K. dhe specialisti M. U. ka përshkrim “Rezulton se PDA Motorola MC4597 me nr serial 14223521640195 ka ekranin me problem” nuk përmban datë dhe as çfarë problemi specifik ka ekranin, për pasojë marrja e ofertave nga ana e grupit të auditimit konsiderohet e paargumentuar, pasi nuk ka asnjë specifikim defekti për të cilin operatorët kanë ofruar. Në datën 15.05.2017 nga ana e operatorit ekonomik “S. & T. A.” shpk është dorëzuar produkti i rregulluar, por nuk ka asnjë marrës në dorëzim nga ana e UKD. Me anë të një procesverbali pa datë nga përgjegjësi i sektorit IT S. K. dhe specialisti M. U. thuhet se ekranin është funksional.

Për sa më sipër grupi i auditimit e konsideron **vlerën 66,000 lekë dëm ekonomik** për UKD, pasi:
-Nuk ka specifikime për defektin e shfaqur nga ekranin, për pasojë ofertat e marra konsiderohen të paargumentuara.

-Procesverbalet e konstatimit të defektit dhe të konstatimit të rifunksionimit të pajisjes janë pa datë dhe pa numër protokoll, për pasojë nuk merren në konsideratë.

-Nga ana e KVO për blerjet e vogla, nuk është bërë asnjë analizë në lidhje me vlerën e lartë të ofertave të marra, duke konsideruar vlerën e blerjes së pajisjes së re.

-Nuk ka asnjë relacion të riparimit të defektit, por është mjaftuar me një procesverbal pa numër protokoll dhe pa datë ku është shprehur se pajisja funksionon.

Për këtë mbajnë përgjegjësi përgjegjësi i sektorit IT S. K., specialisti i sektorit IT M. U., si dhe KVO për blerjet e vogla i përbërë nga J. V., D. B. dhe A. B..

Në datën 12.10.2017 është kryer pagesa prej 75,000 lekë në BKT në favor të operatorit ekonomik “S. & T. A.” shpk, si likuidim i faturës nr. 456 datë 04.11.2016 me përshkrim “Shërbim riparimi MC4597 SN:14223521640123 problem ekranin + tastierë”. Urdhëri i prokurimit nr. 3007/1, datë 04.11.2016. Për këtë procedurë janë marrë 3 oferta ekonomike me përshkrim “Riparim ekran PDA + tastierë”. Komisioni i përbërë nga J. V., D. B. dhe T. S. ka mbajtur procesverbalin e prokurimeve me vlerë nën 100,000 lekë, duke shpallur fitues operatorin ekonomik “S. & T. A.” shpk. Procesverbali i mbajtur në datën 04.11.2016 nga përgjegjësi i sektorit IT S. K. dhe specialistët M. U. e ka përshkrim “Rezulton se PDA Motorola MC4597 me nr serial 14223521640195 ka me problem ekranin dhe tastierën”, për pasojë marrja e ofertave nga ana e grupit të auditimit konsiderohet e paargumentuar, pasi nuk ka asnjë specifikim defekti për të cilin operatorët kanë ofruar. Nuk ka dorëzim nga ana e operatorit ekonomik. Me anë të procesverbalit me datë 04.11.2016 nga përgjegjësi i sektorit IT S. K. dhe specialisti M. U. thuhet se pajisja është funksionale.

Për sa më sipër grupi i auditimit e konsideron **vlerën 75,000 lekë dëm ekonomik** për UKD, pasi:
-Nuk ka specifikime për defektin e shfaqur nga ekranin, për pasojë ofertat e marra konsiderohen e paargumentuar.

-Procesverbalet e konstatimit të defektit dhe të konstatimit të rifunksionimit të pajisjes janë pa numër protokoll, për pasojë nuk merren në konsideratë.

-Nga ana e KVO për blerjet e vogla, nuk është bërë asnjë analizë në lidhje me vlerën e lartë të ofertave të marra, duke konsideruar vlerën e blerjes së pajisjes së re.

-Nuk ka asnjë relacion të riparimit të defektit, por është mjaftuar me një procesverbal pa numër protokoll ku është shprehur se pajisja funksionon.

Për këtë mbajnë përgjegjësi përgjegjësi i sektorit IT S. K., specialisti i sektorit IT M. U., si dhe KVO për blerjet e vogla i përbërë nga J. V., D. B. dhe T. S..



Në datën 12.10.2017 është kryer pagesa prej 70,800 lekë në BKT në favor të operatorit ekonomik “S. & T. A.” shpk, si likuidim i faturës nr. 71 datë 10.02.2017 me përshkrim “Shërbim riparimi MC4597 SN:14223521640123 ekrani + nuk booton”. Urdhëri i prokurimit nr. 394/1, datë 10.02.2017. Për këtë procedurë janë marrë 3 oferta ekonomike me përshkrim “Riparim ekran PDA + boot”. Komisioni i përbërë nga J. V., D. B. dhe T. S..u ka mbajtur procesverbalin e prokurimeve me vlerë nën 100,000 lekë, duke shpallur fitues operatorin ekonomik “S. & T. A.” shpk. Procesverbali pa datë dhe numër protokollit, i mbajtur nga përgjegjësi i sektorit IT S. K. dhe specialistët M. U. e ka përshkrim “Rezulton se PDA Motorola MC4597 me nr serial 14223521640163 ka me problem ekranin dhe sistemin e bootimit”, për pasojë marrja e ofertave nga ana e grupit të auditimit konsiderohet e paargumentuar, pasi nuk ka asnjë specifikim defekti për të cilin operatorët kanë ofruar. Nuk ka dorëzim nga ana e operatorit ekonomik. Me anë të një procesverbali pa datë dhe numër protokollit nga përgjegjësi i sektorit IT S. K. dhe specialisti M. U. thuhet se pajisja është funksionale.

Për sa më sipër grupi i auditimit e konsideron **vlerën 70,800 lekë dëm ekonomik** për UKD, pasi:
-Nuk ka specifikime për defektin e shfaqur nga ekrani, për pasojë ofertat e marra konsiderohen të paargumentuara.

-Procesverbalet e konstatimit të defektit dhe të konstatimit të rifunksionimit të pajisjes janë pa numër protokollit dhe pa datë, për pasojë nuk merren në konsideratë.

-Nga ana e KVO për blerjet e vogla, nuk është bërë asnjë analizë në lidhje me vlerën e lartë të ofertave të marra, duke konsideruar vlerën e blerjes së pajisjes së re.

-Nuk ka asnjë relacion të riparimit të defektit, por është mjaftuar me një procesverbal pa numër protokollit ku është shprehur se pajisja funksionon.

Për këtë mbajnë përgjegjësi përgjegjësi i sektorit IT S. K., specialisti i sektorit IT M. U., si dhe KVO për blerjet e vogla i përbërë nga J. V., D.B. dhe T. S..

4. Në datën 10.01.2018 në Credins Bank është kryer pagesa prej 120,000 lekë në favor të operatorit ekonomik “S.-E. shpk” si shpenzim i kryer nga ana e UKD për festën e vitit të ri. Për këtë Drejtori i Përgjithshëm i UKD ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 3457/1 datë 22.12.2017. Komisioni i përbërë nga F.K, A. B. dhe D. B. ka marrë 3 oferta ekonomike. Me procesverbalin e hartuar në datën 22.12.2017, komisioni ka shpallur fitues OE “S.-E. shpk”. Nga auditimi i procedurës u konstatua se nuk ka asnjë specifikim në lidhje me këto oferta të marra, pa përcaktuar zërat konkret mbi të cilat do të merreshin ofertat në treg. Në përshkrim thuhet vetëm: “Darka festive e vitit të ri”. Për këtë arsye nga grupi i auditimit vlera **120,000 lekë** konsiderohet e pajustificuar dhe e paargumentuar. Për këtë mbajnë përgjegjësi komisioni i përbërë nga F.K, A. B. dhe D. B..

Kontrata me shërbimin përmbartimor.

Nga auditimi i veprimeve me bankë u konstatua se nga ana e UKD për periudhën objekt auditimi janë kryer pagesa në favor të shoqërive përmbartimore për ekzekutimin e detyrimeve të debitorëve. Në total për vitin 2017 janë dorëzuar në shoqëritë përmbartimore 260 raste debitorësh me një detyrim total 33,460,235 lekë. Për këto raste, nga ana e UKD janë paguar për dorëzimin dhe fillimin e procedurave përmbartimore në total 5,718,600 lekë. Deri në momentin e auditimit, është ekzekutuar tarifa përmbartimore e paguar nga UKD në 20 raste me vlerë totale 242,160 lekë, dhe vetëm në 2 raste në vlerën 169,739 lekë është arritur të arkëtohet edhe detyrimi ndaj UKD. Nga sa më sipër, shuma e arkëtuar nga ana e përmbartimit në favor të UKD është 0.5% e detyrimit total, si dhe janë arkëtuar vetëm 4% e pagesës shtesë që ka paguar UKD për fillimin e



procedurave përbarimore. Vlera **5,476,440** lekë e cila përfaqëson diferencën ndërmjet tarifave të paguara nga UKD për shoqëritë përbarimore dhe arkëtimit të kësaj nga debitorët, përbën **efekt financiar negativ** për UKD.

Karburanti.

Nga auditimi me zgjedhje i rregullshmërisë së konsumit të karburantit u konstatuan problematikat e mëposhtme:

1. Në procesrabilin nr. 54/2 prot, datë 28.07.2017 nga komisioni i përbërë nga Ilirian Kuci, L.F dhe E. E., mbi verifikimin e konsumit të mjeteve nuk është trajtuar me detaje procedura e ndjekur duke mos dhënë siguri të arsyeshme mbi vërtetësinë e këtyre normave.
2. Në fletëudhëtimet e mbajtura nga drejtuesit e mjeteve të cilat nuk kanë GPS, u konstatuan mjaft raste ku lëvizjet firmosen jo nga personi i cili ka kryer lëvizjen nëpërmjet urdhër shërbimeve, por nga drejtuesit e mjeteve të tjera, madje edhe në disa ditë të cilat rezultojnë se kanë drejtuar njëkohësisht mjet tjetër. Në këtë mënyrë grupi i auditimit i vlerëson fletëudhëtimet jo të sakta, duke mos dhënë siguri mbi përdorimin e duhur të mjeteve të shoqërisë UKD.
3. Udhëtimet e punonjësve nuk janë të shoqëruara në pjesën më të madhe me urdhëra pune nga titullari apo persona të autorizuar prej tij.
4. U audituan me zgjedhje lëvizjet e automjeteve krahasuar me sistemin GPS. Saktësisht u morën në shqyrtim muajt maj 2017 deri janar 2018. Nga verifikimi i detajuar i lëvizjeve të mjeteve në të cilat është instaluar GPS, u konstatua se lëvizjet e shënuara në fletëudhëtime nuk përputhen me ato të rregjistruara nga sistemi i GPS. Nga grupi i auditimit u përlogaritën kilometrat e shënuara tepër në fletëudhëtime krahasuar me sistemin GPS, dhe më pas u nxorr vlera monetare referuar vlerës së blerjes sipas muajve përkatës. Më poshtë paraqitet tabela e përmbledhur:

Periudha	Sasia e pajustificuar (në Litra)	Çmimi i blerjes (pa TVSH)	Vlera (në lekë)
Maj 2017	2285	135	308,475.00
Qershor 2017	3526	135	476,010.00
Korrik 2017	4189	139	582,271.00
Gusht 2017	5261	140	736,540.00
Shtator 2017	4178	144	601,632.00
Tetor 2017	2192	147	322,224.00
Nëntor 2017	2479	153	379,287.00
Dhjetor 2017	998	151	150,698.00
Janar 2018	514	153	78,642.00
Total	25622		3,635,779.00

Burimi: Grupi i auditimit

Vlera **3,635,799**lekë përbën **efekt financiar negativ**, pasi në opinion të grupit të auditimit, ky shpenzim nuk është totalisht i justifikuar.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Në opinion të grupit të auditimit këto problematika kanë ardhur si pasojë e mungesës së kontrollit nga personat përgjegjës.



Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi E.E., si personi i ngarkuar për mbikëqyrjen e harxhimit të karburantit.

Grupi i auditimit i ka kërkuar punonjësit E. E. fletëudhëtimet për automjetet me sistemin GPS për të gjithë muajt objekt auditimi, të cilat nuk u vunë në dispozicion plotësisht (nuk u vunë në dispozicion muajt prill 2018 deri tetor 2018), dhe në rastin më të mirë u paraqitën me shumë vonesë, duke penguar procesin e auditimit të zhvilluar nga grupi të auditimit lidhur me këtë çështje, veprim ky që bie ndesh me detyrimet dhe përcaktimet ligjore të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Ky veprim i cili ngarkon me përgjegjësi punonjësin E.K. me detyrë Specialist në Sektorin e Financës.

Grupi i auditimit gjithashtu i ka kërkuar punonjësit S. K., log-et dhe fushat e databazës të sistemit të faturimeve, të cilat nuk u vunë në dispozicion, duke penguar procesin e auditimit të zhvilluar nga grupi të auditimit lidhur me këtë çështje, veprim ky që bie ndesh me detyrimet dhe përcaktimet ligjore të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Ky veprim i cili ngarkon me përgjegjësi punonjësin S. K. me detyrë Specialist IT.

Për Aktkonstatimin nr. 7 me nr. 2540/6 prot, datë 28.12.2018 të grupit të auditimit mbi auditimin e ushtruar në UKD mbi auditimin me zgjedhje të pagesave të kryera me anë të arkës dhe bankës, shpenzimeve administrative dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve me vlerë të vogël., është paraqitur observacioni ardhur me shkresën nr. 56/7 prot, datë 10.01.2019.

-Për sa i përket rastit të Albtelekom, nga UKD nuk ka kundërshtime por është dakortësuar me grupin e auditimit.

-Për sa i përket shërbimit të T. AMC, sqarojmë se grupi i auditimit është shprehur gjithnjë numrit të telefonit të titullarit, i cili përballohet nga të ardhurat e shoqërisë, dhe si i tillë duhet të prokurohej si shërbim. Në asnjë rast nuk janë cituar numrat personal të punonjësve (është sqaruar disa herë verbalisht si dhe është trajtuar qartësisht në aktkonstatim). Dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, si dhe pagesa totale e shprehur në aktkonstatim i referohet vetëm numrit të titullarit. Kjo vlerë, në mungesë të zhvillimit të prokurimit konsiderohet përdorim pa efektivitet.

-Për sa i përket kontratës së qerasë e cila ka qënë pa afate gjatë periudhës së auditimit, me observacion është paraqitur kontrata të cilës i janë saktësuar detajet e përmendura. Duke qënë se nga UKD janë marrë masa të menjëhershme për rregullimin e këtij konstatimi, kjo gjetje nuk do të trajtohet tek gjetjet dhe rekomandimet (mqns rekomandimi në këtë rast mund të konsiderohet i ezauruar), por do të vazhdojë të jetë pjesë në projektraport, në pjesën trajtimore, duke shërbyer në të ardhmen.

-Në lidhje me ndihmën ekonomike pa dokumentacion vërtetues, është observuar duke treguar bazën ligjore të shpërblimeve si dhe janë paraqitur dokumentat justifikues. Sqarojmë se grupi i auditimit nuk është shprehur kundër këtyre shpërblimeve, por ka cituar faktin që në praktikën e bankës nuk gjenden këto dokumentacione. Gjithashtu për rastet në fjalë është kërkuar dokumentacioni vërtetues gjatë periudhës së auditimit në subjekt. Për këtë nuk është paraqitur dokumentacion. Observacioni merret në konsideratë.

-Në lidhje me gjobën e marrë për paraqitjen me vonesë të pasqyrave financiare, grupi i auditimit ka vlerësuar faktin që kjo gjobë është marrë dhe paguar, si dhe nuk janë marrë masa për personat përgjegjës. Nëse marrja e kësaj gjobe nuk është ankimuar nga UKD (e cila rezulton të mos jetë ankimuar) atëherë përgjegjësia bie mbi këtë të fundit. Për pasojë observacioni nuk merret në konsideratë.



-Në lidhje me likuidimin e detyrimeve ndaj OE jo me parimin FIFO, sqarojmë se grupi i auditimit ka konstatuar pagesa për shërbime të përfunduara deri në 4 vite më parë, për pasojë observacioni nuk merret në konsideratë.

-Në lidhje me observaionin mbi pagesën ndaj “A. M. C.” e cila nga grupi i auditimit është konsideruar dëm ekonomik, sqarojmë se argumenti i paraqitur nuk legjitimon shpenzimin e kryer. Të qënurit brenda garancisë, sjell logjikisht edhe kryerjen e shërbimit. Nëse në kontratë është specifikuar në mënyrë eksplicite se në garanci nuk përfshihet shërbimi i riparimit, ju lutemi ta paraqisni në observacionet e projektraportit.

-Në lidhje me observacionet e bëra për kryerjen e proedurës së prokurimit për shërbimin e saldimit, sqarojmë se argumentet e paraqitura duhet të jenë pjesë e kërkesës për kryerjen e procedurës, të cilat në rastet e përmendura, nuk rezultojnë të jenë. Gjithashtu nga ana e drejtimit të UKD, nga sa është në dijeni grupit i auditimit, nuk i është paraqitur asnjëherë Këshillit të Administrimit nevoja për saldatorë të tjerë apo me më shumë kualifikime. Për pasojë observacioni nuk merret në konsideratë.

-Në lidhje me gjobat e marra nga automjetet, është observuar se janë marrë për shkak të impenjimeve të automjeteve në reformën e ujit. Ky argument nuk e justifikon aspak konstatimin. Për pasojë observacioni nuk merret në konsideratë.

-Në lidhje me pikën 10/a të observacioneve, sqarojmë: nga data 30.04.2015 deri në datën 30.06.2015, kanë kaluar 61 ditë (31 ditë muaji maj dhe 30 ditë muaji qershor). Observacioni nuk merret në konsideratë.

-Në lidhje me pikën 10/c të observacioneve, sqarojmë:

Neni 33 i DST: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

33.1.Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

33.2.Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.

33.3.Autoriteti Kontraktor mund të zbrisë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

33.4.Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.

33.5.Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

Nga sa më sipër, konstatohet se të dy rastet e përdorura si justifikim për shtyrjen e afatit, nuk përbëjnë forcë madhore, nuk janë në interesin publik, nuk janë të pamundura për tu parashikuar, si dhe nuk ka aprovim nga autoriteti kontraktor (UKD). Për pasojë shtyrja e afatit nuk është e përligjur, dhe observacioni nuk merret në konsideratë.

-Në lidhje me pikën 10/d të observacioneve sqarojmë se nga ana juaj janë llogaritur ditë në fillim të zbatimit të kontratës, ndërkohë që në çdo kontratë apo legjislacion njihet si arsye për shtyrje afati si pasojë e ditëve pushim vetëm nëse dita e fundit e dorëzimit të punimeve apo mallrave korespondon me ditë të shtunë, të dielë apo ndonjë pushimi zyrtar. Nëse ju keni një argument



kundër të bazuar ligjrisht në lidhje më këtë, ju lutemi ta paraqisni në observacionet e projektraportit. Kujtojmë nenin 49 të DST: Llogaritja e Afateve: Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe. Gjithashtu, fakti që operatori ekonomik ka kryer pagesën si dëmshpërblim ndaj ujësjellësit, duke pranuar konstatimin e grupit të auditimit, e përforcon këtë konstatimin.

Gjetja konsiderohet e ezauruar. Por do të jetë pjesë e projektraportit me shënimin përkatës.

-Në lidhje me pikën 10/e të observacioneve, merret në konsideratë.

-Në lidhje me pikën 10/f të observacioneve sqarojmë se: baza ligjore e përmendur nga ana juaj për ligj konstatimin e bërë nga ana juaj. Në vazhdim të citimit të nenit 10 të ligjit nr. 48/2014 kemi “Nëse në kontratën apo marrëveshjen e palëve është përcaktuar një afat tjetër, i ndryshëm nga ai i parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, ky afat do të quhet i vlefshëm, me kusht që, nisur nga natyra e mallit apo nga praktika tregtare, të mos jetë në dëm të interesave të kreditorit dhe të mos e vërë këtë të fundit në një pozitë diskriminuese”. Në rastin e konstatuar është përcaktuar një afat, për pasojë observacioni nuk merret në konsideratë.

-Në lidhje me pikën 10/g të observacioneve, merret në konsideratë.

-Në lidhje me pikën 10/h të observacioneve sqarojmë se: Procesverbali i grupit të punës ashtu edhe fatura tatimore nr. 53 e lëshuar nga operatori ekonomik kanë datën 05.12.2017. Për pasojë grupi i auditimit e vlerëson përfundimin e kontratës në datën 05.12.2017.

-Në lidhje me pikën 10/i të observacioneve, merret në konsideratë.

-Në lidhje me pikën 10/j të observacioneve, merret në konsideratë.

Blerjet e vogla

-Në lidhje me observacionin për konstatimin e copëzimit të fondit, sqarojmë se arsyet e përmendura për kryerjen e blerjeve të vogla nuk janë të paparashikueshme (psh. ngricat në muajt e ftohtë të vitit nuk janë të paparashikueshme për aq kohë sa ndodhin cdo vit, ndërkohë nga UKD është përdorur si event i paparashikueshëm). Këto mallra duhet të parashikohen më saktë nga UKD dhe të jenë pjesë e procedurës së hapur të zhvilluar nga UKD. Për pasojë observacioni nuk merret në konsideratë.

-Në lidhje me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël “Darkë festive e vitit të ri”, është observuar duke thënë se “menyt e darkave të vitit të ri janë standarte”. Grupi i auditimit shpreh opinion të kundërt me këtë citim.

-Në lidhje me procedurat e prokurimit me vlerë nën 100,000 lekë për riparimet e ekraneve PDA, sqarojmë se argumentat e paraqitura i janë bërë një herë të ditura grupit të auditimit gjatë periudhës së auditimit në zyrat e UKD. Ju nuk po paraqisni argumenta të tjera, për më tepër këto argumenta nuk kundërshtojnë konstatimin e grupit të auditimit.

Kontratat me përmbarimin

Në lidhje e konstatimin e grupit të auditimit për efektin e krijuar nga kontratat me përmbarimin, në asnjë moment nuk është shprehur përgjegjësia e UKD. Arsyetja e evidentimit ka të bëjë me analizimin e kësaj situatë nga drejtimi i shoqërisë nëse është e arsyeshme kjo mënyrë e ndjekjes së debitorëve apo jo.

Karburanti

-Në lidhje me përcaktimin e normativës së karburantit mungon rruga e përshkruar nga automjetet e cila duhet të jetë variabël në varësi të rruguës që automjeti kryen më së shumti.



-Në lidhje me firmosjen e fletëudhëtimeve të automjeteve, grupi i auditimit i vlerëson të papërshtatshme duke mos krijuar besueshmëri mënyrën e përdorur. Ju kërkohet të rishikoni të gjitha këto fletë udhëtime pasi nuk mundet që një nga shoferët që ka qenë me shërbim në një qytet të firmosë në fletëudhëtimeve të shoferit tjetër që ka qenë në një tjetër qytet. Observacioni nuk merret në konsideratë.

-Në lidhje me konstatimin se lëvizjet janë në pjesën më të madhe të pashoqëruar me urdhëra pune, është observuar se ka të tilla. Grupit të auditimit i janë vënë në dispozicion urdhëra pune të cilat nuk përputhen të gjitha lëvizjet. Nëse nga ana juaj pretendohet se ka edhe urdhëra pune të tjera, të cilat nuk janë vënë në dispozicion të grupit të auditimit, atëherë jeni në shkelje të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për mosvënje në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar.

-Në lidhje me observacionin se mjetet që posedojnë GPS kanë edhe harxhim mbi bazë ore, ju sqarohet se nga ana e grupit të auditimit është marrë e mirëqënë (e justifikuar) e gjithë sasia e orëve të shënuara në fletëudhëtimeve në një ditë të caktuar, nëse automjetet atë ditë kanë të regjistruar në GPS që kanë lëvizur qoftë edhe 1 metër të vetëm. Për pasojë observacioni juaj nuk qëndron.

Observacioni i dërguar për projekt raportin nr. 417 prot., datë 21.02.2019 nuk qëndron dhe si i tillë, nuk merret në konsideratë, pasi nuk gjendet i bazuar në ligj.

Pika 8. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit dhe funksionimi i auditit të brendshëm.

Program auditimi financiar dhe përputhshmëri në Ujësjellës Kanalizime SHA, Durrës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të shoqërisë:

Në zbatim të pikës 8 të programit të auditimit “Nr. 794/1 datë 13.07.2018”, mbi “Mbi zbatimin e ligjshmërisë në organizimin e menaxhimit financiar, sistemit të kontrollit të brendshëm”, Grupi i Auditimit i kërkoi shoqërisë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Statutin e shoqërisë.
2. Rregulloret e brendshme të funksionimit të SHA UKD.
3. Vendim mbi caktimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues të shoqërisë.
4. Rregjistrin e Riskut të shoqërisë.
5. Kod Sjellje, Etik, ose Udhëzim mbi zbatimin e etikës.
6. Vendim mbi caktimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik. (GMS).
7. Gjurmë të auditimit të shoqërisë, sidomos në aspektet kyçe të funksionimit.
8. Deklaratë të Cilësisë, dorëzuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në Ministrinë e Financave.
9. Pyetësor të Vetëvlerësimit, dorëzuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në Ministrinë e Financave.
10. Urdhëra apo Udhëzime që kanë të bëjnë me menaxhimin e shoqërisë, ku të përcaktohen drejt detyrat dhe përgjegjësitë e personave të ngarkuar me kryerjen e detyrave.
11. Deklaratë e Misionit të shoqërisë.

Nga Auditimi rezultoi se:

Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në UKD, nga Grupi i Auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në



lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij për të gjithë komponentët, konkretisht:

- Mjedisi i kontrollit;
- Menaxhimi i riskut;
- Aktivitetet e kontrollit;
- Informimi dhe komunikimi;
- Monitorimi.

Ky auditim u krye në zbatim të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshime, si dhe në mbështetje të Manualit mbi MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 54, datë 15.07.2010 (i shfuqizuar) dhe Manualit mbi MFK miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, për të vlerësuar nësesistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe si ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi;
- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Nga UKD, Grupit të Auditimit ju vu në dipozicion dokumentacioni i mëposhtëm:

- Statuti i Shoqërisë Aksionare “Ujësjiellës Kanalizime” sh.a. Durrës, miratuar me vendimin e AP nr. 4, datë 20.05.2016, vendim për të cilin Grupi i Auditimit, ka rezerva.
- Rregullore e Brendshme e Funksionimit të Brendshëm të “UKD”, miratuar me vendim të këshillit mbikqyrës nr. 26, datë 07.06.2014, nuk është përditësuar sipas rekomandimeve të mëhershme të KLSH.
- Kodin e etikës së Shoqërisë.
- Manuale procedurash për disa prej operacioneve kryesore të UKD;
- Rregullore procedurash mbi veprimtarinë operacionale kryesore të UKD,
- Gjurmë auditimi dhe hartë procesesh për disa operacione etj.

Nga auditimi i Mjedisit të Kontrollit u konstatua:

I. MJEDISI I KONTROLLIT		
	Kriteri:	Situata:
1	Mbi deklarimin e misionit në përputhje me kërkesat e ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.	Nga auditimi u konstatua se: UKD, ka një deklaratë misioni/vizioni të cilësuar në Planin e Biznesit 2014-2018, të miratuar me Vendim nr 34 dt 15.11.2014 nga KM.
2	Mbi hartimin dhe miratimin e një strategjie, me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me kërkesat e akteve ligjore, si dhe kërkesave dhe prioritetëve AKUK, Entit Rregullator të Ujit.	Nga auditimi u konstatua se: UKD, ka një listë me objektiva strategjike të miratuar nga KM me Vendim nr 34 dt 15.11.2014 si pjesë e Planin e Biznesit 2014-2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A. DURRËS

3	Mbi realizimin e objektivave të planeve të mëparshme operacionale të institucionit. Konkretisht: 2017 dhe 2018.	Nga auditimi u konstatua se: Ka patur rezultate të pranueshme në arritjen e objektivave për vitet 2017 dhe 2018, të cilat janë matur dhe janë raportuar në Këshillin Administrativ dhe AKUK.
4	Menaxherët/drejtuesit/punonjësit e UKD janë informuar mbi misionin, objektivat, strategjitë dhe planin e veprimit.	Nga auditimi u konstatua se: Menaxherët/drejtuesit/punonjësit e UKD, kanë qenë pjesë e grupit për hartimin e tyre. Në përgatitjen e Plan Biznesit afatmesëm 2014-2018 ka marrë pjesë stafi menaxherial.
Etika personale dhe profesionale		
5	Mbi monitorimin e pajtueshmërisë së punonjësve me rregulloren/legjislacionin për etikën personale dhe profesionale, në përputhje me Kodin Etik, apo akte të tjera ku të flitet mbi Kodin Etik dhe zbatimin e tij.	Nga auditimi u konstatua se: Nga UKD, nuk është monitoruar pajtueshmëria e punonjësve me rregulloren, për shkak se rregullorja nuk është në pajtueshmëri me ndryshimet strukturore dhe organizative që ka pësuar UKD, dhe VKM 63, si edhe Statutin e shoqërisë. Detyrë kjo e lënë edhe më herët nga KLSH. Kodi i etikës i shoqërisë është miratuar në datë 11.08.2015, me prot. Nr. 2277, nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë Krijimi i njësisë “Task Force” është i pambështetur në organigramën e kësaj shoqërie. Detyrat dhe detyrimet e task force nuk janë të specifikuar në rregulloren e funksionimit të shoqërisë.
6	Mbi zbatimin e rregullave të etikës. Raportimi i shkeljeve të etikës, si dhe mënyrën e trajtimit të tyre.	Nga auditimi u konstatua se: Ka procedura të zbatimit të kodit të etikës, por nuk janë të komunikuar drejt vendimmarrje për zbatimin e kodit të etikës. Masat e marra në zbatim të kodit të etikës nuk i janë raportuar punonjësit zyrtarisht nëpërmjet zyrës së protokollit. Në masat e marra nuk është zbatuar kontrata kolektive e punës, duke dhënë disa raste vërejtje me paralajmërim dhe mbajtje rroge, njëherazi pa zbatuar sipas kontratës kolektive të punës masat e shkallëzuara.
Struktura organizative duhet të jetë në përputhje me objektivat e njësisë		
7	Mbi Strukturën organizative, nëse është në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e njësisë. Numër punonjësish, Numër popullsie, Numër lidhjesh	Nga auditimi u konstatua se: UKD, ka 675 punonjës të cilët i shërbejnë një popullsie 312,882 banorë, me 83,436 abonentë si dhe një raport 8.09 punonjës për 1000 lidhje, çka është një tregues i lartë me standardet, kur mesatarja kombëtare sipas ERRU është 4.5 punonjës për 1,000 lidhje. Kjo strukturë, nuk është e aprovuar nga AP për të realizuar shpërndarje sipas klasave dhe kategorive. Struktura e punonjësve nuk mbulon nevojat e punës, pasi 79 punonjës janë angazhuar në punë 48-56 orë në javë, në kundërshtim me kodin e punës, i cili vendos limit prej 40 orë punë në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A. DURRËS

		javë.
8	Mbi detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave, nëse janë të përcaktuara qartësisht (në një rregullore të brendshme ose hartë procesesh).	Nga auditimi u konstatua se: Detyrat e strukturave relativisht janë të përcaktuara për secilën prej tyre në Rregullore, por delegimi i detyrave të reja nuk pasqyrohet në rregullore, si në rastin e task force.
Stili i punës së drejtuesve		
9	Mbi trajtimin dhe procedimin e rasteve të shkelje të rregulloreve, kodit të etikës, nga punonjësit.	Nga auditimi u konstatua se: Procedura mbi trajtimin e rasteve të shkeljeve apo thyerjes së disiplinës nga ana e stafit, janë të parashikuar në kontratën individuale të punës dhe kodin etik. Specifikimet sipas kodit të punës, janë cituar në kontratë dhe ndiqen në respektim të tyre. Në UKD gjatë periudhës objekt auditimi ka patur 8 raste të kundërshtimit të masave disiplinore apo largimeve nga puna nga punjësit në gjykatë, ç'ka do të thotë se nga stafi menaxherial nuk është zbatuar plotësisht Kodi i Punës.
10	Mbi delegimin e detyrave dhe përgjegjësi, dokumentimi sipas Ligjit nr.10296/2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" (MFK), të ndryshuar me Ligjin nr.110/2015.	Nga auditimi u konstatua se: Nga ana e titullarit nuk ka delegime kompetencash të evidentuara. Nuk ka një praktikë të vlerësueshme mbi delegimin e kompetencave në këtë shoqëri, dhe nuk ka në rregulloren e brendshme një praktikë të unifikuar mbi delegimin e kompetencave. Delegimi i kompetencave nga Administratori në rastet e prokurimit publik ka qenë në përputhje me detyrimet ligjore, por në rastin e rastin e krijimit të njësisë Task Force, janë deleguar kompetenca të pakufizuara, mbi veprimtarinë e tyre.
11	Mbi kryerjen e detyrat nga ana e stafit menaxherial në përputhje me rregullat e delegimit dhe përgjegjësi.	Nga auditimi u konstatua se: Përgjithësisht, zbatimi i detyrave ka qenë në përputhje me detyrimet, të drejtat dhe përgjegjësitë. Këto detyra të specifikuar në rregulloren e funksionimit të brendshëm të shoqërisë, e cila ka nevojë për përditësim.
12	Mbi përcaktimin e detyrave dhe të drejtave të stafit, në rregulla dhe procedura e brendshme të shkuara, apo hartë procesesh, me qëllim garantimin e një mbikqyrje të stafit nga drejtuesit.	Nga auditimi u konstatua se: Për shkak të mungesës së një Rregulloreje të Funksionimit të Brendshëm të UKD të përditësuar, në përputhje me strukturën, përshkrimi i pozicioneve të punës, të drejtat dhe detyrimet, forma e raportimit, etj., nuk janë në koherencë me pozicionet aktuale dhe mënyrën e funksionimit të UKD-së.
13	Mbi diskutimet e çështjeve që lidhen me MFK gjatë takimeve të Grupit të Menaxhimit Strategjik.	Nga auditimi u konstatua se: Nuk ka grup të menaxhimit Strategjik, por nga stafi menaxherial në analizat periodike janë diskutuar çështje të cilat kanë të bëjnë me MFK, siç janë dobësitë, eliminimi i tyre me qëllim arritjen e objektivave.



Politikat dhe praktikat e burimeve njerëzore		
14	<p>Mbi përshkrimet e punës dhe rishikimin e tyre në mënyrë periodike nga drejtuesit në lidhje me detyrat që duhet të kryhen, kërkesat për kualifikimet e nevojshme dhe linjat e raportimit.</p>	<p>Nga auditimi u konstatua se: Ekziston vetëm një pjesë e tyre, për shkak të ndryshimeve strukturore dhe organizative, si dhe mos përditësimit të Rregullores së Funksionit të UKD, e cila është e vitit 2014. Mbi mënyrën e raportimit nga niveli menaxherial i UKD, raportimi kryhet tek titullari i shoqërisë. Shoqëria në mënyrë periodike raporton në Këshillin e Administrimit, së paku një herë në muaj dhe në DPUK së paku një herë në tre muaj. Nuk ka patur raportim në ERRU mbi treguesit e performancës së shoqërisë. Organet drejtuese të shoqërisë nuk kanë një kontratë performance me AP, të dakordsuar.</p>
15	<p>Mbi vlerësimin periodike të punonjësve, lidhur me detyrat që ata kryejnë si pjesë e përgjegjësive të tyre.</p>	<p>Nga auditimi u konstatua se: Gjatë periudhës së auditimit nuk janë kryer vlerësime periodike të stafit, por vetëm vlerësime të stafit të ri pas periudhës së provës. Shoqëria nuk reflekton ndryshimet në pozicionet e punës, sipas vlerësimit të punonjësve, por krijon bindjen e arsyeshme se këto ndryshime janë zgjedhje subjektive e titullarit të shoqërisë.</p>
16	<p>Mbi politikat dhe praktikat e burimeve njerëzore, nëse ato garantojnë qëndrueshmërinë dhe përmirësimin e aftësive profesionale të stafit.</p>	<p>Nga auditimi u konstatua se: Gjatë periudhës së audituar ka patur lëvizje të stafit. Në total janë larguar 122 punonjës në periudhën 22 mujore audituese, ose 18.1% e punonjësve, dhe janë emëruar 170 punonjës ose 25.2% e punonjësve kanë më pak se dy vjet të punësuar në UKD. Shoqëria nuk disponon kritere mbi punësimet e reja, publikime, njoftime apo çdo lloj metodologjie për rekrutim. Shoqëria nuk ka asnjë njoftim në zyrën e punës të shfaqur për periudhën audituese. Nuk ka plane trajnimi të miratuar, por gjatë periudhës objekt auditimi janë kryer në varësi të nevojave të njësisë, si: Trajnim në lidhje me operatorët e terrenit; Trajnim në lidhje me prokurimet publike; Trajtime të organizuar nga Shoqata e ujit, rreth cilësisë së ujit, humbjeve dhe marrëdhënieve me konsumatorin; Trainim mbi laboratorin e analizave të ujit.</p>

Shkaku: Mjedisi i kontrollit në UKD SHA nuk është përmirësuar për dy arsye;

-Së pari, krijimi i strukturave të reja, marrja e masave të kuptueshme dhe të evidentueshme për shkeljet si në kodin e etikës dhe të punës, por edhe reflektimi i strukturës aktuale të punonjësve të shoqërisë, krijimin e GMS, ka ardhur si pasojë e një situatë në vijueshmëri, pa vendim marrjen e duhur nga drejtimi i shoqërisë;

-Së dyti, për problemet që kanë të bëjnë me metodologjinë e rekrutimeve të burimeve njerëzore si dhe vlerësimin e tyre periodik, delegimin e kompetencave, apo/dhe një hartë procesesh dhe



komunikimi mes degëve dhe sektorëve, vjen si pasojë e mungesës së një praktike të shkruar nga ana e shoqërisë, që të ketë vlerë detyruese mbi gjithë administratën dhe punonjësit.

Pasoja: Defekti i mungesës si dhe vendim marrjes sipërcituar, por edhe e një praktike të shkruar për burimet njerëzore, ka krijuar diferenca të trajtuar mes Situatës dhe Kriterit nga pika 1 deri në pikën 16, duke mos ndikuar pozitivisht për përmirësimin e mjedisit të kontrollit.

Efekti: Të gjitha evidentimet mbi mjedisin e kontrollit, krijojnë mundësinë e një risku të fshehtë, dhe të pazbuluar në shoqëri.

Rëndësia: E lartë.

Observacione:

UKD SHA për akt konstatimin; Me observacionin nr. 56/8 datë 10.01.2019, pretendon se nuk nevojë që roli i Task Force të përshkruhet në MO të shoqërisë, por mjafton urdhëri i brendshëm, si edhe Administratori ka kompetenca të tjera të përcaktuara në ligj dhe statut.

Shoqëria pretendon se masat disiplinore kanë respektuar kodin e etikës dhe kontratën kolektive të punës.

Shoqëria pretendon se ka një organigramë të re të miratuar nga AP. Punonjësit që rezultojnë se kanë punuar tej orareve të lejuara nga Kodi i Punës sipas shoqërisë, janë të mbartura në vite dhe se ata janë në punë jo fort të vështirë.

Funksionimi i Task Force, ju si strukturë e re por si detyrë për një kohë të limituar, sipas UKD është në përputhje me rregulloren.

Shkeljet e disiplinës në punë dhe ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka qëndrim të ndryshëm për të njëjtën çështje, pretendon UKD në observacionin e vet.

Subjekti pretendon se delegimi i kompetencave nga titullari është konform KprA edhe në rastin e strukturës Task Force.

Shoqëria pretendon se ka një kontratë performance mes AP dhe anëtarëve të KA, të paraqitur pranë grupit të auditimit.

Shoqëria mendon se pozicionet e punës janë përcaktuar në bazë të meritokracisë.

Audituesi për akt konstatimin: Nuk është kompetencë e Administratorit referuar VKM nr. 63, e cila shërben si statut tip i shoqërive ujësjellës, neni 18, pika 6, gërma c, miratimi i strukturës së shoqërisë dhe rregullores së brendshme të saj, por vetëm hartimi i saj dhe miratimi nga KA të shoqërisë. Lidhur me MO të shoqërisë, ai i jep kompetenca për nxjerrje urdhërash të veçantë, por me kushtin që mos të jenë në kundërshtim me lejimet ligjore dhe nënligjore sipërcituar.

Për të gjitha masat disiplinore, të periudhës nën auditim, u verifikua në protokollin e shoqërisë se asnjë punonjës nuk ka marrë djeni nëpërmjet firmosjes për të tërhequr aktin administrative nga protokollin i shoqërisë. Njëkohësisht, nuk ka asnjë libër protokoll-mbledhje në Degën e Burimeve Njerëzore që vërtetojnë se “të gjithë punonjësit” ndaj të cilëve janë marrë masa disiplinore, ju është bërë prezent lloji i shkeljes, dhe ju është lënë mundësia e dhënies së versionit të tyre.

Organigrama e miratuar nga AP, nuk specifikon numër punonjësish për çdo degë dhe sektor të shoqërisë, por vetëm korelacionin mes tyre dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve.

Lidhur me numrin e punonjësve të cilët kanë punuar mbi orët e lejuara të punës, sqarojmë se çdo tejkalim i Kodit të Punës, është i ndaluar, dhe motivi pse është shkelur Kodi i Punës, nuk justifikon faktin.

Çdo strukturë, apo veprimtari komplekse në një shoqëri, apo subjekt të audituar, përbën risk të lartë auditimi, kur rregullat në të cilat veprojnë ato janë të pakuptueshme dhe se me rregullore të paspecifikuar qartë. Ky përcaktim sipas ISSAI, vlen edhe për strukturën Task Force, e cila në MO të UKD ka të njëjta kompetenca si edhe Inspektoriati i Ujit, por me ndryshimin se Task Force nuk ka një rregullore funksionimi. Ajo që shoqëria pretendon se është rregullore e funksionimit të njësisë, nuk është aprovuar nga KA në konformitet me VKM nr. 63.

Gjatë auditimit, u konstatua se jo në të gjitha rastet shkëputja e njëanëshe e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A. DURRËS

marrëdhëniet e punës, është ankimuar. Kjo vlen njëloj edhe në rastet e masave disiplinore. Në përgjithësi, ky vlen të merret në konsideratë, si trend i marrëdhënies në shoqëri, por fakti që ka patur raste të ankimit në gjykatë, pa bërë ankimin administrativ në shoqëri, evidenton faktin se kjo ndërprerje ka ardhur në kundërshtim me Kodin e Punës. Ky fakt përforcohet edhe nga vendimet e gjykatave, dhe përcaktimit të masës shpërblim dëmi, sado e vogël qoftë përqindja.

Njësia Task Force, është konceptuar si një njësi me vartësi të trefishtë nga Drejtoria Ligjore, Drejtoria Teknike dhe Drejtoria Tregtare. MO i UKD, specifikon se të tre këto njësi raportojnë tek Administratori, ndërsa Administratori delegon këtë kompetencë të raportimit të Task Force deri tek Drejtorat respektiv, duke shmangur përgjegjësinë e vet të kontrollit, duke i dhënë njësisë atributin e marrjes së vendimit mbi penalitetet deri në ndjekje penale përmes një rregullore të funksionimit dhe delegimit të kompetencave, por të paautorizuar nga KA. Pikërisht kjo metodë delegimi e detyrave të shprehura në ligjin 9901, të administratorit, nuk mund të delegohet.

Kontrata e performancës së paraqitur në grupin e auditimit mban datën 20.09.2018, ose 10 ditë para përfundimit të periudhës audituese, por që për 22 muaj të auditueshëm, kjo kontratë mbulon vetëm 10 ditë. Nga ana tjetër kjo kontratë, duhej të ishte lidhur në momentin e zgjedhjes së KA nga AP, dhe jo domosdoshmërisht të pritej udhëzim nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Ka një arsye pse zgjidhet KA të shprehur në VKM nr. 63, që të monitorojë arritjen e treguesve të shoqërisë, të cilët i caktohen nga AP, për KA të shoqërisë.

Kontrata e paraqitur pranë grupit të auditimit, mes Aksionerit Bashkia Durrës dhe Administratorit, nuk zëvendëson, të gjithë anëtarët e KA. Administratori gjithashtu duhej të kishte edhe një kontratë pune.

Grupi i auditimit i referohet në gjetje emërimet në rekrutimet e reja, të cilat nuk kanë asnjë informacion mbi arsimin, përvojën, por as për kërkesat që ka shoqëria për punonjësit e rinj. Përtej këtyre paqartësive shoqëria në rekrutimet e reja, emëron në administratë punonjës së sapodiplomuar, për të cilët dega e burimeve njerëzore nuk ka asnjë praktikë vlerësuese. Dega e Burimeve Njerëzore nuk dispononte asnjë praktikë mbi vlerësimin e punonjësve, sipas një metodologjie të verifikueshme, të njoftuar ndaj të gjithë punonjësve, rezultatet e së cilës të jenë të matshme. Pretendimi i shoqërisë se këto behën nga titullarët e tyre, nuk mbështetet në MO të UKD, ku të jetë përcaktuar ndonjë detyrë mbi përgjegjësat, për të drejtën e dhënies së një vlerësimi të çertifikuar. Pretendimi i shoqërisë për njoftim për punësimet e reja është i pabazuar. Nuk ka asnjë njoftim të shpallur në konformitet me KPrA, në ambjentet e shoqërisë, i verifikueshëm.

Observacioni i dërguar për projekt raportin nr. 417 prot., datë 21.02.2019 nuk qëndron dhe si i tillë, nuk merret në konsideratë, pasi nuk gjendet i bazuar në ligj, si dhe i pambështetur në fakte e prova.

Në ligjin për MFK, nenin 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 1 ku cilësohet:

Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.	
II. MENAXHIMI I RISKUT	
Kriteri:	Situata:
1 Mbi hartimin dhe miratimin e një strategjie në përputhje me nenin 21, të ligjit nr. 10296/2010, të ndryshuar.	Nga auditimi u konstatua se: Nuk ka një strategji rrisht, në përputhje me kërkesat e MFK. Kjo sidomos për miratimin e një strukture punonjësish të aprovuar në AP, dhe uljen e humbjeve sasiore të ujit që kalojnë mbi 70%.
2 Mbi hartimin, miratimin e një regjistër rrisht, ku të identifikohen rrishtet më të rëndësishme të lidhura me objektivat e njësive.	Nga auditimi u konstatua se: Nga UKD, gjatë auditimit nuk janë paraqitur regjistra të rrishtit, të hartuar nga Administratori



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A. DURRËS

		/struktura të veçanta të UKD, të cilët nuk janë të miratuar dhe inkuadruar në një të vetëm. Nuk ka një Regjistër rrisht për të gjithë kompaninë dhe për rrjedhojë nuk ka një version të miratuar të tij, një ndjekje, një rishikim të tij gjatë vitit, me qëllim ndërmarrjen e procedurave shtesë për minimizimin e tyre.
3	Mbi trajtimin dhe rishikimin e risqeve nga stafi menaxherial/apo GMS në takimet e tij çështje të lidhura me rrishtet që mund të pengojnë përmbushjen e objektivave të njësisë.	Nga auditimi u konstatua se: Nga këqyrja e vendimeve të marra nga strukturat drejtuese, menaxheriale si, Drejtoria e UKD, Këshilli i Administrimit, janë diskutuar çështje në lidhje me rrishtet, identifikimin, apo menaxhimin e tyre. Analizimin e tyre dhe ndikimin në arritjen e objektivave të kompanisë.
4	Mbi nivelin e pjesëmarrjes së strukturave të UKD në hartimin e regjistrit të rrishtit.	Nga auditimi u konstatua se: Strukturat e shoqërisë nuk janë angazhuar në identifikimin e rrishteve të shoqërisë, dhe evidentimin e sektorëve më me rrisht në të cilët duhet të fokusohet puna e UKD. Në rastin e dy problemeve të ndërprerjes së debitorëve nga rrjeti i UKD për furnizim me ujë, dhe keqfaturimit ndaj debitorëve që nuk janë të lidhur në rrjetin e UKD, por që janë debitorë pa marrë furnizimin me ujë, strukturat drejtuese kanë shmangur përgjegjësitë e pozicioneve që ata mbajnë, për të evidentuar numrin e abonentëve dhe vlerën detyrim ndaj UKD, por kanë përcjellë vetëm shkresat e hartuara nga vartësit e titullarëve.

Shkaku: Drejtimi i shoqërisë, duhet të ketë një regjistër rrisht, duke identifikuar se ku janë sektorët dhe proceset më me rrisht, dhe të ushtrorjnë kontroll të vijueshëm për të zvogëluar këtë rrisht. Shoqëria duhet të dalloj qartë se kjo detyrë i takon drejtuesve, dhe jo Auditit të Brendshëm të shoqërisë, e cila duhet theksuar se ka kryer një punë voluminoze audituese. Identifikimi i rrishtit dhe krijimi i regjistrit mbi të, i shërben të gjitha hallkave të shoqërisë, nga drejtorët, drejtorët e degëve, përgjegjësat e sektorëve, deri tek punonjësi më i thjeshtë, si një zinxhir që vetëkorrigjohet në vijueshmëri, nga gabimet që shoqëria vetëevidenton.

Efekt: Mungesa e identifikimit të rrishtit dhe moskrijimi i regjistrit të rrishtit, e vështirëson mjaft, punën vetëpërmirësuese të shoqërisë, për të mbajtur nën kontroll rrishtin dhe proceset që kanë rrisht të lartë. Ky difekt evidentohet nga pika 1 deri në pikën 4 sipërcituar.

Rëndësia: E lartë.

Observacioni:

UKD SHA për akt konstatimin; Me observacionin nr. 56/8, datë 10.01.2019, ka një strukturë të miratuar punonjësish.
Ka një plan të miratuar të uljes së ujit pa të ardhura.
Njësia e Auditimit të Brendshëm ka praktika në këtë pikë, për evidentimin e rrishtit.
Shoqëria është angazhuar në uljen e risqeve.

Audituesi për akt konstatimin: UKD nuk vërteton se si mund të quhet i realizuar projekti i reduktimit të ujit pa të ardhura, kur në të gjithë periudhën audituese, faturohet vetëm 30% e ujit të prodhuar, në të cilin



përfshihet edhe faturimi i abonentëve që nuk marrin ujë nga UKD, por që faturohen afro fe.

Mbi evidentimin e riskut, dhe krijimit të regjistrit të riskut, shoqëria nuk arrin të krijojë një kuptim të saktë mbi këtë problem. Risku dhe evidentimi i tij në një regjistër të posaçëm është detyrë e Administratorit. NJAB, mbi këtë risk, orienton punën e vet audituese, por nuk e krijon atë. KLSH gjithashtu orienton auditimin e vet bazuar në këtë regjistër risku. Në mungesë të një regjistëri risku të shoqërisë si NJAB por edhe KLSH, evidentojnë sektorët më me risk, ku do të shtrijnë auditimin e vet, por kjo nuk largon përgjegjësinë e Administratorit nga detyrimi për evidentimin e riskut, në nivel Drejtorie, Dege, Sektori. Shoqëria gjithashtu duhet të mos keq interpretoj kontrollin me njësinë e kontrollit të brendshëm. Kontrolli është veprimtaria rutinë e shoqërisë që vetkontrollon veten e saj, ndërsa NJAB është kontroll i të gjitha hallkave të shoqërisë, përfshirë dhe kontrollin mbi veprimtaritë e kontrollit të brendshëm. Grupi i auditimit ka vlerësuar pozitivisht kontrollin e NJAB, që është nën vartësinë e KA, por ka vlerësuar negativisht kontrollin e brendshëm.

Shoqëria pretendon se është e angazhuar për uljen e risqeve, por nuk jep prova shkresore, çfarë ka evidentuar sektor me risk, dhe si e ka ulur atë.

Observacioni i dërguar për projekt raportin nr. 417 prot., datë 21.02.2019 nuk qëndron dhe si i tillë, nuk merret në konsideratë, pasi nuk gjendet i bazuar në ligj, **si dhe i pambështetur në fakte e prova.**

Neni 21 “Menaxhimi i riskut”, ku cilësohet:

Pika 1. Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Pika 2. Për t'i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.

III. AKTIVITETET E KONTROLLIT

Kriteri:		Situata:
1	Mbi ekzistencën e manualeve për proceset kryesore operationale dhe financiare.	Nga auditimi u konstatua se: Nga UKD, janë hartuar pjesërisht një sërë manualesh mbi procedurat për operationet kryesore, konkretisht procedura në lidhje me: <i>Shërbimin konsumator:</i> -Ndërprerjen e furnizimit me ujë për debitorët dhe rilidhja pas shlyerjes së detyrimit; -Klientët e rinj, kryerja e pikës së



		<p>lidhjes, regjistrimi në sistem i tyre;</p> <ul style="list-style-type: none">- Faturimi, grumbullimi dhe adminitrimi i të ardhurave; <p><i>Shërbimet administrative:</i></p> <ul style="list-style-type: none">-Mbi qarkullimin e vlerave materiale-Grumbullimi i të dhënave statistikore periodike; <p>Duhet theksuar se bashkëngjitur këtyre manualeve, nuk është vendosur përherë dokumentacioni tip, sipas rasteve përkatëse dhe harta e proceseve, sipas kërklesave të MFK.</p>
2	<p>Mbi ekzekutimin dhe regjistrimin e transaksioneve financiare, miratimi i anagazhimeve financiare (sistemi evitimi i konfliktit të interesit. Shpenzimet iniciohen nga drejtuesi i programit buxhetor/departamentet/drejtoritë përkatëse.</p>	<p>Nga auditimi u konstatua se: Ndërmarrja e angazhimeve financiare dhe ekzekutimi i tyre, bëhet me autorizim nga personat e caktuar. Ka procedura mbi përcaktimin e tyre. Shpenzimet janë realizuar sipas paraqitjes së nevojave nga strukturat përkatëse.</p>
3	<p>Mbi miratimin dhe zbatimin e procedurave të shkruara për menaxhimin e aktiveve e rëndësishme (me vlerë) dhe aktivet afatgjata.</p>	<p>Nga auditimi u konstatua se: Shoqëria ka problem me evidentimin e vlerave të aktiveve afatgjata, të cilat nuk janë të përditësuara në një rregjistër të posaçëm në lidhje me kronologjinë e vlerës ndër vite, rivlerësime, amortizim etj., probleme të mbartura në vite, por që nuk janë zgjidhur plotësisht nga pjesa menaxheriale e shoqërisë.</p>
4	<p>Mbi vendosjen dhe zbatimin e rregullave të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit të IT. (p.sh. Ndryshohen fjalëkalimet rregullisht, fireëall-et, hyrje e kufizuar në të dhënat IT, etj.), si dhe pasjen e një sistem rezervë (back-up) IT të përshtatshëm, plan rekuperimi nga fatkeqësitë të testuar në praktikë.</p>	<p>Nga auditimi u konstatua se: Zbatohen rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit IT (Psh. Ndryshohen fjalëkalimet rregullisht, fireëallet dhe hyrje e kufizuar në të dhënat IT), Ekzistojnë procedura të veçanta shkruara, mbi sistemet IT, të cilat përdoren në UKD, të cilat i janë bërë me dije stafit, që ka të bëjë me mënyrën e ruajtjes së të dhënave mbi klientët, sigurinë e mbrojtjes së të dhënave personale të konsumatorëve që lidhet me adresat, detyrimet dhe pagesat. Mbrojtja e të dhënave financiare të</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A. DURRËS

		shoqërisë, në mënyrë elektronike, mbi punonjësit, adresat, pagat janë të ruajtura nga aksesit i pa autorizuar.
--	--	--

Shkaku: Mungesa e manualeve mbi operacionet kryesore, kryesisht operacionale, që kanë të bëjnë me shërbimin ndaj klientit, ku veçojmë lidhjen në sistem të konsumatorëve, realisht, për të shmangur kontratat e pasakta, metodologjia e ndërprerjes së furnizimit me ujë, në cilat raste aplikohet dhe cilat jo plotësisht, mënyrat zyrtare të njoftimit etj, mënyra e rregjistrimit të aktiveve afatgjata, në kartelat përkatëse, si vlerë dhe si produkt i matshëm. Këto krijojnë edhe një risk financiar aparent, ndaj nevoja e hartimit të këtyre manualeve, është një domosdoshmëri për menaxhimin e riskut në UKD SHA.

Efekti: Diferenca midis kriterit dhe situatës së trajtuar në pikën 1 deri në pikë 4, për ato probleme të evidentuar më sipër, tregon për një veprimtari kontrolli jo të plotë nga stukturat drejtuese. Kjo veprimtari kontrolli, duhet të realizohet nga drejtimi i shoqërisë, si një proces i vijueshëm i kontrollit të brendshëm, pa u ngatërruar me auditimin e brendshëm, që ka një tjetër specifik. Kontrolli i brendshëm, i kontrollon proceset “in factum”, ndërsa auditimi, qoftë i brendshëm (NJAB) apo i jashtëm (KLSH) i kontrollon proceset “post factum”, ndaj MFK ja jep me ligj këtë detyrë drejtuesve të shoqërisë.

Rëndësia: E lartë.

Observacioni:

UKD SHA për akt konstatimin; Me observacionin nr. 56/8, pika 3, datë 10.01.2019, shoqëria ka nisur një proces të vlerësimit të AAGJM, që është në proces tenderimi

Audituesi për akt konstatimin: UKD pranon se ky problem është prezent në periudhën audituese, dhe se ky argument, nuk hedh poshtë gjentjen e grupit të auditimit

Observacioni i dërguar për projekt raportin nr. 417 prot., datë 21.02.2019 nuk qëndron dhe si i tillë, nuk merret në konsideratë, pasi nuk gjendet i bazuar në ligj, si dhe i pambështetur në fakte e prova.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: titullari i njësisë publike “UKD”, pasi nuk ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në ligjin për MFK, neni 22 “Veprimtaritë e kontrollit”, pika 1 ku cilësohet:

Titullarët e njësisë publike miratojnë veprimtaritë e kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

IV. INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI

	Kriteri:	Situata:
1	Mbi njohjen e të drejtave dhe detyrimeve, nga ana e stafit, nëse çdo drejtues/strukturë varësie është në dijeni të detyrave për aktivitetin/grupin e aktiviteteve për të cilën	Nga auditimi u konstatua se: Ju është komunikuar me fillimin e detyrës nëpërmjet përshkrimit të tyre në Kontratën Individuale të punës dhe rregullores së



	është përgjegjës.	funksionimit të brendshëm të shoqërisë.
2	Mbi ekzistencën e një sistem informacioni që u siguron drejtuesve informacion rregullisht mbi arritjen e objektivave të njësisë.	Nga auditimi u konstatua se: Për çështje kryesore, të cilat janë detyrim statutor, nga UKD, janë kryer raportime rregullisht, në organet e prokurorisë. Përsa ju përket raportimeve për marrje informacioni ditore dhe periodik mbi realizimin e treguesve, nuk ka procedurë të miratuar.
3	Mbi ekzistencën e një rregulloreje të brendshme të shkruar në lidhje me komunikimin brenda njësisë publike (të shkruar, elektronik dhe verbal).	Nga auditimi u konstatua se: Në Rregulloren aktuale, nuk ka asgjë të shkruar mbi mënyrën e komunikimit të informacionit të shkruar/elektronik/verbal, brenda UKD-së.
4	Mbi ekzistencën e formave të informimit në kohë, në mënyrë që strukturat drejtuese të informohen dhe a janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për dhënien e këtij informacioni.	Nga auditimi u konstatua se: Çdo muaj bëhet shqyrtimi i realizimit të planit, për ndjekjen në kohë të problematikës, si dhe çdo tre muaj bëhen raportime në strukturat drejtuese.
5	Mbi bashkëpunimin dhe komunikimin me institucionet e tjera jashtë institucionit.	Nga auditimi u konstatua se: Ka patur komunikim me institucionet e tjera, ato lokale si dhe me institucione të tjera qendrore.

Shkaku: Mungesa e një rregullore të brendshme të përditësuar, e cila duhej të përcaktonte qartë mënyrën e komunikimit brenda shoqërisë, dhe ndarjes së kompetencave, ka sjellë si rrjedhojë që shumë sektorë, kryejnë punë të një natyre të përafërt, por me vartësi të ndryshme, siç është struktura e azhornuesve me task force, apo edhe inspektoriat i ujit. E njëjta situatë është në marrëdhëniet me publikun, detyrë kjo që mbulohet nga Nën-Drejtori i Përgjithshëm, por edhe nga Drejtoria Tregëtare, në sektorin e Shërbimit ndaj klientit, si edhe nga Dega e Burimeve Njerëzore, specialisti për marrëdhënie me publikun.

Efekti: Krijimi i strukturave të komplikuar, pa vartësi të qartë hierarkie, por edhe me fushë të njëjtë veprimi, rrit riskun në adresimin drejt të problemeve dhe caktimin e përgjegjësive.

Rëndësia: E lartë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: titullari i njësisë publike “UKD”, pasi nuk ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në ligjin për MFK, Neni 23 “Informacioni dhe komunikimi”, ku cilësohet:

<i>Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi, që sigurojnë...</i>		
V. MONITORIMI		
	Kriteri:	Situata:
1	Mbi mënyrën e raportimit tek Titullari i institucionit.	Nga auditimi u konstatua se: Titullari i UKD, merr raporte periodike mujore, mbi aktivitetet e çdo departamenti/drejtorie.



2	Mbi aktivitetin e njësisë së auditimit të brendshëm.	Nga auditimi u konstatua se: Shoqëria ka një Njësi të Auditimit të Brendshëm (NJAB) me dy punonjës auditues të certifikuar, nga tre të parashikuar si në strukturë, por edhe në VKM nr. 83, datë 03.02.2016, pika 3. Struktura e NJAB nuk është në madhësinë e kërkuar nga lejimet ligjore, për shoqëritë që kanë mbi 300 punonjës. NJAB ka një praktikë të konsoliduar të veprimtarisë së vet audituese, dhe plan auditimi të miratuar nga KA.
3	Mbi monitorimin e treguesve dhe arritjen e objektivave, rregullshmëria e monitorimit dhe analizimi i shkaqeve që mund të çojnë në dështim.	Nga auditimi u konstatua se: Nga UKD, përgatiten dhe Raportet mbi aktivitetin, treguesit për peiudha 3-mujore, të cilat ju paraqiten strukturave/organeve drejtuese për shqyrtim dhe miratim. Gjatë diskutimit analizohen problematikat e dala dhe janë vendosur prioritet për eliminimin e tyre.

Shkaku: Shoqëria në lidhje me treguesit e objektivave dhe monitorimit të shkaqeve për mos arritjen e objektivave të për uljen e sasisë së ujit të pafaturuar, që ende qëndron në afro 70%, nuk ka raporte të verifikueshme për analizimin e shkaqeve.

Efekti: Mungesa e raportimeve për shkaqet e humbjeve të 70% të sasisë së ujit të prodhuar, duhet të adresohet me saktësi në zonat ku ndodh ky fenomen. Matja e produktit kryesor të shoqërisë, ujë i pijshëm, nuk bëhet në tubacionet qendrore që sjellin ujin, nëpërmjet matësve dhe sistemit SCADA, për të kuptuar në kohë reale difektin e mosfaturimit të ujit.

Rëndësia: E lartë.

Observacion:

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: titullari i njësisë publike “UKD”, pasi nuk ka përmbushur plotësisht detyrimet e përcaktuara në ligjin për MFK, Neni 24 “Monitorimi”, pika 1 ku cilësohet:

Titullarët e njësisë publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë kushtet.

Pas analizimit të treguesve të mësipërm, pjesë përbërëse e 5 komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm, arrijmë në konkluzionin që:Funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në UKD nuk ka funksionuar në mënyrën e duhur në 5 komponentët e tij. UKD nuk ka hartuar deklaratën dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe Pyetësorin e Vetëvlerësimit për vitin 2016, 2017 dhe 2018, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave (MF) nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”. Kjo deklaratë nuk duhet të jetë e njëjta me deklaratën e NJAB. Deklarata dorëzohet deri në maj të vitit ushtrimor. Kjo deklaratë dorëzohet brenda muajit Prill të, çdo viti.

I. Deklarata e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm

1. Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme ka detyrimin e përgatitjes dhe nënshkrimit të deklaratës dhe të raportit vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm gjatë vitit të mëparshëm buxhetor për njësinë publike që mbulon, e cila përfshin organin qendror të njësisë, njësitë e vartësisë dhe njësitë e kontrolluara.



2. Njësitë e kontrolluara përfshijnë, në kuptim të këtij udhëzimi, shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, që zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantojnë financiarisht nga njësi e qeverisjes së përgjithshme.
3. Nëpërmjet deklaratës, nëpunësi autorizues merr përsipër përgjegjësinë për menaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve financiare dhe jofinanciare të njësisë, si dhe pohon se sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e objektivave, politikave dhe qëllimeve të njësisë së tij.
4. **Deklarata përbën një element të raportit vjetor të performancës dhe i nënshtrohet shqyrtimit të auditimit të brendshëm të njësisë dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit.**
5. Formati tip i deklaratës gjendet në shtojcën 1 të këtij udhëzimi.
6. Deklarata, së bashku me raportin i paraqitet paraprakisht titullarit të njësisë publike dhe brenda muajit shkurt të çdo viti i paraqitet nëpunësit të parë autorizues në Ministrinë e Financave.
7. Nëpunësi i parë autorizues përgjigjet përpara Ministrit të Financave për monitorimin e zbatimit të kontrollit të brendshëm dhe raporton **brenda muajit prill të çdo viti** mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe mbi çdo të metë dhe masat e ndërmarra nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zgjidhjen e tyre, nëpërmjet “Raportit vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Rëndësia: E lartë.

Ambienti i kontrollit, rezulton me mangësi në disa tregues të tij, si mungesë e një Rregulloreje të brendshme të përditësuar, mungesë të vlerësimit të stafit dhe trajtimit të tij, etj. Në lidhje me menaxhimin e riskut nga auditimi i dokumentacionit dhe nga deklaratat e stafit menaxherial është konstatuar se UKD nuk disponon një regjistër risku në nivel UKD. Nuk ka strategji të hartuar për riskun, nuk është krijuar GMS, dhe nuk ka takime të stafit menaxherial me objekt trajtimin e rrisqeve, evidentimin e tyre, masat për eliminimin e tyre, si dhe rishikim të rrisqeve gjatë periudhave ushtrimore. Në lidhje me aktivitetet e kontrollit ekzistojnë procedura të punës të shkruara për proceset kryesore operacionale dhe financiare, duke përfshirë deri diku dhe qarkullimin e dokumentacionit dhe të informacionit, hallkat e vendim-marrjes dhe kontrollet e brendshme, por mungojnë procedura të shkruara për ruajtjen e aktiveve, etj. Në lidhje me informacionin dhe komunikimin nuk ekziston një procedurë e shkruar për mënyrën e komunikimit brenda institucionit dhe procedurat për qarkullimin e informacionit, kjo si rezultat i mungesës së një rregulloreje të plotë, si dhe në koherencë me ndryshimet në mënyrën e organizimit të UKD. Pavarësisht mungesës së procedurave të shkruara në UKD, shkëmbimi i informacionit ka funksionuar sipas nivelit të hierarkisë, në mënyrë verbale e shkresore. Dokumentimi i veprimtarisë së shoqërisë në protokoll nuk realizohet në kronologjinë e duhur dhe sipas modularëve të përcaktuar për ruajtjen e korespondencës së jashme apo të brendshme. Pavarësisht mungesës së procedurave të shkruara mbi monitorimin duke përfshirë të gjitha hallkat e hierarkisë, titullari i institucionit, por edhe strukturat e tjera menaxheriale, marrin raporte ditore, javore, mujore, 3-mujore dhe vjetore për menaxhimin dhe ecurinë e punës. Gjithashtu, organet drejtuese të shoqërisë kanë monitoruar dhe analizuar realizimin ose shkaqet e mosrealizimit të objektivave. Përsa i përket monitorimit nga organet e larta drejtuese të UKD, si KA dhe AP, kanë monitoruar veprimtarinë e UKD, sipas përcaktimeve të bëra në Statut.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Administratori i Shoqërisë, pasi nuk kanë përmbushur në masën e duhur, disa detyrime të përcaktuara në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” me ndryshime, si dhe të Manualeve sipas periudhave përkatëse, në zbatim të ligjit për MFK, në zbatim të tij, konkretisht:

- nuk ka përmbushur detyrimet në zbatim të nenit 8 “Përgjegjësitë menaxheriale të titullarit”
- nuk ka përmbushur detyrimet në zbatim të nenit 20 “Mjedisi i kontrollit”;
- nuk ka përmbushur detyrimet në zbatim të nenit 21 “Menaxhimi i riskut”;



- nuk ka përmbushur detyrimet në zbatim të nenit 22 “Veprimtaritë e kontrollit”;
- nuk ka përmbushur detyrimet në zbatim të nenit 23 “Informacioni dhe komunikimi”;
- nuk ka përmbushur detyrimet në zbatim të nenit 24 “Monitorimi”.
- nuk ka dorëzuar në MF deklaratën dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, në zbatim të Udhëzimit të MF nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

- 1) SHA UKD nuk ka vlerësuar 5 komponentët e MFK-së.
- 2) Shoqëria nuk ka hartuar dhe dorëzuar Deklaratën e Cilësisë dhe Raportin e Vjetor në Ministrinë e Financës, brenda fundit të muajit Prill të çdo viti.
- 3) Shoqëria nuk menaxhon si duhet riskun, nuk ka GMS, Koordinator Risku, Rregullore të brendëshme të përditësuar, Regjistër risku.
- 4) Shoqëria ka mangësi në mëyrën e delegimit të kompetencave dhe gjurmimin e realizimit të kompetencave të deleguara.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

- 1) Ligjit nr. 10296, datë 08/07/2010, i ndryshuar. “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”,
- 2) Statutit të shoqërisë.
- 3) Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 8980 datë 15.07.2010, ndryshuar me Udhëzimin nr. 108, datë 17.11.2016 “Manual i MFK-së”, i ndryshuar.
- 4) Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 16, datë 20/07/2016 ”Për përgjegjësitë e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Koordinatorit të Riskut në njësitë publike”
- 5) VKM nr. 63 datë 27.01.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”
- 6) Udhëzimit të MF nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”.

Pika 9.Të ndryshme, që mund të dalin gjatë auditimit.

Në zbatim të Programit të Auditimit, financiar dhe përputhshmërie, mbi “Cilësinë e Ujit”;

Nga auditimi rezultoi se:

- U konstatua se nga ana e subjektit, nuk janë të familjarizuar me VKM nr. 379, datë 25.05.2016, UKD sh.a, nuk e zbaton në disa pika këtë VKM e cila është rregullore se si duhet të analizohet dhe trajtohet uji i pijshëm. Nga ana e Ujësjesit bëhen, 2 analiza çdo ditë për cilësinë e ujit, në verifikimin e analizave vërehet se niveli i klorifikimit është më i lartë se sa është përcaktuar në këtë VKM dhe klorifikimi bëhet vetëm në burimet kryesore siç është Fushë Kuqja, Fushë Kruja dhe Çërma (Depo e Ujit Arapaj).
- Duke u bazuar në VKM nr.379, datë 25.05.2016, për miratimin e rregullores “Cilësia e Ujit të Pijshëm” do të kryhet auditimi mbi cilësinë e ujit që UKD sh.a furnizon qytetarët. Qëllimi i kësaj rregullore është që të përcaktojë kërkesat e cilësisë së ujit të pijshëm, me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik nga efektet negative të ndotjes së tij, duke siguruar që uji është i



- shëndetshëm dhe i pastër. Referuar nenit 2, pika 1 të kësaj rregullore, ujë i pijshëm konsiderohet ujë i përcaktuar për përdorim nga njerëzit të trajtuara ose të patrajuara, për qëllim pirjeje, gatimi, përgatitje të ushqimeve dhe për nevojat e higjenës, pamvarësisht origjinës së tyre dhe nëse janë furnizuar nga një rrjet publik ose privat, prej depozitave, prej autoboteve, prej puseve individuale apo kolektive, apo të ambalazhuar në shishe ose në enë.
- Me shkresën nr. 1262 Prot., datë 20.03.2018, UKD sh.a raporton mbi analizat laboratorike për periudhën **Tetor 2017- Shkurt 2018**. Në këtë raport thuhet qartë se sasia mesatare e klorit të lirë nëpër lagjet e qytetit ka qënë mesatarisht rreth **0.30-0.50 mg/l**, gjithashtu sasia e klorit të lirë të ujit që vjen nga stacioni i pompimit të Fushë Kuqës ka ndryshuar në vlerat **0.8-1.15 mg/l**. Janë marrë mostra edhe në depot e qytetit për të monitoruar klorin e lirë dhe ka rezultuar që ka qënë në vlerat e lejuara nga **OBSH**. Në këtë raport thuhet se ka pasur probleme me ujin e pijshëm në disa lagje në qytetin e Durrësit. Nga verifikimi i analizave për periudhën **20.02.2017** deri me datë **24.02.2017** u konstatua se: sasia e klorit të lirë për këtë periudhë kohe ka qënë më e ulëta **0.8 mg/l** dhe më e larta **1.12 mg/l** mostra e ujit e marrë për tu analizuar ka qënë në Ujësjellës Kanalizime Durrës. Si përfundim, për këtë periudhë kohe uji në qytetin e Durrësit ka qënë me sasi të lartë të klorit të lirë dhe jashtë çdo standardi pasi standardi i klorit të lirë është **0.5 mg/l**. Nga verifikimi u konstatua se qytetarët e Durrësit nuk janë njoftuar për këtë periudhë kohore që uji ka qënë i pa konsumueshëm. Gjithashtu, u kontrolluan dhe analizat e ujit për periudhën **01.12.2017** deri me datë **06.12.2017** u konstatua se: sasia e klorit të lirë për këtë periudhë kohe ka qënë më e ulëta **0.80 mg/l** dhe më e larta **0.96 mg/l** mostra e ujit e marrë për tu analizuar ka qënë në Ujësjellës Kanalizime Durrës. U morën për verifikim dhe disa analiza të vitit 2018 dhe u konstatua se sasia e klorit të lirë është **0.90 mg/l**, si përfundim, sasia e klorit të lirë është përsëri e lartë dhe jashtë çdo standarti. UKD sh.a është gjobitur nga Inspektoriat i Shtetëror Shëndetësor me vendimin nr. 19 datë 22.09.2017 në vlerën 580.000 lekë pasi është konstatuar shkelje për klorifikimin e ujit në Depon 1 dhe Depon 2. UKD e ka ankimuar pranë ISHSH por ISHSH ka lënë në fuqi vendimin e mëparshëm.
 - Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se analizat për klorin e lirë bëhen në stacionin e Fushë Kuqes, stacionin e Fushë Krujës, depo nr. 1 Vila e Zogut, depot Nish Tulla vjetër, dhe depo nr. 4 Arapaj. Për depot e tjera që UKD sh.a ka në përdorim për furnizimin me ujë të pijshëm të qytetarëve, të cilat ndodhën në fshatra ose në periferi të qytetit të Durrësit nuk kryhet asnjë analizë mbi sasinë e klorit të lire në ujin e pijshëm. Për më teper dhe në depot e lartpërmendura sasia e klorit të lirë është mbi normat e lejuara sipas **VKM nr.379, datë 25.05.2016, për "Cilësinë e Ujit të Pijshëm"**.
 - Nga ana e UKD sh.a është kontraktuar kompania **S**. për kryerjen e analizave të ujit të pijshëm në Fushë Kuqe, dhe nga raporti i nxjerrë nga kjo kompani janë bërë në total **74** analiza, nga të cilat për 63 analiza kompania nuk është e akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit. Nga 11 analiza që kjo kompani është e akredituar 5 prej tyre janë jashtë standarteve dhe 6 analiza janë brënda parametrave që janë të cilësuara në **VKM nr.379, datë 25.05.2016, për "Cilësinë e Ujit të Pijshëm"**. Nga këto 11 analiza që kompania është e akredituar për kryerjen e analizave është edhe sasia për kloruret, e cila rezulton sipas analizës të jetë 14,19 mg/l në burimin e Fushë Kuqës, gjë e cila mund të kthehet në rrezik për ujin e pijshëm në këtë burim. Gjithashtu sasia e klorit të lirë si përfundim në burim është jashtë standarti pasi mesatarja e klorit të lirë të analizuar është **1 mg/l**.



- Nga verifikimi në terren me përzgjedhje të disa depove të ujit më specifiku Depo uji nr.1 (Vila e Zogut), Depo uji Arapaj dhe Depo uji Jubë. Në të treja depot e ujit mungonte prania e rojeve të armatosura dhe në depo ndodheshin vetem manovruesit, gjithashtu kushtet higjienike të këtyre depove ishin jashtë standartit. Gjithashtu UKD sh.a nuk ka asnjë procesverbal të pastrimit të depove, dhe nuk provohet me dokumentacion që këto depo ujit janë pastruar sistematikisht.
- Gjithashtu gjatë verifikimit në terren në një rast më specifiku në depon e ujit Jubë u konstatua se depo e ujit është shumë afer me dy antena të telefonisë celulare duke mos zbatuar perimetrin e sigurisë së depos e caktuar në VKM, dhe rrezatimi i këtyre antenave është shumë i dëmshëm për cilësinë e ujit që shpërndahet për banorët. Në këtë depo uji u konstatua se nuk ruhet me roje të armatosur 24 orë siç është e parashikuar në VKM nr. 379, datë 25.05.2016, gjithashtu rrethimi i depos nuk është bërë sipas standarteve të kërkuara por rrethimi është me rrethim me material tel dhe oborri i depos është i aksesueshëm nga kushdo pa asnjë pengesë. Gjatë verifikimit u konstatua se depo Jubë në pjesën e tarracës së saj ndodhet një objekt privat më specifiku antenë interneti nga ana e UKD sh.a nuk justifikohet me asnjë dokumentacion ligjor prania e këtij objekti mbi një objekt të rëndësishëm së veçantë siç janë depot e ujit.
- UKD sh.a ka detyrimin ligjor të ngrrej grupin e punës për verifikimin e objektit dhe për të gjithë kohën që ushtron aktivitetin kompania që ka vëndosur antenat brënda territorit të Ujësjiellës Kanalizime Durrës. Të merrën të gjitha masat e nevojshme ndaj subjektit që ushtron aktivitetin dhe nga ana e UKD sh.a të raportohet pranë KLSH-së brënda afatit të observacioneve për hapat e ndjekur për këtë objekt. Në rast të moszbatimit do të ngarkohet me përgjegjësi administratori i UKD sh.a.

Argumenta dhe shpjegime nga subjekti i audituar për akt konstatimin:

Në observacionin e dërguar me shkresën nr. 56/9 prot., datë 10.01.2019, protokolluar pranë UKD sh.a, nga I. D., G. D. dhe L. L. në lidhje me akt-konstatimin nr. 9, datë 28.12.2018, në të cilin citohet se:

1- “...Laboratori i ujit të pijshëm pranë UKD....duke përbërë edhe për ndotje bakteriale.....Në mostrat e marra pranë UKD...do të jetë gjithmonë i pastër për komunitetin....”;

2- “...Gjatë verifikimeve në terren....masat për njoftimin e subjektit....me shkresën nr.24 Prot., dt. 07.01.2019 drejtuar përgjegjësit të repartit Shijak....”;

Sqarime nga grupi i auditimit të KLSH-së për akt konstatimin:

-Lidhur me pretendimin e parë, sqarojmë se nuk merret në konsideratë pasi keni sjellë argumenta dhe dokumenta ligjorë të cilat janë kontrolluar nga ana e audituesve gjatë auditimit të ushtruar pranë UKD sh.a. Gjithashtu theksojmë që nuk keni paraqitur asnjë dokumentacion ligjorë përsa i përket 2 pikave të trajtuara në akt konstatimin nr. 9 që janë: mos prezenca e rojeve në depot e ujit dhe për kushtet higjienike që ndodhen depot e kontrolluara në terren, të pasqyruara edhe ne akt konstatim me pamje vizive.



-Lidhur me pretendimin e dytë, sqarojmë se do të merret në konsideratë pjesërisht pasi keni paraqitur shkresën me nr. 24 Prot., datë 07.01.2019 me anë të cilës të vertetohet që është lënë detyrë repartit të Shijakut për zhvendosjen e antenës. Përsa i përket përfundimit të procedurës së zhvendosjes të raportohet pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit në momentin e takimit përmbyllës në KLSH.

Observacioni i dërguar për projekt raportin nr. 417 prot., datë 21.02.2019 nuk qëndron dhe si i tillë, nuk merret në konsideratë, pasi nuk gjendet i bazuar në ligj.

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi:

Shoqëria nuk ka një strategji të miratuar nga titullari, e cila përditësohet çdo 3 vjet, ose një herë në vit kur ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Gjithashtu konstatohet se, UKD SHA, nuk ka një regjistër risku, nuk është ngritur grupi i menaxhimit strategjik, si dhe nuk është caktuar koordinatori i riskut, veprime këto në kundërshtim me nenin 8 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 130-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi:

Administratori i shoqërisë UKD SHA, të marrë masa për hartimin e regjistrit të riskut, caktimin e koordinatorit të riskut, si dhe ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik, sipas përcaktimeve të mësipërme ligjore.

Menjëherë dhe në vijueshmëri

2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i ushtruar në UKD SHA u konstatua se, shoqëria nuk ka dërguar në Ministrinë e Financave, Deklaratën e Cilësisë dhe Raportin e Kontrollit të Brendshëm, brenda muajit prill të vitit pasardhës, veprim në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 130-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi:

Administratori i UKD SHA, të marrë masat për dorëzimin në kohë në Ministrinë e Financave, Deklaratën e Cilësisë dhe Raportin e Kontrollit të Brendshëm, me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit në shoqëri.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se shoqëria nuk ka përcaktuar sistem për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumentave, formate të unifikuara deri në arkivim, në mënyrë që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin, duke përfshirë edhe afatet për përgjigje. Në rregulloren aktuale të brendshme të shoqërisë, nuk përcaktohet mënyra e komunikimit të informacionit të shkruar/elektronik/verbal. Veprime në kundërshtim me ligjin 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 130-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi:



Administratori i UKD SHA të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e një procedure për informacionin e komunikimin vertikal dhe horizontal në shoqëri, ku të specifikohen qartë detyrat dhe përgjegjësitë e çdo punonjësi që harton, merr apo shpërndan informacion të shoqërisë.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i ushtruar në UKD SHA, u konstatua se, shoqëria nuk ka të publikuara në faqen zyrtare të saj, njoftimet për mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, vendimet e marra prej saj, si dhe regjistrin e aksionerëve, veprime në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 pika 5 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 27-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi:

UKD SHA, të marrë masa për publikimin e çdo njoftimi dhe vendimi të Asamblesë së Përgjithshme, si dhe regjistrin e aksionerëve në faqen zyrtare të shoqërisë me qëllim rritjen e transparencës mbi aktivitetin e shoqërisë.

Menjëherë dhe në vazhdim

5. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të programit ekonomik të shoqërisë u konstatua se, Këshilli i Administrimit me vendim nr. 26/1 datë 18.12.2017 ka ndryshuar planin ekonomik financiar, duke rialokuar fondet në një vlerë prej 1,452,361.03 lekë, pa miratim të Asamblesë së Përgjithshme, veprim në kundërshtim të VKM nr. 63, neni 7, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 27-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi:

UKD SHA, në vijimësi të marrë masa për miratimin e ndryshimeve të planit ekonomik financiar në Këshillin e Administrimit dhe Asamblesë së Përgjithshme, duke i argumentuar në mënyrë sa më të plotë nevojat e shoqërisë për këto ndryshime.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi:

Shoqëria nuk disponon një procedurë të përcaktuar për rekrutimin e punonjësve, si edhe nuk ka gjurmë në asnjë rast në burimet njerëzore, për nevojat e sektorëve apo drejtorive. Nuk ka gjurmë për shpalljen e vendeve vakante dhe intervistimin ose testimin e kandidatëve, deri në përzgjedhjen e tyre.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 38-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi:

Nga Këshilli Administrativ dhe Administratori i Shoqërisë, të hartohet procedura e përcaktimit të kritereve të punësimit, sipas pozicionit të vendeve të punës dhe të merren masa për zbatimin korrekt në rekrutimin e punonjësve, me qëllim bërjen sa më transparent dhe në bazë të aftësive profesionale të këtij procesi.

Menjëherë dhe në vazhdim

7. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i ushtruar në UKD SHA, u konstatua se, nenet 11 dhe 13 të kontratave kolektive të punës, kanë mospërputhje me nenin 83 të Kodit të Punës, për sa i përket kohëzgjatjes javore në punë, si dhe ditëve pushim në muaj.



Në 79 raste për periudhën objekt auditimi, u konstatua se punonjësit kanë kryer orë jashtë kohës normale të punës, konkretisht:

- 16 punonjës qëndrojnë në punë nga 30 ditë në muaj, me 8 orë punë në ditë.
- 41 punonjës punojnë 24 ditë pa asnjë ditë pushim.
- 9 punonjës punojnë nga 48 orë çdo javë.
- 13 punonjës kryejnë 27 ditë punë nga 8 orë çdo ditë.

Për sa më sipër mban përgjegjësi Drejtori i burimeve njerëzore.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 38-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi:

- Administratori i UKD SHA dhe Drejtori i Burimeve Njerëzore, të analizojnë të gjitha rastet e konstatuara nga grupi i auditimit, për periudhën objekt auditimi, si dhe të marrë masat përkatëse, duke vepruar konform parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Administratori i shoqërisë të marrë masat për ndryshimin e neneve të kontratës kolektive të punës, të cilat bien ndesh me përcaktimet e bëra në Kodin e Punës.

Menjëherë dhe në vazhdim

8. Gjetje nga auditimi:

-Gjatë auditimit u konstatua se UKD SHA, nuk respekton sasi të lejuara të çdo elementi që duhet analizuar, sipas shtojcës I të VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Cilësia e ujit të pijshëm”. Nga fletë analizat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se, në disa zona sasia e klorit të lirë në ujin e pijshëm është në nivele më të larta se sasia e lejuar, si dhe në disa zona të tjera, elementi i klorit të lirë nuk është i pranishëm. Gjithashtu, konstatohet se në vitin 2017, UKD SHA, është gjobitur nga ana e ISHSH për sasinë e klorit të përdorur në Depo 1 dhe Depo 2, në vlerën prej 580,000 lekë.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 144-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi:

UKD SHA, të marrë masa të menjëhershme për zbatimin e kriterëve të përcaktuara në shtojcën I të VKM nr. 379 Prot, datë 25.05.2016, për standartizimin e cilësisë së ujit të pijshëm, me qëllim sigurinë e shëndetit publik në qytetin e Durrësit.

Menjëherë dhe në vazhdim

9. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i mëparshëm i ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Ujësjiellës Kanalizime Durrës, janë lënë për zbatim gjithsej 66 masa. Më poshtë trajtohen të përmbledhura masat sipas llojit, si dhe statusi i zbatimit të tyre:

A. Në lidhje me “Masa organizative”, nga 41 masa të rekomanduara, 9 masa janë realizuar, 16 masa janë në proces zbatimi, 9 masa janë realizuar pjesërisht dhe 7 masa nuk janë zbatuar.

B. Në lidhje me “Masa shpërbllim dëmi”, nga 2 masa të rekomanduara në vlerën totale prej 266,221 lekë, 450 USD dhe 711 Euro, rezulton se asnjë masë nuk është zbatuar.

C. Në lidhje me “Masa disiplinore”, nga 23 masa të rekomanduara, rezulton se janë zbatuar 23.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 5-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi:

Punonjësit e ngarkuar me urdhrin nr. 2109/2 prot, datë 07.08.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të UKD SHA për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, të marrin masa për zbatimin e rekomandimeve, që kanë rezultuar të pazbatuara dhe në proces, si dhe të kërkojnë në rrugë administrative duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerave me pasojë financiare për shoqërinë.

**Menjëherë dhe në vazhdim****10. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi u konstatua se, shlyerjet e detyrimeve ndaj operatorëve ekonomik nuk kryhen sipas parimit FIFO (first in first out), duke krijuar seleksionim preferencial. Në disa raste shlyerjet bëhen brenda ditës, dhe në disa raste të tjera shlyerjet arrijnë edhe 4 vite më vonë. Një situatë e tillë në kushtet kur operatorët nuk trajtohen në mënyrë të barabartë, sjell jo vetëm diskriminim ndaj këtyre operatorëve, por njëkohësisht mbart risk ekonomik. Në kushtet e pagesës të kontratave të lidhura nga ana e UKD është e shprehur qartë se: *“Pagesa për mallrat/shërbimet do të bëhet brenda 12 muajve duke filluar nga data e lidhjes së kontratës”*. Gjithashtu në kontratë është shprehur në mënyrë eksplicite se: *“Dëmet e llogaritura, të shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë, konsistojnë në kamatën që fillon nga data e vonesës së debitorit (Autoritetit Kontraktues), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamatës parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti, interesi i maturuar i shtohet shumës totale, mbi të cilën është llogaritur interesi i maturuar. Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (kontraktuesin) të provojë ndonjë dëm. Në se kreditori (kontraktuesi) provon se ka pësuar një dëm më të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktues) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit”*.

Për këtë mbajnë përgjegjësi të gjithë punonjësit e sektorit të financës që janë pjesë e praktikave të kryerjes së pagesave, si dhe personat autorizues të pagesave.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 118-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: Në vazhdimësi, UKD SHA, të ndjekë parimin FIFO në likuidimin e detyrimeve ndaj operatorëve ekonomik, duke shmangur riskun e krijimit të situatave me pasojë dëm ekonomik për shoqërinë, të ardhura si pasojë e mosrespektimit të afateve të pagesës.

Menjëherë dhe në vazhdim**11. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore në 27 raste të procedurave të prokurimeve e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, u konstatua se:

-Nuk janë kryer trajnime të stafit për prokurimin publik, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 83/2.

-Në 14 raste, nuk konstatohet të jetë argumentuar dhe dokumentuar vendosja e kriterëve për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

- Në 12 raste, nga njësia e prokurimit janë vendosur kriterë për kualifikim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20 dhe neni 46.

- Në 4 raste, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 53, pika 3.

- Në 13 raste, zbatimi i kontratave për mallra, shërbime dhe punë, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1.

-Në 3 raste, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, në dosjen e procedurave të prokurimit, nuk u gjetën deklaratat e konfliktit të interesit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 64, pika 2.

- Në 4 raste, në kundërshtim me nenin 68 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në kushtet kur në raportin përmbledhës mungojnë të dhëna kryesore si, referenca e procedurës së prokurimit dhe përshkrimin e



punëve/mallrave/shërbimeve, titullari i autorizuar AK, bazuar në dispozitën e sipërcituar nënligjore, në kushtet e mungesës së elementëve thelbësorë të sipërpërmendur, nuk duhej të kishte bërë miratimin e këtij raporti përmbledhës (në fuqi në kohën e kryerjes së procedurës).

-Në 14 raste, procedurat e përfunduara nuk ishin të inventarizuara dhe të arkivuara, në kundërshtim me nenin 42 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

- Në 3 raste, kontrata me operatorët ekonomikë fitues, nuk është lidhur me bashkimin e operatorëve ekonomikë që është shpallur fitues, por vetëm me kryesuesin e bashkimit të shoqërive, në kundërshtim me nenin 74 pika 2 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

- Në 3 raste, kontratat e nënshkruara sipas dispozitave të prokurimit publik, janë lidhur për vlerën fituese pa TVSH, në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 72-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi:

Për rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike në përputhje me nenin 53/3 të LPP, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përbalueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj. Titullari i AK të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, miratimit të raporteve përmbledhëse, në përputhje me frymën së Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Vazhdimisht

12. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i rregjistrimit të realizimit të procedurave me vlera të vogla u konstatua se, për vitin 2017, në 3 raste janë kryer blerje të mallrave dhe pajisjeve hidraulike me vlerë totale mbi 800,000 lekë pa TVSH, duke copëzuar fondin, veprim në kundërshtim me Nenin 28, pika 2 të ligjit 9643 datë 20.11.2016, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku citohet: “*Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj*”. Për këtë mban përgjegjësi Komisioni i Prokurimit të blerjeve të vogla për periudhën objekt auditimi.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 118-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi:

Nga Titullari i UKD të analizohet situata e krijuar në lidhje me zhvillimin e procedurave nën vlerën 800,000 lekë, pasi në rastin e blerje të mallrave dhe pajisjeve hidraulike ato e kanë kaluar në total këtë vlerë në vitin 2017. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren masa në të ardhmen për zhvillimin e kësaj procedure në kufijtë e përcaktuar ligjor.

Menjëherë dhe në vazhdim

13. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumentacionit bashkëlidhur procedurave me vlera të vogla janë konstatuar disa mangësi të përgjithshme:

- Deklaratat e lëshuara nga punonjësi i magazinës në lidhje me gjendjen e magazinës për mallin e kërkuar janë pa datë, ç’ka nuk vërteton plotësisht mungesën e këtyre mallrave në kohën kur kërkohen.



- Ofertat ekonomike të marra nga operatorë ekonomikë për përlogaritjen e fondit limit janë pa datë, duke krijuar një rezervë mbi saktësinë e vlerave për datën në të cilën kërkohet ajo.

- Kërkesa për materiale e cila kryhet nga punonjësit në rast të lindjes së nevojës është pa datë, duke krijuar po ashtu të njëjtin risk të trajtuar më sipër.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 36.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 118-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandimi:

Në vazhdimësi, të tregohet kujdes i veçantë në dokumentacionin justifikues të blerjeve me vlera të vogla, me qëllim dhënien e një sigurie të arsyeshme për përdorimin me korrektësi dhe besueshmëri të fondeve (mjeteve financiare) për blerjet e vogla.

Menjëherë dhe në vazhdim

14. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi me zgjedhje i rregullshmërisë së konsumit të karburantit u konstatuan problematikat e mëposhtme:

- Në procesvralin nr. 54/2 prot, datë 28.07.2017 nga komisioni i verifikimit të konsumit të karburantit mjeteve, nuk është trajtuar me detaje procedura e ndjekur duke mos dhënë siguri të arsyeshme mbi vërtetësinë e normave të harxhimit.

- Në fletëudhëtimet e mbajtura nga drejtuesit e mjeteve të cilat nuk kanë GPS, u konstatuan mjaft raste ku lëvizjet firmosen jo nga personi i cili ka kryer lëvizjen nëpërmjet urdhër shërbimeve, por nga drejtuesit e mjeteve të tjera, madje edhe në disa ditë të cilat rezultojnë se kanë drejtuar njëkohësisht mjet tjetër. Në këtë mënyrë grupi i auditimit e vlerëson mbajtjen e fletëudhëtimeve të parregullt, duke mos dhënë siguri mbi përdorimin e duhur të mjeteve të shoqërisë UKD.

- Udhëtimet e punonjësve nuk janë të shoqëruara në pjesën më të madhe me urdhëra pune nga titullari apo persona të autorizuar prej tij.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi E. E., në cilësinë e personitë ngarkuar për mbikëqyrjen e harxhimit të karburantit.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 118-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 Rekomandimi:

Nga Titullari i UKD të analizohet situata e krijuar dhe të evidentohen përgjegjësitë, si dhe në vijimësi të merren masa për kontrollin e duhur të konsumit të karburantit, duke vlerësuar dhe trajtuar me korrektësi dokumentacionin justifikues, me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme se karburanti po administrohet konform dispozitave ligjore.

Menjëherë dhe në vazhdim

15. Gjetje nga auditimi:

Nga grupi i auditimit u verifikua dokumentacioni shkresor i paraqitur në lidhje me inventarizimin vjetor të aktiveve të shoqërisë. Në përfundim të këtij procesi është mbajtur një relacion përmbledhës nga ana e personit përgjegjës R. B. në cilësinë e Kontabilistes së AAGJ dhe Inventarizimit. Në fund të këtij relacioni është cituar: “*Gjatë procedurës grupet e punës evidentuan: 1. Aktive të reja të cilat i kanë pasqyruar në fletët përkatëse të Inventarit; 2. Probleme me vendndodhjen e materialeve; 3. Probleme me emërtimin e aktiveve; 4. Probleme me nxjerrjen jashtë përdorimit të pajisjeve të zyrës*”. Për këto përfundime nuk është bërë asnjë analizë, si dhe nuk shpjegohen në mënyrë të detajuar fenomenet e vërejtura, arsyet apo edhe përgjegjësitë për to.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 55-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1 Rekomandimi:



Nga Titullari i UKD të ngrihet një grup pune me specialistë, për të shqyrtuar problematikat e konstatuara nga R. B. në cilësinë e Kontabilistes së AAGJ dhe Inventarizimit, në lidhje me inventarizimin e vitit 2017, duke i trajtuar ato të detajuara, si dhe të mbahen në konsideratë për të ardhmen.

Menjëherë dhe në vazhdim

16. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i debitorëve të shoqërisë u konstatua se gjatë viteve përpara periudhës objekt auditimi (UKD e ka të pamundur të përcaktojë saktësisht periudhën) shoqëria ka shpallur si debitorë individë të cilët nuk kanë patur asnjëherë lidhje me tubacionet e ujit të pijshëm apo kanë lidhje me tubacionet e ujit të pijshëm, por nuk kanë patur asnjëherë furnizim me ujë në banesat e tyre. Kjo situatë vjen si pasojë e regjistrimit të pasaktë të abonentëve nga ana e faturistëve, pa shkuar nëpër banesa dhe pa i njoftuar abonentët për këtë.

Këto raste janë faturuar për një periudhë të gjatë kohore, madje një pjesë vijojnë të faturohen, duke krijuar detyrime të pritshme për shoqërinë, pa dijeninë e personave të interesuar, e për pasojë janë regjistruar fillimisht në aktivet e shoqërisë si të drejta të arkëtueshme, e më vonë pasi është zbuluar si problematikë, Asambleja e Përgjithshme me vendimin nr. 4/3, datë 27.12.2017 ka ngrirë detyrimin e rasteve të evidentuara në shumën 39,239,693 lekë, duke u provigjonuar në bilancin e shoqërisë.

Grupi i auditimit verifikoi në terren me zgjedhje të rastësishme 6 raste debitorësh, dhe konstatoi se atje vijon dërgimi i faturave në mungesë të furnizimit me ujë. Për pasojë, vlera e ngrirë nga Asambleja e Përgjithshme, edhe pse grupi i auditimit e vlerëson si vendim që nuk i jep zgjidhje përfundimtare situatës, me shumë gjasa nuk përputhet me vlerën reale të debive të krijuara nga vitet e kaluara.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 55-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1 Rekomandim:

Këshilli i Administrimit të marrë masat e nevojshme për dhënien e një zgjidhjeje përfundimtare në lidhje me situatën e krijuar me debitorët e shoqërisë.

Gjithashtu, nisur nga verifikimi në terren i grupit të auditimit, nga ku rezulton se situata me debitorët vazhdon të mos jetë e qartë si në shifra ashtu edhe fizikisht, të merren masat e nevojshme për zbullimin dhe reflektimin e të gjitha rasteve të ngjashme.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi:

UKD SHA nuk disponon një regjistër aktivesh përpara vitit 2017. Vlera e aktiveve afatgjata, saktësisht kategoritë e ndërtesave dhe trojeve janë të shënuara si numër aktivesh dhe si vlerë totale, dhe jo të ndara me artikuj. Gjatë viteve, për këto janë kryer rivlerësime në grup për të gjithë klasën, dhe jo për secilin artikull. Kjo problematikë ka ardhur gjithashtu edhe si pasojë e mungesës së çertifikatës së pronësisë për të gjitha këto aktive. Pra, aktualisht shoqëria nuk ka të saktësuar se cilat janë të gjitha aktivet e saj konkretisht, si dhe cila është vlera e secilës prej tyre, veprime në kundërshtim me standardet e kontabilitetit.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 55-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1 Rekomandim:

Administratori i shoqërisë të marrë të gjitha masat e nevojshme duke ngritur grupe pune me specialistë të fushës për krijimin e regjistrimit të aktiveve dhe ndarjen e tyre në artikuj të veçantë.

Menjëherë dhe në vazhdim

18. Gjetje nga auditimi:



Ujësjetllës Kanalizime SHA, Durrës ka përfitur shërbim ndaj Albtelecom dhe Telekom respektivisht për përdorimin e telefonave fiks dhe celular. Për periudhën objekt auditimi, UKD ka paguar vlerën totale 305,205lekë për Albtelecom dhe 4,924,799 lekë për Telekom. Nga auditimi u konstatua se, për këtë shërbim nuk është zhvilluar asnjë procedurë prokurimi, për më tepër nuk ka kontratë të lidhur ndërmjet palëve, në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Nëse për Albtelekom ky shërbim është i mbartur prej kohës kur ka qënë organ shtetëror, e njëjta situatë nuk paraqitet për Telekom. Pagesa për këto shërbime kryhet vetëm me dorëzimin e faturave mujore nga operatorët ekonomik të sipërcituar.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 118-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1 Rekomandimi:

Nga UKD SHA, të merren masa për pezullimin e shërbimeve të cilat janë objekt i Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, por nuk janë përfitur nëpërmjet zhvillimit të procedurave standarte të prokurimit.

Menjëherë dhe në vazhdim

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “*Blerje materiale hidraulike*”, viti 2018, me datë zhvillimi tenderi 16.04.2018, sipas Urdhërit të Prokurimit të titullarit të autoritetit kontraktor Nr. 799/4 Prot., datë 05.03.2018, është konstatuar se, **vlera prej 161,467 lekë përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të UKD SHA**. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos mbajtjes së penalteteve, si pasojë e dorëzimit të mallit me 10 ditë vonesë, në kundërshtim kjo me nenet 59, 60 të të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe dokumentet e tenderit dhe kushtet e kontratës, ku personat përgjegjës janë grupi i marrjes së mallit në dorëzim, operatori ekonomik, si dhe drejtorja e financës.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 72-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandimi:

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës prej 161,467 lekë**, përkatësisht nga shoqëria “P. I.” sh.p.k. si rrjedhojë e dorëzimit të mallit me 10 ditë vonesë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Ndërtim i rrjetit të ri në lagjen Gramsh, Njësia Adm. Rrashbull, Bashkia Durrës”, sipas kontratës së lidhur nr. 1300 prot., datë 06.06.2017, me numër reference 855/4-04-04-2017, me vlerë 11,723,040 lekë pa TVSH, 14,067,648 lekë me TVSH, është konstatuar se, **vlera prej 528,320 lekë përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të UKD SHA**. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos mbajtjes së penalteteve, si pasojë e mos përfundimit të punimeve sipas kushteve të kontratës, në kundërshtim kjo me nenet 59, 60 të të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe dokumentet e tenderit dhe kushtet e kontratës, ku personat përgjegjës janë mbikqyrësi i punimeve dhe grupi i punës së ndjekjes së kontratës.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 72-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës prej 528,320 lekë**, përkatësisht nga shoqëria “L. VII” sh.p.k. si rrjedhojë e mos përfundimit të punimeve sipas kushteve të kontratës.

Menjëherë**3. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje pajisje kompjuterike dhe informatike”, datë zhvillimi tenderi 16.06.2017, sipas Urdhërit të Prokurimit të titullarit të autoritetit kontraktor Nr. 960/11 Prot., datë 08.05.2017, është konstatuar se, **vlera prej 1,567,691 lekë përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të UKD SHA**. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat, për mos dorëzim të mallit sipas kushteve të kontratës së rënë dakort midis palëve, në kundërshtim kjo me nenin 59,60 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe dokumentet e tenderit dhe kushtet e kontratës, ku personat përgjegjës janë grupi i marrjes së mallit në dorëzim.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 72-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandimi:

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës prej 1,567,691 lekë**, përkatësisht nga shoqëria “S.&T. A.” sh.p.k., si rrjedhojë e mos dorëzimit të mallit sipas kushteve të kontratës së rënë dakort midis palëve.

Menjëherë**4. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje materiale kancelarie dhe të ngjashme”, datë zhvillimi tenderi 26.03.2018, sipas Urdhërit të Prokurimit të titullarit të autoritetit kontraktor Nr. 200/5 Prot., datë 01.03.2018, është konstatuar se, **vlera prej 773,760 lekë përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të UKD SHA**. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat, për mos dorëzim të mallit sipas kushteve të kontratës së rënë dakort midis palëve, në kundërshtim kjo me nenin 59,60 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe dokumentet e tenderit dhe kushtet e kontratës, ku personat përgjegjës janë grupi i marrjes së mallit në dorëzim.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 72-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandimi:

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës prej 773,760 lekë**, përkatësisht nga shoqëria “I. O.” sh.p.k. si rrjedhojë e mos dorëzimit të mallit sipas kushteve të kontratës së rënë dakort midis palëve.

Menjëherë**5. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje pjesë këmbimi për automjete, 2017”, datë zhvillimi tenderi 16.04.2018, sipas kontratës së lidhur nr. 727 prot., datë 31.03.2017, me numër reference 40/4-20-01-2017, me vlerë 16,678,464 lekë me TVSH është konstatuar se, **vlera prej 2,502,000 lekë përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të kompanisë UKD SHA**. Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i një shpenzimi të paligjshëm, për një mall i cili nuk provon dhe dokumenton se plotëson specifikimet teknike, si dhe nuk provohet se është konform dokumentacionit, për të cilat kjo shoqëri është kualifikuar dhe shpallur fituese, ku personat përgjegjës janë të gjithë anëtarët e grupit të cilët kanë marrë mallin në dorëzim.



(Trajtuar më hollësisht në faqet 72-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandimi:

Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës prej 2,502,000 lekë**, përkatësisht nga shoqëria “S. & C. C.” sh.p.k. si rrjedhojë e marrjes së një malli në dorëzim, i cili nuk vërteton dhe provon se është konform specifikimeve teknike të kërkuara.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se, në datën 06.02.2017 është paguar vlera 18,900 lekë në favor të “A. M. G.”, për shërbimin rregullimit të mjetit tip Ford me targa AA439LP, faturuar me nr. 494 datë 06.02.2017. Në relacionin me nr. 298 prot, datë 06.02.2017 bashkëlidhur pagesës me objekt “Procesverbal konstatimi” të mbajtur nga grupi i punës i përbërë nga I. K., I. K., R. Ç. dhe E. Sh., ndër të tjera sqarohet se, ky defekt nuk ka ardhur si shkak i përplasjes, keqpërdorimit apo mbingarkesës së mjetit. Por, referuar dokumentacionit të bankës, rezulton se ky shërbim është paguar, edhe pse mjeti (referuar relacionit) është brenda periudhës së garancisë. Për pasojë, **vlera 18,900 lekë** e paguar për rregullimin e mjetit është përfituar në mënyrë të padrejtë nga “A. M. G.” dhe **përbën dëm ekonomik** ndaj UKD SHA.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 118-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandim: Të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës 18,900 lekë nga “A. M. G.”. Kjo vlerë është përfituar në mënyrë të padrejtë nga ky operator ekonomik, pasi automjeti është brenda periudhës së garancisë dhe defekti nuk ka ardhur si shkak i përplasjes, keqpërdorimit apo mbingarkesës së mjetit.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i praktikave të veprimeve me bankë u konstatua se, në datën 12.03.2018 është kryer pagesa prej 498,928 lekë në favor të Drejtorisë Rajonale të Transportit Rrugor për likuidim të taksës vjetore të qarkullimit për mjetet e UKD SHA. Pjesë e pagesës është edhe vlera 23,000 lekë si gjobë e marrë nga automjetet për shkelje rrugore. Për këto gjoba nga ana e titullarit nuk është marrë asnjë masë. Vlera **23,000 lekë përbën dëmekonomik** për UKD SHA.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 118-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandimi: Nga Titullari i UKD SHA, të analizohet vlera **23,000 lekë** e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë, si dhe të evidentojë përgjegjësitë individuale në rastet e konstatuara.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje pjesë këmbimi dhe vegla pune”, sipas kontratës së lidhur me OE “M. K. shpk”, me nr. 840 prot, datë 30.04.2015 konstatohet se, operatori ekonomik e ka dorëzuar mallin e prokuruar me dy pjesë. Pjesa e parë me vlerë totale prej 15,873,309 lekë është dorëzuar në datën 30.05.2015, ndërsa pjesa e dytë me vlerë 30,566,690 lekë është dorëzuar në datën 30.06.2015, pra pjesa e dytë rezulton të jetë dorëzuar 61 ditë pas lidhjes së kontratës, duke shkaktuar **një dëm ekonomik në vlerën prej 126,267 lekë** si rezultat i mosmbajtjes së penalteteve, për dorëzimin e mallit me vonesë.

Për mosmbajtjen e penaltetit ndaj OE “M. K. shpk” mban përgjegjësi grupi i punës i përbërë nga G.D, I. K. dhe B. M..

(Trajtuar më hollësisht në faqet 118-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandimi: Të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës **126,267 lekë** nga operatori ekonomik “M. K. shpk”. Kjo vlerë është përfituar në



mënyrë të padrejtë nga ky operator ekonomik, pasi nuk ka zbatuar afatin maksimal të realizimit të kontratës.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rehabilitim i rrjetit të ujësjellësit L18” sipas kontratës me nr. 9285 prot, datë 30.12.2015, me vlerë 8,236,972 lekë pa TVSH, rezulton se punimet kanë përfunduar 10 ditë më vonë se afati maksimal i parashikuar në kontratë, si dhe vlera prej **vlera 936,575 lekë përbën dëm ekonomik** për UKD SHA, si penalitet i pambajtur për moszbatimin e afateve të kontratës, dhe duhet të dëmshpërblehet nga operatori ekonomik “L. VII” SHA.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi grupi i marrjes në dorëzim i përbërë nga G.D, B. M., E. E., L.F dhe mbikqyrësi i punimeve.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 118-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandimi: Të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës **936,575 lekë** nga operatori ekonomik “L. VII” sha. Kjo vlerë është përfituar në mënyrë të padrejtë nga ky operator ekonomik, pasi nuk ka zbatuar afatin maksimal të realizimit të kontratës.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Projekt Magazina”, për kontratën e lidhur nr. 383 prot., datë 21.02.2017, me numër reference 3359/4-21-12-2016, me vlerë 6,656,263 lekë me TVSH, është **konstatuar dëm ekonomik në vlerën 4,591,310 lekë**, si rezultat i mosdokumentimit dhe argumentimit të pjesës së punës të kryer nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, të cilët janë shpallur fitues në këtë procedurë prokurimi dhe kanë nënshkruar kontratën përkatëse.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 118-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandimi

Të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës **4,591,310 lekë** nga operatori ekonomik “M. & Xh.” Sh.p.k. si rrjedhojë e mos argumentimit dhe mosdokumentimit të realizimit të punimeve sipas specifikimeve teknike dhe kushteve të kontratës së rënë dakort midis palëve.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Fond për studim projektive të investimeve”, sipas kontratës nr. 386 prot, datë 21.02.2017 konstatohet se, shërbimi është realizuar me 10 ditë me vonesë, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën prej **189,861 lekë** për UKD SHA, si pasojë e mosrealizimit në kohë të kushteve të kontratës, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga operatori ekonomik “Invictus” shpk.

Për këtë mbajnë përgjegjësi grupi i marrjes në dorëzim i përbërë nga A. Zh., L.F dhe D. Sh..

(Trajtuar më hollësisht në faqet 118-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandim: Të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës **189,861 lekë** nga operatori ekonomik “I.” shpk. Kjo vlerë është përfituar në



mënyrë të padrejtë nga ky operator ekonomik, pasi nuk ka zbatuar afatin maksimal të realizimit të kontratës.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Pastrim pusesh”, sipas kontratës me nr. 2925 prot, datë 30.10.2017 konstatohet se operatori ekonomik e ka përmbushur kontratën me 21 ditë vonesë, duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën prej **592,704 lekë për UKD SHA**, dhe duhet të dëmshpërblehet nga “AKM shpk”.

Për këtë mbajnë përgjegjësi grupi i punës të marrjes në dorëzim i përbërë nga L.F, B. M. dhe G.D.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 118-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandim: Të kërkohet në mënyrë ligjore duke ndjekur të gjitha shkallët administrative, arkëtimi i vlerës **592,704 lekë** nga operatori ekonomik “A. shpk”. Kjo vlerë është përfituar në mënyrë të padrejtë nga ky operator ekonomik pasi nuk ka zbatuar afatin maksimal të realizimit të kontratës.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatuan 3 raste të blerjeve me vlera të vogla në lidhje me objekt “Riparim Ekran PDA”, me vlerë totale 211,800 lekë, për të cilat:

-Nuk ka specifikime për defektin e shfaqur nga ekrani, për pasojë ofertat e marra konsiderohen të parregullta.

-Procesverbalet e konstatimit të defektit dhe të konstatimit të rifunksionimit të pajisjes janë pa datë dhe pa numër protokoll, për pasojë nuk merren në konsideratë.

-Nga ana e KVO për blerjet e vogla, nuk është bërë asnjë analizë në lidhje me vlerën e lartë të ofertave të marra, duke konsideruar vlerën e blerjes së pajisjes së re.

-Nuk ka asnjë relacion të riparimit të defektit, por është mjaftuar me një procesverbal pa numër protokoll dhe pa datë ku është shprehur se pajisja funksionon.

Për sa më sipër, shpenzimi për riparimin e ekraneve konsiderohet i pajustificuar dhe i paargumentuar, e për pasojë vlera **211,800 lekë përbën dëm ekonomik** për shoqërinë.

Për këtë mbajnë përgjegjësi përgjegjësi i sektorit IT S. K., specialisti i sektorit IT M. U., si dhe KVO për blerjet e vogla i përbërë nga J. V., D. B., T. S. dhe A. B..

(Trajtuar më hollësisht në faqet 118-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandim: Nga Titullari i UKD të analizohet situata e krijuar në lidhje me shpenzimet e pajustificuara dhe të paargumentuara në lidhje me “Riparimet e ekraneve PDA”, si dhe të evidentojë përgjegjësitë individuale për rastet e konstatuara.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi:



Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: **“Blerje pajisje makineri”**, për kontratën e lidhur nr. 1738 prot., datë 09.08.2018, me numër reference 66025-04-30-2018, me vlerë 19,306,000 lekë pa TVSH, 23,167,200 lekë me TVSH, **është konstatuar efekt negativ financiar në vlerën 5,560,080 lekë**, si rezultat i mosdokumentimit të gjurmës së auditimit të mallit të marrë në dorëzim, ku pasoja është shkaktuar nga autoriteti kontraktor.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 72-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandimi

Nga Administratori i shoqërisë, si dhe Këshilli i Administrimit të UKD SHA, të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike **në vlerën prej 5,560,080 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt: **“Blerje pajisje makineri”**, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: **“Rikonstrukcion sheshi në ambjentet e Impiantit të trajtimit të ujrave të ndotur”**, për kontratën e lidhur nr. 2177 prot., datë 19.10.2018, me numër reference 86466-09-19-2018, me vlerë 10,978,857 lekë pa TVSH, 13,174,628 lekë me TVSH, **është konstatuar efekt negativ financiar në vlerën 308,997 lekë**, si pasojë e mosdokumentimit të afatit të përfundimit të punimeve, sipas kushteve kontradiktore të përcaktuara në kontratën e rënë dakort midis palëve, ku pasoja është shkaktuar nga autoriteti kontraktor.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 72-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandimi

Nga Administratori i shoqërisë, si dhe Këshilli i Administrimit të UKD SHA, të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike **në vlerën prej 308,997 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt: **“Rikonstrukcion sheshi në ambjentet e Impiantit të trajtimit të ujrave të ndotur”**, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: **“Lidhja e objekteve me rrjetin e ri, Lagja Nr. 13, Durrës”**, për kontratën e lidhur nr. 1352 prot., datë 29.05.2017, me numër reference 856/4-31-03-2017, me vlerë 21,697,544 lekë pa TVSH, 26,037,053 lekë me TVSH, **është konstatuar efekt negativ financiar në vlerën 2,878,850 lekë**, si pasojë e mosdokumentimit të gjurmës së auditimit, si dhe kushteve kontradiktore të përcaktuara nga palët, në kontratën e mësipërme, ku pasoja ka ardhur nga autoriteti kontraktor.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 72-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandimi

Nga Administratori i shoqërisë, si dhe Këshilli i Administrimit të UKD SHA, të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike **në vlerën prej 2,878,850 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt: **“Lidhja e objekteve me rrjetin e**



ri, Lagja Nr. 13, Durrës”, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje pjesë këmbimi për automjete”, për kontratën e lidhur nr. 1418 prot., datë 20.06.2018, me numër reference 53859-03-06-2018, me vlerë 12,632,500 lekë pa TVSH, 15,159,000 lekë me TVSH, **është konstatuar efekt negativ financiar në vlerën 3,031,800 lekë**, si rezultat i mosargumentimit të pjesës së realizimit të zërave, nga bashkinmi i operatorëve ekonomikë, të cilët janë shpallur fitues në këtë procedurë prokurimi, ku pasoja është shkaktuar nga autoriteti kontraktor.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 72-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandimi

Nga Administratori i shoqërisë, si dhe Këshilli i Administrimit të UKD të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike **në vlerën 3,031,800 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt: “Blerje pjesë këmbimi për automjete”, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi:

Për periudhën objekt auditimi, si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme dhe në mënyrë të njëanshme, shoqëria UKD SHA, është penalizuar nga vendimet e gjykatave në vlerën **4,125,144 lekë**, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 38-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandimi:

Këshilli i Administrimit të analizojë në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbare, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme, si dhe në të ardhmen të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet, që vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi, UKD SHA, edhe pse në stafin e vet ka punonjës saldatorë, ka kryer prokurime për shërbimin e saldimit në 2 raste në vlerën totale 267,600 lekë. Për pasojë vlera **267,600 lekë** përbën **efekt financiar negativ** pasi është përdorur në mungesë të nevojës.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 118-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandim: Nga Këshilli i Administrimit të shqyrtohet vlera **267,600 lekë** e cila përbën efekt financiar negativ për UKD SHA, duke evidentuar përgjegjësitë, si dhe të merren vendimet përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vazhdim

7. Gjetje nga auditimi:



UKD SHA për periudhën objekt auditimi ka kryer pagesa në vlerën totale 5,718,600 lekë në favor të shoqërive përmbareme për ekzekutimin e detyrimeve të 260 debitorëve me një detyrim total 33,460,235 lekë. Shuma e arkëtuar nga ana e shoqërive përmbareme në favor të UKD SHA, është 0.5% e detyrimit total të debitorëve, si dhe 4% e pagesës shtesë që ka paguar shoqëria për fillimin e procedurave përmbareme. Vlera **5,476,440lekë** e cila përfaqëson diferencën ndërmjet tarifave të paguara nga UKD për shoqëritë përmbareme dhe arkëtimit të kësaj nga debitorët, përbën **efekt financiar negativ** për UKD SHA.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 118-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandim: Nga Këshilli i Administrimit të shqyrtohet vlera **5,476,440 lekë**, e cila përfaqëson diferencën ndërmjet tarifave përmbareme të paguara nga UKD dhe arkëtimit të kësaj tarife nga debitorët, pasi kjo vlerë përbën efekt financiar negativ për shoqërinë, si dhe të vlerësojë nëse kjo mënyrë arkëtimi është e përshtatshme për aplikim ose jo në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vazhdim

8. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi me zgjedhje i lëvizjeve të automjeteve, duke i krahasuar me sistemin GPS, u konstatua se lëvizjet e shënuara në fletëudhëtime nuk përputhen me ato të rregjistruara nga sistemi i GPS. Saktësisht u morën në shqyrtim muajt maj 2017 deri janar 2018. Nga grupi i auditimit u përlllogaritën diferencat e kilometrave të shënuara në fletëudhëtime krahasuar me sistemin GPS, dhe më pas u nxorr vlera monetare referuar vlerës së blerjes sipas muajve përkatës.

Sa më sipër, vlera prej **3,635,799lekë**, përbën **efekt financiar negativ** për UKD SHA, pasi në opinion të grupit të auditimit, ky shpenzim nuk është plotësisht i justifikuar.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 19 e në vijim të ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi E. E., si personi i ngarkuar për mbikëqyrjen e harxhimit të karburantit.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 118-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandimi: Nga Titullari i UKD SHA, të shqyrtohet vlera **3,635,799 lekë** e cila përbën efekt financiar negativ për shoqërinë, e ardhur si pasojë e mosrakordimit me sistemin GPS dhe mungesën e kontrollit, si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren masat përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vazhdim

D. MASA ADMINISTRATIVE

D.1. Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, në “Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë”, në “Kontratën Individuale të punës”, si dhe neni 18, pika 1, gërma “I” e Vendimit nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura”, Administratori i shoqërisë të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga:

“Vërejtje me paralajmërim” deri në “Largim nga detyra”, të cilat duhet të jenë në raport me shkeljet e kryera, për personat si më poshtë:



1. Për znj. R. P., me detyrë ish zv. shef i Burimeve Njerëzore dhe aktualisht shefe e Departamentit Juridik, pasi:

- Në një rast, si anëtar i komisionit të shqyrtimit të ankesave, nuk e ka shqyrtuar ankesën në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi me mosveprimet e saj ka sjellë si pasojë vazhdimin e procedurave të prokurimit publik, megjithëse është ndodhur përpara rastit të kërkesave diskriminuese dhe në kundërshtim me LPP.
- Nuk ka plotësuar formularin përkatës mbi deklarinimin e mosndodhjes në kushtet e konfliktit të interesit, në kundërshtim kjo me LPP.
- Për mosrespektim të procedurave ligjore të mbajtjes së protokollit të mbledhjeve kolegjiale.
- Nuk ka bërë ndryshim strukturor të administratës së shoqërisë, si dhe nuk ka specifikuar nivelin dhe profilin arsimor për çdo vend pune.
- Lidhur me punësimet, nuk ka bërë njoftimet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullores së brendshme të institucionit.
- Nuk ka mbajtur dokumentacionin e plotë të dosjeve të të punësuarve, si dhe inventarin përkatës të dokumenteve të secilës dosje.
- Nuk administron rregulla të qarta dhe konkrete për punësimet e reja, si dhe nuk ka bërë asnjë njoftim publik për vendet e reja të punës.
- Vazhdon në mënyrë të përsëritur në shkelje të legjislacionit në fuqi, pavarësisht se edhe në auditimin e mëparshëm është ndëshkuar me masën disiplinore vërejtje me shkrim.

2. Për z. G. S., me detyrë shef i Burimeve Njerëzore, pasi:

- Në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, nuk ka bërë miratim të strukturave përkatëse, si dhe nuk ka përcaktuar numrin e punonjësve për çdo njësi të UKD sh.a., nëpërmjet AP.
- Nuk ka bërë ndryshim strukturor të administratës së shoqërisë, si dhe nuk ka specifikuar nivelin dhe profilin arsimor për çdo vend pune.
- Lidhur me punësimet, nuk ka bërë njoftimet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullores së brendshme të institucionit.
- Nuk ka mbajtur dokumentacionin e plotë të dosjeve të të punësuarve, si dhe inventarin përkatës të dokumenteve të secilës dosje.
- Nuk administron rregulla të qarta dhe konkrete për punësimet e reja, si dhe nuk ka bërë asnjë njoftim publik për vendet e reja të punës.
- Në dy raste, si anëtar i komisionit të shqyrtimit të ankesave, nuk i ka shqyrtuar ankesat në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi me mosveprimet e tij ka sjellë si pasojë vazhdimin e procedurave të prokurimit publik, megjithëse është ndodhur përpara rastit të kërkesave diskriminuese dhe në kundërshtim me LPP.
- Në tre raste, nuk ka plotësuar formularin përkatës mbi deklarinimin e mosndodhjes në kushtet e konfliktit të interesit, në kundërshtim kjo me LPP.
- Në një rast, i ka kthyer përgjigje shoqërisë ankuese në cilësinë e anëtarit të komisionit të shqyrtimit të ankesës duke mos marrë ankesën në shqyrtim, pavarësisht se është ndodhur përpara faktit që specifikimet teknike i përkasin një marke të caktuar, duke mos ndërmarrë asnjë hap ligjor duke u ndodhur përpara një situatë të tillë, në kundërshtim me nenin 23 të LPP.
- Vazhdon në mënyrë të përsëritur në shkelje të legjislacionit në fuqi, pavarësisht se edhe në auditimin e mëparshëm është ndëshkuar me masën disiplinore vërejtje me shkrim.

3. Për znj. A. B., me detyrë juriste pranë drejtorisë së prokurimeve, pasi:



- Në dy raste, si anëtar i komisionit të shqyrtimit të ankesave, nuk i ka shqyrtuar ankesat në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi me mosveprimet e saj ka sjellë si pasojë vazhdimin e procedurave të prokurimit publik, megjithëse është ndodhur përpara rastit të kërkesave diskriminuuese dhe në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik.
- Në raste të përsëritura, nuk ka plotësuar formularin përkatës mbi deklaratën e mosnëndjes në kushtet e konfliktit të interesit, në kundërshtim kjo me LPP, si anëtar i KSHA.
- Në raste të përsëritura, nuk ka deklaruar konfliktin e interesit, duke mos plotësuar formularin përkatës, në cilësinë e anetares së njësisë së prokurimit.
- Ka kryer shkelje të legjislacionit të prokurimit publik, pasi ka hartuar dhe miratuar kërkesa për kualifikim, pa dalë urdhëri i prokurimit.
- Në cilësinë e juristes së njësisë së prokurimit, ka hartuar dhe miratuar kërkesa për kualifikim diskriminuuese, të cilat ulin konkurrencën në prokurim, nuk i vendosin ofertuesit në kushte të barabarta konkurimi dhe vlerësimi, si dhe në kundërshtim me nenin 20, 46 të LPP.
- Në cilësinë e juristes së njësisë së prokurimit, ka mbajtur dy qëndrime lidhur me përcaktimin e kërkesave për kualifikim.
- Në vitin 2017 ka kryer në total blerje të mallrave dhe pajisjeve hidraulike mbi vlerën 800,000 lekë pa TVSH, duke copëzuar fondin, veprim në kundërshtim me nenin 28, pika 2 të ligjit 9643 datë 20.11.2016, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku citohet: “Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj”.
- Nuk dokumenton lidhur me sasitë e prokuruar, sipas procedurës së prokurimit blerje me vlera të vogla.
- Ofertat ekonomike të marra nga operatorë ekonomikë për përlogaritjen e fondit limit janë pa datë, duke krijuar një rezervë mbi saktësinë e vlerave për datën në të cilën kërkohet ajo. Gjithashtu mungesa e datës rrit riskun e përdorimit të këtij dokumenti në procedura të tjera.
- Në cilësinë e juristes së njësisë së prokurimit, nuk ka mbajtur procesverbalin e vendosjes së kërkesave për kualifikim, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës që prokurohet, duke dokumentuar vendosjen e çdo kriteri specifik për kualifikim.
- Në cilësinë e juristes së njësisë së prokurimit, ka hartuar dhe miratuar kërkesa për kualifikim, të ndryshme me ato të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik.

4. Për znj. M. B., me detyrë përgjegjëse sektori, pasi:

- Në cilësinë e anetares së Komisionit të vlerësimit të ofertave, ka bërë vlerësime në kundërshtim me nenin 53/3 të LPP.
- Në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, nuk ka deklaruar mbi konfliktin e interesit, sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, ka hartuar raporte përmbledhëse, duke mos parashikuar të gjithë elementët që duhet të përmbajë ky raport, në kundërshtim me nenin 68 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
- Në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, nuk ka deklaruar se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit me operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender, në cilësinë e anetares së KVO.
- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, ka kualifikuar shoqëri, të cilat nuk plotësojnë kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike.

5. Për z. L.F, me detyrë ish kryetar i Degës Teknike, pasi:



- Në 7 rastet e audituara ku ka qenë anëtar i grupit të marrjes së mallit në dorëzim, ka vepruar në kundërshtim të plotë me kushtet e kontratës së rënë dakort midis palëve dhe specifikimeve teknike, si dhe nuk ka vepruar lidhur me mbajtjen e penaliteteve ndaj kontraktorëve të cilët kanë dorëzuar mallin me vonësë.
- Është personi përgjegjës që ka nënshkruar në të gjitha faturat tatimore të marrjes së mallit në dorëzim, në kundërshtim të plotë me kushtet e kontratës dhe specifikimet teknike, mbi bazën e të cilave janë bërë edhe pagesat përkatëse.
- Ka vepruar në kundërshtim të plotë me legjislacionin e prokurimit publik, si dhe nenin 23 të LPP, mbi hartimin e specifikimeve teknike.
- Në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ka hartuar fonde limite të paargumentuara, ku sasia që prokurohet është e padokumentuar.
- Në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, nuk ka dhënë deklaratat e konfliktit të interesit, në cilësinë e anëtarit të përlllogaritjes së vlerës së fondit limit.
- Vazhdon në mënyrë të përsëritur në shkelje të legjislacionit në fuqi, pavarësisht se edhe në auditimin e mëparshëm është ndëshkuar me masën paralajmërim me shkrim për zgjidhje kontrate.
- Ka nënshkruar në fletëudhëtime të pasakta, duke mos dhënë siguri mbi përdorimin e duhur të mjeteve të shoqërisë UKD.
- Në cilësinë e personit përgjegjës, nuk ka trajtuar në detaje konsumin e karburantit, duke mos dhënë në këtë mënyrë siguri në vërtetësinë e normave të harxhimit.

6. Për z. E. E., me detyrë pranë degës ekonomike, pasi:

- Në rastet e audituara ku ka qenë anëtar i grupit të marrjes së mallit në dorëzim, ka vepruar në kundërshtim të plotë me kushtet e kontratës së rënë dakort midis palëve dhe specifikimeve teknike, si dhe nuk ka vepruar lidhur me mbajtjen e penaliteteve ndaj kontraktorëve të cilët kanë dorëzuar mallin me vonësë.
- Ka marrë mallra në dorëzim, në kundërshtim të plotë me kushtet e kontratës.
- Është personi përgjegjës i ngarkuar nga institucioni për mbikqyrjen e harxhimit të karburantit, ku janë konstatuar shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Në cilësinë e personit përgjegjës, nuk ka trajtuar në detaje konsumin e karburantit, duke mos dhënë në këtë mënyrë siguri në vërtetësinë e normave të harxhimit.
- Vazhdon në mënyrë të përsëritur në shkelje të legjislacionit në fuqi, pavarësisht se edhe në auditimin e mëparshëm është ndëshkuar me masën disiplinore vërejtje me shkrim.
- Në një rast, i ka kthyer përgjigje shoqërisë ankuese në cilësinë e anëtarit të komisionit të shqyrtimit të ankesës duke mos marrë ankesën në shqyrtim, pavarësisht se është ndodhur përpara faktit që specifikimet teknike i përkasin një marke të caktuar, duke mos ndërmarrë asnjë hap ligjor duke u ndodhur përpara një situatë të tillë, në kundërshtim me nenin 23 të LPP.
- Ka nënshkruar në fletëudhëtime të pasakta, duke mos dhënë siguri mbi përdorimin e duhur të mjeteve të shoqërisë UKD.

7. Për z. O.K., me detyrë shef i mirëmbajtjes, pasi:

- Në rastet e audituara ku ka qenë anëtar i grupit të marrjes së mallit në dorëzim, ka vepruar në kundërshtim të plotë me kushtet e kontratës së rënë dakort midis palëve dhe specifikimeve teknike, si dhe nuk ka vepruar lidhur me mbajtjen e penaliteteve ndaj kontraktorëve të cilët kanë dorëzuar mallin me vonësë.



- Ka vepruar në kundërshtim të plotë me legjislacionin e prokurimit publik, si dhe nenin 23 të LPP, mbi hartimin e specifikimeve teknike.
- Në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ka hartuar fonde limite të paargumentuara, ku sasia që prokurohet është e padokumentuar.
- Në kundërshtim me nenin 20, 46 të LPP, nuk ka hartuar kritere specifike për kualifikim sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
- Në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, nuk ka dhënë të detajuara dhe të argumentuara kriteret e veçanta për kualifikim, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit.
- Vazhdon në mënyrë të përsëritur në shkelje të legjislacionit në fuqi, pavarësisht se edhe në auditimin e mëparshëm është ndëshkuar me masën disiplinore paralajmërim me shkrim për zgjidhje kontrate.

8. Për z. D. Sh., me detyrë jurist pranë drejtorisë juridike, pasi:

- Në vitin 2017 ka kryer në total blerje të mallrave dhe pajisjeve hidraulike mbi vlerën 800,000 lekë pa TVSH, duke copëzuar fondin, veprim në kundërshtim me nenin 28, pika 2 të ligjit 9643 datë 20.11.2016, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku citohet: “Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara në këtë ligj”.
- Nuk dokumenton lidhur me sasinë e prokuruar, sipas procedurës së prokurimit blerje me vlera të vogla.
- Ofertat ekonomike të marra nga operatorë ekonomikë për përllogaritjen e fondit limit janë pa datë, duke krijuar një rezervë mbi saktësinë e vlerave për datën në të cilën kërkohet ajo. Gjithashtu mungesa e datës rrit riskun e përdorimit të këtij dokumenti në procedura të tjera.
- Vazhdon në mënyrë të përsëritur në shkelje të legjislacionit në fuqi, pavarësisht se edhe në auditimin e mëparshëm është ndëshkuar me masën disiplinore paralajmërim me shkrim për zgjidhje kontrate.

9. Për znj. D. B., me detyrë specialiste pranë drejtorisë së prokurimeve, pasi:

- Në raste të përsëritura, nuk ka deklaruar konfliktin e interesit, duke mos plotësuar formularin përkatës, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit.
- Në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, ka hartuar dhe miratuar kërkesa për kualifikim diskriminuese, të cilat ulin konkurrencën në prokurim, nuk i vendosin ofertuesit në kushte të barabarta konkurimi dhe vlerësimi, si dhe në kundërshtim me nenin 20, 46 të LPP.
- Ka kryer shkelje të legjislacionit të prokurimit publik, pasi ka hartuar dhe miratuar kërkesa për kualifikim, pa dalë urdhëri i prokurimit, ka mbajtur dy qëndrime në lidhje me kërkesat për kualifikim për xhiron, si dhe ka hartuar dhe miratuar kërkesa për kualifikim, të ndryshme me ato të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik.

10. Për z. K. L., me detyrë shef i mbledhjes së debive, pasi:

- Për shkelje të legjislacionit në fuqi, si dhe mos respektim të afatit të njoftimit të konsumatorëve për ndërprerje të furnizimit me ujë, si dhe për mos furnizimin e banorëve me minimumin jetik të tyre, në kundërshtim me Kodin e Ujit dhe Konventës Europiane të të drejtave të njeriut.

11. Për z. I. K., me detyrë specialist i degës teknike, pasi:

- Në raste të përsëritura, ku ka qenë anëtar i grupit të marrjes së mallit në dorëzim, ka vepruar në kundërshtim të plotë me kushtet e kontratës së rënë dakort midis palëve dhe specifikimeve



teknike, si dhe nuk ka vepruar lidhur me mbajtjen e penaliteteve ndaj kontraktorëve të cilët kanë dorëzuar mallin me vonesë, në kundërshtim me nenet 59,60 të LPP, dokumentet e tenderit dhe kontratat e nënshkuara midis palëve.

12. Për znj. T. S., me detyrë juriste e Drejtorisë Juridike, pasi:

- Në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, ka hartuar dhe miratuar kërkesa për kualifikim diskriminuese, të cilat ulin konkurrencën në prokurim, nuk i vendosin ofertuesit në kushte të barabarta konkurimi dhe vlerësimi, si dhe në kundërshtim me nenin 20, 46 të LPP.
- Në raste të përsëritura, nuk ka deklaruar konfliktin e interesit, duke mos plotësuar formularin përkatës, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit.
- Në një rast, i ka kthyer përgjigje shoqërisë ankuese në cilësinë e anëtarit të komisionit të shqyrtimit të ankesës duke mos marrë ankesën në shqyrtim, pavarësisht se është ndodhur përpara faktit që specifikimet teknike i përkasin një marke të caktuar, duke mos ndërmarrë asnjë hap ligjor duke u ndodhur përpara një situatë të tillë, në kundërshtim me nenin 23 të LPP.
- Nuk ka plotësuar formularin përkatës mbi deklarimin e mosndodhjes në kushtet e konfliktit të interesit, në kundërshtim kjo me LPP.

13. Për z. A.Zh., në cilësinë e ish Drejtorit Teknik, pasi:

- Në rastet e audituara ku ka qenë anëtar i grupit të marrjes së mallit në dorëzim, ka vepruar në kundërshtim të plotë me kushtet e kontratës së rënë dakort midis palëve dhe specifikimeve teknike, si dhe nuk ka vepruar lidhur me mbajtjen e penaliteteve ndaj kontraktorëve të cilët kanë dorëzuar mallin me vonesë.
- Ka vepruar në kundërshtim të plotë me legjislacionin e prokurimit publik, si dhe nenin 23 të LPP, mbi hartimin e specifikimeve teknike.
- Në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ka hartuar fonde limite të paargumentuara, ku sasia që prokurohet është e padokumentuar.
- Në kundërshtim me nenin 20, 46 të LPP, nuk ka hartuar kritere specifike për kualifikim sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

14. Për z. S. K., me detyrë shef i IT, pasi:

- Ka vepruar në kundërshtim të plotë me legjislacionin e prokurimit publik, si dhe nenin 23 të LPP, mbi hartimin e specifikimeve teknike.
- Në një rast, specifikimet teknike të hartuara i përkasin një marke të caktuar, duke mos ndërmarrë asnjë hap ligjor duke u ndodhur përpara një situatë të tillë, në kundërshtim me nenin 23 të LPP.
- Ka hartuar vlera të fondit limit, në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
- Ka vepruar në kundërshtim të plotë me kushtet e kontratës së rënë dakort midis palëve dhe specifikimeve teknike, si dhe nuk ka vepruar lidhur me mbajtjen e penaliteteve ndaj kontraktorëve të cilët kanë dorëzuar mallin me vonesë.

15. Për z. M. U., me detyrë specialist i IT, pasi:

- Ka vepruar në kundërshtim të plotë me legjislacionin e prokurimit publik, si dhe nenin 23 të LPP, mbi hartimin e specifikimeve teknike.



- Në një rast, specifikimet teknike të hartuara i përkasin një marke të caktuar, duke mos ndërmarrë asnjë hap ligjor duke u ndodhur përpara një situatë të tillë, në kundërshtim me nenin 23 të LPP.
- Ka hartuar vlera të fondit limit, në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
- Ka vepruar në kundërshtim të plotë me kushtet e kontratës së rënë dakort midis palëve dhe specifikimeve teknike, si dhe nuk ka vepruar lidhur me mbajtjen e penalteteve ndaj kontraktorëve të cilët kanë dorëzuar mallin me vonesë.

16. Për z. B. M., me detyrë shef i sektorit të kanalizimeve, pasi:

- Ka vepruar në kundërshtim të plotë me kushtet e kontratës së rënë dakort midis palëve dhe specifikimeve teknike, si dhe nuk ka vepruar lidhur me mbajtjen e penalteteve ndaj kontraktorëve të cilët kanë dorëzuar mallin me vonesë.
- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, ka hartuar dhe miratuar kërkesa për kualifikim diskriminuese, të cilat ulin konkurrencën në prokurim, nuk i vendosin ofertuesit në kushte të barabarta konkurimi dhe vlerësimi, si dhe në kundërshtim me nenin 20, 46 të LPP.
- Ka hartuar dhe miratuar kërkesa për kualifikim, të ndryshme me ato të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik.

17. Për znj. D. Sh., me detyrë specialiste e degës teknike, pasi:

- Në cilësinë e anëtares së KVO, ka vlerësuar në kundërshtim me nenin 53/3 të LPP.
- Në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, nuk ka plotësuar deklaratën e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës.
- Ka vepruar në kundërshtim të plotë me kushtet e kontratës së rënë dakort midis palëve dhe specifikimeve teknike, si dhe nuk ka vepruar lidhur me mbajtjen e penalteteve ndaj kontraktorëve të cilët kanë dorëzuar mallin me vonesë.

18. Për z. G.D, me detyrën e Drejtorit Teknik, pasi:

- Në cilësinë e anëtarit të KVO, nuk ka plotësuar saktë formularin mbi konfliktin e interesit, në cilësinë e anëtarit të KVO ka vlerësuar në kundërshtim me LPP, si dhe ka hartuar raporte përmbledhëse në kundërshtim me nenin 68 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
- Ka vepruar në kundërshtim të plotë me kushtet e kontratës së rënë dakort midis palëve dhe specifikimeve teknike, si dhe nuk ka vepruar lidhur me mbajtjen e penalteteve ndaj kontraktorëve të cilët kanë dorëzuar mallin me vonesë.

19. Për znj. A. H., me detyrë Drejtor i departamentit të financës, pasi:

- Ka bërë miratimet dhe pagesat përkatëse për kontrata, në të cilat malli është dorëzuar me vonesë, si dhe nuk janë mbajtur penaltetet përkatëse.

D.2. MASA ADMINISTRATIVE PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për ish punonjësit e mëposhtëm, nuk rekomandojmë masë disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla,



pasi personi nuk është në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë, në bazë të shkeljeve të konstatuara, masa disiplinore do të **nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”**, përkatësisht:

1. **Z. A. I.**, në cilësinë e ish Drejtorit Juridik.
2. **Znj. S. R.**, në cilësinë e ish magazinieres së shoqërisë.
3. **Znj. J. V.**, në cilësinë e specialistes së prokurimeve.
4. **Znj. D. H.**, në cilësinë e specialistes së prokurimeve.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim, ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja.

IV. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Konkluzion:

Nga auditimi i përputhshmërisë mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin UKD SHA, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), efektet e të cilave justifikojnë dhënie opinionit të kualifikuar.

Nga auditimi me përzgjedhje sipas kriterit të vlerës ekonomike, numrit të operatorëve ekonomik pjesëmarrës dhe fushave me risk më të lartë, u audituan rreth 45% e procedurave në vlerë dhe rreth 34% në numër, kryesisht mbi realizimin dhe zbatimin e kontratave sipas zhvillimit të procedurave të prokurimit publik është konstatuar dëm ekonomik në vlerën 12,246,176 lekë, si dhe efekt negativ financiar në vlerën 25,284,710 lekë.

OPINIONI I AUDITIMIT

Baza për opinionin e auditimit mbi përputhshmërinë të veprimtarisë së shoqërisë UKD SHA, është mbështetur në: ligjin nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së; Standardet Ndërkombëtare të auditimit "ISSAI 400"; Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga shoqëria UKD SHA të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe konsistojnë:

Në drejtim të hartimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit jo në përputhje me ligjin "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", në drejtim të prokurimit publik jo në përputhje me ligjet që rregullojnë fushën e prokurimeve publike; ligjit "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", VKM nr. 63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura".



Përgjegjësitë e menaxhimit të shoqërisë UKD SHA janë:

Hartimi, ekzekutimi, monitorimi dhe raportimi i buxheteve të shoqërisë në përputhje me rregullat e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm publik, realizimi i prokurimeve publike në përputhje me rregullat dhe ligjet e prokurimeve publike, hartimi dhe përmirësimi i rregullave të brendshme që rregullojnë veprimtarinë e UKD SHA për përdorimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve buxhetore.

Përgjegjësitë e audituesit janë:

Grupi i auditimit ka kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik, ISSAI 400 dhe 4100. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë”, pjesë e raportit tonë. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura me siguri të arsyeshme, por nuk garantojmë që auditimi i kryer në përputhje me këto standarde mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mundë të ekzistojë. Gjithashtu, besojmë se, dëshmitë dhe evidencat e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat e arsyeshme për arritjen në opinionin e auditimit.

Opinionin e auditimit:

Baza për konkluzionin/opinionin mbi përputhshmërinë (ISSAI 400¹ dhe 4100²):

Nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, mbështetur në Standardet ndërkombëtare të auditimit, ISSAI 400 dhe 4100, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin UKD SHA, u konstatuan devijime dhe shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësishme materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e opinionit të kualifikuar.

V. ANEKSE

1. Shkurtime

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
KM	Këshilli Mbikqyrës
SHA	Shoqëri aksionare
SHPK	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
NJP	Njësia e Prokurimit

¹ISSAI 400(Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë.

²ISSAI 4100“Udhëzimet për auditimin e përputhshmërisë për auditimet që kryhen veçmas nga auditimi i pasqyrave financiare”



AK	Autoriteti Kontraktor
DT	Dokumentet e Tenderit
LPP	Ligji i prokurimit publik
RRPP	Rregullat e prokurimit publik
FL	Fondi limit
DST	Dokumentet Standarte të tenderit
AP	Asambleja e Përgjithshme
KA	Këshilli i Administrimit

VI. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

Akt Konstatimi nr. 1, datë 28.12.2018 “Mbi realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm”.

Akt Konstatimi nr. 2, datë 28.12.2018 “Programet ekonomiko financiare për vitet 2017 dhe 2018”.

Akt Konstatimi nr. 3, datë 28.12.2018 “Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese”.

Akt Konstatimi nr. 4, datë 28.12.2018 “Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi dhe dhënien e pagave dhe shpërblimeve”.

Akt Konstatimi nr. 5, datë 28.12.2018 “Mbi mbajtjen e evidencës kontabël, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, evidentimin, ndjekjen dhe pasqyrimin e debitorëve dhe kreditorëve, si dhe përlllogaritjen, njohjen, regjistrimin dhe pagesën e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore”.

Akt Konstatimi nr. 6, datë 28.12.2018 “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimin e kontratave”.

Akt Konstatimi nr. 7, datë 28.12.2018 “Mbi auditimin me zgjedhje të pagesave të kryera me anë të arkës dhe bankës, shpenzimeve administrative dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve me vlerë të vogël”.

Akt Konstatimi nr. 8, datë 28.12.2018 “Mbi zbatimin e ligjshmërisë në organizimin e menaxhimit financiar, sistemit të kontrollit të brendshëm”.

Akt Konstatimi nr. 9, datë 28.12.2018 “Mbi cilësinë e ujit të pijshëm”.

Akt Konstatimi nr. 10, datë 28.12.2018 “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimin e kontratave”.

Akt Konstatimi nr. 11, datë 28.12.2018 “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimin e kontratave”.

Akt Konstatimi nr. 12, datë 28.12.2018 “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimin e kontratave”.

Akt Konstatimi nr. 13, datë 28.12.2018 “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimin e kontratave”.

Akt Konstatimi nr. 14, datë 28.12.2018 “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimin e kontratave”.

Akt Konstatimi nr. 15, datë 28.12.2018 “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimin e kontratave”.

Akt Konstatimi nr. 16, datë 28.12.2018 “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimin e kontratave”.



Akt Konstatimi nr. 17, datë 28.12.2018 “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimit e kontratave”.

Akt Konstatimi nr. 18, datë 28.12.2018 “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimit e kontratave”.

Akt Konstatimi nr. 19, datë 28.12.2018 “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimit e kontratave”.

Akt Konstatimi nr. 20, datë 28.12.2018 “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimit e kontratave”.

Akt Konstatimi nr. 21, datë 28.12.2018 “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimit e kontratave”.

Akt Konstatimi nr. 22, datë 28.12.2018 “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimit e kontratave”.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

E.GJ.

B.D.

I.H.

A. R.

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

Y. P.